REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI
I PRAKTIKËS GJYQËSORE

Vëllimi I

Botues:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Bordi redaktues:

Znj. Arta Rama-Hajrizi, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës
Prof. Dr. Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës
Almiro Rodrigues, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës
Prof.Dr. Snezhana Botusharova, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës
Milot Vokshi, Sekretar i Përgjithshme e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës
Njësia Ligjore, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Kontribuesit:

Z. Malte Kirchner , Menaxher i projektit, GIZ
Znj. Pranvera Ejupi- Hajzeraj, Kordinatore e projektit, GIZ
Z. Lavdim Krasniqi, Ekspert Ligjor
Premium Consulting

© 2015 Gjykata Kushtetuese e Kosovës

Të drejtat e autorit:

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetesh, elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin dhe incizimin, apo ruajtjen në sisteme ripërdorimi, pa lejen paraprake me shkrim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, përveç nëse një kopjim i tillë në mënyrë të qartë lejohet nga ligji përkatës për të drejtat e autorit.

Përjashtim i përgjegjësisë:

Sipas nenit 116.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, e cila është burim primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ky Buletin nuk zëvendëson burimin primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në rast të ndonjë konflikti apo mospërputhje në mes të vendimeve të botuara në këtë Buletin dhe vendimeve të botuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mbizotëron versioni i botuar në Gazetën Zyrtare.

Qëllimi i përmbledhjes së vendimeve është për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme faktike dhe juridike të rasteve dhe një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Përmbledhja e vendimeve dhe aktgjykimeve është përpiluar nga "Projekti për Reformë Juridike" implementuar nga Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ), dhe si i tillë, nuk zëvendëson vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe nuk përfaqësojnë formulimin e vërtetë të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Published by giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

BULETINI
I PRAKTIKËS GJYQËSORE

Vëllimi I

I GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Ky Buletin është mundësuar nga " Projekti për Reformë Juridike" implementuar nga Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, nën mbështetjen e Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

Tabela e përmbajtjes

Parathënie 11

Nr.1. KI105/14, Parashtrues i kërkesës Ramiz Ukaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, KMLC nr. 45/14, të 2 qershorit 2014 13

Nr.2. KI123/14, Parashtruesja e kërkesës Lalushe Boneshta, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 123/2014, të 19 qershorit 2014 20

Nr.3. KI126/14, Parashtrues i kërkesës Vebi Tahiri, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2109/2013, të 16 dhjetorit 2013 27

Nr.4. KI143/14, Parashtrues i kërkesës Ferbend Haxhiaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 26/2012, të 16 shtatorit 2013 33

Nr.5. KI114/14, Parashtrues i kërkesës Adem Hoti, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 127/2014, të 12 majit 2014 39

Nr.6. KI70/14, Parashtrues i kërkesës Ahmet Arifaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit Komunal të Klinës, Nr. 351-3187/08, të 22 shtatorit 2008 47

Nr.7. KI141/14, Parashtrues i kërkesës Rrahim Ramadani, Vlerësim i kushtetushmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ca. nr. 2862/2014, të 26 gushtit 2014 53

Nr.8. KI111/14, Parashtrues të kërkesës Mladen Denić dhe Milorad Vitković-Denić, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I.-13-0041, të 5 qershorit 201461

Nr.9. KI116/14, Parashtrues i kërkesës Fadil Selmanaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA nr. 294/2013, të 4 shkurtit 2014 78

Nr.10. KI51/14, Parashtrues i kërkesës Radomir Radosavljević, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 301/2013, të 17 dhjetorit 2013 88

Nr.11. KI96/14, Parashtrues Istref Veliçi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për lojëra të fatit, Nr.04/L-080, të 6 prillit 2012 98

Nr.12. KI138/14, Parashtrues Majda Fazli-Neziri, Kërkesë për dhënien e mendimit të Gjykatës lidhur me mundësinë e punësimit me titullin e fituar akademik master 105

Nr.13. KI72/14, Parashtruese e kërkesës Besa Qirezi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 712/2013, të 21 tetorit 2013 110

Nr.14. KI60/14, Parashtrues Tomë Krasniqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 35/2014, të 12 shkurtit 2014 130

Nr.15. KI91/14, Parashtrues Rexhep Sagdati, Vlerësim i kushtetutshmërisë i Aktgjykimit, nr. AC-I-12-0115, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i 25 prillit 2013 140

Nr.16. KI102/14, Parashtrues Arben Ademi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës se Kosovës, Pkl. nr. 150/2012, të 30 janarit 2013 147

Nr.17. KI129/14, Parashtrues Faik Azemi, Vlerësim i kushtetutshmërisë i Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 270/2013, i 4 shkurtit 2014 153

Nr.18. KI128/14, Parashtrues Fillim Guga, Vlerësim kushtetutshmërisë i Aktgjykimit ASC-ll-0073 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 24 korrikut 2014 160

Nr.19. KI133/14, Parashtrues Xhelil Neziri, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr.253/2012, i 7 majit 2013, dhe Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CPP. nr. 3/2014, i 3 qershorit 2014 168

Nr.20. KI140/14, Parashtrues Abdurrahman Nazifi, Vlerësim kushtetutshmërisë së Aktvendimit KP. nr. 416/2014 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, KP. nr. 416/2014, të 10 qershorit 2014 177

Nr.21. KI148/14, Parashtrues Driton Kelmendi, Vlerësim i kushtetutshmërisë i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PML. nr. 101/2014, të 6 qershorit 2014 183

Nr.22. KI77/14, Parashtrues Alban Rexha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr.1/2010, i 3 dhjetorit 2010 191

Nr.23. KI87/14, Parashtrues Ismail Guri, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, KMLC. Nr. 7/14, i 10 shkurtit 2014 199

Nr.24. KI130/14, Parashtrues Fidan Hyseni, Vlerësim kushtetutshmërisë i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr.107/2014, i 30 majit 2014 210

Nr.25. KI80/14 dhe KI93/14, Parashtrues Gazmend Musollaj dhe Nezir Kerrellaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr.166/13, i 6 nëntorit 2013 218

Nr.26. KI97/14, Parashtrues Velibor Jokić, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr. 610/13, i 23 tetorit 2013 225

Nr.27. KI112/14, Parashtrues Srboljub Krstić, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 63/2014 i 3 prillit 2014 235

Nr.28. KI122/14, Parashtrues Adem Berisha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht, Plk. nr. 72/14, i 19 qershorit 2014 242

Nr.29. KI147/14, Parashtrues Avni Ejupi, Vlerësim i kushtetutshmërisë i Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr.81/2014, i 16 Korrikut 2014 251

Nr.30. KI136/14, Parashtrues Abdullah Bajqinca, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 99/2014, i 12 majit 2014 258

Nr.31. KI145/14, Parashtrues Behxhet Mustafa, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Themelore në Prishtinë, A. nr. 1780/14, i 12 shtatorit 2014 266

Nr.32. KI161/14, Parashtrues Mursel Izeti, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 99/2014, i 10 qershorit 2014 270

Nr.33. KI109/14, Parashtrues Ahmet Krasniqi et al., Vlerësim i kushtetutshmërisë së konkluzionit të Kuvendit bazuar në transkriptin e seancës plenare të 10, 11 dhe 17 prillit 2014. 278

Nr.34. KO13/15, Kuvendi i Republikës së Kosovës, vlerësimi i një amendamenti të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga pesëdhjetë e pesë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe të referuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 6 shkurt 2015 me shkresën nr. 05-259/D0-179. 288

Nr.35. KI137/14, Parashtrues Shpejtim Ademaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 194/2013, i 2 prillit 2014. 303

Nr.36. KI162/14, Parashtrues Shefki Hyseni, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 165/14, të 27 gushtit 2014. 313

Nr.37. KI118/14, Parashtrues Raiffeisen Bank Kosovo J. S. C, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 24/2013, të 5 shkurtit 2014. 320

Nr.38. KI182/14, Parashtrues INTERPRESS R. COMPANY/Ruzhdi Kadriu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. MIc. nr. 22/2014, i 15 korrikut 2014. 339

Nr.39. KI120/14, Parashtrues Agjencia Kosovare e Privatizimit, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, II. C. nr. 79/2009, të 27 tetorit 2009 dhe të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. Nr. 45/2012, të 20 majit 2013. 352

Nr.40. KI158/14, Parashtrues Bahri Veseli, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 153/2014, të 4 gushtit 2014, Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR.nr.314/2013, të 29 prillit 2014 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Pn.nr.17/2013, të 7 majit 2013 359

Nr.41. KI186/14, Parashtrues Sahit Kurti, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 153/2014, të 17 qershorit 2014 366

Nr.42. KI26/14, Parashtrues Bajrush Gashi, Vlerësim i kërkesës për rishqyrtim të Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese KI75/13, të 29 janarit 2013 373

Nr.43. KI64/14, Parashtrues Afrim Nuredini, Vlerësim i kushtetutshmërisë së listës së punëtorëve me të drejtë të kompensimit, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. nr. 340/2001, të 11 janarit 2002, me të cilin ishte aprovuar kërkesa për kompensim të pagave të papaguara të 572 punëtorëve të ndërmarrjes shoqërore të Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK 379

Nr.44. KI89/14, Parashtrues Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Pyjore e Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 287/2013, të 18 dhjetorit 2013..... 385

Nr.45. KI127/14, Parashtrues Agron Latifaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 57/2014, të 25 marsit 2014 .. 395

Nr.46. KI183/14, Parashtrues Ilir Berisha, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Njoftimit të Komisionit për Emërim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ref. ZVVGJ/0389/14, të 22 shtatorit 2014..... 403

Nr.47. KO26/15, Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës me shkresën nr. 05-433/DO-318 409

Nr.48. KI159/14, Parashtrues Elife Murseli, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1235/2014, të 5 majit 2014 432

Nr.49. KK109/15 Zbatimi i Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Rastin KI99/14 dhe KI100/14, të 8 korrikut 2014 442

Nr.50. KO22/15, Parashtrues i kërkesës Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, Kërkesë për rishqyrtimin e rastit KO155/14 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 13 nëntorit 2014 444

Nr.51. KO22/15, Parashtrues i kërkesës Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, Kërkesë për përjashtim të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës 458

Nr.52. KI175/14, Parashtrues Sylejman (Daut) Dibra, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0095-A0001-A0005, i 20 majit 2014 462

Nr.53. KI160/14, Parashtrues Ejup Jakupi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr. 215/2014, të 1 shtatorit 2014 467

Nr.54. KI149/14, 150/14 , 151/14, Parashtrues Liridon Aliu, kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së punës të disa institucioneve në Republikën e Kosovës 474

Nr.55. KI02/15, Parashtrues Qendra shoqërore, kulturore, sportive, ekonomike "Pallati i Rinisë", Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-1-14-0077-AOOOI, AC-I-14-0078-AOOOI, AC-1-14-0079-AOOOI dhe AC-I-14-0080-AOOOI, të 15 shtatorit 2014 479

Nr.56. KI166/14, Parashtrues Mentor Paqak , Kërkesë për rishqyrtim të lëndës KI 78/14 489

Nr.57. KI171/14, Parashtrues Agim Vuniqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale/ Departamentit të Pensioneve, Nr. 919, i 24 tetorit 2014 494

Nr.58. KI157/14, Parashtrues Hajriz Alidemaj, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 1579/2014, të 8 shtatorit 2014 499

Nr.59. KI178/14, Parashtrues Xufe Racaj, Kërkesë për përmirësimin e Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Rastin KI107/14, të 26 nëntorit 2014. 505

Nr.60. KI164/14, Parashtrues Shpëtim Halimi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. Nr. 223/2014, të 1 shtatorit 2014 511

Nr.61. KI169/14, Parashtrues Osman Osmanaj, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 124/2014, i 2 korrikut 2014 .519

Nr.62. KI176/14, Parashtrues Sekule Stanković, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 233/2014, i 3 shtatorit 2014. 527

Nr.63. KI03/15, Parashtrues Hasan Beqiri, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, API-KZI nr. 2/2011 , të 25 majit 2012.534

Indeksi i shprehjeve ligjore 540

Indeksi i neneve të kushtetutës..... 556

Parathënie

Në vazhdimësinë e punës vendimmarrëse të Gjykatës Kushtetuese, e cila vite me radhë ka botuar Buletinin e Praktikës Gjyqësore, është kënaqësi imja që, në cilësinë e kryetares së re, të shkruaj këtë parathënie në Buletinin e Praktikës Gjyqësore të vitit 2015 të Gjykatës Kushtetuese, si publikim i pestë i këtij lloji që nga themelimi i Gjykatës. Për punën e shkëlqyeshme dhe për përkushtimin e madh në përgatitjen e këtij buletini, falënderoj përzemërsisht Sekretariatin dhe Njësinë Ligjore të Gjykatës. Ashtu sikurse publikimi i Buletinit për vitin 2014, edhe publikimi i këtij buletini është mundësuar falë një donacioni zemërgjerë të Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) për çka Gjykata është shumë falënderuese.

Ky buletin përmban një numër të rasteve më të veçuara dhe të rëndësishme, duke përfshirë kërkesën për kontrollin kushtetues preventiv të vlerësimit të amendamenteve kushtetuese të propozuara nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës përkitazi me themelimin e Dhomave të Specializuara të gjyqësorit dhe të Prokurorisë, si dhe kërkesën për përfaqësim gjinor në postet e ministrave dhe të zëvendësministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Nga Gjykata kërkohej që të konfirmojë se amendamentet e propozuara nuk pakësonin të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës. Gjykata po ashtu ka nxjerrë dhe dy vendime të tjera të rëndësishme që ndërlidhen me kërkesat individuale ku, nga pikëpamja e gjyqësisë kushtetuese, janë trajtuar çështje të sistemit bankar kosovar dhe çështje të të drejtave që burojnë nga marrëdhëniet e punës.

Nuk është e tepërt të theksohet se sa është e rëndësishme që parashtruesit e ardhshëm dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, të cilët synojnë të dorëzojnë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duhet që, duke përdorur këtë dhe buletinet e mëparshme, të konsultojnë me vëmendje vendimet e Gjykatës në rastet e ngjashme dhe të marrin parasysh nëse rasti i tyre mund të ketë ndonjë mundësi suksesi në dritën e rasteve të ngjashme. Duhet kuptuar qartë që, parimisht, e drejta e ankesës nuk mund t'i mohohet asnjë parashtruesi, por do të ishte më mirë që paraprakisht të njoftoheshin me jurisprudencën e Gjykatës dhe të kenë vlerësim objektiv për suksesin e kërkesës së tyre.

Qëllimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës në Buletin është t'i tregohet opinionit të gjerë se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese marrin vendimet e tyre në mënyrë të pavarur dhe plotësisht transparente, duke zbatuar standardet më të larta të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë kushtetuese.

Arta Rama-Hajrizi
Kryetare e Gjykatës Kushtetuese

KI105/14, Parashtrues i kërkesës Ramiz Ukaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, KMLC nr. 45/14, të 2 qershorit 2014

KI 105/14, Aktvendim për papranueshmëri, i 9 dhjetorit 2014, publikuar më 14 janar 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Themelore në Pejë me Aktvendimin CN. nr. 79/14 urdhëroi Zyrën Kadastrale në Istog ta kthejë ngastrën kontestuese të tokës në gjendjen e saj të mëparshme, sepse konsideronte se parashtruesi i kërkesë kishte tërhequr padinë e tij.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi, *inter alia*, se Gjykata Themelore në Pejë kishte shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, sepse atij nuk i ishte dhënë e drejta e ankesës.

Gjykata Kushtetuese konsideroi se parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar kërkesën e tij mbi baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar asnjë dëshmi se të drejtat dhe liritë e tij themelore janë shkelur nga gjykatat e rregullta. Për më tepër, Gjykata vërejti se parashtruesi e dorëzoi kërkesën kundër Prokurorit të Shtetit, por ankesat e tij ishin të drejtuara kundër Gjykatës Themelore në Pejë. Kërkesa e parashtruesit u deklarua e papranueshme si qartazi e pabazuar, siç parashihet me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së Punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI105/14
Parashtrues
Ramiz Ukaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, KMLC nr. 45/14, të 2 qershorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar,
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Ramiz Ukaj, me vendbanim në fshatin Zallq, komuna e Istogut (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga z. Xhafer Maloku.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Njoftimin e Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, KMLC nr. 45/14, të 2 qershorit 2014, (në tekstin e mëtejmë: Prokurori i Shtetit), i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 11 qershor 2014, me të cilin refuzohej kërkesa e parashtruesit drejtuar Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës, pretendon se njoftimi i mësipërm, i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 32 [E Drejta për Mjete

Juridike], neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 7 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI105/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI105/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 4 shtator 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Në një datë të pacaktuar në vitin 2004, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi civile në Gjykatën Komunale në Istog, kundër individëve N. U. dhe A. U. "*që të vërtetohet se i njëjti është pronar i vetëm i ngastrës e cila evidentohet si ngastër kadastrale nr. 523/5 nga fletë posedimi nr. 350 Z. K. Zallq*".

10. Më 9 shtator 2005, Gjykata Komunale në Istog nxori Aktgjykimin C. nr. 108/04, *"aprovohet kërkesë padia e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetohet se është pronar i vetëm i të drejtave pronësore mbi ngastrën e lartcekur të tokës ... detyrohen të padituri N. U. dhe A. U. ta rivendosin derën e oborrit prej hekurit, të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, e cila ishte hequr-rrëzuar më parë nga ta... dhe t'i paguajnë shpenzimet procedurale..."*.

11. Brenda afatit të paraparë ligjor, të padituri N. U. dhe A. U. ushtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë kundër Aktgjykimit C. nr. 108/04, të 9 shtatorit 2005.

12. Më 13 nëntor 2006, Gjykata e Qarkut në Pejë nxori Aktgjykimin. AC. nr. 243/06, duke aprovuar ankesën e të paditurve për të rivendosur portën e hekurit dhe shpenzimet e procedurës, por refuzoi ankesën e tyre në lidhje me vërtetimin e pronësisë, duke e kthyer rastin për rigjykim nga Gjykata Komunale në Istog.

13. Në një datë të pacaktuar gjatë vitit 2007, të paditurit N. U. dhe A. U. kërkuan mjetin e jashtëzakonshëm juridik të revizionit në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit AC. nr. 243/06, të 13 nëntorit 2006.

14. Më 14 prill 2009, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin 45/2007, me të cilin aprovoi revizionin dhe prishi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Istog C. nr. 108/04 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, AC. nr. 243/06, duke theksuar që *"Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani nuk mund të pranojë një qëndrim të tillë juridik të gjykatave të instancës më të ulët, nga se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimet e të dy gjykatave janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ai i gjykatës së shkallës së parë me shkelje të parapara nga neni 354 par. 2 pika 14 të LPK, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelej të parapara nga neni 354 par. 1 lidhur me nenin 365 par. 2 të LPK, për të cilat arsye është dashur që si të tilla të prishen".*

15. Në Aktvendimin e saj, Gjykata Supreme e ktheu rastin në Gjykatën Komunale në Istog duke theksuar që *"Gjykata e shkallës së parë në rigjykim është e detyruar t'i mënjanojë të metat e sipër përmendura, të urdhërojë paditësit ta precizoj bazën e kërkesëpadisë, nëse me padi kërkohet ndërprerja e servitutit (nëse ekziston), anulimin e marrëveshjes e lidhur më 12.04.1996 (në të cilën mbështeten aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët), apo me padi kërkohet që të vërtetohet pronësia në paluajtshmërinë , të caktojë ekspertizën lidhur me historiatin e paluajtshmërisë, sepse prej ekspertizës që gjindet në shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohen te gjitha elementet lidhur me këto fakte".*

16. Më 23 maj 2011, Gjykata Komunale në Istog, nxori Aktvendimin C. nr. 119/09, me të cilin, siç kërkohet nga Gjykata Supreme, urdhëroi parashtruesin e kërkesës, që në përputhje me nenin 102.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të specifikojë bazën juridike të kërkesëpadisë brenda 3 (tri) ditëve.

17. Parashtruesi i kërkesës nuk iu përgjigj këtij urdhri të Gjykatës Komunale.

18. Më 16 prill 2014, Gjykata Themelore në Pejë, si gjykatë kompetente pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr. 03/L-199), nxori Aktvendimin CN. nr. 79/14, me të cilin urdhëroi Drejtorinë e Kadastrit - Zyra Kadastrale në Istog, në përputhje me Aktvendimin C. nr. 119/09 të 23 majit 2011, për ta regjistruar ngastrën e tokës siç ishte para fillimit të procedurës juridike, pasi që gjykata konsideronte se parashtruesi kishte tërhequr padinë.

19. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi parashtroi kërkesë në Zyrën e Prokurorit të Shtetit, për inicimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, si mjet i jashtëzakonshëm juridik.

20. Më 2 qershor 2014, Prokurori nxori Njoftimin KMLC nr. 45/14, me të cilin u refuzua kërkesa e parashtruesit, pasi që *"vendimi i kundërshtuar nuk është marr në procedurën kontestimore dhe në procedurën jokontestimore dhe as në procedurën përmbarimore, dhe nuk është vendosur lidhur me kërkesat e palëve, në themelin e kërkesëpadisë, por thjesht kemi të bëjmë me një urdhëresë administrative që është marr nga organi i administratës gjyqësore, që nënkupton se vendimi i kundërshtuar nuk e ka cilësinë e vendimit gjyqësor të formës së prerë siç kërkohet me dispozitën e nenit 245.1 te LPK-ës, kundër të të cilit mund të ushtrohet mjet i jashtëzakonshëm juridik, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*Duke mos i dhënë palës së dëmtuar Ramiz Ukaj të drejtë ankimi kundër aktvendimit Cn. nr. 79/14 të 16.04.2014, Kryetarja e Gjykatës ka bërë shkeljen e nenit 21, 24, 31, 32, 53 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës."*

22. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që *"... të konstatohet se me aktvendimin e Kryetares së Gjykatës Themelore në Pejë CN. nr. 79/14, të 16.04.2014, duke mos iu dhënë e drejta e Ramiz Ukaj, si palë të drejtat e të cilit janë cenuar me atë aktvendim, për tu ankuar, janë cenuar të drejtat e tij të njeriut që të jetë palë e barabartë në një gjykim si dhe ta ketë një gjykim të drejt dhe dinjitoz".*

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 117. 3 të Kushtetutës, i cili përcakton se:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterrur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

25. Gjykata merr parasysh edhe rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(1) "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> > *[...], ose*
> >
> > *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese,*
> >
> > *[...], or*
> >
> > *(d) kur parashtruesi nuk dështon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

26. Pavarësisht nga fakti se parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën kundër Njoftimit të Prokurorit të Shtetit KMLC nr. 45/14, të nxjerrë më 2 qershor 2014, ankesat e ngritura në kërkesë janë të drejtuara ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore CN. nr. 79/14.

27. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka dëshmuar asnjë pretendim mbi baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar dëshmi se të drejtat dhe liritë e tij themelore janë shkelur nga gjykatat e rregullta. Parashtruesi ka dështuar të përmbushë afatet e parashikuara me ligj, për ç'gjë është informuar me kohë nga gjykata kompetente (Shih, paragrafin 16 të këtij Aktvendimi).

28. Gjykata mundet vetëm të trajtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete tjera, Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, App. nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).

29. Gjykata vëren se, gjykatat e rregullta kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme vendimet e tyre dhe Gjykata ka gjetur që procedurat përkatëse nuk kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendim i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009)·

30. Si përmbledhje, parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar pse dhe si janë shkelur të drejtat e tij siç janë të garantuara me Kushtetutë. Deklarata e thjeshtë se Kushtetuta është shkelur nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese. Pra, Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

31. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar, dhe si e tillë e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1), c); dhe 5 (2), b) dhe d) të Rregullores së punës, më 9 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. dr. Enver Hasani

KI123/14, Parashtruesja e kërkesës Lalushe Boneshta, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 123/2014, të 19 qershorit 2014

KI 123/14, Aktvendim për papranueshmëri, i 9 dhjetorit 2014, publikuar më 14 janar 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, e drejta e lirisë dhe sigurisë, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin PML. nr. 123/2014, e 19 qershorit 2014 aprovoi kërkesën e parashtrueses për mbrojtjen e ligjshmërisë duke zëvendësuar masën e arrestit shtëpiak me një masë më të butë, atë të paraqitjes në stacionin më të afërt të Policisë dy herë (2) në javë. Megjithatë, parashtruesja e kontestoi atë Aktgjykim në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Parashtruesja e kërkesës pretendoi, *inter alia,* se Gjykata Supreme e Kosovës ka shkelur të drejtën e saj të lirisë dhe sigurisë përveç të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohen me nenin 29 dhe 31 të Kushtetutës, sepse liria e saj e lëvizjes ishte kufizuar dhe kështu ajo ishte vendosur në një pozitë diskriminuese.

Gjykata Kushtetuese theksoi se Gjykata Supreme zëvendësoi masën e arrestit shtëpiak me një masë më të butë dhe më tej shtoi se fakti se parashtruesja nuk është e kënaqur me rezultatin e procedurës nuk mund të ngre një pretendim të argumentuar të shkeljes së të drejtave dhe lirive të saj siç garantohen me Kushtetutë. Kërkesa e parashtrueses u deklarua e papranueshme si qartazi e pabazuar, siç parashihet me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së Punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI123/14
Parashtrues
Lalushe Boneshta
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 123/2014 ,
të 19 qershorit 2014

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Lalushe Boneshta (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës) me vendbanim në Gjakovë. Parashtruesja e kërkesës ka nënshtetësinë e Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Serbisë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 123/2014, i 19 qershorit 2014, i cili i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 123/2014, të 19 qershorit 2014, me të cilin ishte aprovuar kërkesa e parashtrueses së kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe ishin ndryshuar aktvendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta, duke e zëvendësuar masën e arrestit shtëpiak me një masë më të butë, atë të paraqitjes në stacion policor, 2 (dy) herë në javë. Parashtruesja e kërkesës në veçanti pretendon se masa e shqiptuar me aktgjykimin e lartcekur i kishte kufizuar asaj lirinë e lëvizjes dhe se ajo ishte diskriminuar.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 25 korrik 2014, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 8 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI123/14 caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI123/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

7. Më 22 gusht 2014, Gjykata e informoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë aktvendimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të Gjykatës së Apelit në Kosovë. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 12 shtator 2014, parashtruesja e kërkesës i dorëzoi dokumentet shtesë në Gjykatë.

9. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues, dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 21 mars 2014, në bazë të kallëzimit penal (2014 YNM 007, të 21 marsit 2014) Prokuroria Themelore në Prishtinë nxori aktvendimin për fillimin e hetimeve kundër parashtrueses së kërkesës. Parashtruesja dyshohej për kryerje të veprës penale të kontrabandimit me migrantë, nga neni 170, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

11. Më 21 mars 2014, me kërkesë të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, gjyqtari i procedurës paraprake në Gjykatën Themelore në Prishtinë vendosi të shqiptojë masën e arrestit shtëpiak ndaj parashtrueses së kërkesës deri më 19 prill 2014.

12. Më 18 prill 2014, me kërkesë të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Gjykata Themelore në Prishtinë nxori Aktvendimin PPR. KR nr. 107/2014, dhe ia vazhdoi parashtrueses së kërkesës masën e arrestit shtëpiak për 2 (dy) muaj.

13. Kundër aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Prishtinë (PPR. KR nr. 107/2014 të 18 prillit 2014), parashtruesja e kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.

14. Më 12 maj 2014, Gjykata e Apelit me Aktvendimin, PN. 1. 892/14 refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar. Në aktvendimin e saj, Gjykata e Apelit vërtetoi aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë për vazhdimin e masës së arrestit shtëpiak, për shkak të ekzistencës së rrezikut se parashtruesja e kërkesës mund të fshihet ose të ikë, si dhe për shkak të faktit se parashtruesja e kërkesës e kishte nënshtetësinë edhe të Republikës së Serbisë.

15. Kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesja e kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

16. Në kërkesën e saj për mbrojtjen e ligjshmërisë, parashtruesja e kërkesës pretendoi shkelje thelbësore të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, si dhe shkelje të nenit 5 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ). Ajo më tej argumentoi se bashkëshorti i saj, si i pandehuri i parë në këtë procedurë ishte liruar nga paraburgimi.

17. Më 18 qershor 2014, Prokurori i Shtetit në përgjigjen e tij (KMLP 111. nr. 30/14) ndaj kërkesës së parashtrueses për mbrojtje të ligjshmërisë, propozoi që kërkesa e saj të refuzohej si e pabazuar.

18. Më 19 qershor 2014, Gjykata Supreme me Aktgjykimin, PML. nr. 123/2014 aprovoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe zëvendësoi masën e arrestit shtëpiak me një masë më të butë, atë të paraqitjes në stacionin më të afërt të policisë dy (2) herë në javë.

19. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme konstatoi që:

> *"Njëkohësisht kjo Gjykatë vlerëson se nuk ka arsye ligjore për vazhdimin e masës së arrestit shtëpiak, sipas nenit 178 par. I nën par. 1.1 dhe 1.2 lidhur me nenin 187 par. I nënpar. 1.2 pika 1.2. I dhe 1.2.2 të KPPK-së. ngase nuk ka rrethana të posaçme që arsyetojnë frikën e bazuar se me ndodhjen e saj në liri, ajo do të ndikonte në të dëmtuarin dhe të pandehurin e parë. Nuk është*

kontestuese fakti se e pandehura Lalushe Bonishta të dëmtuarin Isuf Bonishta e ka vëlla dhe duke pasur parasysh lidhjet familjare ata gjatë kësaj kohe kanë qenë në kontakt ndërsa nga dita e abrogimit të paraburgimit ndaj të pandehurit të parë ajo është në kontakt të vazhdueshëm me të meqë janë bashkëshortë, kështu që ata gjatë kësaj kohe kanë mundur të ndikojnë të njeri tjetri si bashkëpandehur, si dhe në të dëmtuarin".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Siç u theksua më lart, parashtruesja e kërkesës pretendon se masa e shqiptuar me vendimin e kontestuar kufizon lirinë e saj të lëvizjes. Në këtë drejtim, ajo pretendon: *"Unë kam shtëpi edhe në Suboticë, Rep. e Serbisë. Më është pamundësuar që të shkoj në vendbanimin tim. Atje familja ka edhe dyqan, kështu që me shqiptimin e kësaj mase më është pamundësuar që të shkoj në dyqanin tim. Nga gjendja në shkresa vërtetohet se burrit tim, si bashkëkryes nuk i është shqiptuar ndonjë masë kufizuese. Unë jam sjellë në pozitë diskriminuese. Unë në bashkëshortësi me burrin tim kam 7 fëmijë. Tash fëmijët nuk kanë mundësi që të shkojnë në shtëpinë e tyre në Suboticë, se nuk ka se kush me i këqyrë, nuk ka kush të kujdeset".*

21. Parashtruesja e kërkesës më tej pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 123/2014, të 12 majit 2014, ishin shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës, të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], paragrafi 2, nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

22. Ajo përfundon duke kërkuar nga Gjykata që ta anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (PML. nr. 123/2014, të 19 qershorit 2014).

Pranueshmëria e kërkesës

23. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtrueses, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(2) "Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) aktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

25. Siç është cekur më lart, parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme PML. nr. 123/2014, i 19 qershorit 2014, i kishte shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, në veçanti, ajo argumenton se me masën e shqiptuar i ishte kufizuar liria e saj e lëvizjes, dhe se ajo ishte diskriminuar.

26. Megjithatë, parashtruesja e kërkesës nuk shpjegon dhe dëshmon se si të drejtat dhe liritë e saj të garantuara me Kushtetutë ishin kufizuar, në veçanti liria e saj e lëvizjes.

27. Gjykata vëren se procedura hetimore është duke vazhduar dhe aktakuza ende nuk është nxjerrë. Procedura e përfunduar në gjykatat e rregullta i referohet masës kufizuese të shqiptuar ndaj parashtrueses së kërkesës gjatë fazës së hetimeve.

28. Gjykata Kushtetuese nuk mund ta zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih, gjithashtu, rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

29. Gjykata vëren më tej se me vendimin e kontestuar ishte miratuar kërkesa e saj për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe ishte zëvendësuar masa e arrestit shtëpiak me një masë më të butë. Kështu, fakti që parashtruesja nuk është e kënaqur me rezultatin e procedurës në rastin e saj nuk ngre një pretendim të argumentuar të shkeljes së të drejtave dhe lirive të saj të mbrojtura me Kushtetutë.

30. Përveç kësaj, siç u cek më lart, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjeti se procedurat në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe në Gjykatën e Apelit nuk kanë qenë të padrejta apo

arbitrare (Shih, rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, ECHR, Vendimi i 30 qershorit 2009).

31. Për arsyet e mësipërme, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesja e kërkesës në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë shkeljen e pretenduar të të drejtave dhe lirive kushtetuese, në të cilat thirret parashtruesja e kërkesës dhe se parashtruesja nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e saj.

32. Prandaj, Gjykata përfundon se kërkesa është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullat 36 (2), b) dhe d) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 9 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. dr. Enver Hasani

KI126/14, Parashtrues i kërkesës Vebi Tahiri, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2109/2013, të 16 dhjetorit 2013

KI 126/14, Aktvendim për papranueshmëri, i 9 dhjetorit 2014, publikuar më 14 janar 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, mbrojtja e pronës, kërkesë e paafatshme*

Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin Ac. nr. 2109/2013 aprovoi vendimet e gjykatave të faktit me të cilat prona e hipotekuar e parashtruesit ishte transferuar dhe regjistruar në emër të Pro Credit Bank në Kosovë.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi, *inter alia,* se është shkelur e drejta e tij në pronë, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, sepse ai ishte vënë në pozitë të vështirë për shkak të veprimeve të kreditorit të tij Pro Credit Bank të Kosovës.

Gjykata Kushtetuese theksoi se kërkesa nuk është paraqitur brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe siç specifikohet më tej me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës. Kërkesa e parashtruesit u deklarua e papranueshme, sepse ishte e paafatshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI126/14
Parashtrues
Vebi Tahiri
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2109/2013,
të 16 dhjetorit 2013

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Vebi Tahiri (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Gjilan.Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2109/2013, i 16 dhjetorit 2013, të cilin parashtruesi i kërkesës pohon se e ka pranuar më 12 shkurt 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2109/2013, të 16 dhjetorit 2013, me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës si e pabazuar dhe ishte vërtetuar Aktvendimi (E. nr. 153/2011, i 10 qershorit 2013) i Gjykatës Themelore në Gjilan. Parashtruesi pretendon që aktvendimi i lartcekur i Gjykatës së Apelit, ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 gusht 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 4 shtator 2014, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.

7. Më 5 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin GJR. KI126/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI126/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

8. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 11 maj 2007, parashtruesi i kërkesës dhe ProCredit Bank, filiali në Gjilan, (në tekstin e mëtejmë: kreditori) kishin lidhur marrëveshje për huadhënie. Kontrata për hipotekën mbi paluajtshmërinë e parashtruesit dhe kontrata për pengun ishin regjistruar në Zyrën Kadastrale në Komunën e Gjilanit.

10. Si rezultat i mospagesës së borxhit, kreditori kishte paraqitur propozim për përmbarim dhe si rrjedhojë me Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Gjilan, (E. Nr. 153/2011, të 23 shkurtit 2011) me qëllim të pagesës së borxhit, ishte caktuar shitja e paluajtshmërisë së hipotekuar të parashtruesit.

11. Më 6 mars 2013, Gjykata Themelore në Gjilan nxori konkluzën (E. Nr. 153/2011) lidhur me shitjen e parë publike të paluajtshmërisë së hipotekuar të parashtruesit. Pas dështimit të shitjes së parë në ankand

publik, Gjykata Themelore në Gjilan kishte caktuar shitjen e dytë publike të paluajtshmërisë, e cila ishte mbajtur më 7 qershor 2013.

12. Më 10 qershor 2013, Gjykata Themelore në Gjilan (Aktvendimi, E. Nr. 153/2011) caktoi kreditorin si ofertuesin më të volitshëm i cili kishte ofruar çmimin më të lartë për blerjen e paluajtshmërisë së hipotekuar, dhe urdhëroi që paluajtshmërinë ta regjistrojë në emër të kreditorit.

13. Kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Gjilan (E. Nr. 153/2011, të 10 qershorit 2013) parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke i propozuar Gjykatës që Aktvendimi i ankimuar të prishet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

14. Më 16 dhjetor 2013, Gjykata e Apelit (Aktvendimi, Ac. nr. 2109/13) refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan (E. Nr. 153/2011, të 10 qershorit 2013).

15. Më 19 shkurt 2014, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Gjilan, nxori aktvendimin për regjistrimin e paluajtshmërisë në regjistrimin e paluajtshmërive në emër të kreditorit, ProCredit Bank.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Ashtu siç është cekur më lart, parashtruesi pretendon se Aktvendimi i kontestuar ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

17. Parashtruesi po ashtu pohon se aktvendimi i kontestuar gabimisht ka zbatuar nenin 18, paragrafët 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së, Nr. 29/78 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit, të publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së Nr. 39). Në lidhje me këtë, parashtruesi pohon se *"Në rastin konkret jo se nuk është vepruar në frymën e këtyre dispozitave, por në të kundërtën me apo pa qëllim në çdo mënyrë iu është vështirësuar pozita debitorit nga sjelljet e kreditorit (tri ngastra të debitorit edhe pse kishin vlerën reale të përgjithshme prej 695.0 I 0 euro, nga kreditori blihen vetëm për shumën prej 232.000 euro dhe se vetëm pas 4 muajve vetëm njëra shitet nga kreditori për shumën prej 260.000 euro), kjo pra ilustron sjelljen e kreditorit ndaj debitorit"*.

18. Parashtruesi përfundon duke kërkuar nga Gjykata që të anulojë aktvendimet e Gjykatës Themelore në Gjilan (E. Nr. 153/2011, të 10 qershorit 2013) dhe të Gjykatës së Apelit (Ac. nr. 2109/2013, të 16 dhjetorit 2013).

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita 6 kur ligji ka hyrë në fuqi".*

21. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1), c) të Rregullores së punës:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë një kërkesë vetëm nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi, [...]".*

22. Për të vërtetuar nëse parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesën brenda afatit të paraparë prej 4 (katër) muajsh, Gjykata i referohet datës së marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e parashtruesit të kërkesës, dhe datës së dorëzimit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

23. Parashtruesi në kërkesën e tij pohon që Aktvendimi i Gjykatës së Apelit (Ac. nr. 2109/2013, i 16 dhjetorit 2013) i është dorëzuar atij më 12 shkurt 2014, ndërsa kërkesën e tij në Gjykatë e ka dorëzuar më 4 gusht 2014. Bazuar në këtë, rrjedh se kërkesa nuk është paraqitur brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1), c) të Rregullores së punës.

24. Gjykata përkujton që qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit si dhe rregullit 36 (1), c) të Rregullores së punës, është që të promovojë sigurinë juridike duke siguruar që rastet të cilat paraqesin çështje kushtetuese të shqyrtohen brenda afateve të arsyeshme, si dhe që vendimet e nxjerra më herët të mos jenë pafundësisht të hapura për kontestim (Shih rastin *O'Loughlin dhe të*

tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendimi i 25 gushtit 2005).

25. Prandaj, kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, sepse është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1), c) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 9 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. TË SHPALLË se vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Arta Rama-Hajrizi	Prof. dr. Enver Hasani

KI143/14, Parashtrues i kërkesës Ferbend Haxhiaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 26/2012, të 16 shtatorit 2013

KI 143/14, Aktvendim për papranueshmëri, i 9 dhjetorit 2014, publikuar më 15 janar 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, mbrojtja e pronës, kërkesë tashmë e vendosur*

Në këtë rast, Gjykata vërejti se ajo tashmë kishte vendosur lidhur me kërkesën e parashtruesit, duke e deklaruar atë qartazi të pabazuar dhe se kërkesa e tanishme nuk përmban asnjë bazë për nxjerrjen e një vendimi të ri.

Gjykata e deklaroi kërkesën të papranueshme në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës dhe rregullit 63 (1) dhe 36 (3) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI143/14
Parashtrues
Ferbend Haxhiaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 26/2012, të
16 shtatorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Ferbend Haxhiaj, qytetar i Republikës së Shqipërisë, me vendbanim në Durrës, Republika e Shqipërisë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 26/2012, të 16 shtatorit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 11 nëntor 2013.

3. Gjykata tashmë kishte nxjerrë një vendim për çështjen e njëjtë në rastin KI28/14, parashtrues të kërkesës *Skender Mezini dhe Ferbend Haxhiaj*, Aktvendim për papranueshmëri, nxjerrë më 19 maj 2014, dhe publikuar më 13 qershor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të njëjtë të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 1 [Mbrojtja e

Pronës] të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) dhe të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta). Parashtruesi i kërkesës nuk saktëson se cilat dispozita të Kushtetutës janë shkelur.

Baza juridike

5. Baza juridike e kërkesës është: neni 113.7 i Kushtetutës, neni 20 dhe 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji)

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 19 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 7 tetor 2014, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 21 tetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 19 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën KI143/14, pa paraqitur ndonjë fakt dhe provë të re lidhur me procedurën e përfunduar në gjykatat e rregullta dhe në Gjykatën Kushtetuese.

11. Në të vërtetë, më 10 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës, së bashku me z. Skender Mezini, kishin dorëzuar në Gjykatë kërkesën KI28/14, me të cilën kishin kontestuar të njëjtin Aktgjykim të Gjykatës Supreme (Rev. nr. 26/2012, të 16 shtatorit 2013).

12. Ndërkohë, më 19 maj 2014, Gjykata deklaroi kërkesën KI28/14 të papranueshme, pasi ishte qartazi e pabazuar (Rasti KI28/14, Aktvendim për papranueshmëri, publikuar më 13 qershor 2014).

13. Faktet dhe vendimet e Gjykatës të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës në këtë kërkesë të re KI143/14 tashmë janë shqyrtuar në

rastin nr. KI28/14, siç është vendosur me Aktvendimin për papranueshmëri, të 19 majit 2014.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi në kërkesën e re KI143/14 këmbëngul në pretendimin se aktgjykimi i kontestuar e ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

15. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht të drejtën e tij si trashëgimtar i paraardhësve të tij të cilët ishin lindur në Kosovë për t'u bërë shtetas të Republikës së Kosovës, dhe për të gëzuar të drejtën e pronësisë mbi pronën e paluajtshme të paraardhësve të tij.

16. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk specifikon saktësisht dispozitat e Kushtetutës, të cilat pretendohet se janë shkelur. Në vend të kësaj, ai i referohet neneve 3, 4 dhe 5 të Ligjit për të Drejtat e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë Nr. 03/L-95 (publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 10 dhjetor 2010).

17. Parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata që t'i mundësojë atij që si trashëgimtar të gëzojë të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme të paraardhësve të tij.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.1 të Kushtetutës [Efekti Juridik i Vendimeve], i cili përcakton:

    "Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës..".

20. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 63 (1) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

    "Vendimet e Gjykatës janë të obligueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës".

21. Për më tepër, rregulli 36 (3) d) i Rregullores së punës parasheh:

"Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: (...) e) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri";

22. Gjykata konsideron që faktet dhe pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës në kërkesën e re nuk paraqesin bazë e as arsye të mjaftueshme e relevante për një vendim të ri (Shih, Gjykata Kushtetuese Rasti KI02/14, parashtrues i kërkesës *Hamdi Ademi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 26 majit 2014).

23. Në të vërtetë, Gjykata përkujton që tashmë është marrë me çështjen e përmendur në rastin KI28/14, parashtrues të kërkesës *Skender Mezini dhe Ferbend Haxhiaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i nxjerrë më 19 maj 2014. Në aktvendimin e saj, Gjykata kishte deklaruar kërkesën të papranueshme, për shkak se ishte qartazi e pabazuar sepse faktet e paraqitura nga parashtruesit e atëhershëm të kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetuan pretendimin e tyre për shkeljen e të drejtave kushtetuese, dhe parashtruesit nuk kanë dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme si dhe pse aktgjykimi i Gjykatës Supreme i kishte shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë.

24. Në këtë mënyrë, Gjykata konstaton që tashmë ka marrë vendim për çështjen në fjalë dhe se kërkesa nuk përmban bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri.

25. Prandaj, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës, rregullin 63 (1) dhe rregullin 36 (3) e) të Rregullores së punës, Gjykata konkludon se kjo kërkesë duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 63 (1) dhe 36 (3) d) të Rregullores së punës, më 9 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA SHPALLË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. dr. Enver Hasani

KI114/14, Parashtrues i kërkesës Adem Hoti, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 127/2014, të 12 majit 2014

KI 114/14, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 dhjetorit 2014, publikuar më 19 janar 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit, kërkesë qartazi e pabazuar*

Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër vendimeve të gjykatave të faktit, përkatësisht të apelit, në lidhje me mosvazhdimin e kontratës së tij të punës nga ana e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Podujevë. Gjykata Supreme e Kosovës hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për revizion për shkak se nuk ishte parashtruar në përputhje me kërkesat procedurale të ligjit përkatës.

Parashtruesi pretendoi, *inter alia,* se Gjykata Supreme duke hedhur poshtë kërkesën e tij për revizion, kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 3.2 dhe 113.7 të Kushtetutës, respektivisht, për shkak se ai nuk ishte caktuar në vendin e punës së arsimtarit të arsimit teknik. Gjykata konsideroi se parashtruesi nuk ka dëshmuar si dhe pse janë shkelur dispozitat e veçanta të Kushtetutës. Gjykata deklaroi kërkesën e parashtruesit të papranueshme si qartazi të pabazuar, siç parashihet me nenin 48 të Ligjit dhe siç specifikohet më tej me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI114/14
Parashtrues
Adem Hoti
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 127/2014, të 12 majit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Adem Hoti, me vendbanim të përhershëm në Podujevë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 127/2014, të 12 majit 2014 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), me të cilin është hedhur poshtë, si i palejuar, revizioni i ushtruar nga parashtruesi kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 3661/2013, të 28 shkurtit 2013 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 127/2014, të 12 majit 2014. Më këtë aktvendim të Gjykatës Supreme, parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3.2 dhe me nenin 113.7 të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Bazë juridike për këtë rast është neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe neni 22 e neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin NR. GJR. KI114/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin NR. KSH. KI114/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Prof. dr. Ivan Čukalović dhe Prof. dr. Enver Hasani.

7. Më 22 gusht 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.

8. Më 8 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 30 janar 2013, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë është lidhur Ujdia gjyqësore C. nr. 433/11, ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit në Podujevë (në tekstin e mëtejmë: DKA në Podujevë) për sistemimin e parashtruesit në sistemin e pagave për vitin shkollor 2013/2014. Në ujdinë e lidhur gjyqësore ceket që, DKA në Podujevë, obligohet t'ia paguajë parashtruesit pagat për muajt: korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor dhe janar, nga 215.90 €, gjithsej 1295.40 €. Pagat e papaguara, sipas Ujdisë, DKA në Podujevë do të duhej t'ia paguante parashtruesit në muajin shkurt të vitit 2013, kurse kontrata mbi vepër do t'i vazhdohej deri më 30 qershor të vitit 2013. Po ashtu, DKA në Podujevë është obliguar që t'i shfrytëzojë të gjitha mundësitë që, në fillim të vitit shkollor 2013-2014, ta sistemojë parashtruesin në sistemin e pagave.

10. Më 1 tetor 2013, parashtruesi ka ushtruar propozim për lejimin e përmbarimit të Ujdisë gjyqësore C. nr. 433/11 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë, duke pretenduar se Ujdia gjyqësore C.

nr. 433/11, e lidhur ndërmjet tij dhe DKA-së në Podujevë, nuk është zbatuar plotësisht nga ana e DKA-së në Podujevë.

11. Më 8 nëntor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë (Aktvendimi CP. nr. 439/13) refuzoi propozimin për lejimin e përmbarimit të ushtruar kundër DKA-së në Podujevë.

12. Për më tepër, Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë, konstatoi:

> *"[...] Nga kontrata për punën e lidhur me kohë të caktuar (mbi veprën), paditësi-kreditori vërtetohet se ka pas kontratë prej 1.06.2013 deri më 31.08.2013, andaj meqenëse është një kontratë e llojit të tillë kjo ka mundur të mos i vazhdohet nga debitori pas kalimit të afatit 31.08.2013, dhe nuk është obliguar e paditura-debitori drejtoria për arsim kulturë dhe shkencë nga komuna e Podujevës që ta vazhdoi nëse nuk ka nevojë për punëtor dhe vendin e punës*
>
> *Nisur nga kjo gjendje gjykata është e mendimit se kreditori nuk ka të drejtë dhe për këtë iu refuzua propozimi i tillë si i pabazuar. Nëse mendon se iu kanë shkelë të drejtat, mund ti realizoj të drejtat e tij në kontest të rregullt civil e jo në këtë procedurë përmbarimore sipas propozimit të bërë dhe në bazë të ujdisë që është arritur në mes të palëve".*

13. Më 12 nëntor 2013, parashtruesi ushtroi të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër aktvendimit të gjykatës së instancës së parë. Ankesa e parashtruesit është bazuar në shkeljen e dispozitave procedurale, përkatësisht neni 182.1, pika (n), i Ligjit për Procedurën Kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, përkatësisht të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), nr. 03/L-008.

14. Më 12 maj 2013, Gjykata e Apelit në Prishtinë (Aktvendimi AC. nr. 3661/13) refuzoi, si të pabazë, ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së instancës së parë. Gjykata në fjalë konstatoi se gjykata e instancës së parë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë korrekte dhe të drejtë ka aplikuar ligjin material.

15. Më 19 mars 2014, parashtruesi ushtroi revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të zbatimit të gabuar të ligjit material.

16. Më 12 maj 2014, Gjykata Supreme (Aktvendimi Rev. nr. 127/2014) hodhi poshtë, si të palejuar, revizionin e ushtruar nga parashtruesi, nga arsyet e mëposhtme: *"Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, e në mbështetje të nenit 68 par. 1 të ligjit për procedurën e përmbarimit, Gjykata Supreme e Kosovës, gjeti se, revizioni i kreditorit në këtë çështje juridike në bazë të dispozitës së sipër cituar të ligjit, nuk është i lejuar ndaj aktvendimit të formës së prerë në procedurën përmbarimore".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi ndihet i diskriminuar për faktin se DKA-ja dhe gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të garantuara me nenin 3.2 të Kushtetutës, si dhe nenin 113.7 të Kushtetutës, për shkak se Gjykata Supreme e hodhi poshtë revizionin si të palejuar.

18. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, pretendon se gjykatat e rregullta padrejtësisht ia refuzuan propozimin për përmbarim, me të cilin ka kërkuar që në pajtim me Ujdinë gjyqësore C. nr. 433/11, të 30 janarit 2013, të sistemohet në sistemin e pagave për vitin shkollor 2013/2014, nga fillimi i vitit shkollor.

19. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me këto kërkesa, citojmë: *"Sistemim në vend të punës arsimtar i arsimit teknik ose mësues klase, apo edhe bibliotekist në shkollë fillore ose të mesme, si dhe shtëpiak në shkollë fillore apo të mesme ose ndihmës shtëpiaku në shkollën e mesme ekonomike 'Isa Boletini' në Podujevë".*

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

22. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) d) i Rregullores së punës parasheh:

> *(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

23. Për më tepër, rregulli 36 (2) i Rregullores së punës parasheh:

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;

(b) aktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

24. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se punëdhënësi, DKA-ja në Podujevë, dhe gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të garantuara me nenin 3.2 të Kushtetutës, për faktin se nxorën vendime jo të drejta, dhe me nenin 113.7 të Kushtetutës, për shkak të hedhjes poshtë të revizionit, si të palejuar, nga Gjykata Supreme.

25. Sa i përket pretendimit për shkeljen e nenit 3.2, Gjykata i referohet po kësaj dispozite kushtetuese, që përcakton:

Neni 3.2. *"Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre".*

26. Përkitazi me këtë pretendim, Gjykata konsideron se parashtruesi në asnjë mënyrë nuk argumenton, si dhe pse, gjykata e instancës së parë dhe gjykata e instancës së dytë, shkelën të drejtën e tij të garantuar me këtë dispozitë konkrete të Kushtetutës, përderisa atij i janë dhënë të gjitha mundësitë e paraqitjes së fakteve, ngritjes së argumenteve dhe kundërshtimit të argumenteve të palës kundërshtare.

27. Parashtruesi, gjithashtu, pretendon se edhe Gjykata Supreme shkeli të drejtën e tij të garantuar me nenin 113.7 të Kushtetutës, për faktin se

nuk e aprovoi revizionin e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

28. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se pretendimi i ngritur nga parashtruesi për shkeljen e kësaj dispozite të Kushtetutës nuk ka të bëjë me mundësinë e parashtrimit të një ankese a kërkese në gjykatat e rregullta ose të mohimit të këtyre mjeteve juridike nga të njëjtat, por mundësinë që individët, qytetarët e Republikës së Kosovës, t'i kontestojnë vendimet e gjykatave të rregullta në Gjykatën Kushtetuese për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, me kusht që ata të provojnë se i kanë shterur të gjitha mjetet efektive juridike të përcaktuara me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

29. Për më tepër, nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se, vendimi përfundimtar për çështjen e parashtruesit, sipas ligjit në fuqi, është Aktvendimi Ac. nr. 3661/13 i Gjykatës së Apelit, me të cilin është vërtetuar aktvendimi i gjykatës së instancës së parë, CP. nr. 439/13, i 8 nëntorit 2013, përkitazi me propozimin e parashtruesit për përmbarimin e Ujdisë gjyqësore C. nr. 433/11, të 30 janarit 2013.

30. Mirëpo, vërehet qartë se parashtruesi është ndarë i pakënaqur me rezultatin e vendimit të Gjykatës së Apelit, dhënë në procedurë përmbarimore, dhe është përpjekur që pretendimet e tij t'i realizojë në Gjykatën Supreme, e cila hodhi poshtë, si të palejuar, revizionin për shkaqe procedurale (shih arsyetimin e Gjykatës Supreme në paragrafin 16 të këtij dokumenti).

31. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë që parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'i shërbejë atij si e drejtë për të parashtruar një kërkesë të argumentueshme për shkeljen e dispozitave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis,* Aktgjykimi i GJEDNJ-së, kërkesa Nr. 5503/02, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* ose Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, rasti KI128/12, e 12 korrikut 2013, të parashtruesit *Shaban Hoxha*, kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 316/2011).

32. Gjykata edhe më tutje thekson se nuk është gjykatë e faktit dhe nuk gjykon si gjykatë e instancës së katërt. Gjykata, në parim, nuk gjykon faktin nëse gjykatat e rregullta në mënyrë të drejtë dhe të plotë e kanë konstatuar gjendjen faktike apo, siç është rasti konkret, të vërtetojë nëse punësimi i parashtruesit ishte ndërprerë në bazë ligjore apo joligjore, sepse kjo është kompetencë e gjykatës së rregullt. Për Gjykatën Kushtetuese, thelbësore janë ato çështje, prej ekzistimit të të cilave varet vlerësimi për shkelje eventuale të të drejtave të garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmëria) dhe jo çështjet që janë qartazi

ligjore, ligjshmëria (shih, *mutatis mutandis, i. a., Akdivar kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

33. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk i arsyetojnë pretendimet për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

34. Prandaj, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit, në përputhje me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) d) të Rregullores së punës, është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 36 (1) d), me rregullin 36 (2) b) e d), si dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 8 dhjetor 2014, njëzëri:

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Prof. dr. Enver Hasani

KI70/14, Parashtrues i kërkesës Ahmet Arifaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit Komunal të Klinës, Nr. 351-3187/08, të 22 shtatorit 2008

KI 70/14, Vendim për heqje të kërkesës nga lista, i 23 shtatorit 2014, publikuar më 21 janar 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, mbrojtja e pronës, kërkesë e hequr nga lista*

Në këtë rast, Gjykata gjeti se ajo tashmë kishte vendosur për kërkesën e parashtruesit duke e shpallur atë të papranueshme për shkak të mos-shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj, dhe se, kërkesa e tanishme nuk përmban baza të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri.

Gjykata e hoqi kërkesën nga lista, në pajtim me rregullin 36 (3) (e) të Rregullores së punës.

VENDIM PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA
në
Rastin Nr. KI70/14
Parashtrues
Ahmet Arifaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit Komunal të Klinës, Nr. 351-3187/08, të 22 shtatorit 2008

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Ahmet Arifaj, me vendbanim në Zabërxhë/Stapanicë, Komuna e Klinës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e Kuvendit Komunal të Klinës, nr. 351-3187/08, të 22 shtatorit 2008, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës në një datë të paspecifikuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit Komunal të Klinës, nr. 351-3187/08, të 22 shtatorit 2008, me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës për mbështetje në rindërtimin e shtëpisë së shkatërruar gjatë luftës.

4. Parashtruesi i kërkesës nuk i referohet në mënyrë specifike neneve të Kushtetutës, të cilat pretendohet se janë shkelur, në vend të kësaj ai i ka kërkuar Gjykatës *"... T'i shihni të gjitha dokumentet dhe*

mundësisht të ushtroni presion në Kuvendin Komunal të Klinës që të ma zgjidhin çështjen e rindërtimit të shtëpisë...".

5. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës i kërkon Gjykatës të mos ia zbulojë identitetin, sepse *"... Po frigohem mos po prishi punë nga Kuvendi Komunal i Klinës".*

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 14 prill 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 6 maj 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI70/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI70/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

9. Më 26 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi kopjen e kërkesës Kuvendit Komunal të Klinës.

10. Më 23 shtator 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 30 qershor 2009, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesën e tij në Gjykatë, e cila është regjistruar me numrin KI23/09, duke e kontestuar edhe Aktvendimin e Kuvendit Komunal të Klinës, nr. 351-3187/08 të 22 shtatorit 2008.

12. Në kërkesën KI23/09 parashtruesi është ankuar se i është shkelur e drejta e kompensimit për pasurinë e shkatërruar gjatë luftës, pa specifikuar ndonjë dispozitë konkrete të Kushtetutës. Në të njëjtën kërkesë, Kryetari i Komunës së Klinës thekson që ... *"Ne si komunë nuk kishim qasje apo mundësi të përgatitjes së listës së prioriteteve për përfituesit".*

13. Më 18 shkurt 2010, Gjykata e deklaroi kërkesën e parashtruesit të papranueshme, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës (Rasti nr. KI23/09, Aktvendim për Papranueshmëri). Gjykata theksoi, *inter alia,* se: *"Parashtruesi i kërkesës nuk ka vërtetuar në asnjë mënyrë se pse ai mendon se mjetet ligjore, të cekura në Ligjin nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, duke përfshirë ankimimin në gjykatat e rregullta, nuk ka qenë në dispozicion dhe, nëse kanë qenë në dispozicion, nuk do të ishin efektive, dhe në këtë mënyrë, nuk ka pasur nevojë të shteren".*

14. Më 14 prill 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë të re në Gjykatë, e cila është regjistruar me numrin KI70/14. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës ka deklaruar si në vijim: *"Unë kam bë ankesë në Ombudsperson, pra te Avokati i Popullit në Prishtinë dhe në Pejë. Dikun tjetër nuk kam ba, sepse ata në komunën e Klinës më kanë premtu vazhdimisht se do ta rindërtojm shtëpinë si të gjenden fondet për rindërtimin e shtëpive të djegura, por gjer më sot nuk ma rindërtuan shtëpinë. Kjo është arsyeja që unë nuk kam shku në gjykatë të ushtroj padi".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Në thelb, parashtruesi i kërkesës ankohet se i është shkelur e drejta e kompensimit për pasurinë e shkatërruar gjatë luftës, pa specifikuar asnjë dispozitë konkrete të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.1 të Kushtetutës [Efekti Juridik i Vendimeve], i cili përcakton se:

> *"1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës".*

18. Për më tepër, Gjykata merr gjithashtu parasysh rregullin 63 (1) të Rregullores së punës, i cili parasheh se:

> *"(1) Vendimet e Gjykatës janë të obligueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës".*

19. Për më tepër, rregulli 36 (3) e) i Rregullores së Punës parasheh se:

> *"(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:*
>
> > *(...)*
> >
> > *e) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri".*

20. Gjykata konsideron se faktet dhe pretendimet e ngritura nga parashtruesi në kërkesën e tij të re nuk ofrojnë asnjë bazë, ose arsye të mjaftueshme apo relevante për marrjen e një vendimi të ri.

21. Në fakt, Gjykata dëshiron të theksojë se e ka shqyrtuar tashmë rastin nr. KI23/09 të përmendur më sipër. Në aktvendimin e saj, Gjykata ka theksuar se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

22. Gjykata gjen se tashmë e ka dhënë një vendim për çështjen në fjalë, ndërkohë që kërkesa në rastin KI70/14 nuk përmban baza të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri.

23. Prandaj, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, në përputhje me rregullin 36 (3) e) të Rregullores së punës.

24. Për sa i takon kërkesës së parashtruesit që Gjykata të mos ia zbulojë identitetin, Gjykata rikujton se në pajtim me nenin 22.2 të Ligjit: *"Sekretaria ia dërgon nga një kopje të kërkesës palës kundërshtare dhe palës (palëve) apo pjesëmarrësve të tjerë në procedurë".*

25. Gjykata rikujton gjithashtu se, në pajtim me Udhëzimet e Gjykatës për ndihmë palës, apo palëve, në parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese *"Gjykata Kushtetuese mund të autorizojë anonimitetin në raste të jashtëzakonshme dhe të argumentuara. Sigurisht, nëse lejohet anonimiteti, emri juaj duhet t'i zbulohet palës së kundërshtuar...".*

26. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit për moszbulimin e identitetit duhet të refuzohet, sepse nuk është arsyetuar mjaftueshëm.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (3) e) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 23 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA HEQË kërkesën nga lista;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Arta Rama-Hajrizi	Prof. dr. Enver Hasani

KI141/14, Parashtrues i kërkesës Rrahim Ramadani, Vlerësim i kushtetushmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ca. nr. 2862/2014, të 26 gushtit 2014

KI 141/14, Aktvendim për papranueshmëri, i 9 dhjetorit 2014, publikuar më 21 janar 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për punë dhe ushtrim të profesionit, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata e Apelit të Kosovës anuloi aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilin ishte aprovuar propozimi i parashtruesit të kërkesës për rikthim në vendin e punës.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi, *inter alia* se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit ishte i padrejtë për shkak se ajo nuk kishte marrë parasysh formën e prerë të vendimit të gjykatës së faktit.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ngre çështje të ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë, dhe se, Gjykata e Apelit nxori një vendim të arsyetuar për të mbështetur qëndrimin e saj. Gjykata deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar siç parashihet me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI141/14
Parashtrues
Rrahim Ramadani
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2862/2014,
të 26 gushtit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Rrahim Ramadani nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2862/2014, të 26 gushtit 2014. Aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 4 shtator 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2862/2014, të 26 gushtit 2014.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për

Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 18 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 7 tetor 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI141/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës me Vendimin nr. KSH. KI141/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 22 tetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit të Kosovës.

8. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës ka punuar si arsimtar i gjuhës shqipe gjatë 30 (tridhjetë) viteve në disa shkolla në Kosovë; megjithatë, për shkak të reformave në sistemin e arsimit të Kosovës, kontrata e tij e punës nuk ishte vazhduar.

10. Më 14 dhjetor 2007, Kryeshefi Ekzekutiv i Komunës së Prishtinës vendosi që mos t'ia vazhdojë kontratën e punës parashtruesit të kërkesës (Vendimi nr. 07-24385).

11. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Këshillin Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMK-ja).

12. Më 19 qershor 2008, KPMK-ja me Vendimin A. 02. 139. 2008 anuloi vendimin e lartcekur të Komunës së Prishtinës, dhe detyroi të njëjtin organ t'ia mundësojë parashtruesit të kërkesës t'i realizojë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kontrata e punës, në përputhje me vendimet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

13. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës, si kreditor, paraqiti kërkesë për përmbarimin e vendimit të KPMK-së në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

14. Më 20 mars 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin E. nr. 2433/2011, aprovoi kërkesën e parashtruesit për përmbarimin e Aktvendimit të KPMK-së.

15. Në një datë të pacaktuar, Komuna e Prishtinës si debitor parashtroi prapësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër përmbarimit të vendimit të KPMK-së.

16. Më 16 qershor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin E. nr. 2433/2011, refuzoi si të pabazuar prapësimin e Komunës së Prishtinës, të parashtruar kundër aktvendimit të gjykatës së njëjtë e cila lejoi përmbarimin e vendimit të KPMK-së.

17. Më 4 korrik 2014, Komuna e Prishtinës parashtroi prapësim në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktvendimit të mësipërm të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

18. Më 26 gusht 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin CA. nr. 2862/2014:

    i) aprovoi kërkesën e Komunës së Prishtinës;

    ii) ndryshoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë (E. Nr. 2433/2011, të 19.6.2014); dhe

    iii) refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për përmbarim si të pabazuar.

19. Në Aktvendimin e mësipërm, Gjykata e Apelit e Kosovës arsyetoi më tej:

    "Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës pa bazë ligjore ka lejuar përmbarimin në bazë të propozimit të kreditorit Rrahim Ramadani nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, sepse propozimi për përmbarim nuk bazohej në dokument të përshtatshëm për përmbarim në kuptim të nenit 27 par. 1 të LPP. Nga shkresat në dosje rezulton se gjykata e shkallës së parë ka lejuar përmbarimin në bazë të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, A02,139,2008 të dt. 19.06.2008, në të cilën nuk është specifikuar shuma e të hollave të cilën debitori duhet t'ia paguajë kreditorit në emër të shpërblimit të dëmit, të pësuar si pasojë e largimit nga puna. Pasi që në rastin konkret kërkesa e kreditorit nuk është e përbashkët me kërkesën për kthim në punë, por për shpërblimin e dëmit për largim nga puna, në këtë rast nuk janë përmbushë

kërkesat ligjore nga neni 315 i LPP për lejimin e përmbarimit. Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë të shprehur në aktvendimin ankimor gjykata e shkallës së dytë e vlerëson të pabazuar në ligj, sepse në rast të tillë gjykata e shkallës së parë, duhet ta refuzojë propozimin për përmbarim si të pathemeltë, pasi që ai nuk ka bazë për lejimin e përmbarimit, sepse propozimi nuk bazohej në dokument të përshtatshëm për përmbarim në kuptim të dispozitave ligjore nga nenet 27 par. 1 dhe 29 par. 3 të LPP".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit anuloi në mënyrë të padrejtë vendimet e Gjykatës Themelore gjegjësisht të KPMK-së, sepse ajo nuk mori parasysh afatet për parashtrimin e ankesës dhe se vendimet e KPMK-së janë përfundimtare.

21. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: *"... Të sistemohen në vendin e punës sipas kualifikimit, të më paguhen 13 rroga prej 1.9.2007 e deri 30.09.2008 dhe ndryshimin e pagës që marr ...".*

22. Parashtruesi i kërkesës nuk thirret në asnjë shkelje të ndonjë dispozite kushtetuese, në veçanti.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

25. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh;

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

26. Gjykata merr parasysh edhe rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> ...
>
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij;*

27. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se: *"Gjykata e Apelit në mënyrë të padrejt prish vendimin e Gjykatës Themelore"* dhe se: *"Komuna e Prishtinës ka paraqitur ankesë shtatë ditë pas afatit të paraparë për ankesë"*. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon, *inter alia*, që: *"të caktohem në vend të punës sipas kualifikimit"*.

28. Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk ngre çështje të kushtetutshmërisë, por ngre çështje të ligjit dhe të faktit të cilat kanë të bëjnë me detyrat dhe prerogativën e gjykatave të rregullta, që u jepen atyre me Kushtetutë.

29. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit, që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç, dhe për aq, sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërisë).

30. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM]*, nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ], Aktgjykim i 21 janarit 1999-1)

31. Për më tepër, Gjykata konsideron se Gjykata e Apelit e Kosovës nxori një vendim të arsyetuar mirë, sepse ajo shpjegon mangësitë ligjore dhe faktike të vendimeve të nxjerra nga Gjykata Themelore në Prishtinë gjegjësisht KPMK-ja, përveç sigurimit të bazës ligjore për të mbështetur konkluzionet e veta.

32. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve. Gjykata Kushtetuese dëshiron të ritheksojë se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe

instrumente të tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih, rastin *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* në Rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

33. Përveç kësaj, kërkesa nuk arrin të dëshmojë që Gjykata e Apelit e Kosovës ka vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

34. Fakti që parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës (Shih, rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

35. Në këto rrethana, parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur me prova pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që Gjykata e Apelit e Kosovës ia ka mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

36. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në përputhje me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 9 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. dr. Enver Hasani

KI111/14, Parashtrues të kërkesës Mladen Denić dhe Milorad Vitković-Denić, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I.-13-0041, të 5 qershorit 2014

KI 111/14, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 dhjetorit 2014, publikuar më 26 janar 2015

Fjalët kyç*: Kërkesë individuale, procedurë civile, masë e përkohshme, e drejta për gjykim të drejtë, mbrojtja e pronës, ratione materiae, kërkesë e papranueshme për arsye të ndryshme*

Në këtë kërkesë, parashtruesit e kërkesës pretenduan shkelje të të drejtave të tyre nga disa institucione dhe në disa baza: a) që Gjykata Supreme e Kosovës nxori një vendim të paligjshëm, b) procedurat në Gjykatën Themelore në Prishtinë ishin tepër të gjata, c) trupi i Kolegjit të ankesave të Dhomës së Posaçme nuk kishte përbërje të rregullt, dhe d) Prokurori Publik dhe Gjykata Supreme kishin ndërhyrë si institucione jokompetente.

Gjykata adresoi çdo pretendim të parashtruar nga parashtruesit e kërkesës dhe konstatoi se: i) lidhur me pretendimet në pikën a), kjo pjesë e kërkesës është vendosur tashmë dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (3) (d) të Rregullores së punës, ii) në lidhje me pretendimin në pikën B), kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme për shkak të mos-shterimit të të gjitha mjeteve juridike në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, iii) në lidhje me pretendimin në pikën C), kjo pjesë e kërkesës nuk është dëshmuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës dhe iv) lidhur me pretendimin në pikën Ç) kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme për shkak se nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, në bazë të rregullit 36 (3) (e) të Rregullores së punës. Sa i përket kërkesës së parashtruesve për masë të përkohshme, Gjykata konstatoi se nuk ekziston rasti *prima facie* për caktimin e masës së përkohshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI111/14
Parashtruesit
Mladen Denić dhe Milorad Vitković-Denić
Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I.-13-0041, të 5 qershorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Mladen Denić dhe z. Milorad Vitković-Denić, me vendbanim në Kralevë, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës). Ata përfaqësohen nga z. Branislav M. Vitković, me vendbanim në Kralevë, Republika e Serbisë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I.-13-0041 (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së), i 5 qershorit 2014, për të cilin parashtruesit e kërkesës deklarojnë se e kanë pranuar më 16 qershor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, kundër Aktvendimit (SCC-11-0026, të 20 marsit 2013) të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të

Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së), në lidhje me rikthimin e pronës së paluajtshme.

4. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] në lidhje me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe nenin 103 [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave], paragrafi 7.

5. Parashtruesit e kërkesës po ashtu kërkojnë që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të caktojë Masë të përkohshme, përkatësisht të ndalojë çdo shitje, rishitje, dhënie me qira apo nënqira, ndërtim apo vendosje të çfarëdo ngarkese mbi pronën e paluajtshme, e cila është objekt i kontestit.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 1 korrik 2014, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatë.

8. Më 5 gusht 2014, parashtruesit e kërkesës dorëzuan një dokument shtesë ku kërkuan që Gjykata të caktojë Masë të përkohshme.

9. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI111/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin KSH. KI111/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

10. Më 8 gusht 2014, Gjykata informoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që Mladen Denić ta dorëzojë autorizimin për Branislav M. Vitković, në rast se zgjedh të përfaqësohet nga ai, siç ishte njoftuar në kërkesë. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.

11. Më 20 gusht 2014, Mladen Denić dorëzoi në Gjykatë dokumentin e kërkuar.

12. Më 12 shtator 2014, Gjykata informoi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS) për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që të komentojë lidhur me pretendimet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës përkitazi me tejzgjatjen e procedurës.

13. Më 23 shtator 2014, DHPGJS dorëzoi komentet në Gjykatë.

14. Më 8 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, ta deklarojë kërkesën të papranueshme dhe ta refuzojë kërkesën për Masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

I. Procedura në Gjykatën Kushtetuese

15. Përveç kërkesës në fjalë, parashtruesit e kërkesës kishin parashtruar edhe dy kërkesa të tjera në Gjykatë. Kërkesa e parë (KI18/10) ishte dorëzuar më 24 shkurt 2010 dhe kërkesa e dytë (KI130/11) ishte dorëzuar më 3 tetor 2011.

16. Më 12 prill 2011, Gjykata vendosi për rastin nr. KI18/10, duke e refuzuar kërkesën e parashtruesve për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit (Gzz. Nr. 36/2007, të 13 dhjetorit 2007) të Gjykatës Supreme të Kosovës, si të papranueshme, për shkak se ata nuk i kishin shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion.

17. Pas marrjes së aktvendimit të sipërpërmendur për papranueshmëri, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë kërkesën e tyre të dytë, ku kërkuan një rishqyrtim të atij aktvendimi të Gjykatës.

18. Më 4 maj 2012, Gjykata nxori aktvendimin e saj për rastin nr. KI130/11 dhe e refuzoi kërkesën e parashtruesve për rishqyrtim të aktvendimit të saj për papranueshmëri, në pajtim me rregullin 36 (3) e) të Rregullores së punës, për shkak se ajo nuk konsideronte se ka bazë të mjaftueshme për një vendim të ri. Megjithatë, në lidhje me ankesën e parashtruesve përkitazi me tejzgjatjen e procedurës, Gjykata deklaroi se ky aktvendim "*nuk i ndalon parashtruesit e kërkesës të paraqesin kërkesë të re për t'u ankuar në zgjatjen e tepruar të*

procedurës" pasi *"të ngrenë ankesë në gjykatat më të larta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme".*

19. Më 1 korrik 2014, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë kërkesën e tyre të tretë, me të cilën e kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktvendimit (AC-I.-13-00415, të 5 qershorit 2014) të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.

II. Procedura në gjykatat e rregullta

20. Më 4 dhjetor 2006, parashtruesit e kërkesës parashtruan padi në DHPGJS, ku kërkuan rikthimin e pronës së paluajtshme, e cila ishte nacionalizuar për themelimin e Kooperativës bujqësore "Kosova" [më pas e njohur si "Ndërrmarrja Shoqërore Kosova Export"].

21. Më 31 janar 2007, Paneli i Specializuar i DHPGJS-së, me Aktvendimin SCC-06-0498, e referoi çështjen për gjykim në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

22. Më 16 prill 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi P. Nr. 236/97) gjykoi çështjen e referuar duke verifikuar pronësinë e parashtruesve mbi pronën e paluajtshme dhe urdhëroi që e njëjta t'i bartet në posedim parashtruesve të kërkesës.

23. Më 13 dhjetor 2007, duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga Prokurori i Shtetit, Gjykata e Supreme (Aktvendimi Gzz. Nr. 36/2007) anuloi aktgjykimin e sipërpërmendur të Gjykatës Komunale dhe e ktheu rastin për rigjykim në Gjykatën Komunale.

24. Më 3 tetor 2011, pasi që çështja ishte kthyer te Gjykata Komunale në Prishtinë dhe përderisa rasti ishte ende në pritje të zgjidhej, parashtruesit parashtruan një padi paralele në DHPGJS dhe kërkuan që:

    a) Aktgjykimi (P. nr. 236/97, i 16 prillit 2007) i Gjykatës Komunale në Prishtinë të vërtetohet nga DHPGJS-ja, pasi që sipas parashtruesve të kërkesës "*ky aktgjykim nuk është ankimuar dhe si rrjedhojë është bërë i plotfuqishëm më 5 maj 2007*"; dhe

    b) Aktvendimi (Gzz. Nr. 36/2007, i 13 dhjetorit 2007) i Gjykatës Supreme të Kosovës të shpallet i pavlefshëm, pasi që *"Gjykata Supreme nuk ka pasur kompetenca të shqyrtojë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale P. nr. 236/97 sepse në përputhje me aktvendimin e referuar, SCC-06-0498, Dhoma e Posaçme e ka*

ruajtur juridiksionin ekskluziv ndaj çdo ankese kundër aktvendimit apo aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë".

25. Më 22 qershor 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë i dërgoi shkresat e lëndës [procedurë e përsëritur për rastin P. Nr. 236/97] për gjykim në DHPGJS. Rasti ishte regjistruar në DHPGJS me numrin C-III-12-1095 dhe ende është në pritje në DHPGJS.

26. Më 4 mars 2013, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në DHPGJS kërkesë për urdhër paraprak gjyqësor kundër tre të paditurve, përkatësisht Gjykatës Supreme të Kosovës [i padituri 1], M. M. [i padituri 2] dhe Ndërmarrjes Shoqërore Kosova Eksport [i padituri 3].

27. Më 20 mars 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-ë me Aktvendimin SCC-11-0026 hodhi poshtë si të papranueshme padinë e parashtruesve dhe kërkesën për urdhër paraprak gjyqësor. Në arsyetimin e aktvendimit të saj, DHPGJS-ja konstatoi:

"[...] Gjykata konstaton se padia SCC-06-0498, e cila fillimisht u parashtrua në Dhomën e Posaçme më 4 dhjetor 2006 dhe që është referuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë është ende në pritje të zgjidhet, për arsye se për atë nuk është vendosur me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës. Në pajtim me nenin 4.4 të LDHP-së rasti u kthye në Dhomën e Posaçme nga Gjykata Komunale në Prishtinë dhe aktualisht është në pritje të zgjidhet, dhe mban numrin C-III-12-1095. Dy nga paditësit [parashtruesit e kërkesës] e këtij rasti e kishin parashtruar padinë në fjalë ku kërkonin që Dhoma e Posaçme të konfirmojë aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë [Aktgjykimin P. nr. 236/97, të datës 16 prill 2007] i cili ishte anuluar nga Gjykata Supreme [Aktvendimi Gzz. Nr. 36/2007, i datës 13 dhjetor 2007], me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Megjithatë, pasi që rasti i parë është ende në pritje të zgjidhet dhe është parashtruar përpara rastit në fjalë, ky i fundit është dashur të hidhet poshtë në pajtim me nenin 262.3 dhe 262.4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, nr. 03 /L-006 [...].

Prandaj, padia nuk i përmbush kërkesat e pranueshmërisë nga neni 28.2 i LDHP-së dhe refuzohet si e papranueshme. Rrjedhimisht, edhe kërkesa për urdhër paraprak gjyqësor është e papranueshme".

28. Më 8 prill 2013, parashtruesit dorëzuan ankesë kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së në Kolegjin e Ankesave të DHPGJS-së. Në ankesën e tyre, parashtruesit i kërkuan Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së "*ta prishë aktvendimin e ankimuar, të konfirmojë se aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës është i*

pavlefshëm, ta vërtetojë aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P . Nr 236/07, të 16 prillit 2007 dhe ta detyrojë Zyrën Kadastrale në Prishtinë ta zbatojë plotësisht këtë aktgjykim dhe t'i anulojë të gjitha transaksionet e kryera gjatë periudhës nga viti 2004 në lidhje me këtë çështje".

29. Më 5 qershor 2014, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së (Aktvendimi AC-I. 13-0041) refuzoi ankesën e parashtruesve si të pabazuar dhe konstatoi:

> *"Aktvendimi i ankimuar është i saktë dhe vërtetohet. Padia fillestare është ende në pritje të zgjidhet në DHPGJS [...]me numër C-III-13-1095. Objekti i çështjes është i njëjtë, sepse paditësi dëshiron të vazhdojë me padinë fillestare duke konfirmuar aktgjykimin fillestar të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe palët janë të njëjta, sepse shtimi i Gjykatës Supreme të Kosovës në të njëjtën procedurë me të njëjtën kërkesë nuk bën asnjë ndryshim. Me fjalë të tjera, paditësit kërkojnë që e njëjta padi të gjykohet me të njëjtin aktgjykim [...]".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] në lidhje me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe nenin 103 [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave], paragrafi 7.

31. Në mbështetje të pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se "*Gjykata Supreme e Kosovës (edhe pse parashtruesit pretendonin mungesën e juridiksionit), si një gjykatë jokompetente, është pajtuar që të vendosë për kërkesën e PPK-së* [Prokurorisë Publike të Kosovës], *dhe mori një aktvendim të paligjshëm Gzz. Nr 36/2007 të datës 13.12.2007, i cili kishte krijuar një situatë të përhershme që ka zgjatur deri më sot*".

32. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se "*[...] Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme [...] nuk ka pasur përbërje të rregullt, pasi që ai do të duhej të përbëhej nga tre (3) gjyqtarë ndërkombëtarë dhe dy (2) gjyqtarë vendorë, siç përcaktohet në nenin 3, paragrafi 12, të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, Nr. 04/033, i cili është i zbatueshëm deri më 01.07.2014*".

33. Në mbështetje të pretendimeve të tyre për tejzgjatje të procedurës, parashtruesit e kërkesës theksojnë: *"Me aktvendimin e paligjshëm të*

Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe më tutje me sjelljen e Gjykatës Themelore në Prishtinë, është krijuar një situatë e gjatë për gjithë periudhën 16.04.2007-13.12.2007-22.06.2012, e edhe më tutje, për shkak së cilës, parashtruesit nuk mund të disponojnë e të gëzojnë pronën sipas aktgjykimit të prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë P. no. 236/97 të datës 16.04.2007, i cili duhet ekzekutuar si aktgjykim i prerë [...].”

34. Në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të tyre sipas nenit 46 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës theksojnë se “*[...] me aktvendimin Gzz. Nr. 36/2007, të datës 13.12.2007, të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatë jokompetente në këtë procedurë, gjykata në mënyrë të paligjshme anuloi aktgjykimin e formës së prerë P. Nr. 236/97, të datës 16.04.2007, i cili na e pamundësoi gëzimin e të drejtës në pronë [...]”*.

35. Duke iu referuar pretendimeve të parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 54, në lidhje me nenet 102 dhe 103, paragrafi 7, të Kushtetutës, ata pretendojnë se *“[...] në vitin 2007, Prokurori Publik dhe Gjykata Supreme e Kosovës kanë ndërhyrë në kontest si institucione jokompetente [...]*”. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës *“[...] kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 25, paragrafi 1, në lidhje me nenin 182, paragrafi 2f, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Nr. 03/L-006, Nr. 04/L-118, që të zgjidhë konfliktin e kompetencave në këtë çështje juridike në mes të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe vetë Gjykatës Supreme të Kosovës*”.

36. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës i drejtohen Gjykatës me kërkesën si në vijim:

> *“Ne i propozojmë Gjykatës Kushtetuese që të prishë aktvendimin e Dhomës së Posaçme të GJSK AC-L-13-004/A001 të datës 05.06.2014 si dhe aktvendimin SCC-11-0226 të datës 20.03.2013, si dhe vendimin e gjykatës jokompetente – Gjykatës Supreme të Kosovës Cml-Gzz. nr. 36/2007 të datës 13.12.2007.*
>
> *Të lihet në fuqi aktgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 236/97 të datës 16.04.2007 [...].”*

Pranueshmëria e kërkesës

37. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

38. Në mënyrë që të adresojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me shkeljet e pretenduara kushtetuese, Gjykata konsideron se ato mund të përmblidhen dhe të ndahen si më poshtë:

A) Pretendimet lidhur me vendimin e pretenduar të paligjshëm të Gjykatës Supreme [neni 31 i Kushtetutës];

B) Pretendimet lidhur me tejzgjatjen e procedurës [neni 31 në lidhje me nenin 46 të Kushtetutës];

C) Pretendimi se Kolegji i Apelit të DHPGJS-së nuk ka pasur përbërje të rregullt kur ka vendosur për ankesën e parashtruesve të kërkesës [neni 31 i Kushtetutës];

Ç) Pretendimi se Prokurori Publik dhe Gjykata e Supreme kanë ndërhyrë si institucione jokompetente në rastin e parashtruesve [neni 54 në lidhje me nenet 102 dhe 103, paragrafi 7, i Kushtetutës].

***A) Për sa i përket pretendimeve të parashtruesve lidhur me vendimin e pretenduar të paligjshëm të Gjykatës Supreme* [neni 31 i Kushtetutës]**

39. Siç u theksua më lart, parashtruesit pretendojnë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, duke pretenduar se Gjykata Supreme e Kosovës "*[...] mori një aktvendim të paligjshëm Gzz. Nr 36/2007 të datës 13.12.2007, i cili kishte krijuar një situatë të përhershme që ka zgjatur deri më sot*".

40. Gjykata rikujton se ajo tashmë i ka shqyrtuar pretendimet e parashtruesve lidhur me *"paligjshmërinë"* e pretenduar të vendimit (Gzz. Nr. 36/2007, të 13 dhjetorit 2007) të Gjykatës Supreme të Kosovës kur ka vendosur për kërkesën e parë të parashtruesve (KI18/10, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 gushtit 2011) duke konstatuar:

"36. Sa i përket kërkesës në fjalë, Gjykata vëren që ajo ka të bëjë me çështje që kanë ndodhur para 15 qershorit 2008, dhe, si rrjedhojë, janë jashtë juridiksionit të Gjykatës. Prandaj, Gjykata duhet ta hedhë poshtë kërkesën si ratione temporis në mospërputhje.

37. Edhe po të supozohej se mund të ketë situatë të vazhdueshme në rastin në fjalë, nëse shkelja e Kushtetutës ishte shkaktuar nga një akt i kryer para hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe pasojat e atij akti origjinal ende ekzistojnë, që i japin

kompetencë Gjykatës ta shqyrtojë ankesën, kërkesa është e papranueshme.

38. Në procedurën e 13 dhjetorit 2007, në të cilën parashtruesit nuk ishin të pranishëm, Gjykata Supreme e aprovoi kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë, e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 16 prillit 2006, dhe ia ktheu rastin Gjykatës Komunale për rigjykim. Deri më tani, parashtruesit nuk kanë dorëzuar asnjë dëshmi që tregon se Gjykata Komunale tashmë ka caktuar seancë dëgjimore dhe ka marrë vendim për këtë çështje, përveç që në Gjykatën Komunale i kanë parashtruar ankesat e njëjta si në këtë Gjykatë.

39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47 (2) të Ligjit, sipas të cilave individët që paraqesin kërkesë në Gjykatë duhet t'i shterin të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi."

41. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

[...]

d) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri [...]".

42. Gjykata dëshiron të theksojë se, edhe pse parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktvendimin AC-I.-13-0041 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, thelbi i pretendimeve të parashtruesve qëndron në pakënaqësinë e tyre me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (Gzz. Nr. 36/2007, të 13 dhjetorit 2007), me të cilin u anulua Aktgjykimi (P. Nr. 236/97, i 16 prillit 2007) i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe çështja u kthye në rigjykim.

43. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se pretendimet nën pikën A) janë të njëjta me pretendimet e bëra në kërkesën e parë të parashtruesve dhe të njëjtat janë trajtuar nga kjo Gjykatë në Aktvendimin për papranueshmëri në rastin Nr. KI18/10.

44. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se, në bazë të rregullit 36 (3) d) të Rregullores së punës, nuk mund t'i rishqyrtojë pretendimet të cilat tashmë janë trajtuar nga Gjykata.

***B) Për sa i përket pretendimeve të parashtruesve lidhur me tejzgjatjen e procedurës* [neni 31 në lidhje me nenin 46 të Kushtetutës]**

45. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 46 të Kushtetutës sepse, sipas tyre, *"është krijuar një situatë e gjatë për periudhën 16.04.2007-13.12.2007-22.06.2012, e edhe më tutje"*, për shkak *"të sjelljes së Gjykatës Themelore/Komunale në Prishtinë"*.

46. Përveç kësaj, parashtruesit pretendojnë: *"Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme i dha shkresave të rastit [...] numër të ri C-III-12-1095, por as ajo, që nga data 22.06.2012 e deri më sot nuk ka ndërmarrë kurrfarë veprimi procedural, me gjasë prapë nga presioni i pronarëve të regjistruar në mënyrë të paligjshme të tokës në kontest"*.

47. Në vlerësimin e këtyre pretendimeve, Gjykata tërheq vëmendjen në nenin 47 (2) të Ligjit, i cili përcakton: *"Individi mund ta ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

48. Gjithashtu, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili përcakton: *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: (b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar"*.

49. Për qëllim të vlerësimit të pretendimeve të parashtruesve lidhur me tejzgjatjen e procedurës dhe me ndikimin që kjo tejzgjatje e pretenduar mund të ketë pasur në të drejtat e tjera kushtetuese të parashtruesve, Gjykata po ashtu rikujton arsyetimin e saj në rastin KI130/11, ku i ka refuzuar si të parakohshme pretendimet e parashtruesve në lidhje me "*tejzgjatjen e procedurës*". Në atë rast, Gjykata ka theksuar:

> *"17. [...] për ankesën e parashtruesve të kërkesës, të cilën po e bëjnë tani para kësaj Gjykate lidhur me zgjatjen e tepruar të procedurës, nuk është vendosur ende nga Gjykata Komunale. Andaj, të gjitha argumentet lidhur me pretendimet e zgjatjes së tepruar të procedurës duhet paraqitur nga parashtruesit e kërkesës në Gjykatën Komunale në Prishtinë dhe nëse nuk janë të kënaqur, të*

ngrenë ankesë në gjykatat më të larta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme.

18. Nga kjo rrjedh se, në bazë të rregullit 36 (3) e) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme. Megjithatë, siç është cekur më parë, kjo nuk i parandalon parashtruesit e kërkesës nga parashtrimi i një kërkesë të re duke u ankuar për stërzgjatje të procedurës".

50. Gjykata rikujton se Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, lidhur me çështjen e tejzgjatjes së procedurës para autoriteteve vendore, ka përcaktuar disa kritere, të tilla si: kompleksiteti i çështjes, sjellja e parashtruesve, sjellja e autoriteteve përkatëse, rreziku për parashtruesin në procedurë, gjendja (faza) e procedurës etj.

51. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesit ankohen për sjelljen e autoriteteve përkatëse, konkretisht Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe DHPGJS-së.

52. Për sa i përket kritereve të sjelljes së autoriteteve përkatëse, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme e Kosovës ia ka kthyer lëndën për rigjykim Gjykatës Komunale, më 13 dhjetor 2007. Kjo e fundit vendosi ta bartë rastin për gjykim në DHPGJS, më 22 qershor 2012. Aktualisht, siç është konfirmuar nga Paneli i Specializuar i DHPGJS-ë dhe nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së, rasti është në pritje të zgjidhet në DHPGJS.

53. Për më tepër, Gjykata po ashtu merr parasysh përgjigjen që ka pranuar nga DHPGJS lidhur me pretendimet e ngritura të parashtruesve për sa i përket stërzgjatjes së procedurës. Në shkresën e saj drejtuar Gjykatës, DHPGJS-ja theksoi:

"[...] Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme, më 17 Prill 2013, në bazë të kërkesës së paditësve ka marre aktvendim për bashkimin e procedurës në këto dy lëndë dhe lëndën C-III-12-1100 ia ka bashkuar lëndës C-III-12-1095. Me të njëjtin aktvendim është urdhëruar zyra e regjistrimit të Dhomës së Posaçme që këtë lëndë ta regjistroj me numër të ri për Kolegjin e likuidimeve të Dhomës së Posaçme. [...] Kjo lëndë pasi që ka qenë mjaft voluminoze dhe e shpërndarë është kompletuar në zyrën e regjistrimit dhe me 19.09.2014 është dorëzuar në punë te gjyqtari. Tani e tutje lidhur me këtë lëndë do të vazhdoj procedura sipas rregullave te Ligjit për Dhomën e Posaçme, për çka palët do të njoftohen rregullisht".

54. Në lidhje me periudhën kohore 2007-2012, Gjykata rikujton se Gjykata Komunale ka paraqitur një shpjegim i cili është dorëzuar më

22 shkurt 2012, gjatë kohës që Gjykata ishte duke vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës së dytë të parashtruesve, KI130/11. Në shpjegimin e saj, Gjykata Komunale kishte deklaruar:

> *"[...] Gjykata aktualisht është duke e vlerësuar kompetencën lëndore të saj, duke pasur parasysh që në të gjitha paditë e përmendura e paditur është Kooperativa Bujqësore Kosova [...] dhe sepse ndërkohë ka hyrë në fuqi Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.*
>
> *Ju informoj se rasti është caktuar për në dhjetor 2010 dhe për shkak të kompleksitetit të tij dhe numrit shumë të madh të rasteve në të cilat jemi duke punuar aktualisht, nuk kemi pasur mundësi ta caktojmë seancën para vitit 2011, si dhe po ashtu për arsye se adresat e paditësve janë në Republikën e Serbisë, që e bën komunikimin edhe më të vështirë".*

55. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se nga DHPGJS-ja nuk është marrë asnjë vendim gjyqësor i formës së prerë, pas Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë për ta bartur gjykimin e rastit te DHPGJS-ja. Në fakt, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së (Aktvendimi AC-I.-13-0041, i 5 qershorit 2014) e refuzoi ankesën e parashtruesve kundër Aktvendimit (SCC-11-0226, të 23 marsit 2013) të DHPGJS-së, pikërisht për arsyen se *"padia është ende në pritje të zgjidhet"*. Më konkretisht, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së konstatoi:

> *"[...] Padia fillestare, me numër C-III-13-1095, është ende në pritje të zgjidhet në DHPGJS. Objekti i çështjes është i njëjtë, sepse paditësi dëshiron të vazhdojë me padinë fillestare duke konfirmuar aktgjykimin fillestar të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe palët janë të njëjta [...]. Me fjalë të tjera, paditësit kërkojnë që e njëjta padi të gjykohet me të njëjtin aktgjykim".*

56. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se kërkesa duhet të vlerësohet si e parakohshme, sepse rasti i parashtruesve është ende në procedurë të rregullt gjyqësore dhe se shkeljet e pretenduara kushtetuese sipas pikës B) ende mbeten për t'u vlerësuar nga gjykatat e rregullta.

57. Në këto rrethana dhe, në veçanti, në lidhje me pretendimet e parashtruesve në pikën B), Gjykata vëren se parashtruesit nuk i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, dhe për këtë arsye Gjykata e refuzon këtë pjesë të kërkesës si të parakohshme, në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

***C) Për sa i përket pretendimit të parashtruesve se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nuk ka pasur përbërje të rregullt kur ka vendosur për ankesën e parashtruesve të kërkesës* [neni 31 i Kushtetutës]**

58. Në vlerësimin e këtyre pretendimeve, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...], ose*
> *d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

59. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës vetëm kanë theksuar që *"Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përbëhej nga tre gjykatës kombëtarë dhe dy ndërkombëtarë",* duke mos mbështetur pretendimin se si mund të ketë shkelur kjo të drejtën e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

60. Duke marrë parasysh thëniet e mësipërme, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesve të kërkesës në pikën C) duhet të refuzohen si qartazi të pabazuara, duke marrë parasysh se parashtruesit nuk kanë mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tyre për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës.

***Ç) Për sa i përket pretendimit se Prokurori Publik dhe Gjykata e Supreme kanë ndërhyrë si institucione jokompetente në rastin e parashtruesve* [neni 54, në lidhje me nenet 102 dhe 103, paragrafi 7, i Kushtetutës]**

61. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se është shkelur neni 54, në lidhje me nenet 102 dhe 103, paragrafi 7, i Kushtetutës sepse, sipas tyre, *"në vitin 2007, Prokurori Publik dhe Gjykata Supreme e Kosovës kanë ndërhyrë në kontest si institucione jo kompetente".*

62. Parashtruesit e kërkesës përpiqen ta argumentojnë pretendimin për shkelje duke pohuar: *"Procedura kontestimore është udhëhequr nga parashtruesit e kërkesës para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet që Lidhen me AKM-në, si gjykata e vetme kompetente dhe më e lartë në Kosovë për këto çështje [...]".*

63. Për ta korrigjuar këtë pretendim për shkelje kushtetuese, parashtruesit kërkojnë që Gjykata *"ta zgjidhë konfliktin e kompetencave në këtë*

çështje juridike midis Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe vetë Gjykatës Supreme të Kosovës".

64. Në këtë drejtim, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (3) e) të Rregullores së punës, i cila parasheh: *"(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: e) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën."*

65. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se çështja e zgjidhjes së "*konfliktit të kompetencave*" ndërmjet DHPGJS-së dhe Gjykatës Supreme, apo të çfarëdo konflikti tjetër të kompetencave ndërmjet gjykatave të rregullta, nuk është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

66. Rrjedhimisht, Gjykata i refuzon pretendimet e bëra në pikën D), në pajtim me rregullin 36 (3) e), sepse kërkesa e parashtruesve nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

67. Si përfundim, Gjykata konstaton se kjo kërkesë duhet të deklarohet e papranueshme për shkaqet e mëposhtme:

    i) Lidhur me pretendimet në pikën A), kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (3) d);

    ii) Lidhur me pretendimin në pikën B), kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës;

    iii) Lidhur me pretendimin në pikën C), kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës; dhe

    iv) Lidhur me pretendimin në pikën Ç), kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (3) e) të Rregullores së punës.

Vlerësimi i kërkesës për Masë të përkohshme

68. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë nga Gjykata të caktojë Masë të përkohshme, përkatësisht të ndalojë shitjen, rishitjen, dhënien me qira dhe nënqira, ndërtimin ose vënien e çfarëdo ngarkese mbi ngastrën kadastrale që është objekt kryesor i këtij kontesti.

69. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës pretendojnë:

"Për shkak të mosekzistimit të masës së përkohshme për ndalimin e ndryshimit të pronësisë mbi ngastrën kadastrale nr. 1536/1 [...] bazuar në Aktgjykimin e rremë/të pavlefshëm P. nr. 395/96, e ka bartur të drejtën e pronësisë tek M. M. nga fshati Uglare – Komuna e Gracanicës në bazë të kontratave të pavlefshme për shitblerje, të lidhura më 19.03.2004, me M. M. dhe disa persona fizikë nga Prishtina, më 14.05.2012, e ka bartur të drejtën e pronësisë tek blerësit e rinj "joligjorë". Ne [...] e lusim Gjykatën e titullit të parandalojë veprimet e planifikuara të rishitjes, dhe që urgjent sipas kërkesës-ankesës sonë kushtetuese të datës 01.07.2014, dhe sipas propozimit, të caktojë këtë:

MASË TË PËRKOHSHME

Ndalohet: shitja, rishitja, dhënia me qira dhe nënqira, ndërtimi dhe vënia e çfarëdo ngarkese mbi ngastrën kadastrale [...] ka qenë e evidentuar në fletën poseduese nr. 4011 ZK Prishtinë në emrin e shfrytëzuesit KBI "K.E" Ndërmarrje Shoqërore, kurse prej datës 14.05.2012 evidentohet në emrin e disa pronarëve privatë joligjorë, deri në përfundimin e plotfuqishëm të kësaj procedure.

Këtë masë do ta zbatojnë: Zyra Kadastrale e Komunës së Prishtinës dhe inspektorati kompetent ndërtimor i Komunës së Prishtinës" .

70. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se procedura është ende duke u zhvilluar në gjykatat e rregullta. Prandaj, Gjykata konsideron që kërkesa për Masë të përkohshme nuk është e zbatueshme, për arsye se nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me Ligj dhe me Rregullore të punës.

71. Në mënyrë që Gjykata të lejojë Masë të përkohshme, në përputhje me rregullat 55 (4) dhe (5) të Rregullores së punës, ajo duhet të konstatojë:

"[...]

(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të
pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme.

(c) Masa e përkohshme është me interes publik.

[...]

5) Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".

72. Siç u konstatua më lart, kërkesa është e papranueshme dhe, prandaj, nuk ekziston rasti *prima facie* për caktimin e Masës së përkohshme. Për këto arsye, kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 27 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) b), 36 (2) (d), 36 (3) (d), 36 (3) (e), 55 (4) dhe (5), dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 8 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Kadri Kryeziu	Prof. dr. Enver Hasani

KI116/14, Parashtrues i kërkesës Fadil Selmanaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA nr. 294/2013, të 4 shkurtit 2014

KI 116/14, Aktvendim për papranueshmëri, i 9 dhjetorit 2014, publikuar më 26 janar 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mosshterimi i mjeteve juridike*

Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin AA nr. 294/2013, të 4 shkurtit 2014, aprovoi padinë e Komunës së Mitrovicës me të cilën parashtruesi nuk u riemërua në pozitën e tij të mëparshme të punës.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi, *inter alia,* se Gjykata e Apelit e Kosovës kishte shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, sepse atij i ishte mohuar e drejta për të mbrojtur rastin e tij.

Gjykata Kushtetuese konsideroi se parashtruesi nuk ka proceduar më tej me mjetin e duhur juridik ashtu siç parashihet me ligjin e aplikueshëm në Kosovë. Kërkesa e parashtruesit u deklarua e papranueshme për shkak të mos-shterimit të të gjitha mjeteve juridike të parapara me nenin 113.7 të Kushtetutës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI116/14
Parashtrues
Fadil Selmanaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA nr. 294/2013,
të 4 shkurtit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Fadil Selmanaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA. nr. 294/2013, të 4 shkurtit 2014, i cili i ishte dorëzuar atij më 12 mars 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 8 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI116/14 caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI116/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

7. Më 20 gusht 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit të Kosovës.

8. Më 4 shtator 2014, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamentin për Çështje Administrative lidhur me regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo shkresat e plota të lëndës.

9. Më 8 shtator 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative dorëzoi shkresat e plota të lëndës (nr. A354/12) në Gjykatë.

10. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në vijim është përmbledhja e fakteve, siç janë paraqitur nga parashtruesi në kërkesën e tij dhe të evidentuara në shkresat e lëndës nr. A 354/12 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative.

12. Më 2001, parashtruesi i kërkesës ishte punësuar si drejtor i Drejtoratit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Gjykatën Komunale në Mitrovicë.

13. Më 7 prill 2007, parashtruesit të kërkesës i ishte vazhduar kontrata e punës dhe ai ishte riemëruar në pozitën e njëjtë deri më 9 mars 2008.

14. Më 11 janar 2008, Kryetari i Komunës së Mitrovicës nxori Vendimin nr. 01/49 me të cilin emëroi drejtorët e drejtorive në Komunën e Mitrovicës. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ishte riemëruar.

15. Më 2 tetor 2008, parashtruesi i kërkesës, parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMK-ja).

16. Më 10 shkurt 2009, KPMK-ja me Aktvendimin nr. A.02/285/2008 aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e obligoi Komunën e Mitrovicës: *"që në afatin prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesit t'i mundësoj realizimin e të gjitha të drejtave nga marrëdhënia e punës në përputhje me kontratën e punës, në atë mënyrë që në pamundësi eventuale të kthimit të ankuesit në punë dhe detyrat e punës sipas kontratës së punës, atëherë në përputhje me dispozitat e nenit 11 par. 11.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 2003/2, mbi zbatimin e Rregullores nr.2001/36, mbi Shërbyesit Civil të Kosovës, ta ricaktoj në një post tjetër në nivel dhe shkallë të njëjtë të rrogës, në përputhje me përgatitjen dhe aftësitë e tij profesionale".*

17. Më 24 shkurt 2009, Komuna e Mitrovicës kontestoi vendimin e KPMK-së në Gjykatën Supreme të Kosovës.

18. Më 25 shtator 2009, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin A. nr. 170/2009 aprovoi padinë e Komunës së Mitrovicës dhe anuloi vendimin e KPMK-së nr. A. 02/285/2008, të 10 shkurtit 2009.

19. Më 28 tetor 2010, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën (Rasti nr. KI108/10) në Gjykatë, me të cilën kontestonte kushtetutshmërinë e aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme të Kosovës.

20. Më 5 dhjetor 2011, Gjykata nxori Aktgjykimin në Rastin nr. KI108/10 dhe deklaroi kërkesën të pranueshme. Gjykata gjithashtu konstatoi shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, lidhur me paragrafin 1, të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Rrjedhimisht, Gjykata e shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe e ktheu rastin për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e saj.

21. Në aktgjykimin e saj, Gjykata, *inter alia*, vëren se "*... parashtruesi kurrë nuk ka marrë kopje të aktgjykimit nga Gjykata Supreme. Për më tepër, Gjykata Supreme, nëpërmjet letrës së vet të 8 tetorit 2010, nuk ia dërgoi parashtruesit kopjen e aktgjykimit dhe e udhëzoi t'i drejtohej KPMK-së dhe më pas të kërkonte kopje të aktgjykimit. Prandaj, duket që parashtruesi nuk i ka pasur në dispozicion mjetet e parashikuara juridike".*

22. Në arsyetim, Gjykata theksoi që: "*Gjykata përsëri vëren që, në këtë rast, procedura ka filluar në Gjykatën Supreme dhe ajo ka nxjerrë*

vendim përfundimtar pa praninë e parashtruesit në procedurë dhe pa e njoftuar atë për vendimin qe e ka nxjerrë".

.

23. Në këtë drejtim, Gjykata gjithashtu thirret në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, ku thuhet: "*GJEDNJ më tej konsideroi që "e drejta e ndërgjyqësit për qasje në gjykatë do të ishte iluzore sikur ai/ajo të mos informohej për zhvillimet në procedurë dhe vendimet e gjykatës lidhur me ankesën, posaçërisht nëse vendimet e tilla janë të natyrës së tillë sa që do ta parandalonin shqyrtimin e mëtejmë".* (Shih, *Sukhorubchenko kundër Rusisë,* Aktgjykimi i 10 shkurtit 2005, paragrafi 53.)".

24. Më 17 tetor 2012, lidhur me rastin nr. KI108/10, Gjykata ishte njoftuar nga Gjykata Supreme e Kosovës që: *"... lidhur me këtë çështje, ne ju informojmë se ky rast në Gjykatën Supreme ka marrë numrin e regjsitrimit A. nr. 354/12 dhe është caktuar që të punohet më..."*.

25. Më 1 janar 2013, hyri në fuqi ligji për gjykatat Nr. 03/L-199. Në pajtim me nenin 14.1 të Ligjit: *"Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj"*.

26. Më 11 korrik 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, pas shqyrtimit kryesor, ku ishte i pranishëm parashtruesi i kërkesës, nxori Aktgjykimin A. nr. 354/12 dhe refuzoi si të pabazuar padinë e Komunës së Mitrovicës.

27. Më 22 gusht 2013, Komuna e Mitrovicës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative. Parashtruesit të kërkesës nuk i ishte dorëzuar kopja e ankesës.

28. Më 4 shkurt 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktgjykimin AA nr. 294/2013 vendosi që: i) të aprovojë padinë e Komunës së Mitrovicës, ii) të anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A. nr. 354/12, të 11 korrikut 2013, iii), të anulojë Vendimin e KPMK-së A 02/285/2008 të 10 shkurtit 2009, dhe iv), Vendimi nr. 01/49 i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës, i 11 janarit 2008 mbetet në fuqi.

29. Në aktgjykimin e lartcekur, Gjykata e Apelit e Kosovës, arsyetoi:

> *"Kolegji i Gjykatës se Apelit, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes dhe duke e shqyrtuar vendimin e Kryetarit të Komunës së*

Mitrovicës, vendimin e të paditurës KPM, aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë si dhe shkresat e tjera të lëndës gjen se, vendimi i KPM-së, dhe aktgjykimi i ankimuar nuk janë të plotë, në përmbajtjen e tyre se nuk i kanë përfshirë të gjitha provat dhe argumentet e ofruara nga palët ndërgjyqëse, por janë bazuar vetëm ne disa prova dhe shkresa, pa u shqyrtuar në tërësi çështja si e tillë. Gjykata e shkallës së parë po ashtu nuk i shqyrton te gjitha provat dhe thëniet nga padia ashtu siç parashihet në nenin 44 të LKA-së, duke anashkaluar faktin se në padi paditësi thirret në ndryshimin e legjislacionit që ka përkuar me lëmin organizativ të organizimit të komunës, duke shfuqizuar të gjitha dispozitat paraprake të zgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve deri me atëherë në cilësinë e shërbyesve civil".

30. Më 12 mars 2014, një kopje e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës.

31. Më 21 mars 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër vendimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

32. Më 30 maj 2014, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev. A. nr. 6/2014 refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

33. Në vendimin e lartcekur, Gjykata Supreme e Kosovës, *inter alia*, arsyetoi:

"..., kjo Gjykatë gjeti se kundër vendimeve të formës së prerë për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme dhe prokurori publik mund të parashtrojë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, që do të thotë se kundër vendimeve të formës së prerë për çështje administrative të shkallës së dytë nuk mund të paraqitet revizion, prandaj, kjo Gjykatë e refuzon revizionin e parashtruar nga Fadil Selmanaj si të papranueshëm".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon që *"...Gjykata e Apelit e Kosovës me këtë aktgjykim ka bërë të njëjtën shkelje të cilën edhe me herët e ka bërë Gjykata Supreme e Kosovës... Gjykata e Apelit të Kosovës nuk e ka njoftuar palën e interesuar Fadil Selmanin".*

35. Parashtruesi i kërkesës pretendon që "... *Gjykata e Apelit nuk është lëshuar fare në shqyrtimin e lëndës së parastruesit të kërkesës... nuk ka marrë për bazë fare vendimin e KPMK-së, vendimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë... duke dashur t'i ikë përgjegjësisë së plotë, Gjykata e Apelit është lëshuar me pa të drejtë vetëm në vlerësimin se kinse Rregullorja NR. 2007/30 ku ka paraparë postet e Drejtorëve si poste të emëruara politike ... dhe kinse të gjitha pozitat e drejtorëve të mëhershëm automatikisht nënkuptohen se duhet pushuar vendi i punës... edhe pse parashtruesi i kërkesës, nuk ka qenë i emëruar politik por shërbyes civil i pranuar në punë me anë të konkursit dhe i përzgjedhur në bazë të konkursit në vendin e punës me kontratë".*

36. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit të Kosovës kishte shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, sepse nuk ia dha atij të drejtën për të mbrojtur rastin e tij.

Ligji

Ligji Nr. 03/L-202 për Konflikte Administrative

Neni 24

Kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrojë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.

Kërkesa nga paragrafi 1. i këtij neni mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes.

Mbi kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të gjykatës vendos Gjykata Supreme e Kosovës.

Neni 55

Rishikimi

Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi, që ka marrë formë të prerë, kur:

...

personit të interesuar nuk i është dhënë mundësia për të marrë pjesë në konfliktin administrativ.

Pranueshmëria e kërkesës

37. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

39. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47.2 të Ligjit, i cili përcakton se:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

40. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës i cili përcakton:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
...
(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar ...".

41. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, i cili ishte refuzuar si i papranueshëm për arsye procedurale.

42. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i referohet rastit nr. KI108/10, duke pretenduar se *"... Gjykata e Apelit e Kosovës me këtë Aktgjykim ka bërë të njëjtën shkelje të cilën edhe me herët e ka bërë Gjykata Supreme e Kosovës... Gjykata e Apelit të Kosovës nuk e ka njoftuar palën e interesuar Fadil Selmanin".*

43. Lidhur me rastin nr. KI108/10, kjo Gjykatë deklaroi se *"nuk ka prova që parashtruesi ka qenë i njoftuar për mundësinë e përsëritjes së procedurës në Gjykatën Supreme, apo që ka pasur mundësi të paraqitet në procedurë të re për t'i paraqitur argumentet e veta".*

44. Gjykata vëren se përderisa në rastin nr. KI108/10, parashtruesi i kërkesës kurrë nuk ka pranuar një kopje të aktgjykimit nga Gjykata Supreme prandaj nuk kishte mundësinë për procedurë të re, në rastin në fjalë, parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar kopja e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe kështu, pati mundësinë që të përdorë mjetet e parapara me Ligjin për Konflikte Administrative Nr. 03/L-202.

45. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka përdorur mjet juridik përkatës dhe të përshtatshëm që e kishte në dispozicion dhe për këtë arsye nuk ka respektuar format e parapara me ligjin e aplikueshëm në Kosovë. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka bërë çdo gjë që mund të pritej në mënyrë të arsyeshme prej tij në lidhje me shterimin e mjeteve juridike (Shih rastin D. H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke, Nr. 57325/00, GJEDNJ, Aktgjykimi i 13 nëntorit 2007, para. 116).

46. Gjykata konsideron se në mënyrë që parashtruesi i kërkesës të lirohet nga detyrimi për të shterur të gjitha mjetet juridike që janë të obligueshme për të, ai duhet të tregojë se: i) mjeti juridik në të vërtetë ishte përdorur, ii) mjeti juridik ishte i papërshtatshëm dhe joefektiv në lidhje me rastin e tij, dhe iii) se kanë ekzistuar rrethanat e veçanta për shfajësimin e parashtruesit nga kërkesa për të shterur të gjitha mjetet juridike. Nga dokumentet që gjenden në kërkesë, nuk ka asgjë që tregon se parashtruesi i kërkesës i plotëson kriteret për t'u liruar nga shterja e të gjitha mjeteve juridike në dobi të tij.

47. Për më tepër, Gjykata vëren se pas aktgjykimit të saj në rastin nr. KI108/10, është krijuar një rast i ri me dinamikën e vet dhe, në kontekstin e ri, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike.

48. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih rastin KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë,* Aktvendim për papranueshmëri i 21 janarit 2010, dhe *mutatis mutandis,* shih rastin GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës,* Nr. 25803/94, Vendimi i GJEDNJ-së, i 28 korrikut 1999).

49. Prandaj, parashtruesi i kërkesës, duke mos proceduar më tej me mjet juridik përkatës, siç parashihet me ligjin e aplikueshëm në Kosovë, mban përgjegjësinë që rasti i tij të deklarohet i papranueshëm, meqë

do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për procedim të mëtejshëm për të kundërshtuar shkeljen e të drejtave kushtetuese. (Shih rastin KI16/12, parashtrues i kërkesës *Gazmend Tahiraj,* Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 majit 2012).

50. Nga kjo rrjedh se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet efektive të parapara me nenin 113.7 të Kushtetutës, në mënyrë që Gjykata të vazhdojë me pretendimet lidhur me kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 9 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. dr. Enver Hasani

KI51/14, Parashtrues i kërkesës Radomir Radosavljević, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 301/2013, të 17 dhjetorit 2013

KI 51/14, Aktvendim për papranueshmëri, i 9 dhjetorit 2014, i publikuar më 3 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, e drejta për gjykim të drejtë, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 301/2013, të 17 dhjetorit 2013 aprovoi vendimin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, me të cilin ishte ndërprerë punësimi i parashtruesit të kërkesës.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Gjykata Supreme i ka mohuar atij të drejtën për një gjykim të drejtë, sepse nuk arriti të adresojë objektin e çështjes.

Gjykata vërejti se parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta të paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit të aplikueshëm në Gjykatën Supreme. Gjykata arsyetoi se ajo nuk ka gjetur se procedurat përkatëse si tërësi kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit nuk ishte dëshmuar dhe e deklaroi atë të papranueshme si qartazi të pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI51/14
Parashtrues
Radomir Radosavljević
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 301/2013, të 17 dhjetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Radomir Radosavljević. Ai përfaqësohet nga z. Agim Lushta, avokat, banor i Mitrovicës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 301/2013, të 17 dhjetorit 2013. Ky aktgjykim i ishte dorëzuar parashtruesit më 8 shkurt 2014.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 mars 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 2 prill 2014, Kryetari caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

7. Më 21 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës.

8. Më 6 qershor 2014, Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës (MPB-PK), përmes përfaqësuesit të saj ligjor, Departamenti për Përfaqësim Ligjor në Ministrinë e Drejtësisë, dorëzoi sqarime shtesë.

9. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Nga shkresat e lëndës rrjedh se parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar në Policinë e Kosovës, në stacionin e policisë në Zveçan, në Drejtorinë Rajonale të Mitrovicës, në pozitën e Togerit të Policisë. Në kohën e ngjarjeve të përshkruara më poshtë ai ishte Udhëheqës i Njësisë së Sigurisë në Gjykatën e Mitrovicës-Veri.

11. Më 13 maj 2011, parashtruesi i kërkesës ishte emëruar komandant i stacionit të policisë në Zveçan. Ky vendim do të hynte në fuqi më 16 maj 2011, në të cilën ditë pritej që parashtruesi të paraqitej në detyrë në këtë funksion të ri. Nga shkresat shihet që parashtruesi i kërkesës në këtë kohë ka qenë në pushim vjetor.

12. Më 24 maj 2011, pasi që parashtruesi ende nuk ishte paraqitur në detyrë si Komandant i Stacionit Policor në Zveçan, kishte filluar një

hetim i brendshëm disiplinor kundër tij, dhe parashtruesi ishte suspenduar nga detyra për 48 orë, efektshëm nga 25 maji 2011. Me sa duket, në këtë kohë parashtruesi ishte paraqitur në detyrë përsëri në vendin e tij të mëparshëm si Udhëheqës i Njësisë së Sigurisë në Gjykatën e Mitrovicës-Veri.

13. Më 4 korrik 2011, marrëdhënia e punës së parashtruesit të kërkesës me Policinë e Kosovës ishte ndërprerë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës në bazë të "mosbindjes së rëndë nga neni 46 (b) të Ligjit, Nr. 03/L-035 (Ligji për Policinë) të 20 shkurtit 2008, dhe siç përcaktohet më tej në udhëzimet përkatëse administrative. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij vendimi te Ministri i Punëve të Brendshme.

14. Më 19 gusht 2011, Ministri i Punëve të Brendshme refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi paraqiti padi kundër këtij vendimi në Gjykatën Komunale në Mitrovicë.

15. Më 24 dhjetor 2012, me Aktgjykimin C. nr. 188/2011, Gjykata Komunale në Mitrovicë anuloi Vendimin e Ministrit të Punëve të Brendshme, të 19 gushtit 2011 dhe Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, të 4 korrikut 2011, me të cilin i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës parashtruesit të kërkesës. Gjykata Komunale në Mitrovicë urdhëroi Ministrinë e Punëve të Brendshme ta kthejë parashtruesin e kërkesës në pozitën e tij të mëparshme në Polici të Kosovës dhe t'ia kompensojë atij shpenzimet e procedurës gjyqësore.

16. Gjykata Komunale në Mitrovicë bazoi vendimin e saj, *inter alia*, në arsyet e mëposhtme:

> *"Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë sa më të drejtë dhe të plotë u lëshua në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të emërimit gjë që e kërkonte edhe pala paditëse ndërsa në këtë rast kjo çështje konsiston si qështje paraprake, sepse kjo është e lidhur ngushtë me vendimin mbi ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe se vetëm në këtë mënyrë mund të vërtetohet gjendja në faktike në tërësi.*
>
> *Sipas Ligjit për Policinë [Ligji Nr. 03/L-035 i 20 shkurti 2008], neni 40 dhe neni 41 e kërkojnë si kusht që përzgjedhja apo emërimi i komandantëve në stacionet policore bëhet në bashkëpunim me autoritetet lokale (bashkësitë lokale), e sidomos në vendet apo lokalitetet ku shumicë përbënë komuniteti serb. Sipas po të njëjtit ligj, udhëheqja lokale i jep 3 propozime për komandantë pas kërkesës së drejtorit të përgjithshëm të policisë së Kosovës të bërë*

në drejtim të tyre. Në rastin konkret në shkresat e lëndës nuk ka asnjë shkresë me të cilën do të vërtetohej se drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës i ka bërë kërkesë autoriteteve lokale për emërimin e komandantëve të stacioneve përkatëse, ndërsa një gjë të tillë nuk arriti ta provoj e paditura [gjegj. Ministria e Punëve të Brendshme] as në seanca gjyqësore

[...]

[Parashtruesi i kërkesës] akuzohet për mosbindje të rëndë (moszbatim të urdhërit dhe mungesës pa arsye për më shumë se tri ditë në punë) që sanksionohet si shkelje e rëndë sipas ligjit për policinë dhe udhëzimeve administrative.

[...]

Më lart u potencua fakti se vendimi mbi emërimin është jo i ligjshëm, pikërisht sepse është bërë pa u konsultuar fare me autoritet lokale në atë komunë, kjo pastaj ka pasuar me pamundësinë e [parashtruesit e kërkesës] për të zbatuar vendimin, jo me refuzimin për një gjë të tillë. Pamundësia dhe refuzimi janë terme diametralisht të kundërta, përderisa pamundësia ka të bëjë me mungesën e kushteve apo rrezikun në rast zbatimi të vendimit përkundër vullnetit dhe dëshirës së paditësit, ndërsa te refuzimi kemi të bëjmë me një refuzim apo jo gatishmëri për zbatim.

[...]

Nga shkresat tjera të lëndës vërtetohet fare qartë se [parashtruesi i kërkesës] nuk ka munduar ta ushtroi pozitën e re, ndërsa është kthyer dhe ka punuar në pozitën e mëhershme si shef i njësisë së sigurimit të gjykatës në veri, do të thotë nuk kemi as mungesë pa arsye [...].

Ndërsa krejt në fund gjykata konsideron se paditësi edhe ashtu nuk ka qenë i obliguar ta zbatoj vendimin e tillë mbi emërimin pasi që ky vendim ka qene i paligjshëm, ku në nenin 13 paragrafi 2 thuhet se: "Zyrtari policor ka për detyrë t' i refuzojë urdhrat të cilët janë qartësisht të paligjshëm dhe të raportojë për ta, pa u frikësuar nga ndëshkimi."

[...]"

17. Më 5 korrik 2013, me Aktgjykimin AC. nr. 419/2013, Gjykata e Apelit refuzoi si të pabazuar ankesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Mitrovicës. Ministria

e Punëve të Brendshme paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme.

18. Më 17 dhjetor 2013, me Aktgjykimin Rev. nr. 301/2013, Gjykata Supreme aprovoi revizionin si të bazuar. Gjykata Supreme konsideroi se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vërtetuar drejtë faktet e rastit, por kanë zbatuar gabimisht ligjin. Në veçanti, Gjykata Supreme hodhi poshtë pretedimin se vendimi për të caktuar parashtruesin e kërkesës në pozitën e Komandantit të Stacionit të Policisë së Zveçanit ishte i paligjshëm, dhe se, për këtë arsye, vendimi për ndërprerjen e punësimit të tij ishte i paligjshëm. Lidhur me këtë, Gjykata Supreme konsideron se:

> *"Një pikëpamje e tillë juridike për këtë Gjykatë është e papranueshme, sepse objekt shqyrtimi në këtë çështje juridike nuk është vlerësimi i ligjshmërisë së emërimit [të parashtruesit të kërkesës] në vendin e komandantit të Stacionit Policor të Zveçanit, por vendimi për pushimin e marrëdhënies së punës".*

19. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konkludoi se:

> *"Për këto arsye, janë të bazuara pretendimet e ngritura në revizion se të dy aktgjykimet e goditura janë marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, prandaj ato u ndryshuan dhe kërkesëpadia [e parashtruesit të kërkesës] u refuzua si e pabazuar".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij kushtetuese, të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme i ka mohuar atij të drejtën për një gjykim të drejtë, sepse nuk arriti të adresojë objektin e çështjes.

22. Parashtruesi i kërkesës theksoi se:

> *"Objekti i kontestit i pretenduar nga paditësi ka qenë ligjshmëria e vendimit të Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës datë 13.05.2011 me të cilën pala – [parashtruesi i kërkesës] emërohet Komandant i stacionit policor në Zveqan [...] Gjykata Supreme e Kosovës nuk është shprehur ne se vendimi Drejtorit të*

përgjithshëm të Policisë së Kosovës datë 13.05.2011 është i ligjshëm apo jo.

[...]

Gjykata Supreme [...] e kishte për detyrë të kryente një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm e në përputhje me ligjin (neni 7 dhe 8 K. Pr. kontestimore) për të sqaruar nëse vendimi Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës datë 13.05.2011 është në pajtim apo në kundërshtim me ligjin. Duke mos u shprehur për ligjshmërinë e vendimit të Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës datë 13.05.2011, gjykata Supreme ka lënë pa zgjidhur mosmarrëveshjen objekt i gjykimit".

23. Në veçanti, parashtruesi i kërkesës konsideron se:

"Gjykata Supreme e Kosovës, lidhur me zbatimin e vendimit për emërimin e komandantëve në pozitat e reja komanduese në pjesën veriore të Kosovës, duhet të kishte parasysh se edhe vetë policia e Kosovës e cila në radhët e veta ka afër 10.000 pjesëtarë, nuk ka mundur që të depërtojë në këto lokalitete përkundër forcës se saj. Gjatë tentimit për të marrë pjesët e këtyre lokaliteteve ka ra si dëshmor i ndjeri polici Enver Zymeri dhe shumë të tjerë janë plagosur. Kjo tregon se vullneti i [parashtruesit të kërkesës] dhe mundësia e zbatimit të vendimit të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës për tu bërë komandant i stacionit policor në Zveçan ishte e barabartë me zero, pasi që këtu kemi pas të bëjmë me një person të vetëm të lënë në mëshirë dhe të pa ndihmuar nga institucionet relevante për zbatim të vendimit të drejtorit të Përgjithshëm".

24. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se ai nuk ishte trajtuar në mënyrë të barabartë, në shkelje të nenin 24 të Kushtetutës, sepse, *"[...] ndërimi i komandantëve është bërë në mënyrë selektive përkatësisht vetëm në rajonet ku banojnë komuniteti serb në shumicë të banorëve e jo edhe në rajonet tjera, gjë që tregon qartë qëllimet politike të vendimit të Drejtorit të përgjithshëm të policisë së Kosovës me çka shkaktohet diskriminimin nacional dhe shkelje të nenit 2 dhe 3 të ligjit kundër diskriminimit".*

Pranueshmëria e kërkesës

25. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

26. Gjykata duhet gjithashtu të vërtetojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës dhe të nenit 47.2 të Ligjit. Neni 113, paragrafi 7 parasheh se:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

27. Vendimi i fundit për rastin e parashtruesit të kërkesës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 301/2013, i 17 dhjetorit 2013. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës ka dëshmuar se ai i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit.

28. Parashtruesi i kërkesës duhet gjithashtu të dëshmojë se i ka plotësuar kërkesat e nenit 49 të Ligjit në lidhje me parashtrimin e kërkesës brenda afatit ligjor. Nga shkresat e lëndës mund të shihet se vendimi përfundimtar për rastin e parashtruesit është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 301/2013, i 17 dhjetorit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më ose rreth 8 shkurtit 2014, ndërsa parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën në Gjykatë më 19 mars 2014, që do të thotë se kërkesa është paraqitur brenda afatit prej 4 (katër) muajsh të parashikuar me Ligj dhe me Rregullore të punës.

29. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohen të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërisë). Prandaj, në këtë rast, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

30. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë ashtu që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa Nr. 13071/87, e 10 korrikut 1991).

31. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta të paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit të aplikueshëm në Gjykatën Supreme. Interpretimi i objektit të çështjes

së rastit është në kuadër të fushëveprimit të Gjykatës Supreme. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,* Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

32. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës gjithashtu thirret në nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës Supreme, i kontestuar nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e pengon parashtruesin e kërkesës të punojë ose të ushtrojë profesionin. Me vendimin e saj, Rev. nr. 301/2013, Gjykata Supreme thjesht vërtetoi se punësimi konkret i parashtruesit të kërkesës me Policinë e Kosovës ishte ndërprerë në mënyrë të ligjshme. Kjo në asnjë mënyrë nuk e pengon ose ndalon parashtruesin e kërkesës që të fillojë ndonjë punë tjetër që ai mund të zgjedhë. Si të tillë, nuk ka asgjë në pretendimet e parashtruesit që arsyeton përfundimin se atij i është cenuar e drejta kushtetuese e punës.

33. Përveç kësaj, Gjykata vëren se pretendimi i parashtruesit të kërkesës në lidhje me diskriminimin në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës është i bazuar në pretendimin e tij se në kohën e shkarkimit të tij nga puna, komandantët e rinj të stacioneve ishin emëruar vetëm në zonat e populluara me shumicë nga pjesëtarët e komunitetit serb. Parashtruesi nuk ka treguar se si kjo ka të bëjë me emërimin e komandantëve të stacioneve në zonat tjera të Kosovës, dhe në çfarë mënyre emërimi i tij ishte ndryshe nga ai i komandantëve të stacioneve të tjera.

34. Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar se, si emërimi dhe shkarkimi pasues i tij paraqet trajtim jo të barabartë në lidhje me të tjerët në situata të ngjashme.

35. Në përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar pretendimet e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar asnjë dëshmi se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

36. Rregulli 36 (2) d) i Rregullores së punës parasheh se "*Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: (...) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij*".

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe të rregullave 36 (2) (d) e 56 (2) të Rregullores së punës, më 9 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Prof. dr. Enver Hasani

KI96/14, Parashtrues Istref Veliçi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për lojëra të fatit, Nr.04/L-080, të 6 prillit 2012

KI96/14, Aktvendim për papranueshmëri i 8 dhjetorit 2014, publikuar më 3 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, palë e paautorizuar*

Ministria e Financave nëpërmjet aplikimit të Ligjit për lojërat e fatit, Nr. 04/L080 ka mbyllur disa lokale afariste që ushtronin veprimtari ekonomike e po ashtu edhe lokalin e parashtruesit.

Parashtruesi pretendoi ndër të tjera, se Ministria e Financave interpretoi dhe zbatoi në mënyrë të gabuar Ligjin për lojërat e fatit, Nr. 04/L080 duke mbyllur lokalet afariste me ç'rast shkeli të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi nuk është palë e autorizuar për të kontestuar kushtetutshmërinë e ligjit *in abstrakto,* e as të kërkojë interpretim të ligjit. Kërkesa e parashtruesit u shpall e papranueshme për shkak se parashtruesi nuk ishte palë e autorizuar ashtu siç është përcaktuar me nenin 113.1 të Kushtetutës, dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI96/14
Parashtrues
Istref Veliçi
Kërkesë për interpretim të disa dispozitave të Ligjit për lojëra të fatit, Nr. 04/L-080, të 6 prillit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Istref Veliçi, kryetar i Shoqatës së lojërave të fatit me seli në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi nuk konteston ndonjë vendim konkret të ndonjë autoriteti publik.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa e parashtruesit për interpretim të nenit 66, paragrafit 2, nënparagrafëve 2.4 dhe 2.6; nenit 70, paragrafit 2, nënparagrafëve 2.7 dhe 2.8; dhe nenit 81, paragrafit 3 të Ligjit për lojërat e fatit, Nr. 04/L080 (në tekstin e mëtejmë: Ligji për lojërat e fatit).

4. Parashtruesi pretendon se Ministria e Financave e Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ministria), përmes aplikimit të Ligjit për lojërat e fatit, i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e

mëtejmë: Kushtetuta) për sa i përket *"barazisë para ligjit, vlerave, parimeve të përgjithshme, të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, interpretimit të dispozitave për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjes gjyqësore të të drejtave"*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 2 qershor 2014, parashtruesi parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 4 korrik 2014, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI96/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI96/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 7 korrik 2014, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë informata shtesë.

9. Më 15 korrik 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 8 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 6 prill 2012, është miratuar Ligji për lojërat e fatit i cili ka hyrë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare.

12. Sipas pretendimeve të parashtruesit, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për lojërat e fatit, Ministria, pa të drejtë, ka mbyllur disa lokale afariste që ushtronin veprimtari ekonomike të cilat rregullohen përmes dispozitave të këtij ligji.

13. Sipas parashtruesit, lokalet e lartcekura afariste ishin mbyllur për arsye se Ministria kishte konsideruar që nuk janë plotësuar kriteret lidhur me distancën e këtyre lokaleve afariste në raport me objektet edukative-arsimore, historike, fetare dhe pronës komunale.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesi pretendon se Ministria përmes aplikimit të Ligjit për lojëra të fatit ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me nenin 3 [Barazia para Ligjit] paragrafi 1, nenin 7 [Vlerat] paragrafi 1.1, nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para Ligjit] paragrafi 1, nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] paragrafi 1, nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

15. Parashtruesi arsyeton kërkesën e tij për interpretim të dispozitave të Ligjit për lojërat e fatit duke pohuar se *"anëtarët e shoqatës pa fajin e tyre kanë ardhur në një pozitë të palakmueshme dhe denigruese si në aspektin ekonomik ashtu edhe në aspektin moral, si pasojë e interpretimit të gabuar të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-080 për Lojëra të Fatit".*

16. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesë:

> *"[...] që të bëjë interpretimin autentik të: Dispozitave të nenit 66, parag. 2 nënparag. 2.4 dhe 2.6 , neni 70, parag.2, dhe nënparg.2.7, dhe 2.8, [...] dispozitave të nenit 66, parag.2 nënparag.2.4, dhe 2.6, neni 70, parag. 2,nënparag.2.7 dhe 2.8, të Ligjit Nr. 04/-080 për Lojra të Fatit , duke precizuar se këto dispozita a aplikohen me rastin e licensimit të subjekteve të reja për lojra të fatit , apo me rastin e zgjatjes së afatit të licensave ekzistuse , apo se këto dispozita aplikohen automatikisht nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të lartpërmendur, pavarsisht faktit se ende nuk ka skaduar afati i licensave të lëshuara sipas ligjit të mëparshëm për lojra të fatit, Nr. 2004/35 Licensave.*
>
> *Si dhe të dispozitave të nenit 81, parag.3, të Ligjit .04/L-080 për Lojra të Fatit , të datës 06 Prill 2012 , duke precizuar-nxjerrë përfundim konkret se Licensat e lëshuara për ushtrimin e lojrave të fatit , sipas Ligjit të mëparshëm për Lojra të Fatit Nr. 2004/35 , a konsiderohen si të pavlefshme, në hyrje në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-080 për Lojra të Fatit , pavarsisht se nuk ju ka skaduar afati, apo se të gjitha licensat e lëshuara për ushtrimin e lojrave të fatit, sipas ligjit të mëparshëm për Lojra të Fatit Nr. 2004/35, konsiderohen valide gjerë në ditën e skadimit të tyre".*

Pranueshmëria e kërkesës

17. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

    "(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

    [...]

    (7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj ".

19. Më tutje, Gjykata i referohet nenit 47.1 të Ligjit, i cili parasheh:

    "1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje Juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik".

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (a) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

    "(1) Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë nëse:

    [...]

    (a) Kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar".

21. Siç është cekur më lart, parashtruesi kërkon interpretimin e disa dispozitave të Ligjit për lojëra të fatit me arsyetimin se Ministria ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese duke bërë, sipas tij, interpretim të gabuar të atyre dispozitave ligjore.

22. Në rastin në fjalë, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka ngritur ndonjë pretendim për shkelje të kryer nga autoritetet publike siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.1 të Ligjit.

23. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi, nuk ka paraqitur asnjë informatë në lidhje me ndonjë procedurë ose veprim ligjor që ka nisur me qëllim të adresimit të ankesave të tij, lidhur me pretendimet për zbatim të gabuar të atyre dispozitave të Ligjit për lojërat e fatit.

24. Sa i përket të drejtës së parashtruesit për të parashtruar kërkesë sipas nenit 113. 7 të Kushtetutës dhe nenit 47.1 të Ligjit, Gjykata vëren se parashtruesi nuk i referohet ndonjë veprimi apo vendimi konkret të një autoriteti publik që mund të ketë cenuar të drejtat e tij kushtetuese. Ajo çfarë parashtruesi kërkon është *"interpretim autentik"* i dispozitave të caktuara të Ligjit për lojërat e fatit meqë, sipas tij, si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të tyre nga ana e Ministrisë ai dhe anëtarët e tjerë të Shoqatës për lojërat e fatit janë vënë në "*një pozitë të palakmueshme dhe denigruese si në aspektin ekonomik ashtu edhe në aspektin moral*".

25. Gjykata rikujton se vetëm autoritetet që janë të numëruara në mënyrë eksplicite në nenet 113.2 deri 113.6 të Kushtetutës janë palë të autorizuara për të ngritur në Gjykatë çështjet e vlerësimit abstrakt të kushtetutshmërisë dhe të kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së legjislacionit.

26. Në këtë drejtim, Gjykata gjithashtu dëshiron të theksojë se rasti i parashtruesit është i ngjashëm me rastin nr. KI230/13 (Shih Rastin nr. KI230/13 të parashtruesit *Tefik Ibrahimi*, rast i Gjykatës Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri, i 19 majit 2014). Në atë rast, parashtruesi kishte kontestuar, *in abstracto*, kushtetutshmërinë e nenit 7.5 të Ligjit, Nr. 03/L-072 për zgjedhjet lokale duke konsideruar që ky nen është i pa drejtë dhe diskriminues ndaj tij. Gjykata kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit ngase ai ishte konsideruar si palë e paautorizuar për të kontestuar kushtetutshmërinë e ligjit *in abstracto*.

27. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk është palë e autorizuar për të kontestuar kushtetutshmërinë e ligjit *in abstrakto* e as të kërkojë interpretim të ligjit, dhe, rrjedhimisht, kërkesa e tij duhet të deklarohet e papranueshme.

28. Si përfundim, për arsyet e lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi nuk është palë e autorizuar, dhe në bazë të nenit 113. 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenit 47.1 të Ligjit dhe të rregullit 36 (1) (a) kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 47.1 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 8 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Prof. dr. Enver Hasani

KI138/14, Parashtrues Majda Fazli-Neziri, Kërkesë për dhënien e mendimit të Gjykatës lidhur me mundësinë e punësimit me titullin e fituar akademik master

KI138/14, Aktvendim për papranueshmëri i 8 dhjetorit 2014, publikuar më 3 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, mendim këshillëdhënës, juridiksioni ratione materiae*, *kërkesë e papranueshme*.

Parashtruesja ishte studente e studimeve në nivelin master, Departamenti i Historisë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, dhe pas fitimit të titullit master dëshironte të punojë si profesoreshë e historisë në gjuhën boshnjake në një shkollë fillore në Prizren.

Parashtruesja pretendoi se pas një bisede joformale me stafin e Drejtoratit për Arsim në Prizren, asaj i është thënë se me titullin e fituar master, ajo nuk mund të punojë në shkollën fillore si arsimtare e rregullt e lëndës së historisë.

Parashtruesja kërkoi nga Gjykata që të deklarohet nëse pas diplomimit do të mund të punësohet si profesoreshë e historisë në shkollë fillore.

Gjykata Kushtetuese konstatoi, se kërkesa e parashtrueses nuk ishte ngritur në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe si e tillë, nuk është *ratione materia* në pajtim me dispozitat e Kushtetutës. Kërkesa u shpall e papranueshme në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 (3) f) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI138/14
Parashtrues
Majda Fazli-Neziri
Kërkesë për dhënien e mendimit të Gjykatës lidhur me mundësinë e punësimit me titullin e fituar akademik master

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Majda Fazli-Neziri, fshati Lubizhdë, komuna e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës nuk i konteston vendimet e autoriteteve publike, por vetëm kërkon mendimin e Gjykatës lidhur me titullin e fituar akademik dhe mundësinë e punësimit.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes ka të bëjë me mendimin këshillëdhënës të Gjykatës, lidhur me mundësinë e punësimit në shkollën fillore me titullin e fituar akademik master.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 15 shtator 2014, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 7 tetor 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI138/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI138/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 10 tetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 8 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesja e kërkesës, parashtroi në Gjykatë kërkesën prej një gjysmë faqe në të cilën thotë *„... se ajo është studente e studimeve master, Departamenti i Historisë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, se ajo është studente e mirë dhe se pas fitimit të titullit master dëshiron të punojë si profesoreshë e historisë në gjuhën boshnjake në shkollën fillore“*.

10. Sidoqoftë, në një datë të pacaktuar, në një bisedë joformale me stafin e Drejtoratit për arsim në Prizren, i është thënë se me titullin e fituar master, ajo nuk mund të punojë në shkollën fillore si arsimtare e rregullt e lëndës së historisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

11. Parashtruesja në kërkesën e saj ka theksuar se i ka dhënë të gjitha provimet me notë mesatare, dhe momentalisht është duke punuar në tezën e masterit.

12. Parashtruesja e kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesën si në vijim:

> *„Lus Gjykatën Kushtetuese që të deklarohet, të jap mendimin, kur të diplomoj MASTER-HISTORI, pranë Universitetit të Prishtinës-Departamenti Histori, a mund të punoj si profesor i historisë në shkollën fillore“*.

Pranueshmëria e kërkesës

13. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtrueses, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

14. Sa i përket kërkesës konkrete të parashtrueses, Gjykata i referohet rregullit 36, paragrafi 3, pika f) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

    „Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: f) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën“.

15. Gjykata është e obliguar të shqyrtojë nëse ka juridiksion *ratione materiae* në çdo fazë të procedurës. Përputhshmëria me Kushtetutën dhe instrumentet ndërkombëtare, të cilat janë pjesë përbërëse të Kushtetutës në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës *ratione materiae* e ndonjë kërkese, buron nga kompetenca thelbësore e Gjykatës. Në mënyrë që një kërkesë të jetë në pajtim *ratione materiae* me Kushtetutën, e drejta në të cilën thirret parashtruesja, duhet të jetë e mbrojtur me Kushtetutë.

16. Pasi që parashtruesja para Gjykatës ka ngritur çështjen e cila nuk është në përputhje me pikën 113.7 të Kushtetutës, del se kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me dispozitat e Kushtetutës, dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (3) f) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 8 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetueses**
Ivan Čukalović	Prof. dr. Enver Hasani

KI72/14, Parashtruese e kërkesës Besa Qirezi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 712/2013, të 21 tetorit 2013

KI 72/14, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2014, i publikuar më 4 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, kërkesë e pranueshme, forma e prerë dhe përmbarueshmëria e vendimeve, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, mbrojtja e pronës*

Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin CA nr. 712/2013, të 21 tetorit 2013, anuloi vendimet e Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, me të cilat ishte aprovuar propozimi i parashtrueses së kërkesës për kompensimin e plotë të pagave, pas kthimit të saj në vendin e punës.

Parashtruesja e kërkesës pretendoi, *inter alia,* se Gjykata e Apelit nuk ka respektuar formën e prerë të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, dhe në këtë mënyrë, ia ka mohuar asaj të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mjet efektiv juridik dhe përmbarimin e vendimeve të formës së prerë dhe detyruese, si dhe mbrojtjen e pronës.

Gjykata së pari theksoi se kërkesa e parashtrueses i plotëson të gjitha kriteret procedurale dhe për këtë arsye është e pranueshme. Sa i përket meritave të kërkesës, Gjykata deklaroi se detyra e saj është që të shqyrtojë dhe të merr parasysh aspektet kushtetuese të kërkesës, dhe jo nëse gjykatat e rregullta kanë zbatuar drejt ligjin e aplikueshëm. Përkitazi me çështjen e kompensimit të pagave, Gjykata konstatoi se mosekzekutimi i vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, respektivisht mos-kompensimi i pagave të papaguara ndaj parashtrueses së kërkesës, përbën shkelje të të drejtave të shumta të ndërlidhura, siç janë e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për përmbarimin e vendimeve të plotfuqishme dhe detyruese, e drejta për mjet efektiv juridik dhe mbrojtja e pronës. Gjykata mbështeti gjetjet e saj të shkeljes duke u thirrur vetë praktikën gjyqësore të saj, veçanërisht në çështjet që kanë të bëjnë me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, krahas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

AKTGJYKIM
në
Rastin Nr. KI72/14
Parashtrues
Besa Qirezi
Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 712/2013,
të 21 tetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Besa Qirezi me vendbanim në Vushtrri.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, CA. nr. 712/2013, i 21 tetorit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 16 dhjetor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit (CA. nr. 712/2013 i 21 tetorit 2013), me të cilin ishte anuluar Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë (E. nr. 2668/2012, i 11 shkurtit 2013) i nxjerrë në procedurën përmbarimore lidhur me kompensimin e pagave të papaguara nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (në tekstin e mëtejmë: MKK) në bazë të Vendimit (A02 (114) 2008, të 25 majit 2009) të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMK-ja).

4. Lidhur me këtë, parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit (CA. nr. 712/2013 të 21 tetorit 2013) janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) dhe nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 14 prill 2014, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 6 maj 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin GJR. KI72/14 caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI72/14 caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

8. Më 16 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe ua dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe MKK-së.

9. Më 18 shtator 2014, Kryetari ndryshoi Vendimin (KSH. KI72/14 të 6 majit 2014) dhe caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

10. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesja e kërkesës ishte e punësuar në MKK si Zyrtare për barazi gjinore, në bazë të kontratës për periudhë të caktuar kohore prej 1 qershorit 2007 deri më 30 maj 2009.

12. Më 22 janar 2008, Komisioni disiplinor i MKK-së vendosi të caktojë masën disiplinore: ndërprerjen e kontratës së punës së parashtrueses së kërkesës me MKK-në (në tekstin e mëtejmë: Vendimi i Komisionit disiplinor).

13. Më 24 janar 2008, MKK-ja në bazë të Vendimit të saj Nr. 108 ndërpreu marrëdhënien e punës (në tekstin e mëtejmë: Vendimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës) me parashtruesen e kërkesës.

Procedura administrative

14. Më 31 mars 2008, pas ankesës së parashtrueses së kërkesës kundër Vendimit të Komisionit disiplinor dhe Vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa i MKK-së, bazuar në Vendimin e tij Nr. 484/1 (në tekstin e mëtejmë: Vendimi i Komisionit për Ankesa) e refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës.

15. Më 11 prill 2008, parashtruesja e kërkesës ushtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMSHCK) kundër Vendimit të Komisionit disiplinor, Vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe Vendimit të Komisionit për Ankesa.

16. Më 25 maj 2009, KPMK-ja me Vendimin A02 (114) 2008 (në tekstin e mëtejmë: Vendimi i KPMK-së) vendosi si në vijim:

"I. APROVOHET si e bazuar ankesa nr. 02 i 14/08 e datës 11.04.2008 e ankueses znj. Besa Qirezi.

II. ANULOHEN: Vendimi i Organit të Punësimit nr. 484/1 të datës 31.03.2008. Aktvendimi nr. 108 i datës 24.01.2008 dhe Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 22.01.2008.

III. OBLIGOHET - Organi i punësimit që në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij Vendimi, ankuesit t'ia mundësojë kthimin në punë dhe realizimin e të gjitha të drejtave nga mardhënia e punës dhe t'i përtrijë kontratën e punës në pajtim me procedurën sipas Udhëzimit Administrativ nr. MSHP/DASHC 2003/02.

IV. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Sekretari i Përhershëm i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

V. Pas ndërmarrjes së masave sipas këtij vendimi, të njoftohet Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës.

VI. Në rast mosveprimi sipas këtij vendimi Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, do të njoftojë Kuvendin e Kosovës, i cili ia përcjellë raportin Kryeministrit të Kosovës në përputhje me nenin 2 parag. 11.4 të Rregullores Nr. 2001136 mbi Shërbimin Civil të Kosovës e ndryshuar me Rregulloren nr. 2008/12".

17. Më 6 korrik 2009, parashtruesja e kërkesës e njoftoi KPMK-në se MKK-ja nuk e kishte përmbaruar Vendimin e KPMK-së.

18. Në një datë të pacaktuar, MKK-ja kishte paraqitur padi në Gjykatën Supreme kundër Vendimit të KPMK-së.

19. Më 24 mars 2010, Gjykata Supreme, me Aktvendimin A. nr. 472/2009 shpallet jokompetente për të vendosur lidhur ma padinë e parashtruar nga MKK-ja. Gjykata Supreme ia përcolli lëndën Gjykatës Komunale në Prishtinë si gjykatë kompetente për këtë çështje.

20. Gjykata Supreme në vendimin e lartcekur konstatoi se:

"Me nenin 9 par. 1 pika 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, parashikohet se konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet për çështje për të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ.

Gjykata Supreme vlerëson se në rastin konkret bëhet fjalë për kontest nga marrëdhënia e punës, për vendosjen e të cilit, në përputhje me nenin 26 par.l pika 7 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta (Gaz . Zyrtare e Kosovës nr. 21/78), kompetente është gjykata komunale.

Nga sa u tha më lart, Gjykata Supreme, në përputhje me nenin 60 të LKA, lidhur me nenin 15 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi".

21. Më 17 qershor 2010, parashtruesja e kërkesës e informoi Kryeministrin për mospërmbarimin e Vendimit të KPMK-së dhe gjithashtu kërkoi nga ai që të ndërmerr masat e nevojshme për përmbarimin e Vendimit të KPMK-së. Kjo kërkesë e parashtrueses i ishte përcjellë Kuvendit të Kosovës, më 7 korrik 2010.

22. Më 7 shtator 2010, kryetari i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione në Konkluzionin e tij adresuar MKK-së, kërkoi nga MKK-ja që të ndërmerr masa të nevojshme për përmbarimin e Vendimit të KPMK-së.

Procedura kontestimore

23. Në përpjekje për të përtërirë marrëdhënien e saj të punës duket se parashtruesja ishte përfshirë në procedurë kontestimore si paditëse. Për më tepër, si rezultat i Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme, një procedurë kontestimore gjithashtu ishte iniciuar edhe me MKK-në si paditëse. Këto dy procedura kontestimore megjithatë nuk janë relevante për pretendimet e ngritura në këtë kërkesë.

Vendimi i MKK-së për kthimin e parashtrueses së kërkesës në vendin e saj të punës

24. Më 21 nëntor 2012, Sekretari i Përgjithshëm i MKK-së, me qëllim të përmbarimit të Vendimit të KPMK-së, nxori Vendimin për kthim të parashtrueses së kërkesës në një vend të punës në MKK, por në një pozitë tjetër, atë të Zyrtares për pranim të kërkesave në Zyrën për Komunikim Publik me MKK-në.

25. Në vendimin e njëjtë, MKK-ja vendosi më tej që kompensimi i parashtrueses së kërkesës do të bëhet si në vijim: ” *[...] kompensimi i të ardhurave personale në pagë mujore i bëhet që nga dt. 22.01.2008 kur dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga ana e Komisionit Disiplinor të MKK-së deri më dt. 31.05.2009, kur dhe i ka skaduar kontrata e punës Nr. 226/2007. [...]*”.

26. Më 3 dhjetor 2012, parashtruesja e kërkesës ishte kthyer në vendin e saj të punës.

27. Më 17 dhjetor 2012, Sekretari i Përgjithshëm i MKK-së nxori Vendimin për transferimin e parashtrueses së kërkesës në Divizionin për të Drejta të Njeriut në MKK, në vendin e saj të mëparshëm të punës Zyrtare për Barazi Gjinore.

Procedura përmbarimore

28. Si rezultat i Vendimit të MKK-së për kompensimin e pagave vetëm për periudhën nga dita kur parashtrueses së kërkesës i është ndërprerë marrëdhënia e punës deri në ditën kur i kishte skaduar kontrata (22 janar 2008 e deri më 31 maj 2009), më 26 dhjetor 2012, parashtruesja e kërkesës parashtroi propozim për përmbarimin e pagave të papaguara për periudhën prej 1 qershorit 2009, dita kur kishte skaduar kontrata e mëparshme e punës deri më 3 dhjetor 2012, dita e kthimit në vendin e saj të punës në MKK.

29. Më 11 shkurt 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin E. nr. 2668/2012 vendosi që ta përmbarojë propozimin e

parashtrueses së kërkesës për pagat e papaguara për periudhën ndërmjet 1 qershorit 2009 dhe 3 dhjetorit 2012.

30. Më 6 mars 2013, sipas kundërshtimit të MKK-së ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, (E. nr. 2668/2012, të 11 shkurtit 2013), Gjykata Themelore në Prishtinë refuzoi në tërësi kundërshtimin e parashtruar nga MKK-ja.

31. Rrjedhimisht, MKK-ja ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë (E. nr. 2668/2012, të 6 marsit 2013).

32. Më 21 tetor 2013, Gjykata e Apelit me Aktvendimin, CA. nr. 712/2013 aprovoi ankesën e MKK-së, në cilësi të debitorit dhe refuzoi propozimin e parashtrueses së kërkesës për përmbarimin e Aktvendimit të KPMK-së.

33. Gjykata e Apelit, në Aktvendimin e lartcekur konstatoi:

"Nga shkresat në dosje rezulton: Se procedura e përmbarimit për kthimin në punë të kreditorit sipas vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës A02(114) 2008 i datës 25.5.2009, ka përfunduar me datën 3.12.2012 sipas vendimit të Ministrisë për komunitete dhe kthim nr. 2517 të datës 21.11.2012, ndërsa kreditori e ka paraqitur propozimin për shpërblim pas përfundimit të procedurës së përmbarimit, pra me datë 26.12.2012.

Gjykata e shkallës së parë ka caktuar përmbarimin me aktvendimin e saj
E. nr. 2668/2012 të datës 11.02.2013. Kundër këtij aktvendimi debitori kishte paraqitur prapësim, ndërsa gjykata e shkallës së parë kishte vendosur si në dispozitivin e aktvendimit ankimor, duke vlerësuar se nuk ka pengesa ligjore për zbatimin e aktvendimit mbi caktimin e përmbarimit, por paraprakisht nuk kishte shqyrtuar se propozimi për përmbarim a ishte paraqitur brenda afatit ligjor.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë të dhënë në aktvendimin ankimor, kolegji e vlerëson të pa drejtë dhe të pabazuar në ligj, sepse me nenin 294 par. 2 të Ligjit për procedurën Përmbarimore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 33/2008) më tej LPP është përcaktuar: "Propozimi për shpërblim mund t'i bashkëngjitet propozimit për përmbarim, ose mund të paraqitet më vonë deri në përfundimin e procedurës së përmbarimit". Në rastin konkret procedura e përmbarimit për kthimin e kreditorit në punë ka përfunduar me dt. 03.12.2012,

ndërsa propozimin kreditori e ka paraqitur me dt. 26.02.2012 [26.12.2012]*, e që do të thotë pas skadimit të afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën e lart cituar të LPP".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

34. Siç u cek më lart, parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit (CA. nr. 712/2013 të 21 tetorit 2013) i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së si dhe nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

35. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës argumenton që "*Mirëpo Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk e përmbaroi në tërësi vendimin e KPMK-së, sepse më kompensojë pagat vetëm për periudhën sa kam pas kontratë, ndërsa për periudhën sa kam qenë e papunë, u arsyetua se nuk ka "mjete financiare". Si është e mundur që për mua MKK nuk paska mjete monetare për kompensimin e rrogave të humbura, kurse për kolegun tim, i cili është larguar dhe është kthyer në të njëjtën kohë në punë me mua, i'u bë kompensimi? Mua padrejtësisht më është mohuar e drejta e përfitimit të pagave të humbura, ndërkohë që kolegut tim i'a kompensuan pagat e humbura?*
Kjo provon më së miri trajtimin e pabarabartë të individëve".

36. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, parashtruesja e kërkesës pretendon që:

"[...] sipas praktikës së GJEDNJ-së çështjet e mospërmbarimit të vendimeve të formës së prerë res judicata paraqesin shkelje të vazhdueshme sepse një e drejtë e fituar nuk duhet të ngelet vetëm në letër, ose pjesërisht e zbatuar por duhet të realizohet edhe në praktikë, shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KI129/11, pjesë të cituara nga gjykata e Strasburgut.

Nuk kam faj unë nëse MKK-ja nuk ka të holla për të më kompensuar. KPMK ka marr një vendim me të cilin mua duhet të më kompensohen pagat e humbura nga dita e largimit tim nga puna deri në kthimin tim në punë. Shteti duhet të gjejë mekanizma për të siguruar zbatimin e vendimeve të autoriteteve publike, pse duhet të jem unë viktimë e mungesës së këtyre mekanizmave?".

37. Për më tepër, siç u cek më lart, parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, parashtruesja e kërkesës pretendon që:*"Si rrjedhojë e mospërmbarimit në tërësi të vendimit të KPMK-së mua më janë mohuar të drejtat e fituara, sepse pritjet e mia kanë qenë legjitime, me këtë rast më është cënuar e drejta ime".*

38. Parashtruesja e kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata si në vijim: *"[...]*

duke u referuar sipas Aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës sëKosovës: KI72/12, KI29/11, KI04/12 dhe fakteve që u përmendën, kërkoj nga Gjykata Kushtetuese që të vendos në bazë të meritave të kërkesës sime, dhe ta shfuqizojë Aktvendimin e Gjykatës së Apelit CA. nr. 712/2013, të dt. 21.10.2013".

Dispozitat relevante ligjore në lidhje me procedurat për përmbarimin e vendimeve administrative dhe gjyqësore

Ligji për Procedurën Përmbarimore (Ligji Nr. 03/L-008)

Neni 1 [Përmbajtja e ligjit]

"1.1 Me këtë ligj caktohen rregullat për procedurën e gjykatës sipas të cilës realizohen kërkesat në bazë të titujve ekzekutiv (procedura e përmbarimit), po që se me ligj të posaçëm nuk është paraparë diçka tjetër.

1.2 Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të dhënë në procedurën administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbarimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër".

Neni 24, paragrafi 1 [Titulli ekzekutiv]

"Tituj ekzekutiv janë:

a) vendimi ekzekutiv i gjykatës dhe ujdia gjyqësore ekzekutive ; 10

b) vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia administrative, po që se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po që se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër;

c) dokumenti noterial ekzekutiv;

d) dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument ekzekutiv".

Neni 26, paragrafi 3 [Përmbarueshmëria e vendimit]

"Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimorë, po që se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë".

Neni 294, paragrafi 1 [Shpërblimi i pagës në rast të kthimit të punëtorit në punë]

"Propozuesi i përmbarimit që e ka parashtruar propozimin për kthim në punë, ka të drejtë të kërkojë që gjykata të nxjerrë aktvendim me të cilin do të caktojë se, debitori ka për detyrë që atij t'ia paguajë në emër të pagës shumat mujore që janë bërë të kërkueshme, nga dita në të cilën ka marrë formë të prerë vendimi e deri në ditën e rikthimit në punë. Me të njëjtin aktvendim, gjykata e cakton përmbarimin për realizimin e shumave mujore të caktuara".

Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Nr. 03/L-192

Neni 13 [Vendimi i Këshillit]

"Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarë të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit".

Neni 14 [E drejta e ankesës]

"Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrative në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit".

Neni 15 [Procedura në rast mos zbatimi të vendimit të këshillit]

"Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjigjes i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës".

Pranueshmëria e kërkesës

39. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

41. Gjykata gjithashtu i referohet neneve 48 dhe 49 të Ligjit, të cilët parashohin se:

48. Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

49. Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.

42. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar, ose

(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar, ose

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi; ose

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

43. Sa i përket shterjes së mjeteve juridike, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në institucionet e punësimit dhe me ankesën e saj në KPMK, i cili vendim është final në procedurën administrative. Ajo gjithashtu kishte shteruar mjetin e fundit juridik në procedurën përmbarimore, që në rastin konkret është Aktvendimi, CA. nr. 712/ 2013 të Gjykatës së Apelit, të 21 tetorit 2013, ndaj të cilit nuk lejohet e drejta e ankesës. Si rezultat, parashtruesja e kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas legjislacionit në fuqi.

44. Gjykata më tej vëren se më 16 dhjetor 2013, parashtrueses së kërkesës i ishte dorëzuar vendimi i kontestuar dhe më 14 prill 2014, ajo e kishte dorëzuar kërkesën në Gjykatë.

45. Gjykata gjithashtu vëren që parashtruesja e kërkesës kishte saktësuar cilat të drejta kushtetuese pretendohen t'i jenë shkelur dhe ajo e konteston vendimin konkret, gjegjësisht, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit (CA. nr. 712/ 2013, të 21 tetorit 2013).

46. Gjykata më tej vëren se parashtruesja e kërkesës mundet në mënyrë legjitime të pretendojë të jetë viktimë e anulimit të Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë (E. nr. 2668/2012, i 6 marsit 2013) nga Gjykata e Apelit, i cili ishte nxjerrë në dobi të saj.

47. Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, se e ka dorëzuar kërkesën në afatin ligjor dhe se ajo e kishte specifikuar saktësisht shkeljen e pretenduar të të drejtave dhe lirive dhe i është referuar vendimit të cilin ajo e konteston.

48. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa i plotëson të gjitha kriteret për pranueshmëri.

Meritat e rastit

49. Parashtruesja e kërkesës kryesisht pretendon shkeljen e të drejtës së saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe të drejtën për mbrojtje të pronës, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1, të Protokollit Nr. 1, të KEDNJ-së.

50. Gjykata shqyrton meritat e çdo pretendimi të parashtrueses së kërkesës.

51. Parashtruesja e kërkesës ankohet se është shkelur e drejta e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.

52. Neni 31.1 i Kushtetutës përcakton:

> *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

53. Përveç kësaj, neni 6.1 i KEDNJ-së përcakton:

> *Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.*

54. Gjykata i referohet nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

55. Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) mjaft shpesh e ka theksuar vendin e shquar të së drejtës për gjykim të drejtë në një shoqëri demokratike (shih, *Perez kundër Francës*, nr. 47281/99, GJEDNJ, Aktgjykimi i 12 shkurtit 2004).

56. Siç është përmendur në fakte, dy procedura kontestimore ishin iniciuar nga MKK-ja dhe nga parashtruesja e kërkesës në anën tjetër. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se procedurat kontestimore nuk bien nën fushëveprimin e kërkesës dhe prandaj, do të shqyrtojë vetëm procedurën lidhur me objektin e çështjes së kërkesës.

57. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, CA. nr. 712/2013, të 21 tetorit 2013, me të cilin është anuluar Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë (E. nr. 2668/2012, i 6 marsit 2013) për përmbarimin e propozimit të parashtrueses së kërkesës për kompensimin e pagave të papaguara.

58. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, më 25 maj 2009, KPMK-ja (Vendimi nr. A02 (114) 2008) aprovoi ankesën e parashtrueses së kërkesës, duke kërkuar nga MKK-ja që brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita kur u është dorëzuar vendimi, ta

kthejë parashtruesen e kërkesës në vendin e saj të punës me të gjitha të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës dhe përtëritjen e kontratës së punës në pajtim me procedurat e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ Nr. MPS/DCSA 2003/02. Në Vendimin e KPMK-së theksohet se:

> *Vendimi i Këshillit paraqet vendim administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet prej zyrtarit të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës.*

59. Gjykata vëren se pas Vendimit të KPMK-së, MKK-ja nuk e ka kthyer parashtruesen e kërkesës në vendin e saj të mëparshëm të punës brenda afatit të paraparë me Vendimin e KPMK-së.

60. Vetëm më 21 nëntor 2012, më shumë se 3 (tri) vjet pas nxjerrjes së Vendimit të KPMK-së, MKK-ja me Vendimin e Sekretarit të saj të Përgjithshëm vendosi të kthejë parashtruesen e kërkesës në vendin e punës në MKK dhe si rezultat, më 3 dhjetor 2012, parashtruesja e kërkesës ishte kthyer në vendin e saj të punës në MKK.

61. Në këtë drejtim, duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore, Gjykata rikujton që KPMK-ja është institucion i pavarur i konstituuar me ligj, në pajtim me nenin 101.2 të Kushtetutës. Prandaj, të gjitha obligimet që dalin nga vendimet e këtij institucioni, lidhur me çështjet që janë nën juridiksionin e tij, prodhojnë efekte juridike për institucionet tjera përkatëse, ku statusi i të punësuarve është i rregulluar me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Vendimi i KPMK-së paraqet vendim përfundimtar dhe detyrues, dhe se ankesa e ushtruar kundër Vendimit të KPMK-së nuk e ndalon përmbarimin e vendimeve të KPMK-së (Shih Rastin KI129/11, parashtrues i kërkesës *Viktor Marku*, Gjykata Kushtetuese, Aktgjykimi i 17 korrikut 2012).

62. Megjithatë, sa i përket kompensimit të pagave të papaguara, MKK-ja në Vendimin e 11 nëntorit 2012 vendosi që ” *[...] kompensimi i të ardhurave personale në pagë mujore i bëhet që nga dt. 22.01.2008 kur dhe i është ndërpre marrëdhënia e punës nga ana a Komisionit Disiplinor të MKK-së, deri më dt. 31.05.2009, kur dhe i ka skaduar kontrata e punës Nr. 226/2007.[...]”*. Kjo do të thotë që MKK-ja kishte vendosur mos ta kompensojë parashtruesen e kërkesës për periudhën prej 1 qershorit 2009, dita kur kishte skaduar kontrata e saj e mëparshme e punës, deri më 3 dhjetor 2012, dita e kthimit në vendin e saj të punës në MKK. Si i tillë, Vendimi i MKK-së nuk është në pajtim me Vendimin e KPMK-së.

63. Gjykata më tej vëren se si pasojë e mospërmbarimit të Vendimit të KPMK-së në tërësi, parashtruesja e kërkesës ka vendosur të iniciojë procedurë për përmbarim dhe të propozojë kompensimin e pagave të papaguara për periudhën e lartpërmendur prej 1 qershorit 2009 deri më 3 dhjetor 2012. Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin e saj (E. nr. 2668/2012, i 11 shkurtit 2013) dhe në bazë të vendimeve të KPMK-së miratoi propozimin e parashtrueses së kërkesës për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën e lartpërmendur.

64. Megjithatë, si rezultat i ankesës së parashtruar nga MKK-ja kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit miratoi ankesën e paraqitur nga MKK-ja dhe hodhi poshtë propozimin e parashtrueses së kërkesës për ekzekutimin e Vendimit të KPMK-së, respektivisht propozimit për kompensimin e pagave të papaguara dhe zëvendësoi Vendimin e KPMK-së me vendimin e vet.

65. Në këtë drejtim, Gjykata dëshiron të sqarojë se nuk është detyrë e saj që të shqyrtojë nëse Gjykata e Apelit me Aktvendimin e saj ka interpretuar drejt ligjin e aplikueshëm, por të shqyrtojë dhe të merr parasysh nëse ajo me vendimin e saj të lartpërmendur kishte cenuar të drejtat dhe liritë individuale të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

66. Si rezultat i anulimit të Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me Aktvendim të Gjykatës së Apelit (CA. nr. 712/2012 të 21 tetorit 2013), parashtruesja e kërkesës pretendon se mospërmbarimi i Aktvendimit të KPMK-së në tërësi, përkatësisht moskompensimi i pagave të papaguara për periudhën e sipërpërmendur përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

67. Në këtë drejtim, Gjykata duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore (Shih, ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese, Rasti KI04/12, parashtrues i kërkesës *Esat Kelmendi*, Aktgjykimi i 20 korrikut 2012), thekson se një vendim i lëshuar nga një organ administrativ i themeluar me ligj, prodhon efekte juridike për palët dhe, për këtë arsye, një vendim i tillë është një vendim përfundimtar administrativ dhe i përmbarueshëm.

68. Bazuar në sa u tha më lart, Gjykata konfirmon se vendimi i formës së prerë, përkatësisht vendimi që konsiderohet të jetë objekt i procedurës përmbarimore është Vendimi i KPMK-së. Vendimi i KPMK-së detyron MKK-në që ta kthejë parashtruesen e kërkesës në vendin e saj të mëparshëm të punës me të gjitha të drejtat që rrjedhin nga marrëdhënia e punës dhe të përtërijë kontratën e punës, e cila kishte skaduar më 31 maj 2009. Prandaj, Gjykata konkludon se Vendimi i KPMK-së është i formës së prerë dhe i përmbarueshëm. Kjo nënkupton se parashtruesja e kërkesës ka të drejtë për t'u rikthyer në

vendin e saj të mëparshëm të punës në MKK dhe, për t'iu paguar të gjitha pagat e papaguara nga momenti i shkarkimit nga puna deri në kthimin e saj në vendin e mëparshëm të punës.

69. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se përmbarimi i një vendimi të formës së prerë dhe të detyrueshëm duhet shikuar si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Parimi i lartpërmendur është i një rëndësie të madhe në kuadër të procedurës administrative në lidhje me një kontest, rezultati i të cilit është i një rëndësie të veçantë për të drejtat civile të palëve në kontest (Shih, *mutatis mutandis, r*asti *Hornsby kundër Greqisë*, GJEDNJ, Aktgjykim i 19 marsit 1997, para. 40-41, shih gjithashtu Rastin KI112/12. parashtrues i kërkesës *Adem Meta*, Gjykata Kushtetuese, Aktgjykim i 5 korrikut 2013).

70. Nga kjo rrjedh që Gjykata e Apelit, kur kishte anuluar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë për përmbarimin e një vendimi përfundimtar dhe të përmbarueshëm administrativ të KPMK-së, kishte shkelur të drejtën e parashtrueses së kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

71. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së.

72. Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] parasheh që:

> *Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.*

73. Përveç kësaj, neni 13 i KEDNJ-së parasheh që:

> *Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.*

74. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion në lidhje me përmbarimin e Vendimit të KPMK-së. Megjithatë, pavarësisht nga përpjekjet e saj, ai vendim nuk ishte përmbaruar as nga MKK-ja dhe as nga Gjykata e Apelit.

75. Gjykata rithekson se mosekzistimi i mjeteve juridike apo i mekanizmave të tjerë efektivë për përmbarimin e Vendimit të KPMK-së cenon të drejtën e garantuar me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, dhe të nenit 13 të KEDNJ-së.

76. Për më tepër, *"organet kompetente kanë për obligim që ta themelojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor edhe në atë praktik, dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme* (Shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI50/12, Parashtrues i kërkesës *Agush Llulluni*, Aktgjykim i 16 korrikut 2012*,* para. 41, shih gjithashtu *Pecevi kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë,* nr. 21839/03, GJEDNJ, Aktgjykim i 6 nëntorit 2008*).*

77. Prandaj, Gjykata konkludon se pamundësia për të ndërmarrë veprime të mëtejshme juridike përkitazi me mospërmbarimin e vendimit të KPMK-së, gjithashtu përbën shkelje të nenit 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së.

78. Parashtruesja e kërkesës po ashtu pretendon shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

79. Parashtruesja e kërkesës pretendon që: *"Si rrjedhojë e mospërmbarimit në tërësi të vendimit të KPMK-së mua më janë mohuar të drejtat e fituara, sepse pritjet e mia kanë qenë legjitime, me këtë rast me është cënuar e drejta ime".*

80. Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] e Kushtetutës përcakton:

> *1. E drejta e pronës është e garantuar.*
>
> *2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
>
> *3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.*
>
> *4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet*

se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

81. Neni 1 i Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së parasheh:

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

82. Siç u theksua më lart, Gjykata rikujton se Vendimi i KPMK-së ishte përfundimtar dhe i përmbarueshëm.

83. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konsideron se parashtruesja e kërkesës ka një "pritje legjitime" të merr kompensim për pagat e papaguara për periudhën e lartcekur, në pajtim me Vendimin e KPMK-së, i cili mori formën e prerë dhe është i përmbarueshëm. (Shih, *mutatis mutandis*, rasti *Pressos Compania Naviera SA e tjerët kundër Belgjikës,* GJEDNJ, Aktgjykimi i 20 nëntorit 1995, paragrafi 31).

84. Pritja e tillë legjitime gjithashtu garantohet me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës (Shih, *mutatis mutandis, Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, nr. 39794/98, GJEDNJ, Vendim i 10 korrikut 2002, para. 73)·

85. Nga arsyet e mësipërme, dhe duke u bazuar në përfundimin e mësipërm se është shkelur e drejta e parashtrueses së kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata më tej konstaton se mospërmbarimi i Vendimit të KPMK-së në lidhje me pagat e papaguara përbën gjithashtu shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

86. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

87. Përfundimisht, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme që të merret më tej me pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, sidomos pasi ajo ka gjetur shkelje të neneve relevante 31, 54 dhe 46 të

Kushtetutës dhe nenit 6 dhe 13 të KEDNJ-së si dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

Përfundim

88. Në përfundim, Gjykata konstaton se mospërmbarimi i Vendimit të KPMK-së në tërësi nga ana e autoriteteve kompetente administrative dhe nga gjykatat e rregullta për pjesën e kompensimit të pagave të papaguara, përbën shkelje të neneve 31 dhe 54 të Kushtetutës dhe neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së. Si rezultat i kësaj shkeljeje, parashtruesja e kërkesës ishte privuar nga e drejta e saj që të merr kompensim për pagat e papaguara. Në këtë mënyrë, është shkelur e drejta për mbrojtje të pronës, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së. Prandaj, vendimi i KPMK-së për pjesën e kompensimit të pagave të papaguara nga momenti i shkarkimit të saj nga puna deri në momentin e kthimit të saj në vendin e punës në MKK, gjegjësisht për periudhën prej 1 qershorit 2009 deri më 3 dhjetor 2012, mbetet për t'u përmbaruar.

89. Gjykata më tej thekson se ky përfundim ka të bëjë vetëm me shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Në të vërtetë, përfundimi nuk ka të bëjë me faktin nëse vendimi i gjykatave të rregullta ose Vendimi i KPMK-së interpreton drejt ligjin e aplikueshëm, për shkak se Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me atë se çfarë është interpretim i duhur i ligjit.

90. Si përmbledhje, në pajtim me rregullin 74 (1) të Rregullores së punës, Vendimi i Gjykatës së Apelit (CA. nr. 712/2013, i 21 tetorit 2013) është i pavlefshëm dhe, lënda i kthehet Gjykatës së Apelit për rishqyrtim.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit, dhe me rregullat 56 (a) dhe 74 (1) të Rregullores së punës, njëzëri, në seancën e saj të mbajtur më 9 dhjetor 2014

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së;

III. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së;

IV. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1, të Protokollit Nr. 1, të KEDNJ-së;

V. TË SHPALLË TË PAVLEFSHËM Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, CA. nr. 712/2013 të 21 tetorit 2013, DHE TË KTHEJË rastin në Gjykatën e Apelit për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht të merr parasysh se Vendimi i KPMK-së duhet të përmbarohet në tërësi;

VI T'UA PËRKUJTOJË autoriteteve kompetente obligimet e tyre sipas nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës dhe rregullit 63 [Zbatimi i vendimeve] i Rregullores së punës të Gjykatës;

VII. TA URDHËROJË Gjykatën e Apelit, në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, t'i dorëzojë Gjykatës Kushtetuese informata për masat e ndërmarra për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese;

VIII. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve;

IX. TA PUBLIKOJË këtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

X. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Prof. dr. Enver Hasani

KI60/14, Parashtrues Tomë Krasniqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 35/2014, të 12 shkurtit 2014

KI60/14, Aktvendim për papranueshmëri i 17 shtatorit 2014, publikuar më 5 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, moszbulim i identitetit, kërkesë qartazi e pabazuar.*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin, Rev. nr. 35/2014, të 12 shkurtit 2014 refuzoi kërkesën për revizion të parashtruesit, me ç'rast konstatoi se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, nuk përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ashtu siç pretendonte parashtruesi.
Parashtruesi, ndër të tjera, pretendoi se Gjykata Supreme e Kosovës shkeli të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, sepse atij i është mohuar e drejta në pension.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi nuk i kishte mbështetur dhe arsyetuar pretendimet e tij për shkelje të Kushtetutës, dhe se Vendimi i Gjykatës Supreme ishte i arsyetuar përkitazi me faktet e rastit dhe konkluzionin. Kërkesa e parashtruesit u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar, ashtu siç është paraparë në rregullin 36 (1) dhe (2) d) të Rregullores së punës. Gjykata, po ashtu hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për moszbulim të identitetit si të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI60/14
Parashtrues
Tomë Krasniqi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 35/2014, të 12 shkurtit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Tomë Krasniqi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 35/2014 të 12 shkurtit 2014, i cili i është dorëzuar atij më...

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht neni 23 [Dinjiteti i Njeriut], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 46 [Mbrojtja e Pronës], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 145 [Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm] dhe nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa), neni 1 [Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut], neni 3 [Ndalimi i torturës], neni 14 [Ndalimi i diskriminimit], neni 1 i Protokollit 1 [Mbrojtja e Pronës] dhe neni 9 i Konventës

Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (në tekstin e mëtejmë: KNDESK).

4. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që mos ta zbulojë identitetin e tij. Parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 36 [E Drejta e Privatësisë] të Kushtetutës, nenit 17 [Parimi i Publicitetit] të Ligjit dhe nenit 1 *[Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut]* dhe 14 *[Ndalimi i diskriminimit],* të Konventës, pa ofruar ndonjë arsye për një kërkesë të tillë.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 31 mars 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 3 prill 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin, Nr. GJR. KI60/14 caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese, dhe me Vendimin, Nr. KSH. KI39/14 caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

8. Më 13 maj 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 15 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI60/14, zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan me gjyqtarin Ivan Čukalović, si anëtar të Kolegjit shqyrtues.

10. Më 17 shtator 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Baza faktike e kërkesës KI60/14 është e njëjtë si ajo në kërkesën KI39/11, e cila gjithashtu ishte dorëzuar në Gjykatë nga parashtruesi i kërkesës. Kjo kërkesë ishte refuzuar si e papranueshme për shkak të

mosshterimit të mjeteve juridike (shih Aktvendimin për papranueshmëri KI39/11 të 15 janarit 2013).

12. Më 11 qershor 1998, Fondi për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Kosovës (Aktvendimi nr. 181-1/98) i njeh parashtruesit të kërkesës të drejtën në pension që nga 3 maji 1998.

13. Parashtruesi i kërkesës ka gëzuar të drejtën e pensionit të pleqërisë deri në nëntor të vitit 1998, mirëpo, për shkak të rrethanave në Kosovë, në fillim të vitit 1999, e drejta e parashtruesit për shfrytëzimin e pensionit të pleqërisë ishte ndërprerë pa kurrfarë baze ligjore.

14. Më 4 maj 2007, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (më parë e njohur si Gjykata Komunale) kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me pretendimin se ajo është e obliguar ta kompensojë dhe të vazhdojë me pagesa, në pajtim me Vendimin nr. 181-1/98 të 11 qershorit 1998.

15. Më 17 janar 2013, Gjykata Themelore (Aktgjykimi C. nr. 1155/2007) e refuzoi padinë e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës si të pabazuar dhe konstatoi se:

> *"Gjykata vlerëson se të paditurës Republika e Kosovës-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale Prishtinë i mungon legjitimiteti pasiv në këtë çështje juridike civile edhe për faktin se paditësi, siç del nga shkresat e lëndës, s'ka qenë në asnjë raport juridik me të paditurën dhe në asnjë dispozitë ligjore nuk është paraparë detyrimi i paditurës që të pranojë obligimet e institucioneve të paraluftës të cilat kanë funksionuar sipas legjislacionit të RS, përfundimisht deri në qershor të vitit 1999. Sipas nenit 1.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1 mbi autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë (e cila ka hy në fuqi me 10 qershor 1999), gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën i vishet UNMIK-ut dhe udhëhiqet nga PSSP. Pas kësaj janë themeluar institucionet e përkohshme të Kosovës për qeverisjen autonome dhe demokratike në nivel komunal dhe qendror".*

16. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë *"për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore"*.

17. Më 7 tetor 2013, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi CA. nr. 1144/2013) e refuzoi ankesën e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore C. nr. 1155/2007 të 17 janarit 2013.

18. Gjykata e Apelit konstatoi që:

"Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të nenit 182 pika 2 të LPK, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194, të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave dhe për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, aktgjykimi i shkallës së parë nuk është përfshirë me shkelje qenësore".

[...]

"Me rregulloren e UNMIK-ut nr. 200/10 është themeluar departamenti administrativ i shëndetësisë dhe i mirëqenies sociale, i cili departament nuk është trashëgimtarë i asnjë institucioni të Kosovës të para luftës që do të thotë se nuk është suksesor as i Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Kosovës, me të cilin aktvendim paditësi ka shfrytëzuar të drejtën e pensionit. Është fakt notor se e paditura e ka krijuar Fondin e sigurimeve shoqërore të Kosovës nr. 3/2001. Mirëpo nga Fondi pensional i para luftës tani fondi pensional i Kosovës nuk ka kurrfarë suksesioni andaj edhe e paditura nuk ka obligim që të paguaj pensionet të cilin fond e ka rrëmbyer shteti serb dhe mbetet rreth këtij fondi të lidhet ndonjë marrëveshje në mes të Shtetit të Kosovës dhe atij serb, nga se fondi i cituar për të cilën thirret paditësi ai është fond i qytetarëve të Kosovës dhe se të gjithë qytetarët që kanë kontribuar në atë fond kanë të drejtën e shfrytëzimit meqë të njëjtit kanë kontribuar për krijimin e atij fondi".

19. Parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

20. Më 12 shkurt 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 35/14) e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion duke konstatuar se:

"Gjykatat e instancës më të ulët, drejt i kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë konkluduar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, se aktgjykimet e përmendura nuk përmbajnë shkelje thelbësore të

dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK".

[...]

"Sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/35 është themeluar Administrata Pensionale e Kosovës, si njësi administrative në kuadër të Departamentit kalimtar të Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila përcakton kompetencën dhe përgjegjësitë e Administratës Pensionale si organ i rij, i pavarur që administron pagesën e pensioneve bazë, sipas të cilës Rregullore Administrata Pensionale e Kosovës, nuk ngarkohet me asnjë përgjegjësi lidhur me pensionet e periudhës së para luftës, Edhe me Rregulloren Nr. 2005/20 të datës 29. prill 2005 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK Nr. 2001/35 mbi pensionet në Kosovë,me nenin 39 është paraparë që kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me te, e cila rregullore ka hyrë në fuqi më 29. prill 2005, si dhe Ligjin për ndryshimin e Rregullores së UNMIK 2005/20 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës, me të cilin është miratuar Ligji për Fondin Pensional të Kosovës, si subjekt i ri i pavarur juridik, sipas të cilit ligj nuk është paraparë se ky fond është suksesor juridik i ish Fondit Republikan për sigurimin pensional dhe invalidorë të punësuarve -Filjala Prishtinë, që ka funksionuar deri më në muajin Qershor të vitit 1999, i cili fond me hyrjen e Kosovës nën administrimin ndërkombëtar ka pushuar funksionimi i tij në territorin e Kosovës, prandaj sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, e paditura nuk ka qenë në raport materialo-juridiko civil me paditësin, çka do të thotë se të paditurës i mungon legjitimiteti pasiv në këtë çështje juridike, ngase të paditurat janë subjekte te reja juridike në raport me ato të paraluftës në Kosovë, ndërsa kërkesëpadia e paditësit ka të bëjë me raportet e krijuar sipas vendimit të ish Fondit Pensional të paraluftës, prandaj gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale kur kane gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar dhe si të tillë e kanë refuzuar nga se të paditurave u mungon legjitimiteti pasiv për të qenë palë në procedurë".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon që *"pensionin e pleqërisë e gëzon mbi bazën e dispozitave të Ligjit të Aplikueshëm mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor i shpallur në Gazetën Zyrtare të KSAK, Nr. 26/83 i datës së 30 qershorit 1983, i cili është i aplikueshëm konform Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24".*

22. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon që *"Autoritetet e UNMIK-ut, e më vonë edhe ato të Republikës së Kosovës, menjëherë pas luftës kanë qenë të detyruara që Kërkuesit i cili para vitit 1999 e ka fituar të drejtën në pension, t'ia sigurojnë dhe mundësojnë marrjen e rregullt të pensioneve, mirëpo, deri më tani autoritetet e Republikës së Kosovës, ndaj Kërkuesit nuk e kanë respektuar e as zbatuar detyrimin ligjor".*

23. Në këtë mënyrë, bazuar në atë që u përmend më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon që aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta ia kanë shkelur të drejtat si në vijim:

    a) Shkelja e të drejtave të garantuara me Kushtetutë:

    Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 46 [Mbrojtja e Pronës], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 145 [Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm]

    b) Shkelja e të drejtave sipas së drejtës ndërkombëtare:

    KEDNJ

    Neni 1 [Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut], neni 3 [Ndalimi i torturës], neni 14 [Ndalimi i diskriminimit], neni 1 i Protokollit 1 [Mbrojtja e Pronës]

    KNDESK

    Neni 9

24. Si përfundim, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që *"pensioni i tij i fituar nga kontributet e paguara, detyrimisht t'i caktohet proporcionalisht me kontributet që janë paguar gjatë shekullit të punës së tij e sipas legjislacionit të punës nga marrëdhënia e punës dhe mbi bazën e punës së kaluar".*

Pranueshmëria e kërkesës

25. Para së gjithash, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri.

26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) dhe rregullit 36 (2) b) të Rregullores së punës, që parasheh se:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese

[...]".

27. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit pretendon shkeljen e nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 46 [Mbrojtja e Pronës], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 145 [Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm] të Kushtetutës dhe neni 1 [Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut], neni 3 [Ndalimi i torturës], neni 14 [Ndalimi i diskriminimit], neni 1 i Protokollit 1 [Mbrojtja e Pronës] të KEDNJ-së dhe neni 9 i KNDESK.

28. Megjithatë, Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar si dhe pse këto të drejta kushtetuese ishin shkelur me vendimin e kontestuar. Pakënaqësia me vendimin apo thjesht përmendja e neneve dhe dispozitave të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme për të ngre një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkeljet e Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë argument bindës dhe të arsyetuar mirë në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar.

29. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).

30. Gjykata më tej thekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011). Fakti i thjeshtë që parashtruesi i kërkesës nuk është i

kënaqur me rezultatin e procedurave në rastin e tij nuk mund të ngre kërkesë të argumentueshme për shkelje të të drejtave të tij të mbrojtura me Kushtetutë. Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të shumta ta paraqesë rastin e tij në gjykatat e rregullta.

31. Gjykata mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të vështruara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në atë mënyrë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, App. nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, miratuar më 10 korrik 1991).

32. Gjykata konsideron se procedurat në gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe ato në Gjykatën Supreme, kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).

33. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ka ofruar arsyetim për faktet e rastit dhe gjetjet e tyre.

34. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur dhe arsyetuar pretendimet e tij për shkelje të Kushtetutës nga ana e vendimit të kontestuar.

35. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

36. Për më tepër, kërkesa e parashtruesit për moszbulimin e identitetit të tij duhet të refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me rregullat 36 (1) c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 17 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. dr. Enver Hasani

KI91/14, Parashtrues Rexhep Sagdati, Vlerësim i kushtetutshmërisë i Aktgjykimit, nr. AC-I-12-0115, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i 25 prillit 2013

KI91/14, Aktvendim për papranueshmëri i 25 nëntorit 2014, publikuar më 5 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, diskriminim në baza kombëtare, kërkesë qartazi e pabazuar*

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me Aktgjykimin, nr. AC-I-12-0115, të 25 prillit 2013 miratoi ankesën e Sindikatës së Pavarur dhe Këshillit drejtues të ndërmarrjes NSH Kooperativa, të 17 tetorit 2012, me ç'rast parashtruesit nuk i ishte njohur e drejta në 20% të fitimeve nga privatizimi i "NSH Kooperativa Prizrenkop".

Parashtruesi pretendoi ndër të tjera, se Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës e diskriminoi vetëm pse ishte pjesëtar i nacionalitetit pakicë, dhe shkeli të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se Vendimi i Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme ishte argumentuar qartë, dhe se procedurat nuk ishin të padrejta apo arbitrare. Parashtruesi nuk kishte dëshmuar se si vendimi i kontestuar i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë. Kërkesa e parashtruesit u shpall e papranueshme, si qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI91/14
Parashtrues
Rexhep Sagdati
Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nr. AC-I-12-0115, të 25 prillit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Rexhep Sagdati, fshati Reçan, Komuna e Prizrenit, të cilin e përfaqëson avokati z. Salim Rexha.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Kolegjit të ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-12-0115 (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme) të 25 prillit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 2 maj 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [nr. AC-I-12-0115] të Kolegjit të ankesave të Dhomës së Posaçme, të 25 prillit 2013, me të cilin sipas parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës si dhe liritë dhe të drejtat themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 49 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 25 maj 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI91/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI138/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 30 shtator 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Kolegjin e ankesave të Dhomës së Posaçme për regjistrimin e kërkesës, dhe të njëjtën kohë Gjykata kërkoi që parashtruesi i kërkesës, në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit, të dorëzojë të gjitha dëshmitë relevante me të cilat do ta arsyetonte pretendimin e tij se aktgjykimi i kontestuar [nr. AC-I-12-0115] i Kolegjit të ankesave të Dhomës së Posaçme, i 25 prillit 2013, i është dorëzuar atij më 2 maj 2014.

8. Më 10 tetor 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi fletëkthesën si dëshmi se aktgjykimi i kontestuar [nr. AC-I-12-0115] i Kolegjit të ankesave të Dhomës së Posaçme, i është dorëzuar atij më 2 maj 2014.

9. Më 25 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 10 mars 1977, parashtruesi i kërkesës kishte themeluar marrëdhënie të punës me ndërmarrjen shoqërore „NSH Kooperativa Prizrenkop“ (në tekstin e mëtejmë: NSH Kooperativa) ku kishte punuar deri më 9 qershor 1999.

11. Më 6 qershor 2008, ndërmarrja “NSH Kooperativa” ishte privatizuar.

12. Më 30 qershor 2009, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP-ja) publikoi listën e përkohshme të punëtorëve të cilët në atë kohë kishin fituar të drejtën në 20% të privatizimit të

ndërmarrjes NSH Kooperativa, në të cilën nuk gjendej parashtruesi i kërkesës.

13. Më 19 gusht 2009, parashtruesi i kërkesës parashtroi kundërshtim ndaj listës së përkohshme të 30 qershorit 2009, të publikuar nga AKP-ja, me të cilin kërkoi që t'i njihet e drejta legjitime në 20% nga privatizimi.

14. Më 16 dhjetor 2010, AKP-ja publikoi listën përfundimtare të punëtorëve të cilët kishin fituar të drejtën në 20% të privatizimit të ndërmarrjes NSH Kooperativa, në të cilën nuk gjendej parashtruesi i kërkesës.

15. Më 23 dhjetor 2010, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme), me të cilën ai pretendonte se është viktimë e politikës diskriminuese të menaxhmentit të NSH Kooperativa.

16. Më 26 shtator 2012, Dhoma e Posaçme nxori Aktgjykimin [SCEL- 10-0040], me të cilin ankesa e parashtruesit të kërkesës ishte miratuar si e bazuar.

17. Më 17 tetor 2012, Sindikata e pavarur dhe Këshilli drejtues i ndërmarrjes NSH Kooperativa, ushtruan ankesë në Kolegjin e ankesave të Dhomës së Posaçme kundër Aktgjykimit [SCEL- 10-0040] të Dhomës së Posaçme të 26 shtatorit 2012, me të cilin kontestuan të drejtën e parashtruesit të kërkesës në 20%, duke dorëzuar dëshmi me të cilat mbështetnin bazueshmërinë e pretendimeve të tyre se parashtruesi i kërkesës nuk ishte viktimë e një politike diskriminuese.

18. Më 25 prill 2013, Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme nxori Aktgjykimin [nr. AC-I-12-0115] me të cilin aprovoi ankesën e Sindikatës së pavarur dhe Këshillit drejtues të ndërmarrjes NSH Kooperativa, të 17 tetorit 2012, ndërsa refuzoi Aktgjykimin [SCEL-10-0040] e Dhomës së Posaçme të 26 shtatorit 2012 si të pabazuar.

19. Në përfundimin e Aktgjykimit të Kolegjit të ankesave të Dhomës së Posaçme, theksohej: „*Kolegji i ankesave konsideron se ankesa e 17 tetorit 2012 është e bazuar, sepse parashtruesi i kërkesës nuk kishte dëshmuar se ka qenë i diskriminuar. Përkundër kësaj, Sindikata e pavarur dhe Këshilli drejtues i NSH Kooperativa i dëshmuan pretendimet e tyre me faktin se vëllai i parashtruesit të kërkesës dhe disa punëtorë tjerë të komunitetit pakicë kishin punuar në ndërmarrje deri në privatizimin e saj. […] dhe për këtë arsye ankesa e paditësit ishte refuzuar si e pabazuar*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi në kërkesën e tij theksoi se në bazë të asaj që u tha më lart, mund të konkludohet se ishte diskriminuar dhe ende diskriminohet si pjesëtar i komunitetit pakicë në Kosovë.

21. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën:

> *"... që Gjykata ta shpallë jokushtetues Aktgjykimin [nr. AC-I-12-0115] e Kolegjit të ankesave të Dhomës së Posaçme të 25 prillit 2013,sepse atij, si pjesëtar të nacionalitetit pakicë i shkelen të drejtat kushtetuese".*

Pranueshmëria e kërkesës

22. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

24. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit shqyrtohet nga aspekti i shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën e tij nuk kishte specifikuar se cilat të drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur me Aktgjykimin [nr. AC-I-12-0115] të Kolegjit të ankesave të Dhomës së Posaçme, edhe pse neni 48 i Ligjit parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

25. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh që:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

[...]

c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".

26. Për më tepër, Gjykata vëren se Kolegji i ankesave të Dhomës së Posaçme në Aktgjykimin [nr. AC-I-12-0115], të 25 prillit 2013, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin: *"Kolegji i ankesave nuk mund ta pranon si të drejtë miratimin e aspektit të diskriminimit vetëm se dikush është i nacionalitetit jo-shqiptar pa ndonjë indikacion të besueshëm lidhur me mundësinë që ai punëtor të ishte vërtet i diskriminuar".*

27. Gjykata gjithashtu rikujton se në pajtim me nenin 8.1 të Ligjit kundër diskriminimit [Ligji nr. 2004/3], është përcaktuar:

> Neni 8.1.: "*Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë...".*

28. Prandaj, Gjykata është e mendimit se shpjegimi i dhënë nga Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme në Aktgjykimin [nr. AC-I-12-0115] është i argumentuar qartë dhe ligjërisht, dhe se procedurat në Kolegjin e ankesave të Dhomës së Posaçme nuk ishin të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, nr 17064/06, Vendimi i GJEDNJ, i 30 qershorit 2009).

29. Gjykata thekson se, fakti i thjeshtë se parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkeljen e dispozitave të Kushtetutës (Shih*, mutatis mutandis, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* Nr. 5503/02, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 26 korrikut 2005).

30. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kriteret e pranushmërisë, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se vendimi i kontestuar i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

31. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 nëntor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetueses**
Arta Rama-Hajrizi	Prof. dr. Enver Hasani

KI102/14, Parashtrues Arben Ademi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës se Kosovës, Pkl. nr. 150/2012, të 30 janarit 2013

KI102/14, Aktvendim për papranueshmëri i 21 tetorit 2014, publikuar më 5 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, vrasje e rëndë, kërkesë e paafatshme*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin, Pkl. nr. 150/2012, refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë përkitazi me dënimin e tij me burgim prej 35 vjetësh për shkak të kryerjes së veprës penale,vrasje e rëndë.

Parashtruesi nuk iu referua ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti, por pretendoi se zbatimi i Ligjit penal nga Gjykata Supreme përbën shkelje të plotë të drejtësisë, sepse në rastin e tij nuk bëhet fjalë për vrasje.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi ka parashtruar kërkesën e tij në Gjykatë pas kalimit të afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh. Kërkesa u shpall e papranueshme për shkak se ishte e paafatshme ashtu siç është përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, si dhe specifikuar më tej me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI102/14
Parashtrues
Arben Ademi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pkl. nr. 150/2012, të 30 janarit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Arben Ademi nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), i përfaqësuar nga z. Alban Ademi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), Pkl. nr. 150/2012, të 30 janarit 2013, të dorëzuar te parashtruesi më 25 mars 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë.

4. Parashtruesi nuk specifikon ndonjë të drejtë të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) që mund t'i jetë shkelur.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) si dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 qershor 2014, parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 19 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

8. Më 20 qershor 2014, parashtruesi dorëzoi autorizimin për përfaqësim nga z. Alban Ademi.

9. Më 7 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI102/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI102/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

10. Më 25 korrik 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj Gjykatës Supreme.

11. Më 2 tetor 2014, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës, dhe i kërkoi që të dorëzojë në Gjykatë fletë-kthesën si dëshmi që provon datën kur parashtruesi e ka pranuar Aktgjykimin (Pkl. nr. 150/2012, të 30 janarit 2013) e Gjykatës Supreme.

12. Më 8 tetor 2014, Gjykata pranoi përgjigjen nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

13. Më 21 tetor 2014, Kolegji shqyrtues, shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 22 dhjetor 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi P. nr. 728/2005), dënoi parashtruesin me burgim në kohëzgjatje prej 35 (tridhjetë e pesë) vjetësh për shkak të kryerjes së veprës penale, vrasje e rëndë.

15. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

16. Më 7 shtator 2011, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pkl. nr. 351/2009) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit duke arsyetuar:

> *"[...] Gjykata e shkallës së parë analizën dhe vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitën e nenit 387 të KPPK, kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 396 par. 7 të KPPK, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i merr si të provuara ose si të paprovuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore, pra, ajo me konkludimet të cilat i ka nxjerrë, Gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të administruara e të cilat nuk vihen në dyshim me asnjë provë, si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo Gjykatë".*

17. Parashtruesi, parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, duke pretenduar *"shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe konstatim jo të plotë dhe të gabuar të fakteve".*

18. Më 30 janar 2013, Gjykata Supreme (Aktgjykimin Pkl. nr. 150/2012) refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë duke arsyetuar:

> *"[...] Gjykata Supreme pranon në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë të vërtetuar me aktgjykimin e shkallës së dytë dhe të tretë, përkitazi me përgjegjësinë penale të të gjykuarit Arben Ademi se në veprimet e të gjykuarit formohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale të vrasjes së rëndë [...] për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënuar".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi në kërkesën e tij thekson se *"Neni 147 par. 1 dhe par. 3 lidhur me nenin 23 të KPK-së është plotësisht shkelje e drejtësisë. Sepse nuk ka të bëj me vrasje në këtë rast por e vetmja mangësi e jona është se nuk dim se si ta dëshmojmë, zbulojmë, tregojmë që nuk është ashtu siç është akuzuar dhe dënuar me këtë nen".*

20. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me këtë kërkesë:

> *"E vetmja gjë që duam dhe mundohemi është që të zbulohet drejtësia që është bërë, dhe me shpresë ndaj kësaj gjykate që*

drejtësia të bie në vend. Ju lutemi që të na ndihmoni që të zbulohet rasti ashtu siç ka qenë dhe që drejtësia të del në shesh".

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]".

23. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi, [...]".

24. Në bazë të të dhënave nga shkresat e rastit, Gjykata konstaton se parashtruesi e ka parashtruar kërkesën më 16 qershor 2014. Gjithashtu, Gjykata, në bazë të shkresave të rastit, ka vërtetuar që Aktgjykimi Pkl. nr. 150/2013 i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit më 25 mars 2013. Në bazë të kësaj, rrjedh se parashtruesi e ka parashtruar kërkesën e tij në Gjykatë pas kalimit të afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, si dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

25. Gjykata përkujton që qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit si dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë sigurinë juridike duke siguruar që rastet të cilat paraqesin çështje kushtetuese të shqyrtohen brenda afateve të arsyeshme, si dhe vendimet e nxjerra më herët të mos jenë pafundësisht të hapura për kontestim (Shih, rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendimi i 25 gushtit 2005).

26. Nga sa u tha më lart, rrjedh se kërkesa është e paafatshme dhe duhet të refuzohet si e papranueshme në bazë të nenit 49 të Ligjit, dhe të rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 21 tetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Prof. dr. Enver Hasani

KI129/14, Parashtrues Faik Azemi, Vlerësim i kushtetutshmërisë i Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 270/2013, i 4 shkurtit 2014

KI129/14, Aktvendim për papranueshmëri i 25 nëntorit 2014, publikuar më 5 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkesë e paafatshme*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin, nr. 270/2013 kishte anuluar Vendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, dhe e kishte kthyer rastin për rigjykim përkitazi me pagat e papaguara të parashtruesit.

Parashtruesi ndër të tjera, pretendoi se Gjykata Supreme kishte shkelur të drejtën e tij për proces të rregullt gjyqësor.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, dhe se rrjedhimisht, ishte e paafatshme. Kërkesa u shpall e papranueshme për shkak se ishte e paafatshme ashtu siç është përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe specifikuar më tej rregullin 36 (1) c) të Rregullores se punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI129/14
Parashtrues
Faik Azemi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 270/2013,
të 4 shkurtit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Faik Azemi nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 270/2013, të 4 shkurtit 2014. Vendimi i kontestuar i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 20 mars 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jetë *"shkelur e drejta e tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm"*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit

për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 gusht 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 5 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI129/14 caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI129/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 16 shtator 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi atij që të dorëzojë dëshmi për datën e dorëzimit të vendimit të kontestuar. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës i është dërguar Gjykatës Supreme të Kosovës.

8. Më 25 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi dokumentet shtesë në Gjykatë.

9. Më 7 tetor 2014, Gjykatës Themelore në Prishtinë i është kërkuar të dorëzojë dëshmi lidhur me datën e dorëzimit të vendimit të kontestuar te parashtruesi i kërkesës.

10. Më 10 tetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi dëshmitë e kërkuara.

11. Më 25 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 29 dhjetor 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C1. nr. 515/2007) aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, se marrëdhënia e tij e punës i ishte ndërprerë në mënyrë të paligjshme, dhe urdhëroi Komunën e Prishtinës që t'ia pranojë parashtruesit të kërkesës të gjitha të drejtat që i kishte pasur për periudhën prej 1 tetorit 2003 deri më 31 dhjetor 2007, si sekretar i Shkollës së mesme të bujqësisë "Avdyl Frashëri" në Prishtinë.

13. Më 23 nëntor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 1816/2009) obligoi Komunën e Prishtinës që t'ia paguajë parashtruesit të kërkesës pagat e papaguara, për periudhën prej 1 tetorit 2003 deri më 31 dhjetor 2007, duke përfshirë edhe kamatën.

14. Më 25 qershor 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë refuzoi si të papranueshme ankesën e paraqitur nga Komuna e Prishtinës, për shkak të mospagesës së taksave gjyqësore.

15. Më 12 gusht 2013, Gjykata e Apelit të Kosovës (Aktvendimi CA. nr. 3581/2012) e refuzoi si të pabazuar ankesën e palës së paditur, Komunës së Prishtinës, dhe vërtetoi Aktvendimin (C. nr. 1816/09) e Gjykatës Komunale në Prishtinë.

16. Më 9 tetor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi E. nr. 1220/2013) lejoi përmbarimin e aktvendimit. Komuna e Prishtinës parashtroi një kundërshtim kundër aktvendimit për përmbarim. Gjykata Themelore e refuzoi kundërshtimin si të pabazuar.

17. Në një datë të pacaktuar, Komuna e Prishtinës parashtroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, me të cilin kontestoi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës (CA. nr. 3581/2012 të 12 gushtit 2013).

18. Më 4 shkurt 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktvendimi nr. 270/2013) pranoi revizionin e paraqitur nga Komuna e Prishtinës, anuloi vendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe e ktheu rastin për rigjykim.

19. Gjykata Supreme e Kosovës arsyetoi:

"Nga shkresat e lëndës del se e paditura taksat gjyqësore për ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale Prishtinë, C. nr. 1816/2009 datë 23.11.2011 e ka paguar me datën 04.06.2012, çka vërtetohet edhe nga urdhërpagesa me nr. fiskal 600365226. Këtë urdhërpagesë gjykata e shkallës së dytë ka pasur në shkresat e lëndës. Vërejtja për pagesë të taksës gjyqësore të padituës nga ana e Gjykatës Komunale, Prishtinë i është dorëzuar me 02.05.2012, të cilës e paditura ka pranuar me 04.05.2012, ndërsa vërejtjen e fundit e paditura ka pranuar me 01.06.2012.

Në bazë të nenit 3.2 pika (c) të Udhëzimit administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore nr. 2008/02, është përcaktuar se parashtruesit të parashtresave duhet të i caktojë datën deri kur ai duhet të paguajë taksën. Sipas vërejtjes së fundit për pagimin e taksës për të padituën, afati ka qenë 7 ditë. Duke u nisur nga fakti se e paditura vërejtjen e fundit ka pranuar më

01.06.2012, dhe se urdhëri për obligim pagesës në emër të taksave për ankesë nga ana e padituës në emër të Këshillit Gjyqësor të

Kosovës është bërë me 06.06.2012, nënkupton se bartja e mjeteve në emër të taksës gjyqësore është bërë në afat ligjor.

Gjykata e Apelit në këtë çështje juridike duhet të vlerësojë të gjitha pretendimet ankimore të paditurës dhe pastaj të merr vendim meritor lidhur me ankesën e të paditurës".

20. Më 8 prill 2014, Gjykata e Apelit të Kosovës, me Aktvendimin Ac. nr. 3779/13 e refuzoi ankesën e debitorit, Komunës së Prishtinës, dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, E. nr. 1220/13, të 12 nëntorit 2013.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *"... Ky Aktvendim shkel Kushtetutën, Nenin 31 të Kushtetutës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shkel edhe nenet 6.5, 6.6, dhe 6.7 të Udhëzimit Administrativ 2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore".*

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *"... Është shkelur edhe e drejta për një proces të rregullt. Këso shkelje bën Gjykata Supreme sepse përkundër faktit se të dy gjykatat (Gj. Themelore dhe Gj. e Apelit) kanë hudhur poshtë ankesën e të paditurës si të palejuar për shkak të mospagesës së taksës gjyqësore".*

23. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që ta anulojë Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe ta detyrojë Gjykatën Themelore dhe Gjykatën e Apelit të Kosovës ta përmbarojë Aktvendimin nr. 3581/2012, si dhe urdhrin për përmbarim E. nr. 1220/2013, të 30 prillit 2014.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

26. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".

27. Gjykata merr parasysh edhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

...

c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi...".

28. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, i cili i ishte dorëzuar atij më 20 mars 2014. Afati prej 4 (katër) muajve ka kaluar më 20 korrik 2014. Kërkesa është dorëzuar në Gjykatë më 13 gusht 2014.

29. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa është dorëzuar pas afatit prej 4 (katër) muajsh, të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

30. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesit i është dhënë mundësia për të shpjeguar se pse kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit të paraparë me ligj. Përkundër kërkesës në Gjykatë, ai nuk ka dhënë asnjë shpjegim.

31. Rrjedhimisht, kërkesa është e paafatshme dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 25 nëntor 2014 njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. dr. Enver Hasani

KI128/14, Parashtrues Fillim Guga, Vlerësim kushtetutshmërisë i Aktgjykimit ASC-ll-0073 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 24 korrikut 2014

KI128/14, Aktvendim për papranueshmëri i 9 dhjetorit 2014, publikuar më 9 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, kërkesë qartazi e pa bazuar.*

Më 24 korrik 2014, Kolegji i Apelit i Gjykatës Supreme të Kosovës me Vendimin ASC-11-0073 refuzoi, si të papranueshme kërkesën e parashtruesit për përsëritjen e procedurës duke arsyetuar se të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit të Apelit janë të formës se prerë, dhe kundër tyre nuk mund të parashtrohet ankesë apo kërkesë për përsëritjen e procedurës.

Parashtruesi pretendoi ndër të tjera, se Kolegji i Apelit i Gjykatës Supreme të Kosovës shkeli të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, sepse atij i është mohuar e drejta për përsëritjen e procedurës.

Gjykata Kushtetuese u shpreh se vendimi i Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës ishte i qartë, dhe i mbështetur në ligj, dhe se procedurat nuk ishin të padrejta apo arbitrare. Parashtruesi nuk kishte dëshmuar, se si vendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë. Kërkesa u shpall e papranueshme, si qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI128/14
Parashtrues
Fillim Guga
Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ASC-11-0073,
të 24 korrikut 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtar
Kadri Kryeziu, gjyqtar i
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Fillim Guga, nga Gjakova, i përfaqësuar nga avokati z. Teki Bokshi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme), ASC-11-0073 ,të 24 korrikut 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [ASC-11-0073] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të 24 korrikut 2014, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, është shkelur neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 46 [Mbrojtja e Pronës] të

Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenet 1, 4, 6, 7, 12 dhe 13 të KEDNJ.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), Nr. 03/L-121, dhe rregulli 56 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 6 gusht 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 5 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI128/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI128/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

7. Më 22 shtator 2014, Gjykata informoi parashtruesin e kërkesës dhe Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës, në periudhën prej 20 qershorit 1980 e deri më 23 mars 1999, kishte kontratë të përhershme në ndërmarrjen shoqërore "KNI Dukagjini - BP IMG Tjegullorja" (në tekstin e mëtejmë: IMG).

10. Më 31 korrik 2006, ndërmarrja IMG është privatizuar.

11. Më 10 prill 2007, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM) shpalli listën e përkohshme të punëtorëve, të cilët kishin të drejtë në 20% të privatizimit të ndërmarrjes IMG, në të cilën nuk ishte i përfshirë parashtruesi i kërkesës.

12. Më 19 prill 2007, parashtruesi dorëzoi kërkesë në AKM me të cilën kërkoi që ai të përfshihet në listën e përkohshme, duke argumentuar se është kthyer në Kosovë në vitin 2001, kur është paraqitur në punë, por kërkesën e tij e refuzoi menaxhmenti i ndërmarrjes.

13. Më 26 mars 2008, AKM-ja publikoi listën përfundimtare të punëtorëve, në të cilën nuk ishte përfshirë parashtruesi i kërkesës.

14. Më 11 prill 2008, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër vendimit të AKM-së të 26 marsit 2008, duke pretenduar të jetë viktimë e diskriminimit për shkak se i përket një komuniteti pakicë në Kosovë.

15. Më 29 prill 2008, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme i dorëzoi parashtruesit të kërkesës përgjigjen e AKM-së ndaj ankesës së tij, të 11 prillit 2008. AKM-ja është deklaruar shprehimisht në përgjigje se "*nuk kishte asnjë indikacion se ankuesi e kishte kundërshtuar vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës atij apo se kishte provuar të kthehet në pozitën e tij të mëparshme*". AKM-ja, në pretendimet e parashtruesit të kërkesës se është viktimë e diskriminimit, ka cekur: "*... nuk kishte dëshmi se ankuesi kishte qenë viktimë e ndonjë diskriminimi në kuptim të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, të 9 majit të vitit 2003, mbi bartjen e së drejtës për shfrytëzim të pronës së paluajtshme shoqërore*".

16. Më 12 maj 2008, parashtruesi i kërkesës iu përgjigj pretendimeve të AKM-së, të 29 prillit 2008, ku deklaroi se *„ai është refugjat politik i cili kishte shkuar në Mal të Zi"*.

17. Më 17 qershor 2008, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka marrë vendimin [SCEL-08-0001], duke ia refuzuar ankesën parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

18. Në konkluzionin e vendimit, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme deklaron:

> *„Ankuesit të cilët pretendojnë diskriminimin duhet të paraqesin fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim direkt apo indirekt, në pajtim me nenin 8. 1 të Ligjit kundër diskriminimit. Përveç kësaj, pasi ankuesi të paraqet një rast të diskriminimit direkt apo indirekt në shikim të parë, i padituri obligohet të hedhë poshtë diskriminimin.*
>
> ...
> *Dhoma e Posaçme i ka shqyrtuar të gjitha dëshmitë dhe pajtohet me analizën e të paditurit [AKM]. Prandaj, Dhoma e Posaçme e hedh poshtë kërkesën e ankuesit për t'u përfshire në listën e punëtorëve me të drejtë në fitimet e privatizimit".*

19. Më 14 korrik 2008, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër Vendimit [SCEL-08-0001] të Dhomës së Posaçme të Gjykatës

Supreme, të 17 qershorit 2008, duke iu referuar Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/4, të 5 shkurtit 2008.

20. Më 10 shtator 2008, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme nxori vendim duke refuzuar ankesën e parashtruesit. Në konkluzionin e vendimit theksohet: *"Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2008/4 më vonë u ndryshua me rregulloret të cilat e shtynin hyrjen e saj në fuqi deri më 31 tetor 2008. Prandaj asnjë ankesë nuk ishte e mundur të paraqitet kundër aktgjykimit të datës 17 qershor 2008".*

21. Më 15 qershor 2011, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi kërkesë Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme me të cilën kërkoi përsëritjen e procedurës.

22. Më 24 korrik 2014, Kolegji i Apelit nxori vendim [ASC-11-0073] me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të papranueshme me arsyetimin:

> *„Kolegji i Apelit vëren se në pajtim me Nenin 10, paragrafi 14 i Ligjit Nr. 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit të Apelit janë të formës së prerë dhe kundër tyre nuk mund të parashtrohet ankesë apo kërkesë për përsëritjen e procedurës. Për me tepër LDHP dhe Shtojca nuk ofrojnë asnjë mjet tjetër të jashtëzakonshëm kundër aktvendimeve të tilla të formës së prerë të Kolegjit të Apelit (një mjet i tillë i jashtëzakonshëm nuk është përcaktuar as me Rregulloren e UNMIK-ut 2008/4 dhe as me Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2008/6). [...] Prandaj, propozimi i parashtruesit për përsëritjen e procedurës është i papranueshme dhe si i tillë do të hidhet poshtë".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi në kërkesë pretendon se me vendimet e Dhomës së Posaçme i janë shkelur të drejtat dhe liritë elementare të njeriut, të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për Drejtat e Njeriut, dhe konkretisht:

> *"- të drejtat e parapara me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,*
>
> *- e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, nga neni 31. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës,*

- *të drejtat e garantuara me Konventën për mbrojtën e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore të shoqëruara nga Protokollet Nr. 1, 4, 6, 7, 12 e 13".*

24. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesë:

"Anulimin e aktvendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit Asc-11-0073 të dt. 24.07.2014 dhe vendimet e atakuara me kërkesën time për përsëritjen e procedurës - Aktgjykimi SCEL-08-0001 të datës 17.06.2008, Aktvendimi i datës 10.09.2008 dhe detyrimin e AKP për pagesë të 20%-it nga shuma e privatizimit të NSH IMN Gjakovë".

Pranueshmëria e kërkesës

25. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës së Gjykatës.

26. Në këtë kuptim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe të lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

27. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(1) "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar."

28. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, më 27 korrik 2009, dorëzoi kërkesë në Gjykatë, në të cilën kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë të Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës [SCEL-08-0001], të 17 qershorit 2008, dhe të Vendimit [SCEL-08-0001], të 10 shtatorit 2008.

29. Në të njëjtën ditë, Gjykata e regjistroi kërkesën e parashtruesit me numrin KI33/09.

30. Më 18 tetor 2010, Gjykata nxori Aktvendim për papranueshmërinë e kërkesës, KI33/09, në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

31. Përkitazi me këtë, Gjykata vëren se, në rastin KI128/14, do të merret ekskluzivisht me vlerësimin kushtetues të Aktgjykimit [ASC-11-0073] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme, të 24 korrikut 2014, ndërsa vendimet të cilat tashmë ishin objekt i çështjes në rastin KI33/09 nuk do t'i rishqyrtojë.

32. Sa i përket kërkesës KI128/14, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur fakte të reja për të justifikuar pretendimet e tij se Aktgjykimi [ASC-11-0073] i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme i shkeli të drejtat dhe liritë e tij, të cilat janë cekur në paragrafin 22 të këtij aktvendimi.

33. Për më tepër, Gjykata konsideron se Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme, në Aktgjykimin ASC-11-0073 e 24 korrikut 2014, është përgjigjur në kërkesën e parashtruesit kur theksoi: *„Për lëndën në fjalë, kërkesa për përsëritjen e procedurës e parashtruesit është kundër Aktgjykimit të Dhomës se Posaçme SCEL-08-0001 të datës 17/06/2008, që tani është vendosur me Aktvendimin, më datë 10/09/2008 nga një Kolegj i caktuar, vendimi është i formës së prerë. Prandaj, propozimi i parashtruesit për përsëritën e procedurës është i papranueshëm".*

34. Në bazë të kësaj, Gjykata shpreh qëndrimin se shpjegimi i dhënë nga Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme në Aktgjykimin ASC-11-0073 është i qartë dhe i argumentuar në mënyrë ligjore, dhe se procedurat para Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme nuk ishin të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, vendimi i GJEDNJ-së, më 30 qershor 2009).

35. Gjykata Kushtetuese rithekson që, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt sa i përket vendimeve të marra nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih, gjithashtu, rastin KI70/11, parashtruesit e kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

36. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të atillë që parashtruesi të ketë pasur një gjykim të drejtë (shih, ndër burimet e

tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

37. Gjykata thekson se, fakti që parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të paraqesë pretendim të argumentuar për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

38. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kërkesat e pranueshmërisë, duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se vendimi i kontestuar shkel të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

39. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 9 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Prof. dr. Enver Hasani

KI133/14, Parashtrues Xhelil Neziri, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr.253/2012, i 7 majit 2013, dhe Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, CPP. nr. 3/2014, i 3 qershorit 2014

KI133/14, Aktvendim për papranueshmëri i 5 nëntorit 2014, publikuar më 9 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë admnistrative, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta në punë dhe në ushtrim të profesionit, mos vazhdim i kontratës së punës, përbërja dhe paanshmëria e gjykatave, përsëritje e procedurës, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës kishte refuzuar kërkesat e parashtruesit për revizion dhe përsëritje të procedurës përkatësisht kishte vërtetuar vendimet e gjykatave të instancës më të ulët përkitazi me mosvazhdimin e kontratës së punës.

Parashtruesi ndër të tjera, pretendoi se punëdhënësi i tij dhe gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e barazisë para ligjit, të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtën në punë dhe në ushtrim të profesionit, siç përcaktohet me nenet 3, 31 dhe 49 të Kushtetutës përkatësisht, për shkak se ato nuk i kishin bazuar konstatimet e tyre në faktet relevante dhe se në instancën e parë, dhe të dytë i njëjti gjyqtar mori pjesë në gjykim të çështjes.

Gjykata Kushtetuese shqyrtoi në tërësi ecurinë e procedurave të rregullta dhe të jashtëzakonshme dhe konstatoi, se pretendimet e parashtruesit nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Kërkesa u shpall e papranueshme, si qartazi e pabazuar, në përputhje me rregullin 36 (1) d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI133/14
Parashtrues
Xhelil Neziri
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 253/2012, të 7 majit 2013, dhe Aktvendimit CPP. nr. 3/2014, të 3 qershorit 2014, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Xhelil Neziri, nga fshati Velekincë, komuna e Gjilanit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin Rev. nr. 253/2012 të 7 majit 2013, dhe Aktvendimin CPP. nr. 3/2014 të 3 qershorit 2014 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme).

3. Vendimin përfundimtar të Gjykatës Supreme, CPP. nr. 3/2014, të 3 qershorit 2014, parashtruesi i kërkesës pohon se e ka pranuar më 15 gusht 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 253/2012 të 7 majit 2013, dhe Aktvendimit CPP. nr. 3/2014 të 3 qershorit 2014 të Gjykatës Supreme, përkitazi me shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm],

dhe nenin 49 [E Drejta në Punë dhe Ushtrim të Profesionit] të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Bazë juridike për këtë rast është neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 22 dhe 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 29 gusht 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 5 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI133/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI133/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

8. Më 5 shtator 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme, për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 5 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

Faktet sipas mjeteve të rregullta juridike

10. Më 1 shtator 2007, parashtruesi lidhi kontratë pune me Drejtorinë Komunale për Arsim në Gjilan (në tekstin e mëtejmë: DKA në Gjilan), si mësimdhënës i lëndëve juridike në shkollën e mesme ekonomike "Marin Barleti" në Gjilan.

11. Më 20 gusht 2008, DKA në Gjilan nxori Vendimin 05. nr. 519/08 me të cilin vendosi që parashtruesit të mos i vazhdohet kontrata e punës. Kundër vendimit të DKA-së së Gjilanit, parashtruesi ushtroi të drejtën e ankesës në të njëjtin organ, për t'i kuptuar arsyet e shkëputjes së kontratës së punës.

12. Më 17 dhjetor 2008, DKA-ja e Gjilanit, refuzoi ankesën e parashtruesit, dhe la në fuqi vendimin e saj 05. nr. 519/08. Kundër këtyre vendimeve parashtruesi ka ushtruar kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Gjilan.

13. Më 10 janar 2012, Gjykata Komunale e Gjilanit (Aktgjykimi, C. nr. 480/2008), refuzoi padinë e parashtruesit, ushtruar kundër DKA-së së Gjilanit. Gjykata në fjalë kishte konstatuar, si në vijim:

    "Me dëgjimin e paditësit në cilësi të palës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi në bazë të kontratës së punës të lidhur në mes tij dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gjilan, të datës 03. 09. 2007, kishte themeluar marrëdhënie të punës në Shkollën e Mesme Ekonomike 'Marin Barleti' në Gjilan, si mësimdhënës i lëndëve juridike me pagë mujore prej 214 Euro në muaj, dhe se në këtë vend të punës ka punuar gjer më datë 31. 08. 2008, respektivisht deri në përfundimin e kontratës së punës dhe se deri në muajin korrik të vitit 2008 është shpërblyer për punën e bërë, kurse për muajin gusht të vitit 2008 nuk është paguar fare.

    Pas analizimit të të gjitha provave së bashku, gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar në ligj, pasi që e paditura në tërësi ka respektuar dispozitat ligjore të Rregullores nr. 2001/27, për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, me rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës".

14. Më 16 janar 2012, parashtruesi, kundër aktgjykimit të gjykatës së instancës së parë, ushtroi të drejtën e ankesës në Gjykatën e Qarkut në Gjilan. Ankesa është bazuar në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, në aplikimin e gabuar të ligjit material dhe në shkeljen e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/27, për ligjin themelor të punës në Kosovë.

15. Më 15 qershor 2012, Gjykata e Qarkut në Gjilan (Aktgjykimi, Ac. nr. 25/2012) refuzoi, si të pa bazë, ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së instancës së parë. Gjykata në fjalë konstatoi se gjykata e instancës së parë, në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë korrekte dhe të drejtë ka aplikuar ligjin material.

Faktet sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike

16. Më 23 korrik 2012, parashtruesi, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, ushtroi revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të ligjit material dhe shkeljes së dispozitave të nenit 188 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

17. Më 7 maj 2013, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Rev. nr. 253/2012), refuzoi revizionin e ushtruar nga parashtruesi dhe vërtetoi si të drejtë aktgjykimin e gjykatës së instancës së dytë.

18. Për më tepër, Gjykata Supreme kishte konstatuar: *"Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, në mënyrë të drejtë gjykatat e instancës më të ulët kanë vendosur, kur kanë refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, nga arsyeja se paditësi te e paditura ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të caktuar në kuptim të nenit 10.1 pika (b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të punës në Kosovë dhe se kontrata është lidhur në kohë të caktuar në bazë të nenit 11.1 pika (d) kontrata shkëputet me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit. Gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e të ardhurave personale për shkak se pas skadimit të kohëzgjatjes së punësimit, pushojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet në mes të punëdhënësit dhe të punësuarit.*

[...]

Paditësi është pranuar në detyrat e punës të mësimdhënësit te e paditura në lëndët juridike dhe në bazë të konkursit, mirëpo më parë në këtë vend të punës ka qenë N. G. e cila është kthyer në vendin e punës në lëndët juridike, të cilat i ka pasur paditësi dhe se kjo ka qenë arsyeja që paditësit të mos i përtërihet kontrata e punës në kohë të caktuar".

Faktet përkitazi me përsëritjen e procedurës

19. Më 3 korrik 2013, parashtruesi, parashtroi kërkesë për përsëritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 253/2012, të 7 majit 2013, dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit, Ac. nr. 25/2012 të 15 qershorit 2012, përmes së cilës ka kërkuar që çështja t'i kthehet gjykatës së instancës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje.

20. Edhe pse, kërkesa për përsëritjen e procedurës i është drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nga shkresat e lëndës del se kërkesa është shqyrtuar nga Gjykata Supreme.

21. Më 3 qershor 2014, Gjykata Supreme (Aktvendimi, CPP. nr. 3/2014) refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për përsëritjen e procedurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 253/2012 të 7 majit 2013.

22. Për më tepër, Gjykata Supreme, aktvendimin e saj e arsyetoi si më poshtë:

"Propozimi për përsëritjen e procedurës është i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se me dispozitën ligjore të nenit 232 par. 1 pika (e) të LPK-së, është paraparë se procedura mund të përsëritet sipas propozimit të palës, në qoftë se pala e fiton mundësinë ta përdorë vendimin e formës së prerë të gjykatës, i cili më parë, është dhënë në procedurën e zhvilluar midis palëve të njëjta për të njëjtën kërkesëpadi. Nga arsyetimi i propozimit për përsëritjen e procedurës del se paditësi përkitazi me dispozitën e cekur ka arsyetuar se gjyqtari B. S., ka gjykuar në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësit Xhelil Neziri (parashtruesi), në lëndën C. nr. 480/2008 dhe ka marrë pjesë si anëtar i kolegjit në shkallën e dytë, në çështjen kontestimore, sipas padisë së paditëses N. G., në lëndën Ac. nr. 228/2008. Andaj, në rastin konkret kemi të bëjmë me paditës të ndryshëm dhe kërkesëpadi të veçanta, dhe një fakt i tillë i cekur në propozimin për përsëritjen e procedurës ka të bëjë eventualisht me përjashtimin e gjyqtarit nga procedura, sipas kreut III të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Kjo gjykatë vëren se edhe pretendimet tjera të cekura në propozimin për përsëritjen e procedurës për shkeljet procedurale nga neni 67 i ligjit të cekur kanë të bëjnë me kapitullin e cekur.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, paditësi nuk ka propozuar asnjë rrethanë me të cilën do të plotësoheshin kushtet nga neni 232 i LPK-së, për përsëritjen e procedurës, andaj e njëjta u refuzua si e pa bazuar".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi pretendon se DKA-ja e Gjilanit dhe gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 të Kushtetutës, për shkak se në gjykatën e instancës së parë dhe të dytë mori pjesë në gjykim të çështjes i njëjti gjyqtar; me nenin 31 të Kushtetutës për shkak se Gjykata Komunale në Gjilan nuk mori parasysh faktin se parashtruesi kishte më shumë fakte relevante për t'iu vazhduar punësimi sesa kolegia e tij, së cilës i është pranuar kërkesëpadia për kthim në punë; dhe, me nenin 49 të Kushtetutës, për shkak se DKA-ja e Gjilanit dhe gjykatat e rregullta nxorën vendime të padrejta duke e lënë pa punë parashtruesin e kërkesës.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

25. Përkitazi me këtë kërkesë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, që parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

26. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) d) i Rregullores së punës, parasheh:

(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
(Ndryshuar më 28 tetor 2014)

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(Ndryshuar më 28 tetor 2014)

27. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon së DKA-ja e Gjilanit, dhe gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të parapara me nenin 3. 31 dhe 49 të Kushtetutës, për faktin se autoritetet që nxorën vendime për çështjen e tij nuk i bazuan konstatimet e tyre në fakte relevante dhe si pasojë vendimet e atyre gjykatave u nxorën me aplikim të gabuar të ligjit material dhe procedural, dhe se në gjykatën e instancës së parë dhe të dytë mori pjesë në gjykim të çështjes i njëjti gjyqtar.

28. Në rastin konkret, Gjykata shqyrtoi në tërësi ecurinë e gjithë procedurës së rregullt dhe të procedurës së jashtëzakonshme dhe konsideron se pretendimet e ngritura, në asnjë fazë të zhvillimit të tyre nuk paraqesin bazë të mjaftueshme kushtetuese, që do të mund të rezultonin me shkelje të të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë, dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ-së).

29. Gjykata vëren se, përgjatë procesit të rregullt gjyqësor, ankesat e parashtruesit janë të bazuara në ligj (ligjshmëri), përkitazi me mosvazhdimin e kontratës së punës nga DKA-ja në Gjilan.

30. Përkitazi me këtë proces të rregullt, Gjykata Supreme, sipas detyrës zyrtare ka vlerësuar ligjshmërinë e aktgjykimit të gjykatës së instancës së dytë dhe pas shqyrtimit në tërësi të shkresave të lëndës, ka përfunduar se revizioni i ushtruar nga parashtruesi është i pabazuar. Në këtë kontekst, Gjykata, konsideron se aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk përmban elemente të shkeljes së të drejtave kushtetuese të parashtruesit, duke qenë se vendimi është i argumentuar, i

arsyetuar, dhe me asnjë provë nuk mund të konstatohet se aktgjykimi është i paqartë dhe arbitrar.

31. Gjykata gjithashtu vëren se, në fazën e ngritjes së kërkesës për përsëritjen e procedurës, kundër vendimeve të gjykatës së instancës së dytë dhe të tretë parashtruesi, e adreson dhe argumenton ankesën e tij gjithnjë në bazën e ligjshmërisë dhe fokusohet kryesisht në shkeljen e ligjit procedural.

32. Përkitazi me këtë, Gjykata vëren se, Gjykata Supreme, në Aktvendimin CPP. nr. 3/2014 të 3 qershorit 2014, në mënyrë të qartë ka argumentuar se kërkesa e parashtruesit për përsëritjen e procedurës adresohet kryesisht në çështjet që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e gjyqtarit të njëjtë në dy instanca gjyqësore, gjë për të cilën Gjykata Supreme i ka dhënë përgjigje parashtruesit, ku thotë se "N*ë rastin konkret kemi të bëjmë me paditës të ndryshëm dhe kërkesëpadi të veçanta dhe një fakt i tillë i cekur në propozimin për përsëritjen e procedurës ka të bëjë eventualisht me përjashtimin e gjyqtarit nga procedura, sipas kreut III të Ligjit të Procedurës Kontestimore",* prandaj gjykata në fjalë ka vlerësuar se parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë fakt të ri, rrethanë të re faktike, që do të mundësonte aprovimin e kërkesës për përsëritjen e procedurës.

33. Prandaj, arsyen e refuzimit të kërkesës për përsëritjen e procedurës, Gjykata Supreme e bazon në ligjin procedural, dispozitat e të cilit kanë paraparë qartë se, në cilat raste palëve u mundësohet shfrytëzimi i këtij mjeti juridik. Edhe në këtë kontekst, parashtruesi në asnjë mënyrë nuk ka arritur të argumentojë se, vendimi për refuzimin e kërkesës për përsëritjen e procedurës është i paarsyetuar, i paqartë apo arbitrar.

34. Gjykata edhe më tutje thekson se nuk është gjykatë e faktit dhe nuk gjykon si gjykatë e instancës së katërt. Gjykata në parim nuk gjykon faktin nëse gjykatat e rregullta në mënyrë të drejtë dhe të plotë e kanë konstatuar gjendjen faktike apo, siç është rasti konkret, të vërtetojë nëse punësimi i parashtruesit ishte ndërprerë në bazë ligjore apo joligjore, sepse kjo është kompetencë e gjykatës së rregullt. Për Gjykatën Kushtetuese, thelbësore janë ato çështje, prej ekzistimit të të cilave varet vlerësimi për shkelje eventuale të të drejtave të garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmëria), dhe jo çështjet që janë qartazi ligjore (ligjshmëria), (Shih*, mutatis mutandis, i. a., Akdivar kundër Turqisë,* 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65).

35. Gjykata rikujton se, fakti i thjeshtë se parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'i shërbejë atij si e drejtë për të parashtruar një kërkesë të argumentuar për shkeljen e dispozitave

kushtetuese (Shih, *mutatis mutandis,* Aktgjykimi i GJEDNJ-së, kërkesa Nr. 5503/02, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* ose aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese, rasti KI128/12, i 12 korrikut 2013, të parashtruesit *Shaban Hoxha,* në kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 316/2011).

36. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e tij për shkeljen e të drejtës për barazi para ligjit, gjykim të drejtë e të paanshëm dhe të drejtën në punë.

37. Prandaj, Gjykata përfundon se, kërkesa e parashtruesit, në përputhje me rregullin 36 (1) d) të Rregullores së punës është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) d), si dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 5 nëntor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Arta Rama-Hajrizi	Prof. dr. Enver Hasani

KI140/14, Parashtrues Abdurrahman Nazifi, Vlerësim kushtetutshmërisë së Aktvendimit KP. nr. 416/2014 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, KP. nr. 416/2014, të 10 qershorit 2014

KI140/14, Aktvendim për papranueshmëri i 25 nëntorit 2014, publikuar më 9 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, vepra penale përmbajtje e pavërtetë, vepra penale e mashtrimit, dënim me burgim, parimi i subsidiaritetit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete juridike, mosshterje e mjeteve juridike.*

Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin, Kp. Nr. 416/2014 refuzoi, si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për rishikimin e procedurës penale përkitazi me dënimin e tij me burgim prej 3 (tre) vjetësh për shkak të veprave penale të përmbajtjes së pavërtetë dhe mashtrimit, përkatësisht.

Parashtruesi ndër të tjera, pretendoi se Gjykata Themelore në Prishtinë nuk ka zbatuar drejtë dispozitat e ligjit penal dhe në këtë mënyrë ka shkelur të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe për mjete juridike të garantuara me nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës përkatësisht.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi nuk kishte shteruar të gjitha mundësitë në procedurë të rregullt gjyqësore bazuar në parimin e subsidiaritetit. Kërkesa e u shpall e papranueshme, për shkak të mosshterjes së të gjitha mjeteve juridike siç është përcaktuar me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe specifikuar më tej me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI140/14
Parashtrues
Abdurrahman Nazifi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, KP. nr. 416/2014, të 10 qershorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Abdurrahman Nazifi nga fshati Sallabajë, komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi) i përfaqësuar nga z. Safet Krasniqi, avokat nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, KP. nr. 416/2014, të 10 qershorit 2014, me të cilin iu refuzua kërkesa e tij për rishikim të procedurës penale.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Themelore, KP. nr. 416/2014, të 10 qershorit 2014, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 30 paragrafin 5 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës **s**ë Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 shtator 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 22 shtator 2014, parashtruesi dorëzoi dokumentacionin shtesë (plotësues) në Gjykatë.

7. Më 7 tetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI140/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI140/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

8. Më 20 tetor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 20 tetor 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës.

10. Më 5 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 18 prill 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë me aktgjykimin P. nr. 279/2006, shpalli fajtor parashtruesin për veprën penale të legalizimit të përmbajtjes së pavërtetë dhe për veprën penale të mashtrimit, duke i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vjetësh.

12. Brenda afatit ligjor, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër aktgjykimit (P. nr. 279/2006) të Gjykatës Komunale në Prishtinë.

13. Më 16 maj 2013, Gjykata e Apelit me aktgjykimin PA1. Nr. 766/12 aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit dhe ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë (P. nr. 279/2006), duke i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjetësh.

14. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër aktgjykimit (P. nr. 279/2006 të 18 prillit 2011) të Gjykatës Komunale në Prishtinë, dhe kundër aktgjykimit (PA1. Nr. 766/12 të 16 majit 2013) të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

15. Më 3 prill 2014, Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin PML. Nr. 58/2014 refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesit, duke arsyetuar se pretendimet e tij nuk qëndrojnë për shkak se *"[...] aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, meqë aktgjykimet e kundërshtuara janë të kuptueshme, në to nuk ka kundërthënie me vetveten e as me arsyet e dhëna në to. Aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë arsyet e duhura faktike dhe juridike mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje penale pra edhe për dashjen e të dënuarit për kryerjen e veprës penale [...]"*.

16. Më 16 maj 2014, parashtruesi parashtroi kërkesë për rishikim të procedurës penale në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër aktgjykimit (P. nr. 279/2006) të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të ndryshuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin (PA1. Nr. 766/12).

17. Më 10 qershor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin Kp. Nr. 416/2014 refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishikim të procedurës penale të parashtruesit, duke i dhënë kështillë juridike se ndaj aktvendimit (Kp. Nr. 416/2014) është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 3 (tri) ditëve nga dita e marrjes së aktvendimit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi pretendon se *"gjykatat nuk kanë zbatuar drejt dispozitat e KP dhe KPP"*.

19. Parashtruesi më tej pretendon se janë shkelur:

> *"Neni 30, të drejtat e të akuzuarit, par. 5 lidhur me të drejtën të ketë ndihmën e një mbrojtësi që zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurojë mjete falas;*
>
> *Neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] par. 1 me të cilin, çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike;*

Neni 32 E Drejta për Mjete Juridike [...]".

20. Parashtruesi gjithashtu pretendon se: *"Të tria aktgjykimet, nuk kanë marrë për bazë faktin se, kontrata për shitblerje dhe dokumentacioni përcjellës është vërtetuar dhe legalizuar nga ana e personit përgjegjës kompetent. Njëkohësisht, i dënuari është i dëmtuar për faktin se, ka paguar shumën e të hollave sipas kontratës për shitblerje të palujtshmërisë".*

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret procedurale të pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

22. Parashtruesi në rastin konkret është person fizik, i cili kërkesën e tij e bazon në nenin 113.7 (Kërkesat individuale) të Kushtetutës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

    "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

24. Përveç kësaj, neni 47. 2 i Ligjit gjithashtu përcakton:

    "Individi mund ta ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

25. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, që përcakton:

    1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
    (Ndryshuar më 28 tetor 2014)

    [...]

    (b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar, ose
    (Ndryshuar më 28 tetor 2014)

26. Në këtë rast, vërehet se parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, pasi që vendimi i

kontestuar (Kp. Nr. 416/2014) i mundësonte shfrytëzimin e të drejtës së ankesës në Gjykatën e Apelit.

27. Prandaj, në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, siç kërkohen me nenin 113.7 të Kushtetutës.

28. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës, apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Ndryshe, parashtruesi është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse ai ose ajo dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo nëse dështon të raportojë shkeljet e Kushtetutës në procedurë të rregullt (Shih, Aktvendimin për papranueshmëri KI41/09, të 21 janarit 2010, *AAB-RIINVEST L.L.C. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës,* dhe shih*, mutatis mutandis,* ECHR, *Selmouni vs. France,* no. 25 803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).

29. Rrjedhimisht, kërkesa është e papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b), si dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 25 nëntor 2014, njëzëri:

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Arta Rama-Hajrizi	Prof. dr. Enver Hasani

KI148/14, Parashtrues Driton Kelmendi, Vlerësim i kushtetutshmërisë i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PML. nr. 101/2014, të 6 qershorit 2014

KI148/14, Aktvendim për papranueshmëri i 9 dhjetorit 2014, publikuar më 9 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Masë e përkohshme, kërkesë qartazi e pabazuar*.

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin, PML. nr. 101/2014 refuzoi, si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së parashtruesit, të paraqitur kundër vendimeve të gjykatave të instancës më të ulët, me ç'rast parashtruesit i ishte shqiptuar dënimi prej 23 vjetësh burgim për shkak të vrasjes së rëndë dhe armëmbajtjes pa leje.

Parashtruesi ndër të tjera, pretendoi, se Gjykata Supreme e Kosovës shkeli të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, sepse kishte refuzuar dhe shpërfillur propozimet e parashtruesit përkitazi me procedimin e provave të reja. Parashtruesi, po ashtu kërkoi vënien e masave të përkohshme dhe pezullimin e vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se gjykatat e rregullta në mënyrë të detajuar i ishin përgjigjur pretendimeve të parashtruesit, dhe se ai nuk kishte dorëzuar ndonjë dëshmi për shkeljen e të drejtave të tij nga gjykatat e rregullta. Gjykata, po ashtu refuzoi kërkesën për vënien e masave të përkohshme sepse nuk ishte *prima facie* e arsyetuar. Kërkesa u shpall e papranueshme, si qartazi e pabazuar, ashtu siç është paraparë në rregullat 36 (2) b) dhe 55 (4) dhe (5) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI148/14
Parashtrues
Driton Kelmendi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 101/2014, të 6 qershorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Driton Kelmendi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) nga Peja, i cili aktualisht vuan dënimin me burgim në Qendrën Korrektuese në Dubravë, dhe të cilin në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës e përfaqësojnë avokatët z. Ramë Dreshaj dhe z. Halil Palaj nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës PML. nr. 101/2014, të 6 qershorit 2014, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 12 qershor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PML. nr. 101/2014, të 6 qershorit 2014, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, është shkelur neni 31 i Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi i kërkesës njëkohësisht kërkon të vendoset Masë e përkohshme me të cilën do të pezullohet ekzekutimi i aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës PML. nr. 101/2014, të 6 qershorit 2014.

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113. 7 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47.1 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 7 tetor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 8 tetor 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI148/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI148/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 10 tetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 14 nëntor 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktgjykimin, P. nr. 181/12 e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 147, paragrafi 4, dhe 9 i KPK-së, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, paragrafi 2, i Kodit Penal të Kosovës, dhe e gjykoi me dënim unik në kohëzgjatje prej 23 (njëzet e tre) vjetësh me burgim afatgjatë.

11. Më 16 janar 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin PAKR. nr. 134/2013 e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë P. nr. 181/12, përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale dhe në lidhje me vendimin për dënim, ashtu që kjo gjykatë për veprën penale Vrasje

e rëndë nga neni 147, paragrafi 1, nënparagrafi 4 i KPK-së e cilëson si vepër penale vrasje nga neni 146 të KPK-së, dhe për këtë vepër penale parashtruesit të kërkesës i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 17 (shtatëmbëdhjetë) vjetësh, ndërsa për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të armëve nga neni 328, paragrafi 2, i Kodit Penal të Kosovës e vërtetoi dënimin me burgim të caktuar nga gjykata e shkallës së parë në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjetësh dhe për dy vepra penale konform dispozitës së nenit 71 të KPK-së i shqiptoi dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) vjetësh.

12. Më 10 maj 2014, avokatët mbrojtës të parashtruesit të kërkesës parashtruan kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, në të cilën pretendojnë dyshime të konsiderueshme në lidhje me saktësinë e fakteve vendimtare të vërtetuara me aktgjykimet e kontestuara, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'i hedh poshtë aktgjykimet e kontestuara, duke kthyer çështjen në rigjykim, dhe propozuan ndalimin e ekzekutimit të dënimit me burg.

13. Më 22 maj 2014, Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP. II. nr. 73/14 propozoi që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

14. Më 6 qershor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin PML. nr. 101/2014 refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së mbrojtësve të të dënuarit Driton Kelmendi, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. Nr. 181/12 të 14 nëntorit 2012 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 134/2013 të 16 janarit 2014, me arsyetim të detajuar të të gjitha pretendimeve të parashtruara nga ana e mbrojtëseve.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"... aktgjykimet e kundërshtuara, edhe procedurat penale që i kanë paraprirë aktgjykimeve, kanë një të përbashkët: këmbënguljen për të mos marrë parasysh propozimet e shumta të Mbrojtjes për procedimin e provave të reja. Këto propozime të reja, ose refuzoheshin me të njëjtin arsyetim të paqëndrueshëm, ose nuk përfilleshin fare duke filluar nga Hetimi Penal e deri te seanca dëgjimore e Apelit përkatësisht prej Aktgjykimit të shkallës së parë e deri te Aktgjykimi i shkallës së dytë dhe ai i Gjykatës Supreme të Kosovës"*.

16. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se *„Refuzimi i provave të propozuara nga Mbrojtja me shpërfilljen e tyre, domosdo e kalonte*

kufirin deri te i cili gjykata, sipas bindjes së lirë i vlerëson provat dhe faktet. Fakti se provat e Mbrojtjes refuzoheshin me arsyetime të përsëritura dhe të pa qëndrueshme dhe të kundërligjshme ose nuk përfilleshin fare - me një këmbëngulje të paparë, edhe po të mos doje, nuk mund t'i ikje mendimit se kjo nuk po bëhej me qëllime të mira".

17. Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën para Gjykatës Kushtetuese, pretendon më tej një numër propozimesh për administrimin e provave të cilat ishin pjesë përbërëse e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur para Gjykatës Supreme që kishin lidhje me gjendjen faktike, si dhe një varg të shkeljeve të Ligjit për procedurën penale të cilat i ka theksuar edhe para Gjykatës Supreme të Kosovës, por edhe para Gjykatës së Apelit.

18. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese si në vijim:

"Të vendos masë të përkohshme, të ndërpresë ekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë – vuajtjen e dënimit si aktgjykim antikushtetues i marrë në bazë të shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës, meqë konsideron se do të shkaktonte dëme të paripërueshme për parashtruesin e kërkesës dhe lënia e tij në vuajtje të jashtëligjshme të një dënimi të pamerituar".

"Që të konstatoj se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e drejta në proces të rregullt".

"Të shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës PML. nr. 101/2014, të dt. 06.06. 2014".

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata vërën se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

21. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

22. Për më tepër, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *„(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> ...
>
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

23. Duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e ligjit për procedurë penale, Gjykata Kushtetuese thekson se Gjykata Kushtetuese nuk është Gjykatë e Apelit, kur shqyrtohen vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë ligjin dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës* [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

24. Duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me pretendimet se nuk janë administruar dëshmitë të cilat mbrojtja e parashtruesit të kërkesës i ka kërkuar dhe propozuar, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin, PAKR. nr. 134/2013 të 16 janarit 2014, duke marrë parasysh pretendimet e tilla, e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë P. nr. 181/12 të 14 nëntorit 2012, dhe arsyetoi në detaje mënyrën në të cilën i pranoi dhe refuzoi provat, si dhe mënyrën në të cilën i vlerësoi provat.

25. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 134/2013 i 16 janarit 2014, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës PML. nr. 101/2014, i 6 qershorit 2014, në arsyetimin e tyre në mënyrë të detajuar e arsyetojnë dhe përgjigjen në pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me arsyen e zbatimit të rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale, si dhe arsyet për administrimin ose refuzimin e administrimit të disa provave të cilat parashtruesi i kërkesës i përsërit edhe para Gjykatës Kushtetuese.

26. Gjykata Kushtetuese thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (Shih, *Vanek kundër Republikës Sllovake*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, të 31 majit 2005.).

27. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë dhënë mundësitë për të paraqitur dhe kontestuar interpretimin e ligjit për të cilin konsideron që është i pasaktë, para Gjykatës së Qarkut në Pejë, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë dhe para Gjykatës Supreme të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

28. Si përmbledhje, në këtë kërkesë nuk janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të tregojë dhe të mbështesë me prova pretendimin e tij se vendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese.

29. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës.

Kërkesa për Masë të përkohshme

30. Siç është theksuar më lart, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata *"Të vendos masë të përkohshme, të ndërpresë ekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë – vuajtjen e dënimit si aktgjykim antikushtetues i marrë në bazë të shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës, meqë konsideron se do të shkaktonte dëme të paripërueshme për parashtruesin e kërkesës dhe lënia e tij në vuajtje të jashtëligjshme të një dënimi të pamerituar"*.

31. Në mënyrë që Gjykata të vendos Masë të përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) dhe 5) të Rregullores së punës, është e nevojshme.

> *"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
>
> *(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të*
> *paripërueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe*

(...)
Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".

32. Siç u theksua më lart, kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, për këtë arsye, nuk ka rast *prima facie* për vendosjen e Masës së përkohshme. Prandaj, kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafi 7, të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) b) i 55 (4) dhe 5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 9 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për vendosjen e Masës së përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetueses**
Robert Carolan	Prof. dr. Enver Hasani

KI77/14, Parashtrues Alban Rexha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr.1/2010, i 3 dhjetorit 2010

KI77/14, Aktvendim për papranueshmëri i 16 shtatorit 2014, publikuar më 10 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, burgim afatgjatë, përgjegjësi e zvogëluar, veprat penale të grabitjes dhe armëmbajtjes së paautorizuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkesë e paafatshme*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin, Pkl.nr 1/2010, të 3 dhjetorit 2010 refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar, përkitazi me dënimin me burgim afatgjatë për shkak të kryerjes së veprave penale, të grabitjes, dhe armëmbajtjes së paautorizuar.

Parashtruesi, pretendoi ndër të tjera, se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkesa ishte dorëzuar jashtë afatit ligjor dhe, për më tepër, theksoi se bazuar në dokumentet e dorëzuara procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta nuk kishin qenë të padrejta ose arbitrare. Kërkesa u shpall e papranueshme për shkak se ishte dorëzuar jashtë afatit ligjor siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI77/14
Parashtrues
Alban Rexha
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 1/2010, të 3 dhjetorit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Alban Rexha nga Peja (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), i përfaqësuar nga z. Mahmut Halimi, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 1/2010, të 3 dhjetorit 2010 përmes së cilit është refuzuar kërkesa e tij për mbrojtje të ligjshmërisë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor siç janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), Konventën Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut dhe Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 30 prill 2014, parashtruesi parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 mars 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI77/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI77/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 23 maj 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 18 qershor 2014, Gjykata njoftoi edhe Gjykatën Themelore në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës, dhe i kërkoi që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën si dëshmi që provon datën kur parashtruesi e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 1/2010, të 3 dhjetorit 2010.

9. Më 10 korrik 2014, Gjykata pranoi përgjigjen nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

10. Më 16 shtator 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 26 qershor 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, përmes Aktgjykimit P. nr. 667/06, dënoi parashtruesin me burgim afatgjatë në kohëzgjatje prej 23 (njëzet e tri) vjetësh për shkak të kryerjes së veprës penale, në bashkëkryerje, të vjedhjes së rëndë grabitqare ose grabitjes, si dhe mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve.

12. Parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 667/06, të 26 qershorit 2007, Aktgjykimit

të Gjykatës Supreme, Ap. nr. 488/2007, të 11 qershorit 2008 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, API. nr. 5/2008, të 11 qershorit 2009. Parashtruesi kërkoi që Gjykata Supreme *"t'ia kthejë lëndën gjykatës së shkallës së parë për rigjykim apo atij* [parashtruesit] *t'i shqiptojë një dënim dukshëm më të butë".*

13. Më 3 dhjetor 2010, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Pkl. nr. 1/2010, me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë duke arsyetuar se:

> *"[...] janë dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo Gjykatë. Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitën e nenit 387 par.2 të KPPK* [Kodi i Procedurës Penale të Kosovës]*, kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 396 par.7 të KPPK, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i merr si të provuara ose si të paprovuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore, pra, ajo ka bërë analizën e të gjitha provave te procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me ato ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat, si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i ka aprovuar edhe gjykata e shkallës së dytë, ajo e shkallës së tretë e njëkohësisht si të tilla i aprovon edhe kjo Gjykatë.*
>
> *Qëndron fakti se nuk është bërë një ekspertizë neuropsikiatrike ndaj të gjykuarit Alban Rexha. Arsyerat për një mos veprim të tillë janë dhënë në pasusin e fundit të aktgjykimit Ap. nr. 488/2007 datë 11.06.2008. Përveç një propozimi, gjykatës nuk i prezantohet ndonjë provë që kishte me treguar për lëndimin e të dënuarit për ndonjë sëmundje psikike.*
>
> *[...]*
>
> *Nga arsyet e cekura më lart kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403. par 1 pika 8, 12 dhe par. 2 pika 1 të KPPK, drejt janë aplikuar dispozitat e ligjit material, andaj kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë refuzuar si të pabazuara".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi në kërkesën e tij pretendon shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], paragrafi 2, dhe 3 të Kushtetutës; të nenit 6 [E drejta për një Proces të Rregullt], paragrafi 3, pika d) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; si dhe të nenit 14,

paragrafi 1, të pikës b) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

15. Parashtruesi pretendon se këto të drejta i janë shkelur, ngase gjykatat e rregullta nuk e miratuan kërkesën e tij për t'iu nënshtruar *"një ekzaminimi neuropsikiatrik në mënyrë që të nxirret raporti profesional shkencor se i njejti* [parashtruesi] *a veproi në gjendje të përgjegjshmërisë esencialisht të zvogëluar në momentin e kryerjes së veprës penale"*.

16. Përfundimisht, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me këtë kërkesë: *"Prishjen e të gjitha aktgjykimeve të cituara dhe kthimin e çështjes në rigjykim"*.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kushtet e nevojshme të pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tutje me Ligj dhe me Rregullore të punës.

18. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]"*.

19. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> [...]
>
> *(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi, [...]"*.

20. Në bazë të të dhënave nga shkresat e rastit, Gjykata konstaton që parashtruesi e ka parashtruar kërkesën më 30 prill 2014 përderisa vendimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi Pkl. Nr. 1/2010 i Gjykatës Supreme është marrë me 3 dhjetor 2010.

21. Parashtruesi në formularin e kërkesës së dorëzuar në Gjykatë thekson që Aktgjykimi (Pkl. Nr. 1/2010, i 3 dhjetorit 2010) i Gjykatës Supreme *"ende nuk i është dorëzuar të dënuarit* [parashtruesit]". Parashtruesi këtë pretendim nuk e ka arsyetuar fare në parashtresën e tij, e as nuk

ka paraqitur ndonjë argument apo provë që do të dëshmonte se gjykatat nuk i kanë dorëzuar aktgjykimin në fjalë; ai vetëm e thekson një gjë të tillë në formular pa dhënë sqarime apo shpjegime shtesë.

22. Më tutje, Gjykata vëren se parashtruesi pikërisht në datën kur e ka dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë, pra më 30 prill 2014, në po të njëjtën datë i është drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë me ç'rast ka kërkuar që ti dorëzohet Aktgjykimi (Pkl. Nr. 1/2010, i 3 dhjetorit 2010) i Gjykatës Supreme duke pretenduar se nuk e ka marrë kopjen e aktgjykimit në fjalë.

23. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi, edhe pse pretendon se Aktgjykimi (Pkl. Nr. 1/2010, i 3 dhjetorit 2010) i Gjykatës Supreme nuk i është dorëzuar, ai të njëjtin e ka dorëzuar në Gjykatë së bashku me kërkesën e tij.

24. Në bazë të asaj që u tha më lart, faktit që parashtruesi momentalisht është në vuajtje të dënimit të tij ngase vendimet e gjykatave të rregullta janë bërë të plotfuqishme, si dhe faktit që parashtruesi e ka dorëzuar në Gjykatë aktgjykimin të cilin pretendon se nuk e ka pranuar së bashku me kërkesën e tij, Gjykata do të marrë datën e miratimit të aktgjykimit si datë kur i njejti i është dorëzuar palës, përkatësisht datën 3 dhjetor 2010.

25. Në bazë të kësaj, rrjedh që parashtruesi e ka parashtruar kërkesën e tij në Gjykatë pas kalimit të afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, përkatësisht rreth tri (3) vjet e katër muaj pas kalimit të afatit ligjor.

26. Gjykata përkujton që qëllimi i afatit ligjor prej katër muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit si dhe rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, është që të promovojë sigurinë juridike duke siguruar që rastet të cilat paraqesin çështje kushtetuese të shqyrtohen brenda afateve të arsyeshme, si dhe që vendimet e nxjerra më herët të mos jenë pafundësisht të hapura për kontestim (Shih, rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendimi i 25 gushtit 2005).

27. Gjithsesi, edhe po të supozohet që kërkesa me të vërtetë ishte parashtruar brenda afatit kohor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullorës së punës, Gjykata Kushtetuese dëshiron të theksojë se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese, është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë, dhe instrumente të tjera ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Si rrjedhojë, Gjykata

Kushtetuese nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

28. Siç u theksua më lart, në thelb, parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat e tij për sa i përket gjykimit të drejtë dhe të paanshëm duke mos miratuar kërkesën e tij për *"një ekzaminim neuropsikiatrik"*. Parashtruesi pretendon se një ekzaminim i tillë ishte i nevojshëm për të vërtetuar se *"a veproi në gjendje të përgjegjësisë esencialisht të zvogëluar në momentin e kryerjes së veprës penale"*.

29. Nga faktet e paraqitura së bashku me kërkesën shihet që parashtruesi i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, dhe që gjykatat e rregullta i kanë marrë parasysh dhe ju kanë përgjigjur ankesave të tij në lidhje me kërkesën e tij. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme lidhur me kërkesën e parashtruesit për një ekzaminim neuropsikiatrik. Me atë rast, Gjykata Supreme theksoi:

> *"Qëndron fakti se nuk është bërë një ekspertizë neuropsikiatrike ndaj të gjykuarit Alban Rexha. [...] Përveç një propozimi, gjykatës nuk i prezantohet ndonjë provë që kishte me treguar për lëndimin e të dënuarit për sëmundje psikike. Në të kundërtën i dënuari në të gjitha fazat e procedurës jep mbrojtje logjike, të drejtuar me qëllim të lehtësimit të gjendjes së tij në procedurën penale, duke pretenduar që ka qenë i detyruar nga bashkë ekzekutuesit"*.

30. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese rithekson se ajo mund vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia,* rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar me 10 korrik 1991).

31. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se arsyetimi në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, që i referohet pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se atij nuk i ishte mundësuar një ekspertizë neuropsikiatrike është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu ka gjetur se procedurat në Gjykatën e Qarkut nuk kanë qenë të padrejta ose arbitrare (Shih, rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

32. Nga se u tha më lart, rrjedh që kërkesa është e paafatshme dhe duhet të refuzohet si e papranueshme në bazë të nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (c) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 16 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Arta Rama-Hajrizi	Prof. dr. Enver Hasani

KI87/14, Parashtrues Ismail Guri, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, KMLC. Nr. 7/14, i 10 shkurtit 2014

KI87/14, Aktvendim për papranueshmëri i 8 dhjetorit 2014, publikuar më 10 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mbrojtje gjyqësore e të drejtave, e drejta e parablerjes, pronë e paluajtshme, përsëritje e procedurës, kërkesë qartazi e pabazuar*

Prokurori i Shtetit me Njoftimin, KMLC.nr. 7/14, refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë duke u arsyetuar se nuk ka gjetur asnjë bazë ligjore për të ushtruar këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik. Thelbi i ankesës kishte të bënte me të drejtën e parablerjes dhe anulimin e kontratës së shitjes në lidhje me një pronë të paluajtshme.

Parashtruesi ndër të tjera, pretendoi se Gjykata e Qarkut, Gjykata e Apelit dhe Prokurori i Shtetit duke refuzuar kërkesën për përsëritje të procedurës kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën e tij për mbrojtjen gjyqësore e të drejtave të garantuara me nenet 31 dhe 54 të Kushtetutës përkatësisht.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi nuk shpjegoi saktësisht, si dhe pse vendimet e kontestuara me të cilat ishte refuzuar kërkesa e tij për përsëritje të procedurës përbën shkelje të të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me Kushtetutë. Kërkesa u shpall e papranueshme, si qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI87/14
Parashtrues
Ismail Guri
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Njoftimit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, KMLC. nr. 7/14,
të 10 shkurtit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Ismail Guri, nga Kaçaniku (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga znj. Vahide Braha, avokate nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Njoftimin e Kryeprokurorit të Shtetit (KMLC. nr. 7/14, të 10 shkurtit 2014), me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë. Ky vendim i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 3 mars 2014.

3. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit (Ca. nr. 5315/2012, të 5 nëntorit 2013) në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut (Ac. nr. 534/09, të 4 prillit 2011), me të cilët ishte refuzuar kërkesa e tij për përsëritje të procedurës lidhur me padinë e tij.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, të cilat pretendohen të kenë *"shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] dhe nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ)"*.

5. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu kërkoi nga Gjykata të mbajë dëgjim publik për rastin e tij.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës në lidhje me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 15 maj 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 10 qershor 2014, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 8 korrik 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Gjykatës së Apelit.

10. Më 8 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 13 maj 2004, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Kaçanik, duke kërkuar që të vërtetohet e drejta e tij e

parablerjes, si dhe anulimin e kontratës së shitjes në lidhje me një pronë të paluajtshme.

12. Më 23 nëntor 2004, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C. nr. 95/2004), e refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi kontratën e shitjes në lidhje me pronën e paluajtshme.

13. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale.

14. Më 10 dhjetor 2007, Gjykata e Qarkut (Aktgjykimi Ac. nr. 65/2005), e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale.

15. Parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimeve të Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Komunale.

16. Më 18 dhjetor 2008, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 95/2008) refuzoi kërkesën për revizion, duke konstatuar *"[...] aktgjykimet e gjykatave më të ulëta, drejt kanë zbatuar dispozitat materiale dhe aktgjykimet e lartcekura nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të cilave u referohet në revizion"*.

17. Më 29 prill 2009, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për përsëritje të procedurës në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, duke argumentuar se ai kishte gjetur prova të reja të cilat, pretendohet se, vërtetojnë *"gjyqtari [...] ka qenë i njëanshëm dhe ka vendosë në dëm të tij, pasi që ishte nip i të paditurit [...]"*.

18. Më 4 prill 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktvendimi Ac. nr. 534/2009), refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për përsëritje të procedurës, duke konsideruar që:

> *"[...] Pretendimi i paditësit se pas marrjes së vendimit nga Gjykata Supreme e Kosovës, me hulumtimet e tij ka marrë dijeni se gjyqtari i lëndës në shkallë të parë ka qenë i njëanshëm dhe ka vendosë në dëm të tij, pasi që ishte nip i të paditurit [...] është i pa bazuar, i pa argumentuar e në të njëjtën kohë edhe i pa qëndrueshëm dhe si i tillë është refuzuar, me arsyetim se paditësin përkatësisht palët në procedurë, qysh në seancën e parë të shqyrtimit kryesor, kryetari i trupit gjykues i ka njoftuar me përbërjen e trupit gjykues dhe paditësi nuk ka bërë vërejtje.*
>
> *[...] paditësi nuk paraqet prova bindëse e as argumente se në çfarë shkalle është afërsia e gjyqtarit me siç thuhet nipin e tij në rastin*

konkret nga se nuk mjafton vetëm të thuhet se "e ka nip" pa dhënë kurrfarë shpjegimi konkret.

Meqenëse paditësi në propozimin e tij për përsëritjen e procedurës, nuk ka ofruar ndonjë provë të re bindëse dhe të argumentuar, e cila nuk është paraqitur në procedurën e mëparshme kontestimore, e nga se ndikon në marrjen e vendimit gjyqësor në dobi të paditësit, për këtë arsye, gjykatësi vlerësoi se në situatën konkrete nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 232 al. 1 pika g) lidhur me nenin 233 al .2 e LPK-së për përsëritjen e procedurës kontestimore, c cila ka përfunduar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I. nr. 95/2008 i dt. 18.12.2008".

19. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut për shkak të *"vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale"*. Ai kërkoi nga Gjykata Supreme *"që aktvendimi i ankimuar të prishet ose të ndryshohet dhe propozimi për përsëritjen e procedurës të miratohet"*.

20. Pas riorganizimit të sistemit gjyqësor në Kosovë në vitin 2013, Gjykata Supreme transferoi rastin e parashtruesit të kërkesës për gjykim në Gjykatën e Apelit, si gjykatë kompetente e shkallës së dytë.

21. Më 5 nëntor 2013, Gjykata e Apelit (Aktvendimi CA. nr. 5315/2012), refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut. Gjykata e Apelit e arsyetoi vendimin si në vijim:

"[...] Duke studiuar pretendimet ankimore të cilat tregojnë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, kolegji kësaj gjykate gjeti se të njëjtat janë të pabazuara, sepse gjykata e shkallës së parë të njëjtat i ka vërtetuar në bazë të provave të ofruara, kurse në paditësin [...], ka rënë barra që pretendimet e paraqitura në propozim për përsëritjen e procedurës t'i arsyetojë me provat përkatëse dhe të njëjta t'i vërtetojë në mënyrën përkatëse".

22. Parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë te Prokurori i Shtetit kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit.

23. Më 10 shkurt 2014, Prokurori i Shtetit (Njoftimi KMLC. nr. 7/14) refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, duke konstatuar *"[...] pasi që kam shqyrtuar të dy aktvendimet e kundërshtuara si dhe shkresat e tjera të lëndës të*

sjellura nga gjykata vërtetoj se nuk kam gjetur bazë ligjore për të ushtruar mjetin e jashtëzakonshëm juridik, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë".

Pretendimet e parashtruesit

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon *"[...] po që se do ta gjykonte gjyqtari i paanshëm sigurisht do të merreshin për bazë provat e administruara në gjykatë dhe me këtë bindshëm do të forconte bazën e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës".*

25. Parashtruesi i kërkesës, më tej, pretendon *"[...] Gjykata fare nuk bëri fjalë për provën e propozuar si provë e re e dorëzuar gjykatës".*

26. Prandaj, parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata e Qarkut, Gjykata e Apelit dhe Prokurori i Shtetit, duke refuzuar kërkesën për përsëritje të procedurës, kishin shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe të drejtat e tij të garantuara me KEDNJ, përkatësisht nenin 6 [E drejta për një Proces të Rregullt] dhe nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit].

27. Parashtruesi i kërkesës, më tej, pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur *"nenin 19 të Ligjit mbi Qarkullimin e Pasurisë së Patundshme, si dhe Neni 458,527,528, dhe Neni 533 i LMD-ës* [Ligji për Marrëdhëniet Detyrimore] *[...]"* kur kanë refuzuar kërkesën për rishikimin e rastit të tij.

28. Parashtruesi i kërkesës përfundon, duke kërkuar nga Gjykata:

> *"[...]që të rivendos të drejtën e humbur për parablerje për arsye të aplikimit arbitrar dhe të kundërligjshëm të Vendimeve të Gjykatave të rregullta Gjykata e Qarkut me Aktvendimin Ac. nr. 534/09, të dt. 04.04.2011, Gjykata e Apeli Ca. nr 5315/2012, dt. 05.11.2013, dhe Prokuroria e Shtetit KMLC nr. 7/14, dt. 10.02.2014 dhe që ti anuloj ato Vendime kundërkushtetuese mbi bazën e provave që ju paraqitëm.*
>
> *Gjykatës i propozojmë, që ta thërras gjyqtarin e Gjykatës Themelore të Kaçanikut [...] në seancën e shqyrtimit kryesor ose paraprakisht, në mënyrë që të deklarohet mbi pretendimet e parashtruesit [...]. Gjykata mund që me shkrim të kërkoj zyrtarisht nga zyra e gjendjes civile ti siguroj provat se mbiemri i nënës së tij të vajzërisë ishte [...]".*

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kërkesat e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar..*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

31. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit, parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".*

32. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, përkitazi me kërkesën e tij për përsëritje të procedurës në rastin e tij, kërkoi të mbrojë të drejtat e tij në Gjykatën e Qarkut, Gjykatën e Apelit dhe në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

33. Gjykata, gjithashtu vëren se Njoftimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 3 mars 2014, dhe se ai kishte parashtruar kërkesën e tij në Gjykatë më 15 maj 2014.

34. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, se ai ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të aplikueshëm dhe se kërkesa ishte paraqitur brenda afatit kohor prej katër muajsh.

35. Megjithatë, Gjykata po ashtu duhet të merr parasysh nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës.

Neni 48 i Ligjit

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Rregulli 36 i Rregullores së punës

"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...] d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

36. Siç u cek më lart, parashtruesi i kërkesës konteston Njoftimin e Prokurorit të Shtetit (KMLC. nr. 7/14, të 10 shkurtit 2014), Aktvendimin e Gjykatës së Apelit (Ca. nr. 5315/2012, të 5 nëntorit 2013) si dhe Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut (Ac. nr. 534/2009, të 4 prillit 2011) duke pretenduar shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me Kushtetutë dhe KEDNJ.

37. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Qarkut, Gjykata e Apelit dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit refuzuan kërkesën e tij për përsëritje të procedurës *"edhe pse provat e paraqitura nga ai ishin bazë e fortë për të urdhëruar përsëritjen e procedurës".*

38. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se edhe Gjykata e Qarkut edhe Gjykata e Apelit kishin arsyetuar vendimet e tyre në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, ndërsa Prokurori i Shtetit e kishte njoftuar atë se nuk kishte bazë ligjore për të parashtruar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet arsyetimit të Gjykatës së Qarkut i cili adreson pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata e Qarkut gjeti:

"[...] Propozimi për përsëritjen e procedurës për shkak të marrjes në dijeni për fakte të reja mund të kërkohet vetëm po që se pala, pa fajin e saj nuk ka mundur t'i parashtroj këto rrethana para se të ketë marrë fund procedura e mëparshme me vendim gjyqësor të formës së prerë, çka në rastin konkret nuk e kemi një gjendje të tillë. Poashtu gjykata te përsëritja e procedurës. nuk lëshohet në gjendjen e vërtetuar faktike të gjertanishme me vendime gjyqësore të formës së prerë nga se ato janë definitive, por vetëm verifikon faktet dhe provat e reja nëse ato ekzistojnë të cilat përcaktohen si të mundshme për të ndikuar në vendosje ndryshe e që do të ishte e lejueshme përsëritja e procedurës, për çka në rastin konkret propozimet e propozuara nga paditësi nuk i përmbushin kërkesat

ligjore nga se nuk janë specifikuar rrethanat nga të cilat mund të përfundohet se ekziston ndonjë bazë ligjore për përjashtimin e gjyqtarit siç parashihet me nenin 68.4 të LPK-së [Ligji për Procedurën Kontestimore]".

40. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe arsyetimit të Gjykatës së Apelit, ku theksohet *"[...] Paditësi në propozim për përsëritjen e procedurës nuk ka ofruar dhe as që i ka dorëzuar gjykatës së shkallës së parë ndonjë provë e cila do t'i arsyetonte pretendimet në propozim për përsëritjen e procedurës dhe që një propozim të këtillë do të bënin të bazuar. Paditësi në propozimin e paraqitur thjesht i paraqet pretendimet, i pohon disa nga njohuritë e tij, por të njëjtat nuk i arsyeton me asnjë provë me të cilën do t'i bënte të bazuara pretendimet e këtilla".*

41. Përfundimisht, Gjykata i referohet përgjigjes së Prokurorit të Shtetit, ku theksohet *"[...] nuk kam gjetur bazë ligjore për të ushtruar [...], kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë".*

42. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk shpjegon saktësisht si dhe pse vendimet e kontestuara, me të cilat ishte refuzuar kërkesa e tij për përsëritje të procedurës përbëjnë shkelje të të drejtave dhe lirive të tij individuale, të garantuara me Kushtetutë, dhe ai nuk ka paraqitur prova për të arsyetuar pretendimin për një shkelje të tillë.

43. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson që nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmëria) që pretendohen të jenë bërë nga autoritetet publike, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

44. Gjykata Kushtetuese gjithashtu rithekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta ose nga autoritetet tjera publike. Roli i gjykatave të rregullta është, në rastet kur është e aplikueshme, t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, paragrafi 28; shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese në rastin Kl70/11, të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima,* Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

45. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi dhe të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*,

Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, 10 korrik 1991).

46. Gjykata konsideron se procedurat në Gjykatën e Qarkut, Gjykatën e Apelit dhe refuzimi i propozimit të tij për të parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, KEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

47. Në rastin konkret, Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës nuk paraqiti ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (Shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, Vendimi i GJEDNJ-së, nr. 53363/99, i 31 majit 2005) dhe se ai nuk saktësoi se si nenet e përmendura të Kushtetutës, mbështesin pretendimin e tij, siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

48. Në fund, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të mbajë një dëgjim publik për rastin e tij. Gjykata konsideron se nuk ka çështje të faktit ose të ligjit për t'u sqaruar lidhur me ankesën e tij kushtetuese. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa nuk i plotëson kushtet e parapara me rregullin 39 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] të Rregullores së punës, dhe si e tillë ajo refuzohet.

49. Si përmbledhje, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave dhe lirive të tij sipas Kushtetutës dhe KEDNJ-së janë të paargumentuara dhe të padëshmuara, dhe prandaj janë qartazi të pabazuara.

50. Për arsyet e lartcekura, Gjykata konsideron se, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) d), kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) d) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 8 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. dr. Enver Hasani

KI130/14, Parashtrues Fidan Hyseni, Vlerësim kushtetutshmërisë i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr.107/2014, i 30 majit 2014

KI130/14, Aktvendim për papranueshmëri i 9 dhjetorit 2014, publikuar më 10 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, e drejta për mjete juridike, vepra penale e rrezikimit të trafikut publik, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin, Pml.nr 107/2014, të 30 majit 2014 refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar, përkitazi me dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim për shkak të veprës penale të rrezikimit të trafikut publik.

Parashtruesi ndër të tjera, pretendoi se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë shkelur të drejtën e tij për mjete juridike të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës, për shkak se ai nuk kishte pranuar fletë-kthesën e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se gjykatat e rregullta, kishin arsyetuar vendimet e tyre kur kishin hedhur poshtë ankesën e parashtruesit si të paafatshme, dhe se procedurat e zhvilluara nuk kishin qenë të padrejta ose arbitrare. Parashtruesi nuk arriti në asnjë mënyrë të arsyetojë pretendimet e tij për shkelje kushtetuese andaj, në përputhje me rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit u shpall e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI130/14
Parashtrues
Fidan Hyseni
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 107/2014, të 30 majit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Fidan Hyseni me vendbanim në Mitrovicë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës). Ai përfaqësohet nga z. Gani Rexha, avokat nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) Pml. nr. 107/2014, të 30 majit 2014, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), PA1. nr. 320/2014 të 27 marsit 2014.

3. Vendimi i fundit (Aktgjykimi Pml. nr. 107/2014, i 30 majit 2014) i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit dhe të aktvendimit të kontestuar, me të cilët pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së

Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 14, paragrafi 5, të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe nenin 2 [E drejta për arsim] të Protokollit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Protokolli i GJEDNJ-së).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 18 gusht 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 5 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI130/14 caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë Kryetari, me Vendimin KSH. KI130/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

8. Më 15 shtator 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë autorizimin për përfaqësuesin të cilin ai e kishte cekur në kërkesën e tij.

9. Më 22 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumentin e kërkuar në Gjykatë.

10. Më 15 tetor 2014, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme dhe Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës dhe u dërgoi atyre nga një kopje të kërkesës.

11. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 5 dhjetor 2012, Prokuroria Publike Komunale në Mitrovicë ngriti aktakuzën penale kundër parashtruesit të kërkesës bazuar në dyshimin se ai kishte kryer veprën penale të rrezikimit të trafikut publik.

13. Më 29 janar 2014, Gjykata Themelore në Mitrovicë (Aktgjykimi, P. nr. 168/2012) dënoi parashtruesin e kërkesës me burgim prej 6 (gjashtë) muajsh për kryerjen e veprës penale, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike Komunale. Gjykata Themelore i shqiptoi parashtruesit të kërkesës edhe dënimin plotësues, me të cilin atij i ndalohet drejtimi i automjetit në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

14. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit për shkak të *"shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, vendimit mbi dënim dhe vendimit mbi shqiptimin e dënimit plotësues"*.

15. Më 27 mars 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendimi, PA1. nr. 320/2014) hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të paafatshme. Në aktvendimin e saj, Gjykata e Apelit konsideron:

> *"[...] Ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit [...] është e paafatshme.*
>
> *Nga shkresat e lëndës, respektivisht nga fletëdërgesa për dorëzim personal rezulton se aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë P.nr.168/2012 datë 29.01.2014, i është dorëzuar të akuzuarit me datë 30.01.2014 dhe se pranimin e aktgjykimit të kundërshtuar, i akuzuari e ka vërtetuar me nënshkrimin e tij. Mbrojtësi i të akuzuarit, ankesën kundër aktgjykimit të kundërshtuar, në gjykatë e ka dorëzuar më 24.02.2014. Duke pasur parasysh që kundër aktgjykimit ankesa është e lejuar në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nga ana e të akuzuarit, në këtë rast rezulton se ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit është dorëzuar pas afatit ligjor, prandaj është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi"*.

16. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme për shkak të *"shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale"*. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendoi:

> *"[...] aktgjykimi i shkallës së parë nuk i është dorëzuar të akuzuarit e as që e ka vërtetuar pranimin e aktgjykimit me nënshkrimin e tij. Nga shkresat e lëndës e sidomos nga fletëdërgesa për dorëzim personal vërtetohet fakti se nuk është nënshkrimi personal i të akuzuarit por se dikush tjetër në vend të tij ka nënshkruar pranimin e aktgjykimit"*.

17. Më 30 maj 2014, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Pml. nr. 107/2014) refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi si në vijim:

> *"[...] kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar. [...] në shkresat e lëndës ekziston [...] fletë dorëzimi për dorëzimin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë. Në këtë fletë dorëzim janë të shënuara emri, mbiemri dhe adresa e të dënuarit, numri dhe data e aktgjykimit, nënshkrimi i të dënuarit, data e dorëzimit dhe nënshkrimi i dorëzuesit. Në fletë dorëzim nuk ka shënim për ndonjë vërejtje eventuale. Andaj, kjo gjykatë konstatojë se me rastin e dorëzimit të aktgjykimit të shkallës së parë të dënuarit janë respektuar rregullat ligjore për dorëzimin personal të aktgjykimit".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë shkelur të drejtat e tij, të garantuara me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, nenin 14, paragrafi 5, të Paktit Ndërkombëtar Për të Drejtat Civile dhe Politike dhe nenin 2 [E drejta për arsim] të Protokollit të KEDNJ-së.

19. Parashtruesi i kërkesës pohon se *"Të akuzuarit nuk iu ka dorëzuar fare aktgjykimi i shkallës së parë"*. Në këtë drejtim, ai pretendon se e drejta e tij *"në ushtrimin e ankesës kundër aktgjykimit të shkallës së parë"* është shkelur, për shkak se, sipas tij *"Gjykata e Apelit ka qenë e obliguar [...] që ta vërtetoj faktin se i akuzuari a e ka pranuar personalisht aktgjykimin e shkallës së parë e tek pastaj të lëshohet në afatshmërinë e ankesës"*.

20. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Nga këto arsyera nuk qëndron as konstatimi i Gjykatës Supreme në Prishtinë, se me rastin e dorëzimit të aktgjykimit të shkallës së parë të dënuarit janë respektuar rregullat ligjore për dorëzimin personal të aktgjykimit"*.

21. Parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata si në vijim:

> *"[...] Që aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 107/2014 të dt. 30.05.2014 dhe aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PA1. nr. 320/2014 të dt. 30.05.2014, ti shpall të pavlefshëme si rrjedhojë e shkeljes së të drejtës në mjetin juridik dhe çështjen t'ia kthej Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, për rigjykim".*

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> > *[...]*
> >
> > *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese,*
> >
> > *[...]*

24. Siç u cek më lart, në substancë, parashtruesi i kërkesës ankohet se e drejta e tij për mjet juridik është shkelur nga ana e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, për shkak se pretendohet që ai nuk ka pranuar dhe nënshkruar fletëkthesën e pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

25. Gjykata merr parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës, se e drejta e tij për mjet juridik është shkelur pas një dështimi të pretenduar të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme për të respektuar plotësisht dispozitat e ligjit të procedurës penale kur atij i është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore.

26. Megjithatë, Gjykata gjithashtu vëren se Gjykata e Apelit arsyetoi vendimin e saj, kur ajo hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të paafatshme, duke iu referuar dispozitave të ligjit. Për më tepër, Gjykata gjithashtu vëren se në procedurën e vlerësimit të mbrojtjes së ligjshmërisë, Gjykata Supreme e arsyetoi vendimin e saj lidhur me këto pretendime të veçanta të parashtruesit të kërkesës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se ajo që parashtruesi ngre është çështje e ligjshmërisë dhe jo e kushtetutshmërisë.

28. Përkitazi me këtë, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme në përgjigjen ndaj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të ligjit të procedurës penale, që pretendohet të jetë kryer nga Gjykata e Apelit, kur ajo hodhi poshtë ankesën e tij si të paafatshme. Gjykata Supreme thekson se:

"[...] Me aktvendimin e Gjykatës se Apelit kjo ankese është hedhur si e pa afatshme [...] pasi që afati për ushtrimin e ankesës mbrojtësit të dënuarit rrjedh nga dita kur aktgjykimi i është dorëzuar të dënuarit e që në rastin konkret ankesa e mbrojtësit është dorëzuar pas skadimit të afatit ligjor".

29. Për më tepër, Gjykata gjithashtu rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për "*keqpërdorimet eventuale me rastin e dorëzimit të aktgjykimit*". Gjykata Supreme konstatoi si në vijim:

"Ndërsa, çështje e cila potencohet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, nuk është çështje e cila mund të shqyrtohet nga kjo gjykatë, por me mjete tjera me të cilat mund të vërtetohen keqpërdorimet eventuale me rastin e dorëzimit të aktgjykimit".

30. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

31. Gjykata Kushtetuese më tej thekson se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011). Fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të të drejtave të tij të mbrojtura me Kushtetutë.

32. Gjykata Kushtetuese mund vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia,* rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).

33. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se arsyetimi në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, që i referohet pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se

atij nuk i ishte dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në përputhje me dispozitat e Ligjit të Procedurës Penale është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu ka gjetur se procedurat në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Themelore nuk kanë qenë të padrejta ose arbitrare (Shih, rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

34. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë shkeljen e pretenduar të së drejtës kushtetuese, në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës.

35. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me rregullat 36 (2) (b) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 9 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. dr. Enver Hasani

KI80/14 dhe KI93/14, Parashtrues Gazmend Musollaj dhe Nezir Kerrellaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr.166/13, i 6 nëntorit 2013

KI80/14_KI93/14, Aktvendim për papranueshmëri i 25 nëntorit 2014, publikuar më 11 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, dënim me burgim afatgjatë, veprat penale vrasje e rëndë dhe armëmbajtje e paautorizuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, barazia para ligjit, zbatimi i së drejtës ndërkombëtare, kërkesë e paafatshme*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin, Rml. nr. 166/13, të 6 nëntorit 2013 refuzoi, si të pabazuara kërkesat e parashtruesve për mbrojte të ligjshmërisë, duke vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët, kanë aplikuar drejt Ligjin penal kur kanë shpallur fajtorë parashtruesit përkitazi me kryerjen e veprave penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje, dhe armëmbajtjes së paautorizuar.

Parashtruesi Gazmend Musollaj (KI80/14) pretendoi se është shkelur paragrafi 4, i nenit 33 të Kushtetutës mbi Parimin e Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale, ndërsa parashtruesi Nezir Kerrellaj (KI93 /14) pretendoi shkeljen e nenit 3 për Barazinë Para Ligjit, nenit 19 për Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare dhe nenit 31 për të Drejtën për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkesat e parashtruesve ishin dorëzuar jashtë afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh. Kërkesat u shpallën të papranueshme sepse nuk ishin dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, dhe specifikuar më tej me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
rastet Nr. KI80/14 dhe KI93/14
Parashtrues
Gazmend Musollaj dhe Nezir Kerrellaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit
të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 166/13, të 6 nëntorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesat janë dorëzuar nga z. Gazmend Musollaj nga fshati Gurakoc, komuna e Istogut dhe z. Nezir Kerrellaj nga fshati Serbobran, komuna e Istogut (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit). Z. Gazmend Musollaj (KI80/14) përfaqësohet nga z. Zenel Mekaj, avokat nga Peja, ndërsa z. Nezir Kerrellaj (KI93/14) përfaqësohet nga z. Zeqir Bërdynaj, avokat nga Peja.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 166/13, të 6 nëntorit 2013 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesa e tyre për mbrojtjen e ligjshmërisë.

3. Aktgjykimi i kontestuar iu dorëzua parashtruesve më 23 dhjetor 2013.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.

5. Parashtruesi Gazmend Musollaj (KI80/14) pretendon se aktgjykimi i kontestuar "*ia ka shkelur të drejtën kushtetuese të garantuar nga neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës*" (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

6. Parashtruesi Nezir Kerrellaj (KI93/14) pretendon se me aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur "*të drejtat e garantuara me Kushtetutë, përkatësisht neni 3 [Barazia Para Ligjit], neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare], dhe neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]*".

Baza juridike

7. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

8. Më 8 maj 2014, parashtruesi Gazmend Musollaj (KI80/14) parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata). Më 22 maj 2014, parashtruesi Nezir Kerrellaj parashtroi kërkesë (KI93/14) në Gjykatë.

9. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

10. Më 18 qershor 2014, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, Kryetari urdhëroi që kërkesa KI93/14 të bashkohet me kërkesën KI80/14 dhe që gjyqtari raportues dhe Kolegji shqyrtues për të dy rastet (KI80/14 dhe KI93/14) të jenë të njëjtë ashtu siç ishte vendosur në kërkesën KI80/14.

11. Më 20 qershor 2014, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesave KI80/14 dhe KI93/14 dhe bashkimin e tyre. Gjykata po ashtu iu kërkoi parashtruesve që të dorëzojnë autorizimet për përfaqësim për z. Zenel Mekaj dhe z. Zeqir Bërdynaj, si dhe t'i plotësojnë kërkesat e tyre. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi Gjykatës së Apelit nga një kopje të këtyre kërkesave.

12. Më 30 qershor 2014, parashtruesi Gazmend Musollaj (KI80/14) dorëzoi dokumentet shtesë, të kërkuara nga Gjykata.

13. Më 4 shtator 2014, Gjykata i kërkoi Gjykatës Themelore në Pejë të dorëzojë fletëkthesën që tregon datën në të cilën parashtruesve u është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, të cilin e kontestojnë.

14. Më 12 shtator 2014, parashtruesi Nezir Kerrellaj (KI93/13) dorëzoi dokumentet shtesë të kërkuara nga Gjykata.

15. Më 16 shtator 2014, Gjykata Themelore në Pejë paraqiti informatat shtesë të kërkuara nga ana e Gjykatës.

16. Më 18 shtator 2014, Gjykata i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesave KI80/14 dhe KI93/14.

17. Më 25 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

18. Më 29 mars 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë (Aktgjykimi, P. Nr. 473/11), i shpalli fajtorë parashtruesit për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje. Parashtruesi Gazmend Musollaj (KI80/14) u shpall fajtor edhe për kryerjen e veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontrollit, apo posedimit të pa autorizuar të armëve.

19. Parashtruesi Gazmend Musollaj (KI80/14) u dënua me burgim afatgjatë me kohëzgjatje prej 27 (njëzet e shtatë) vjetësh, kurse parashtruesi Nezir Kerrellaj (KI93/14) u dënua me burgim prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjetësh.

20. Prokurori Publik i Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe përfaqësuesi i të dëmtuarës Z. A. parashtruan ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, në lidhje me kohëzgjatjen e dënimit.

21. Më 12 dhjetor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Ap. nr. 391/2012) e zëvendësoi dënimin e mëparshëm të parashtruesit Gazmend Musollaj (KI80/14) me burgim afatgjatë prej 32 (tridhjetë e dy) vjetësh, ndërsa dënimin e mëparshëm të parashtruesit Nezir Kerrelaj (KI93/14) e zëvendësoi me burgim afatgjatë prej 30(tridhjetë) vjetësh.

22. Parashtruesit parashtruan ankesë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme (Ap. nr. 391/2012, të 12 dhjetorit 2012).

23. Më 21 mars 2013, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Pa. II. nr. 1/2013) refuzoi si të pabazuara ankesat e parashtruesve dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.

24. Kundër këtij aktgjykimi, parashtruesit kanë parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

25. Më 6 nëntor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Pml. nr. 166/2013) i refuzoi si të pa bazuara kërkesat e parashtruesve për mbrojte të ligjshmërisë, duke vlerësuar se *"[...] gjykata e shkallës se parë, shkallës së dytë e po ashtu edhe ajo e shkallës së tretë, drejtë kanë aplikuar ligjin penal kur kanë përfunduar se në veprimet e të gjykuarve qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilat të gjykuarit janë shpallë fajtor [...]"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi Gazmend Musollaj (KI80/14) pretendon se është shkelur paragrafi 4, i nenit 33 të Kushtetutës [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale]. Ai pretendon:

> *"[...] është shkelur parimi i përgjithshëm, ku duhet të veprohet në favor të tij, sepse nga gjykata e shkallës së parë, i gjykuari Musollaj, për vepra penale të cekura më lart, është dënuar me burgim afatgjatë prej 27 vitesh, derisa gjykata e shkallës së dytë e ndryshon vendimin e shkallës së parë dhe i shqipton dënim me burgim afatgjatë prej 30 vitesh, pa hy në fuqi Kodi i ri Penal, ndërsa gjykata e shkallës së tretë, refuzon ankesat e mbrojtësve dhe vërteton aktgjykimin e shkallës së dytë, në seancën e mbajtur, pas hyrjes në fuqi të Kodit të ri Penal, që do të thotë se vendimi nuk ishte ende i plotfuqishëm"*.

27. Parashtruesi, Nezir Kerrellaj (KI93 /14) pretendon shkeljen e nenit 3 [Barazia Para Ligjit], nenit 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare] dhe nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës. Ai pretendon:

> *"[...] në rastin konkret duhet respektuar ligji i cili është më i favorshëm për të akuzuarin pra ligji i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale e që dënimi ishte i shqiptuar 15 vite dhe ka mundur t'i shqiptohet më së shumti gjer në 20 vite burg e jo në 30 vite burg siç kanë vepruar Gjykatat [...]"*.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

29. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]".*

30. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:* [...] *(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi, [...]".*

31. Gjykata vëren se aktgjykimi i kontestuar u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 23 dhjetor 2013.

32. Gjykata vëren se parashtruesi Gazmend Musollaj (KI80/14) e ka parashtruar kërkesën e tij më 8 maj 2014, ndërsa parashtruesi Nezir Kerrellaj (KI93/14) e ka parashtruar kërkesën e tij më 22 maj 2014.

33. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesit i kanë parashtruar kërkesat e tyre në Gjykatë pas afatit kohor prej katër muajsh, në bazë të nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

34. Gjykata përkujton që qëllimi i afatit ligjor prej katër muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit si dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë sigurinë juridike duke siguruar që rastet të cilat paraqesin çështje kushtetuese të shqyrtohen brenda afateve të arsyeshme si dhe që vendimet e nxjerra më herët të mos jenë pafundësisht të hapura për kontestim (Shih, rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendimi i 25 gushtit 2005).

35. Nga se u tha më lart, rrjedh që kërkesa është e paafatshme dhe duhet të refuzohet si e papranueshme në bazë të nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullave 36 (1) c) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 25 nëntor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. dr. Enver Hasani

KI97/14, Parashtrues Velibor Jokić, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr. 610/13, i 23 tetorit 2013

KI97/14, Aktvendim për papranueshmëri i 8 dhjetorit 2014, publikuar më 11 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile dhe penale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mbrojtje gjyqësore e të drejtave, mbrojtja e pronës, paditës subsidiar, ratione materiae (kompetenca lëndore)*

Gjykata e Apelit të Kosovës me Aktgjykimin, PN.nr 610/2013, të 23 tetorit 2013 vendosi që gjykata e shkallës së parë kishte vepruar drejt kur kishte hedhur poshtë të pabazuar aktakuzën e parashtruesit – si paditës subsidiar - të paraqitur ndaj drejtorit të administratës së Komunës së Vitisë.

Parashtruesi, ndër të tjera, pretendoi se hedhja poshtë e aktakuzës së tij nga gjykatat e rregullta i kishte mohuar atij qasjen në drejtësi dhe rrjedhimisht i ishte mohuar dhe posedimi paqësor i pronës. Parashtruesi iu referua shkeljes të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën për mjete juridike, të drejtën për mbrojtje të pronës të përcaktuara me nenin 31, 32 dhe 46 të Kushtetutës si dhe neneve përkatëse të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se ankesat e parashtruesit përkitazi me procedurën penale kundër drejtorit të administratës së Komunës së Vitisë, nuk i takojnë fushëveprimit të së drejtës për gjykim të drejtë nga neni 31 i Kushtetutës, dhe për më tepër, ato procedura nuk kishin asnjë ndikim në të drejtat e tij për posedim paqësor të pronës. Kërkesa u shpall e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (3) e) të Rregullores së punës për shkak se nuk ishte *ratione materiae,* në pajtim me Kushtetutën.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI97/14
Parashtrues
Velibor Jokić
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 610/2013, të 23 tetorit 2013

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Velibor Jokić, me vendbanim në Serbi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 610/2013, të 23 tetorit 2013, me të cilin ishte hedhur poshtë ankesa e tij si paditës subsidiar. Ky aktvendim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 4 shkurt 2014.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktvendimin e lartpërmendur të Gjykatës së Apelit i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta). Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, thirret në nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), si dhe në nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 (b) të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 qershor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 4 korrik 2014, Kryetari caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

7. Më 18 nëntor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Gjykatës së Apelit të Kosovës.

8. Më 8 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit

Sa i përket kërkesave pronësore të parashtruesit të kërkesës

9. Nga shkresat e rastit rrjedh se parashtruesi i kërkesës pretendon pronësinë e dy parcelave të tokës, që gjenden në komunën e Vitisë. Me sa duket, pronësia e parashtruesit u konfirmua nga Gjykata Komunale në Viti, në vitin 1994.

10. Më 11 mars 2004, parashtruesi paraqiti një kërkesë në Drejtorinë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Vitisë, duke kërkuar regjistrimin e pronësisë së tij të këtyre dy parcelave në kadastrën komunale. Megjithatë, kjo kërkesë nuk është zbatuar. Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Komunale e Vitisë që ta detyrojë përmbarimin e kërkesës së tij.

11. Më 11 janar 2008, Gjykata Komunale e Vitisë e aprovoi kërkesën për përmbarim të dhunshëm. Megjithatë, më 24 shtator 2008, drejtori i administratës së Komunës së Vitisë, X. S., refuzoi kërkesën e parashtruesit. Duket se, më 6 mars 2008, me Vendimin nr. 01-013/838, Kuvendi Komunal i Vitisë kishte urdhëruar pezullimin e

përkohshëm të transferimit të regjistrimit të pronave që janë aktualisht të regjistruara në emrat e ndërmarrjeve shoqërore ose të ndërmarrjeve publike, që të regjistrohen në emrat e individëve privatë.

12. Parashtruesi i kërkesës kishte ndërmarrë hapa të ndryshëm ligjorë kundër refuzimit për të regjistruar pronat në emër të tij. Duket se këto procedura të ndryshme janë ende në pritje, por ato nuk janë objekt i kësaj kërkese.

Sa i përket ndjekjes penale të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës

13. Më 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti kallëzim penal kundër drejtorit të administratës së Komunës së Vitisë. Parashtruesi vetë paraqitej si "paditës subsidiar" sipas kapitullit V të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (UNMIK/REG/2003/26, siç ishte ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-003 të 6 nëntorit 2008). Parashtruesi i kërkesës akuzoi drejtorin e administratës për veprën penale "Shpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizimit", sipas nenit 339, paragrafi 1, të Kodit Penal të Kosovës (UNMIK/REG/2003/25, ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-002 të 6 nëntorit 2008).

14. Më 12 tetor 2012, me Aktvendimin UO. nr. 48/2009, Gjykata Komunale në Viti vendosi ta refuzojë aktakuzën e parashtruesit kundër drejtorit të administratës, sepse veprimi për të cilin ai ishte i akuzuar, nuk përbënte vepër penale. Gjykata komunale konsideroi se drejtori i akuzuar i administratës ishte thjesht duke e zbatuar vendimin e Kuvendit Komunal, të 6 marsit 2008.

15. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër këtij vendimi te Kolegji në përbërje të plotë të Gjykatës. Parashtruesi i kërkesës argumentoi se ai kishte dorëzuar kërkesën e tij për regjistrimin e pronave më 11 mars 2004, ndërsa Kuvendi Komunal i Vitisë nuk kishte vendosur të pezullojë përkohësisht regjistrimin e pronave deri më 6 mars 2008. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se dështimi për të regjistruar pronat në emrin e tij gjatë 4 (katër) vjetësh para vendimit të Kuvendit Komunal përbënte vepër penale të shpërdorimit të pozitës.

16. Më 15 maj 2013, me Aktvendimin UO. nr. 48/2009, Gjykata Themelore në Gjilan, dega në Viti, vendosi ta refuzojë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Gjykata Themelore konsideroi se drejtori i administratës thjesht përmbaroi vendimin e Kuvendit Komunal dhe nuk kishte keqpërdorur në asnjë mënyrë tjetër pozitën ose autorizimin e tij. Parashtruesi parashtroi ankesë kundër këtij vendimi.

17. Më 23 tetor 2013, me Aktvendimin PN. nr. 610/2013, Gjykata e Apelit vendosi që ankesa e parashtruesit të kërkesës ishte e pabazuar. Gjykata e Apelit konkludoi:

> *"Kjo Gjykatë gjeti se në rastin konkret ankesa është e pabazuar dhe se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e [parashtruesit të kërkesës], me të cilën kishte propozuar anulimin e aktvendimit të Gjykatës Komunale të Vitisë, [...] sepse [drejtori i Administratës], me cilësi të personit përgjegjës, ka vepruar në përputhje me vendimin e KK të Vitisë [...], me të cilin ishte pezulluar përkohësisht regjistrimi mbi personat fizikë i paluajtshmërive të evidencuara në emër të ish-ndërmarrjeve shoqërore".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të drejtave të tij kushtetuese të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, thirret në nenet 6, 13 dhe 14 KEDNJ, si dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se e drejta për gëzimin paqësor të pronës së tij nuk është mbrojtur nga autoritetet publike dhe gjykatat. Për më tepër, ai pretendon se, duke refuzuar aktakuzën e tij të ndjekjes subsidiare, gjykatat i kanë mohuar parashtruesit të kërkesës të drejtën e qasjes në drejtësi.

20. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat nuk kanë dhënë arsye për vendimet e tyre, duke shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë. Ai pretendon se i është mohuar e drejta për barazi me palën tjetër në procedurë dhe se ai nuk ka përfituar nga një gjykim brenda një kohe të arsyeshme.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

22. Gjykata, gjithashtu, duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit. Neni 113, paragrafi 7 përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

23. Vendimi përfundimtar për rastin e parashtruesit është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, PN. nr. 610/2013 të 23 tetorit 2013, kundër të cilit nuk lejohet ankesa e mëtejshme. Si rezultat i kësaj, parashtruesi i kërkesës ka dëshmuar se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit.

24. Parashtruesi i kërkesës duhet gjithashtu të dëshmojë se i ka plotësuar kërkesat e nenit 49 të Ligjit, në lidhje me parashtrimin e kërkesës brenda afatit ligjor. Nga shkresat e lëndës mund të shihet se vendimi përfundimtar për rastin e parashtruesit është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit PN. nr. 610/2013, i 23 tetorit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 4 shkurt 2014, ndërsa parashtruesi paraqiti kërkesën në Gjykatë më 4 qershor 2014, që do të thotë se kërkesa është paraqitur brenda afatit prej 4 (katër) muajsh të paraparë me Ligj dhe me Rregullore të punës.

Sa i përket qasjes në mjete gjyqësore

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se atij i është mohuar qasja në mjetet gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të tij pronësore. Parashtruesi pretendon se atij i është mohuar e drejta për gëzimin paqësor të pronës së tij, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

26. Gjykata vëren se procedurat e ndryshme juridike dhe gjyqësore janë përmendur në shkresa të lëndës, por asnjë nga këto procedura nuk është shpjeguar ose shtjelluar. Asnjë kopje e vendimeve në procedurat e tilla nuk janë në shkresat e lëndës. Në të vërtetë, duket se të paktën disa nga këto procedura ende mund të jenë në pritje. Për më tepër, Gjykata vëren se procedurat të cilat janë objekt i kësaj kërkese, nuk kanë asnjë ndikim në të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gëzimin paqësor të pasurisë së tij, por kanë të bëjnë me një akuzë penale kundër një zyrtari publik për keqpërdorim të pozitës.

27. Në këtë mënyrë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur në baza kushtetuese pretendimet e tij në lidhje me të drejtën e tij për mbrojtje gjyqësore dhe të drejtën për mjete juridike,

dhe nuk ka ofruar asnjë dëshmi se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

28. Rregulli 36 (2) d) i Rregullores së punës, parasheh që *"Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...] parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij"*.

Sa i përket të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe gëzim të pronës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai nuk ka përfituar nga një gjykim i drejtë, në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së.

30. Neni 31 i Kushtetutës, në pjesën përkatëse të paragrafit të dytë të saj, parashikon se,

> *"Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale [...]"*

31. Neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, në pjesët përkatëse, parashikon,

> *"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht [...]"*.

32. Përveç kësaj, neni 53 i Kushtetutës parasheh që:

> *"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"*.

33. Gjykata vëren se ankesa e parashtruesit në lidhje me një gjykim të drejtë ka të bëjë ekskluzivisht me procedurën penale kundër një pale të tretë në të cilën kishte paraqitur veten si paditës subsidiar. Akuza e parashtruesit të kërkesës kundër palës së tretë ishte refuzuar nga gjykata e shkallës së parë dhe nga Gjykata e Apelit me arsyetim se akuzat kundër kësaj pale të tretë nuk përbëjnë vepër penale.

34. Gjykata vëren se, në qoftë se këto procedura penale do të ishin lejuar të vazhdojnë, rezultati i tyre do të mund të përfundonte vetëm me një vërtetim të akuzave penale të paraqitura kundër kësaj pale të tretë. Nuk kishte akuza penale të paraqitura kundër parashtruesit të kërkesës.

35. Kur të lexohet neni 31 i Kushtetutës, në dritën e nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së, Gjykata konstaton se shprehja "*për cilëndo* akuzë penale*",* siç përdoret në nenin 31, duhet të kuptohet si "*për cilëndo akuzë* penale të ngritur kundër parashtruesit të kërkesës". Në këtë mënyrë, pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë nuk mund të bie brenda fushëveprimit të titullit "*për cilëndo* akuzë penale*",* të përfshirë në nenin 31 të Kushtetutës.

36. Për më tepër, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet, Gjykata rikujton Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut në rastin Perez kundër Francës (nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004), i cili, në paragrafët 70 dhe 71, thotë që,

> *"*70. [*Gjykata Evropiane për të* Drejta të Njeriut*]* vëren se Konventa nuk jep asnjë të drejtë*,* siç kërkohet nga parashtruesi i kërkesës*,* për "*hakmarrje* private" apo për një actio popularis. Kështu, e drejta për të ndjekur penalisht *palët e treta* apo *për të* dënuar për një vepër penale nuk mund të realizohet në mënyrë të pavarur*:* ajo duhet të jetë e pandashme nga ushtrimi një të drejte të viktimës për të ushtruar të drejtën për procedurë civile në të drejtën vendore*,* edhe në qoftë se *kjo është* vetëm për të siguruar dëmshpërblim simbolik ose për të mbrojtur një e drejtë civile siç është e drejta për një "*reputacion të mirë"* [*...].*
>
> 71. Gjykata [*Evropiane]* arrin në përfundimin se një ankesë civile *e palës* bie në kuadër të fushëveprimit të nenit 6 § 1 të Konventës*,* **përveç në rastet e përmendura në paragrafin e mëparshëm"**. [Theks i shtuar]

37. Për dallim nga rasti Perez kundër Francës, parashtruesi nuk ishte palë civile në një ndjekje penale, por vetë kishte filluar procedurën penale si paditës subsidiar. Nga shkresat e lëndës mund të shihet se këto procedura penale nuk kanë përfshirë kërkesën për kompensim të çfarëdo dëmi të pësuar nga parashtruesi i kërkesës. Për më tepër, këto procedura penale nuk mund të kishin ndikuar në rezultatin e ndonjë procedure tjetër juridike lidhur me të drejtat pronësore të parashtruesit të kërkesës. Në këtë mënyrë, rezultati i ndjekjes penale kundër drejtorit të administratës së Komunës së Vitisë nuk do të kishte ndikuar në gëzimin e ndonjë të drejte nga ana e parashtruesit, dhe as nuk do të kishte përcaktuar ndonjë detyrim të parashtruesit të kërkesës.

38. Siç u citua më lart në Aktgjykimin Perez kundër Francës, GJEDNJ nuk siguron të drejtën e ndjekjes ose dënimit të një pale të tretë për një vepër penale. As Kushtetuta nuk ofron një të drejtë të tillë.

39. Duke pasur parasysh se procedurat ndaj të cilave ankohet nuk kanë të bëjnë me përcaktimin e çfarëdo të drejte dhe obligimi të parashtruesit të kërkesës, rrjedh se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë nuk bie brenda fushëveprimit të titullit "*të drejtat dhe obligimet*", të përfshira në nenin 31 të Kushtetutës.

40. Në përfundim, Gjykata konstaton se ankesat e parashtruesit në lidhje me procedurën penale kundër drejtorit të administratës së Komunës së Vitisë nuk i takojnë fushëveprimit të së drejtës për gjykim të drejtë, nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së.

41. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi ankohet se është shkelur e drejta e tij për gëzim paqësor të pronës, për shkak të refuzimit të gjykatave të rregullta për të lejuar ndjekjen e tij subsidiare kundër drejtorit të administratës së Komunës së Vitisë. Megjithatë, siç përshkruhet më lart, këto procedura nuk kishin asnjë ndikim në të drejtat pronësore të parashtruesit të kërkesës.

42. Prandaj, Gjykata gjen se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtave të tij pronësore nuk i takojnë fushëveprimit të nenit 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, sepse gëzimi i të drejtave të tij pronësore, nuk ka mundur në asnjë mënyrë të preket nga këto procedura.

43. Prandaj, Gjykata konsideron se ankesat e parashtruesit në lidhje me të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të drejtën e tij për mbrojtje të pronës nuk janë ratione materiae në pajtim me Kushtetutën.

44. Rregulli 36 (3) (e) i Rregullores së punës parasheh që "*Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: [...] kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;*

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) d), 36 (3) e), dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 8 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Arta Rama-Hajrizi	Prof. dr. Enver Hasani

KI112/14, Parashtrues Srboljub Krstić, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 63/2014 i 3 prillit 2014

KI112/14, Aktvendim për papranueshmëri i 22 tetorit 2014, publikuar më 12 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, barazia para ligjit, mbrojtja e pronës, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin, Rev. nr. 63/2014, të 3 prillit 2014 hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për revizion të paraqitur kundër gjykatave të instancës më të ulët, përkitazi me mosplotësimin e kërkesëpadisë sipas formës së kërkuar me ligj.

Parashtruesi, ndër të tjera, pretendoi se Aktvendimi i Gjykatës Supreme për moslejimin e revizionit ka shkelur të drejtën e tij për barazi para ligjit, të përcaktuar me nenin 3 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se shpjegimet e gjykatave të rregullta ishin të qarta dhe ligjërisht të argumentuara, dhe se procedurat e zhvilluara nuk ishin të padrejta ose arbitrare. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI112/14
Parashtrues
Srboljub Krstić
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 63/2014, të 3 prillit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga :

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Alaty Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Srboljub Krstić, nga fshati Preoc, komuna e Graçanicës, të cilin e përfaqëson avokati z. Isak Islami nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 63/2014, të 3 prillit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Rev. nr. 63/2014] të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 3 prillit 2014, me të cilin, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, është shkelur neni 3 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 49 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/ L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe

rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI112/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI112/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 29 shtator 2014, Gjykata e informoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 22 tetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 10 tetor 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesëpadinë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamentit në Graçanicë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) kundër z. A. N., me vendbanim në Smederevë, Republika e Serbisë, me të cilën ka kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi parcelën në sipërfaqe prej 712 m2, e cila në regjistrimin kadastral evidentohet me shenjën P-73414058-00353-2.

10. Parashtruesi i kërkesës në kërkesëpadinë ka cekur se vlera e kontestit në këtë çështje juridike është 300 (treqind) euro.

11. Më 15 qershor 2013, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [P. nr. 2673/12] me të cilin kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që në afat prej 3 (tri) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të plotësojë kërkesëpadinë, dhe ta shkruajë saktë adresën e të paditurit.

12. Më 31 korrik 2013, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [P. nr. 2673/12] me të cilin konsideron që kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është tërhequr në pajtim me nenin 102.3 dhe nenin 112 të Ligjit për procedurën kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK).

13. Të njëjtën ditë (31 korrik 2013), parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore të 31 korrikut 2013.

14. Më 25 tetor 2013, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin [Pž. nr. 2882-2013] me të cilin hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar ndërsa Aktvendimin e Gjykatës Themelore [P. nr. 2673/12] të 31 korrikut 2013, e vërtetoi në tërësi. Në konkludimin e Aktvendimit, Gjykata e Apelit theksoi: „ ... *se ankesa e parashtruesit të kërkesës nuk bazohet në baza ligjore, sepse me arsyet ankimore, parashtruesi i kërkesës nuk ka kontestuar gjendjen faktike në të cilën është bazuar aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë".*

15. Më 7 shkurt 2014, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

16. Më 3 prill 2014, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktvendimin [Rev. nr. 63/2014] me të cilin e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për revizion si të palejuar në pajtim me nenin 211.3 të LPK-së.

Ligji relevant

Ligji për procedurën kontestimore (LPK) nr. 03/L- 006

Neni 102.3.: *"Do të konsiderohet se është tërhequr parashtresa po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hidhet poshtë...".*

Neni 112.: *"Kur personi të cilit i është dërguar shkresa, përkatësisht anëtari i rritur i familjes së tij, përkatësisht personi i autorizuar ose i punësuari në organin shtetëror apo në personin juridik, pa ndonjë arsye të ligjshme refuzon ta marrë në dorëzim shkresën, dorëzuesi do t'ia lë në banesë ose në lokalet në të cilat punon personi i tillë apo do t'ia bashkëngjis shkresën në derën e banesës apo lokalit të punës. Në fletë dërgesë do të shënohet dita, ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa. Komunikimi i kryer në këtë mënyrë quhet i ligjshëm".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi në kërkesë theksoi se me Aktvendimin e kontestuar [Rev. nr. 63/2014] të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, dhe atë: neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës i cili parasheh se Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera që qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, nëpërmjet institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

18. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me këtë kërkesë:

"Me këtë shkresë dëshirojmë të arrijmë respektimin e ligjit dhe evidentimin e shkeljeve, duke kërkuar miratimin e revizionit të datës 03.04.2014 të Gjykatës Supreme të Kosovës i cili është në kundërshtim më revizionin e kërkuar i cili është në kundërshtim me rregullat ligjore ku në në bazë të revizionit nuk kemi paraqitur shumë më të vogël se 3000 euro. Andaj, Gjykata Supreme e Kosovës është dashur të shqyrtoj kërkesën e revizionit e ushtruar më afat ligjor, e jo të refuzoj atë me vendimin 63/2014".

Pranueshmëria e kërkesës

19. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë ankesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës të Gjykatës.

20. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

21. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".

22. Siç është cekur më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon që me Aktvendimin [Rev. nr. 63/2014] e Gjykatës Supreme të Kosovës të 3 prillit 2014, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

23. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesë nuk ka shpjeguar si dhe pse me Aktvendimin [Rev. nr. 63/2014] e Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, por pretendimet e tij në lidhje me shkeljen e nenit 3 të Kushtetutës i justifikon me qëndrimin: *„ [...] se Kosova është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në*

mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore".

24. Gjykata Kushtetuese rithekson se, sipas Kushtetutës nuk është detyrë e saj që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtruesit e kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

25. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm t'i shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të rregullt dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në atë mënyrë sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur një gjykim të drejtë (Shih, ndërmjet burimeve të tjera, rasti *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar,* nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).

26. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme me Aktvendimin [Rev. nr. 63/2014] të 3 prillit 2014, refuzoi kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës në pajtim me nenin 211.3 të LPK-së.

27. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se neni 211.3 i LPK-së parasheh: "*Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3.000 Euro".*

28. Prandaj, Gjykata është e mendimit se shpjegimi i dhënë nga Gjykata Supreme në Aktvendimin [Rev. nr. 63/2014] është i qartë dhe ligjërisht i argumentuar, dhe se procedurat para Gjykatës Supreme dhe gjykatave të tjera të rregullta nuk ishin të padrejta dhe arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, nr.* 17064/06, vendimi i GJEDNJ-së të 30 qershorit 2009).

29. Gjykata vëren se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e rastit nuk mund vetvetiu ti jep të drejtë të iniciojë një pretendim të argumentuar për shkeljen e dispozitave të Kushtetutës (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrik 2005).

30. Si përmbledhje, Gjykata gjen se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kushtet për pranueshmëri, duke pasur parasysh që parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

31. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet si e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 22 tetor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Arta Rama-Hajrizi	Prof. dr. Enver Hasani

KI122/14, Parashtrues Adem Berisha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht, Plk. nr. 72/14, i 19 qershorit 2014

KI122/14, Aktvendim për papranueshmëri i 25 nëntorit 2014, publikuar më 13 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dënim me burgim, lirim me kusht, kërkesë qartazi e pabazuar*

Paneli për Lirim me Kusht i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me Aktvendimin, Plk.nr.72/14, të 19 qershorit 2014 kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit për lirim me kusht për pjesën e mbetur të dënimit të tij me burg.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se me vendimin e kontestuar atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] paragrafi 1 dhe 2, neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër].

Gjykata Kushtetuese konstatoi se vendimi i Panelit për lirim me kusht ishte i arsyetuar, dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar me saktësi, dhe nuk ka arritur të dëshmojë se si dhe pse vendimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje të të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me Kushtetutë. Kërkesa u shpall e papranueshme, si qartazi e pabazuar, siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI122/14
Parashtrues
Adem Berisha
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Panelit për lirim me kusht, Plk. nr. 72/14,
të 19 qershorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Adem Berisha, nga fshati Grashticë, komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Panelit për lirim me kusht të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Plk. nr. 72/14 (në tekstin e mëtejmë: Paneli për lirim me kusht), të 19 qershorit 2014, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e parashtruesit për lirim me kusht për pjesën e mbetur të dënimit të tij me burg.

3. Vendimi i kontestuar i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 20 qershor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet *"t'i ketë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, respektivisht neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]*

paragrafi 1 dhe 2, neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta)".

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 23 korrik 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 6 gusht 2014, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kyeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 29 gusht 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që ai të dorëzojë vendimin e kontestuar në Gjykatë.

9. Më 9 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi vendimin e kërkuar në Gjykatë.

10. Më 25 shtator 2014, Gjykata i dorëzoi një kopje të kërkesës Panelit për lirim me kusht.

11. Më 2 tetor 2014, Paneli për lirim me kusht iu përgjigj kërkesës.

12. Më 25 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 2 nëntor 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi P. nr. 727/08) e dënoi parashtruesin e kërkesës me burgim.

14. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

15. Më 14 mars 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Ap. nr. 459/2009) e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

16. Më 22 mars 2013, parashtruesi i kërkesës filloi vuajtjen e dënimit në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë.

17. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për lirim me kusht te Paneli për lirim me kusht.

18. Më 19 qershor 2014, Paneli për lirim me kusht (Aktvendimi Plk. 72/14) e refuzoi kërkesën e parashtruesit për lirim me kusht.

19. Në arsyetimin e tij, Paneli për lirim me kusht konstatoi:

> *"[...] Pas vlerësimit të të gjitha të dhënave të paraqitura në shkresat e cekura më lart, paneli ka gjetur se:*
> *Lirimi për shkak të përfundimit të mbajtjes së dënimit është caktuar për 23.4.2015.*
>
> *I dënuari ka shfaqur sjellje të mira dhe qëndrim korrekt gjatë vuajtjes së dënimit, ndërsa sa i përket veprës penale i njëjti ka deklaruar se vepra është kryer nga pakujdesia.*
>
> *Mirëpo, edhe përkundër raporteve pozitive përkitazi me shkallën risocializimit, paneli vlerëson se ende nuk është arritur qëllimi [...] të sanksionit penal [...], për të cilën arsye kërkesa e të dënuarit u refuzua, mirëpo si rezultat i sjelljeve të mira paneli vendosi që kjo çështje mund të rishqyrtohet në tre (3) muaj .*
>
> *Paneli me rastin e vendimit mori parasysh të gjitha kriteret për lirimin me kusht të përcaktuara në dispozitën e nenit 14 të Rregullores nr. 01/39. mbi Organizimin dhe funksionimin e Panelit për lirim me kusht.*
>
> *Nga sa u tha më lart, me zbatimin e nenit 25 pika 1.2 e të Rregullores nr. 01/39 të Këshillit gjyqësor të Kosovës. u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Panelit të lirimit me kusht "[...] *nuk i ka marrë për bazë raportet nga Q. K. të vlerësuara nga stafi profesionist, por e sjell një vendim të gabuar, ku përsëri e vlerëson gjendjen faktike ku gjykata* [Gjykata e Qarkut në Prishtinë] *njëherë ka vendos për këtë".*

21. Prandaj, parashtruesi i kërkesës pretendon që refuzimi i kërkesës së tij për lirim me kusht *"t'i ketë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, respektivisht neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] paragrafi 1 dhe 2, neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës".*

22. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se Aktvendimi i Panelit për lirim me kusht gjithashtu ka shkelur *"Kodin Penal dhe të Procedurës Penale (neni 94 paragrafi 1) [...]".*

23. Parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata *"të anulohet vendimi i PLK* [Paneli për lirim me kusht] *të 19 qershorit 2014 dhe rasti të kthehet në rivendosje, sa më parë dhe të vlerësohet gjendja faktike dhe arritje e shkallës së risocializimit të mbështetur në raportet e Q. K. Smrekonicë* [Qendra Korrektuese] *Smrekonicë. Dua të theksoj që Q. K. Smrekonicë takon Q. K. të tipit të hapur".*

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".*
>
> *[...]*
>
> *"7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

26. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".*

27. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion duke marrë parasysh se vendimet e Panelit për

lirim me kusht janë përfundimtare dhe nuk i nënshtrohen ankesës, dhe as kontestit administrativ. Gjykata, gjithashtu vëren se Aktvendimi i Panelit për lirim me kusht i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 20 qershor 2014, dhe ai e kishte dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë më 23 korrik 2014.

28. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të aplikueshëm dhe se kërkesa ishte parashtruar brenda afatit kohor prej katër muajsh.

29. Megjithatë, Gjykata gjithashtu duhet të merr parasysh nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës.

Neni 48 i Ligjit

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Rregulli 36 i Rregullores së punës

"(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

30. Parashtruesi i kërkesës, siç u cek më lart, e konteston Aktvendimin e Panelit për lirim me kusht (Plk. nr. 72/14, të 19 qershorit 2014), duke pretenduar shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, aplikimit të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare dhe të së drejtës së tij për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër penale.

31. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Paneli për lirim me kusht e refuzoi kërkesën e tij për lirim me kusht, duke i ofruar atij *"arsyetim të pa qartë dhe tepër konfuz"*. Ai më tej pretendon se Paneli për lirim me kusht *"nuk i ka marrë për bazë raportet nga Q. K. të vlerësuara nga stafi profesionist, por e sjellë një vendim të gabuar [...]"*.

32. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Paneli për lirim me kusht e arsyetoi Aktvendimin e tij lidhur me këto pretendime konkrete të parashtruesit të kërkesës duke konstatuar që *"[...] edhe përkundër raporteve pozitive përkitazi me shkallën risocializimit, paneli vlerëson se ende nuk është arritur qëllimi [...] të sanksionit penal të paraparë sipas dispozitës së nenit 41 të Kodit Penal të Republ1kës së Kosovës dhe nenit 4 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ngase qëllimi i dënimit nuk është vetëm rehabilitimi dhe risocializimi i personit të dënuar por edhe ndikimi në personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave të tilla apo të ngjashme penale për të cilën arsye kërkesa e të dënuarit u refuzua".*

33. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet përgjigjes së Panelit për lirim me kusht, ku thuhet se "*pretendimi i të dënuarit për shkelje të Kushtetutës dhe ligjit nuk qëndron ngase si i tillë rasti [...] është trajtuar konform ligjit dhe standardeve profesionale, duke marrë parasysh qëllimin e ekzekutimit të sanksionit penal, siç parashihet në ligj dhe rregulla procedurale".*

34. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë kryer nga autoritetet publike, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

35. Gjykata Kushtetuese gjithashtu thekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta apo nga autoritet tjera publike. Është roli i gjykatave të rregullta apo autoriteteve tjera publike, kur është e aplikueshme, që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, para. 28, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, para. 28, shih edhe rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. 70/11, *parashtrues Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

36. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, *Edëards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut të 10 korrikut 1991)

37. Gjykata konsideron se procedurat në Panelin për lirim me kusht kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara (Shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,* Nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

38. Gjykata rikujton se çështja e parashtruesit të kërkesës është e ngjashme me rastin Nr. KI90/13 (Shih, rastin KI90/13 parashtrues *Lumni Limaj*, rast i Gjykatës Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 24 marsit 2014). Në atë rast, parashtruesi kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit për lirim me kusht, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për lirim me kusht. Kërkesa e parashtruesit për vlerësim të kushtetutshmërisë ishte refuzuar si qartazi e pabazuar, pasi që Gjykata vlerësoi se kërkesa nuk ishte arsyetuar *prima facie* dhe se parashtruesi nuk e kishte dëshmuar mjaftueshëm pretendimin e tij.

39. Në rastin e tanishëm, Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar asnjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës (Shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005) dhe nuk ka saktësuar se si nenet e përmendura të Kushtetutës e mbështesin pretendimin e tij, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 48 të Ligjit.

40. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar me saktësi si dhe pse vendimi i Panelit për lirim me kusht, me të cilin atij nuk i lejohej lirimi me kusht, përfshin shkelje të të drejtave dhe lirive të tij individuale të garantuara me Kushtetutë, dhe ai nuk ka paraqitur dëshmi për ta arsyetuar pretendimin për një shkelje të tillë.

41. Si përmbledhje, pretendimet për shkelje të të drejtave dhe lirive të tij janë të padëshmuara dhe të pavërtetuara, dhe si të tilla janë qartazi të pabazuara.

42. Për arsyet e cekura më lart, Gjykata konsideron që, në pajtim me rregullin 36 (2) d), kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) d) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 25 nëntor 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. dr. Enver Hasani

KI147/14, Parashtrues Avni Ejupi, Vlerësim i kushtetutshmërisë i Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr.81/2014, i 16 Korrikut 2014

KI147/14, Aktvendim për papranueshmëri i 22 janarit 2015, publikuar më 13 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, ligji i punës, shkelje e rëndë e detyrave të punës, vlerësim i afatshmërisë, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme me Aktvendimin, Rev.nr.81/2014 refuzoi kërkesën e parashtruesit për revizion duke vërtetuar se padia e parashtruesit në gjykatën e shkallës së parë ishte e paafatshme, si dhe konstatoi, se gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kishin zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale. Thelbi i ankesës së parashtruesit ndërlidhet me mosvazhdim të kontratës së punës.

Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën, që të vlerësojë çështjen e afatshmërisë së padisë së tij pranë gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën ta kthejë në rishqyrtim. Në kërkesën e tij, nuk saktëson se cilat të drejta dhe liri i janë cënuar.

Gjykata Kushtetuese vërejti se parashtruesi nuk është i kënaqur kryesisht me kualifikimin juridik të fakteve dhe ligjit të aplikuar nga gjykatat e rregullta, dhe se nuk ka arritur të arsyetojë në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij për shkelje kushtetuese, andaj në përputhje me rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit u shpall e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI147/14
Parashtrues
Avni Ejupi
Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 81/2014,
të 16 korrikut 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Avni Ejupi nga komuna e Ferizajt.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 81/14, i 16 korrikut 2014, me të cilin revizioni i parashtruesit kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit (Ac. Nr. 4792/12 i 13 janarit 2014) ishte refuzuar si i pabazuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme. Në kërkesën e tij parashtruesi nuk saktëson se cilat të drejta dhe liri i janë cenuar, dhe cila dispozitë kushtetuese në veçanti mbështet kërkesën e tij, mirëpo kërkon vlerësimin e çështjes së afatshmërisë së padisë së tij.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 nëntor 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 10 nëntor 2014, me Vendimin GJR. KI147/14, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, me Vendimin KSH. KI147/14, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 14 nëntor 2014, Gjykata Kushtetuese e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, duke i kërkuar plotësimin e kërkesës së tij me dokumente shtesë.

8. Më 3 dhjetor 2014, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës në Gjykatën Supreme.

9. Më 18 dhjetor 2014, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës dhe dokumentet shtesë.

10. Më 22 janar 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

11. Duke filluar nga 1 korriku 2000 e deri më 31 dhjetor 2001, parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar si referent për punë të përgjithshme juridike në Drejtorinë Komunale për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi në Ferizaj (në tekstin e mëtejmë: punëdhënësi).

12. Më 8 janar 2002, punëdhënësi nxori Aktvendim (02 nr. 77) për mos vazhdimin e kontratës me arsyetim se parashtruesi kishte bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës.

13. Më 8 janar 2002, ndaj aktvendimit të lartcekur, parashtruesi ka paraqitur ankesë te organet e punëdhënësit.

14. Më 22 shkurt 2002, si rezultat i mospërgjigjes ndaj ankesës nga ana e punëdhënësit brenda afatit të caktuar ligjor, parashtruesi ka paraqitur urgjencë për heshtje administrative.

15. Më 10 prill 2002, Kryeshefi Ekzekutiv i Komunës së Ferizajt, si përgjigje ndaj urgjencës së parashtruar nga parashtruesi e njofton atë se nuk ka elemente bindëse për ndryshimin e aktvendimit të punëdhënësit për mosvazhdimin e kontratës.

16. Të njëjtën ditë, përkatësisht më 10 prill 2002, parashtruesi ka paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Ferizaj për kthimin në vendin e tij të punës.

17. Më 29 dhjetor 2006, derisa padia e parashtruesit ishte akoma në procedurë e sipër pranë Gjykatës Komunale në Ferizaj, parashtruesi ka paraqitur ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMK).

18. Më 31 janar 2007, KPMK, me Vendimin A. nr. 02/195/2006, refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar, me arsyetimin se parashtruesi kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Ferizaj, për të cilën nuk ishte vendosur akoma.

19. Më 13 nëntor 2012, Gjykata Komunale në Ferizaj (Aktvendimi, C. Nr. 66/09) padinë e parashtruesit e hodhi poshtë si të paafatshme.

20. Gjykata Komunale në Ferizaj, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit të Punës së Bashkuar, të cilin ligj e konsideroi si të aplikueshëm në këtë rast, konstatoi se, pasi që punëdhënësi ndaj ankesës së parashtruesit të 8 janarit 2002 nuk kishte nxjerrë vendim në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, parashtruesi padinë e tij në gjykatë është dashur ta parashtrojë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas skadimit të afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga paraqitja e ankesës së tij në organet e punëdhënësit. Si rrjedhojë, Gjykata Komunale në Ferizaj konstatoi se parashtruesi padinë e tij në gjykatë e kishte paraqitur me vonesë prej 28 (njëzet e tetë) ditësh.

21. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, parashtruesi ka paraqitur ankesë.

22. Më 13 janar 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendimi, AC. nr. 4792/12) ankesën e parashtruesit e refuzoi si të pabazuar dhe vërtetoi

Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj (C. Nr. 66/09, të 13 nëntorit 2012).

23. Më 18 shkurt 2014, kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit parashtruesi ka paraqitur revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.

24. Më 16 korrik 2014, Gjykata Supreme (Aktvendimi, Rev. Nr. 81/2014) revizionin e parashtruesit e refuzoi si të pabazuar.

25. Gjykata Supreme e Kosovës vërtetoi se padia e parashtruesit në gjykatën e shkallës së parë ishte e paafatshme, si dhe konstatoi se gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kishin zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën që të vlerësojë çështjen e afatshmërisë së padisë së tij pranë gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën ta kthejë në rishqyrtim.

27. Parashtruesi në kërkesën e tij nuk saktëson se cilat të drejta dhe liri i janë cenuar dhe cila dispozitë kushtetuese në veçanti mbështet kërkesën e tij.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

29. Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, që parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që kërkesën e tij ta qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akt konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

30. Gjykata, gjithashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *(2) Gjykata do të deklaroj një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

31. Ashtu siç u cek më lart, parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën që të vlerësojë çështjen e afatshmërisë së padisë së tij pranë gjykatës së shkallës së parë, dhe lëndën ta kthejë në rishqyrtim.

32. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur kryesisht me kualifikimin juridik të fakteve dhe të ligjit të aplikuar nga gjykatat e rregullta. Kualifikimi juridik i fakteve dhe ligji i aplikueshëm janë çështje të cilat bien në sferën e ligjshmërisë.

33. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përfshirë edhe nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

34. Gjykata, po ashtu vëren se parashtruesi në kërkesë nuk thekson se cila e drejtë i është shkelur dhe cili nen i Kushtetutës mbështet kërkesën e tij.

35. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë që procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, ndër të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).

36. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar si dhe pse përfundimi i Gjykatës Supreme për "Ligjin e zbatueshëm në atë kohë", në rastin e tij ka shkelur të drejtat dhe liritë të garantuara me Kushtetutë, dhe as që ka pretenduar ndonjë padrejtësi dhe arbitraritet në procedurë.

37. Përveç kësaj, Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin Nr. KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima*

dhe Bestar Hima, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

38. Nga arsyet e mësipërme, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

39. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar, dhe rrjedhimisht e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës, më 9 shkurt 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Arta Rama-Hajrizi	Prof. dr. Enver Hasani

KI136/14, Parashtrues Abdullah Bajqinca, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 99/2014, i 12 majit 2014

KI136/14, Aktvendim për papranueshmëri i 9 dhjetorit 2014, publikuar më 18 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, e drejta e punës dhe e ushtrimit të profesionit, kufizimi i të drejtave themelore, vepra penale vjedhje e pasurisë, suspendim nga puna, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev. nr. 99/2014, të 12 majit 2014 kishte ndryshuar aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë përkitazi me kthimin e parashtruesit në vendin e mëparshëm të punës, duke marrë parasysh faktin, se parashtruesit të kërkesës i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës, për shkak të veprës penale - vjedhje e pasurisë së punëdhënësit.

Parashtruesi pretendoi se Gjykata Supreme e Kosovës ka shkelur të drejtat e tij, që burojnë nga neni 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] dhe neni 55 [Kufizimi i të Drejtave Themelore] të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi vetëm përmend shkeljen e dispozitave kushtetuese pa i mbështetur ato me argumente dhe prova bindëse, dhe për më tepër, theksoi se ai është i pakënaqur me vendimin e kontestuar dhe se Gjykata Supreme në asnjë mënyrë nuk e ndaloi atë që ta kryej punën ose ushtroj profesionin e tij. Kërkesa u shpall e papranueshme, si qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI136/14
Parashtrues
Abdullah Bajqinca
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 99/2014,
të 12 majit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Abdullah Bajqinca, me vendbanim në Bardh të Madh, komuna e Fushë-Kosovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi kërkesës). Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga znj. Fehmije Bytyqi-Gashi, avokate në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 99/2014, të 12 majit 2014, me të cilin ishte ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1870/2012, i 21 gushtit 2013, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2146/2009, i 22 prillit 2010.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, që pretendohet të ketë shkelur nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji)

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 7 tetor 2014, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 20 tetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës ishte punëtor në Departamentin e Mirëmbajtjes së Qymyrit-KEK (në tekstin e mëtejmë: punëdhënësi) prej 1 tetorit 2006.

10. Më 16 maj 2007, punëdhënësi suspendoi nga puna parashtruesin e kërkesës për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale të vjedhjes së pasurisë së punëdhënësit.

11. Pas atij suspendimi, u iniciuan procedurat administrative, penale dhe kontestimore.

Procedura administrative

12. Më 27 korrik 2007, Komisioni Disiplinor i Punëdhënësit vendosi të ndërpresë marrëdhënien e punës me parashtruesin e kërkesës, për shkak të shkeljes së detyrave të punës.

13. Më 31 korrik 2007, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë te organi disiplinor i shkallës së dytë i punëdhënësit kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të Punëdhënësit.

14. Më 6 gusht 2007, shkalla e dytë refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi vendimin e Komisionit Disiplinor.

Procedura penale

15. Më 27 shkurt 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi P. nr. 2287/07) liroi parashtruesin e kërkesës nga akuza për vjedhje të pasurisë së punëdhënësit. Vendimi për lirim ishte i formës së prerë dhe detyrues.

Procedura kontestimore

16. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale, për kthim në vendin e tij të mëparshëm të punës.

17. Më 22 prill 2010, Gjykata Komunale (Aktgjykimi, C. nr. 2146/09) miratoi padinë e parashtruesit të kërkesës, anuloi vendimet e dy organeve disiplinore të punëdhënësit dhe detyroi punëdhënësin ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e tij të mëparshëm të punës.

18. Gjykata Komunale konkludoi se vendimet e dy organeve disiplinore të punëdhënësit ishin nxjerrë me shkelje të ligjit në fuqi, sepse "[...] *siç rezulton nga aktgjykimi penal teli për marrjen e të cilit ngarkohet paditësi dhe për çka ai akuzohet (...) nuk i ka tiparet e veprës së vjedhjes"*.

19. Punëdhënësi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, duke pretenduar shkelje të procedurës, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

20. Më 21 gusht 2013, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi CA. nr. 1870/2012), refuzoi si të pabazuar ankesën e punëdhënësit dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, të 22 prillit 2010.

21. Pas kësaj, punëdhënësi paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

22. Më 12 maj 2014, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 99/2014) miratoi revizionin e punëdhënësit si të bazuar dhe ndryshoi aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë.

23. Gjykata Supreme konstatoi se *"gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale"*.

24. Në fakt, Gjykata Supreme ka sqaruar "*Paditësit iu është shkëputur marrëdhënia e punës për shkak të shkeljeve të rënda të detyrave të punës, vjedhje të pasurisë së të padituës, nga neni 6 al. 1 pika 4 të Rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të punëtorëve të KEK-ut. Nga ana e të padituës është zhvilluar procedura disiplinore në kuptim të dispozitave të Rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale dhe në këtë procedurë është vërtetuar përgjegjësia e paditësit, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore – ndërprerjes së marrëdhënies së punës ndaj paditësit nga ana e të padituës, janë respektuar dispozitat nenit 112 të Ligjit të marrëdhënies së punës, i cili ka qenë Ligj i aplikueshëm në momentin e zbatimit të procedurës disiplinore ndaj paditësit. Gjykata në këtë çështje juridike nuk mund të lëshohet në faktin e ekzistimit apo mosekzistimit të veprës disiplinore pasi që kjo vërtetohet në procedurën e zhvilluar te punëdhënësi. Nga provat që ekzistojnë në shkresat e lëndës del se procedura disiplinore te e paditura kundër paditësit, është zhvilluar në kuptim të Rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale si dhe Ligjit të punës që ka qenë në fuqi"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi nuk paraqet ndonjë pretendim për shkelje kushtetuese, ai vetëm pohon *"[...] sipas vendimit të fundit të Gjykatës Supreme pretendohet se i është shkelur e drejta themelore e kjo e përcaktuar me Kushtetutë, sipas nenit 49 dhe 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës"*.

26. Parashtruesi më tej kërkon nga Gjykata të anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (Rev. nr. 99/2014, të 12 majit 2014).

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.*

29. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(2) "Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *...*
>
> *(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.".*

30. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.

31. Megjithatë, parashtruesi nuk ngre asnjë pretendim për shkeljen e të drejtave kushtetuese siç pohon ai.

32. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, nuk është i kënaqur, kryesisht me kualifikimin juridik të fakteve dhe të ligjit të aplikuar nga Gjykata Supreme. Kualifikimi juridik i fakteve dhe ligji i aplikueshëm janë çështje të cilat bien në sferën e ligjshmërisë.

33. Fakti i thjeshtë se parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ose vetëm përmendja e nenit 49 dhe 55 të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës.

34. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thirret në nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme në asnjë mënyrë nuk e ndalon parashtruesin e kërkesës të punojë ose të ushtrojë profesionin. Si e tillë, nuk ekziston asgjë në pretendimin e parashtruesit që do të arsyetonte përfundimin se është shkelur e drejta e tij kushtetuese për punë.

35. Gjykata vëren se Gjykata Supreme konkludoi, gjegjësisht *"procedura disiplinore te e paditura kundër paditësit, është zhvilluar në kuptim të Rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale si dhe Ligjit të punës që ka qenë në fuqi"*.

36. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta

(kushtetutshmëria).

37. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë që procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, ndër të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).

38. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar si dhe pse përfundimi i Gjykatës Supreme për "ligjin e zbatueshëm në atë kohë", në rastin e tij ka shkelur të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, dhe as që ka pretenduar ndonjë padrejtësi dhe arbitraritet në procedurë.

39. Përveç kësaj, Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin Nr. KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011)

40. Nga arsyet e mësipërme, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur një pretendim për shkelje kushtetuese dhe as nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

41. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar, dhe rrjedhimisht e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) d) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 10 shkurt 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. dr. Enver Hasani

KI145/14, Parashtrues Behxhet Mustafa, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Themelore në Prishtinë, A. nr. 1780/14, i 12 shtatorit 2014

KI145/14, Vendim per heqje të kërkesës nga lista i 9 dhjetorit 2014, publikuar më 18 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë admnitrativo-kushtetuese, tërheqje e kërkesës, shterim i mjeteve juridike, heqje e kërkesës nga lista*

Parashtruesi kontestoi zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" mirëpo ndërkohë, njoftoi Gjykatën për tërheqjen e kërkesës së tij, sepse dëshiron t'i shterojë mjetet juridike.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se nuk ka rrethana të jashtëzakonshme lidhur me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut që kërkojnë shqyrtimin e mëtutjeshëm të kërkesës, kësisoj vendosi ta heq kërkesën nga lista në pajtim me rregullin 32 të Rregullores së punës.

VENDIM PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA
në
Rastin Nr. KI145/14
Parashtrues
Behxhet Mustafa
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, A. nr. 1780/14, të 12 shtatorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Behxhet Mustafa, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, A. nr. 1780/14, të 12 shtatorit 2014, i cili i ishte dorëzuar atij më 13 shtator 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së procedurës së zgjedhjes së rektorit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me të cilën pretendohet se është shkelur neni 20 (4.1) i Statutit të Universitetit të Prishtinës. Parashtruesi i kërkesës nuk i është referuar asnjë dispozite kushtetuese.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për

Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 shtator 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 30 shtator 2014, parashtruesi parashtroi kërkesë për tërheqjen e kërkesës së tij, sepse dëshiron t'i shterojë mjetet juridike.

7. Më 7 tetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI145/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI145/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 9 tetor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Pranueshmëria e kërkesës

10. Gjykata vëren se, në mënyrë që ta vlerësojë pranueshmërinë, duhet të shqyrtojë kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe me Rregullore të punës.

11. Në rastin në fjalë, parashtruesi i kërkesës konteston procedurën e zgjedhjes së rektorit të Universitetit të Prishtinës, "Hasan Prishtina". Megjithatë, më 30 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për të tërhequr kërkesën e tij për shkak se dëshiron t'i shterojë mjetet juridike.

12. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 32 (Tërheqja e kërkesës dhe përgjigjes) së Rregullores së punës, i cili parashikon:

> *"(1) Pala mund të tërheqë kërkesën ose përgjigjen e parashtruar për atë kërkesë në çdo kohë para fillimit të seancës dëgjimore, ose në çdo kohë para marrjes së vendimit nga Gjykata, nëse vendimi merret pa seancë dëgjimore.*

(2) Pavarësisht tërheqjes së kërkesës, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë përkitazi me të.

(3) Në rast të tillë, Gjykata vendos pa seancë dëgjimore, duke u bazuar vetëm në kërkesë, në përgjigjet e parashtruara dhe në çfarëdo dokumentesh që i janë bashkëngjitur asaj".

13. Prandaj, Gjykata konkludon se nuk ka rrethana të jashtëzakonshme lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut të cilat do të kërkonin shqyrtim të mëtejshëm të kërkesës dhe, kësisoj vendos ta heqë kërkesën nga lista në pajtim me rregullin 32 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 36 (3) e) të Rregullores së punës, më 23 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

I. TA HEQË kërkesën nga lista;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Prof. dr. Enver Hasani

KI161/14, Parashtrues Mursel Izeti, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 99/2014, i 10 qershorit 2014

KI161/14, Aktvendim për papranueshmëri i 22 janarit 2015, publikuar më 19 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, armëmbajtje e paautorizuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkesë qartazi e pabazuar.*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin, Pml. nr. 99/2014, të 10 qershorit 2014 e ka refuzuar, si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë. Në kërkesën e tij parashtruesi pretendonte se gjykatat e shkallëve më të ulëta kanë bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale përkitazi me dënimin e tij me burgim për kryerjen e veprës penale, armëmbajtje e paautorizuar.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se në rastin e tij ishte cenuar parimi i barazisë së armëve, sepse gjykatat e rregullta kishin hedhur poshtë propozimin e tij për dëgjimin e ekspertëve mjekoligjor dhe balistik përkatësisht pa dhënë ndonjë arsye për refuzim.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se gjykatat e rregullta i ishin përgjigjur të gjitha pretendimeve të parashtruesit, kanë arsyetuar mjaftueshëm vendimet e tyre dhe janë mbështetur dhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe dispozitave kushtetuese përkitazi me supozimin e pafajësisë së parashtruesit. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar, siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullat 36(1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI161/14
Parashtrues
Mursel Izeti
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 99/2014, të 10 qershorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Mursel Izeti (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), nga fshati Greme, komuna e Ferizajt, i përfaqësuar nga z. Besnik Berisha, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 99/2014, i 10 qershorit 2014, me të cilin është refuzuar, si e pabazuar kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë. Ky vendim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 25 qershor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohen të jenë shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] i Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), sepse "*Gjykatat pa ndonjë arsyetim të qëndrueshëm nuk i kanë shqyrtuar provat e propozuara nga Mbrojtja. Provat e pa*

administruara nga kjo Gjykatë janë shumë relevante dhe me ndikim për vërtetimin e fajësisë apo pafajësisë së parashtruesit të kërkesës".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 (b) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 tetor 2014, parashtruesi dorëzoi me postë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), dhe ajo arriti në Gjykatë, më 29 tetor 2014.

6. Më 6 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin GJR. KI161/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës me Vendimin KSH. KI161/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 6 nëntor 2014, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai dorëzimin e autorizimit për përfaqësim për z. Besnik Berishën.

8. Më 19 nëntor 2014, parashtruesi dorëzoi dokumentacionin e kërkuar nga Gjykata.

9. Më 24 nëntor 2014, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme dhe Gjykatën Themelore në Ferizaj - Departamentin për krime të rënda (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga kjo e fundit dorëzimin e fletëkthesës, që dëshmon datën kur parashtruesi ka pranuar Aktgjykimin (Pml. nr. 99/2014, të 10 qershorit 2014) të Gjykatës Supreme.

10. Më 4 dhjetor 2014, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën, e cila tregon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, i 10 qershorit 2014, i është dorëzuar avokatit të parashtruesit, më 25 qershor 2014.

11. Më 22 janar 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 22 mars 2013, Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti për krime të rënda (Aktgjykimi PKR. nr. 9/2013-P. 94/12 PR1), shpalli fajtor parashtruesin për kryerjen e veprës penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe e dënoi atë me burgim. Parashtruesi kishte pranuar fajësinë në fillim të seancës për veprën penale të "mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve" siç parashihet me nenin 328, paragrafi 2, i Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK), por jo edhe për veprën penale "vrasje e rëndë" siç parashihet me nenin 147, paragrafi 1, nënparagrafi 9 i KPK-së, sepse veprimet e tij janë kryer në vetëmbrojtje. Gjykata Themelore bazoi gjetjet e saj në provat vijuese:

    a. pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarve gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe gjatë procedurës hetimore;

    b. nga dëshmitë e dëshmitarëve;

    c. nga shikimi në fotoalbum, skicë dhe fotografi në vendngjarje;

    ç. nga leximi i raportit të autopsisë së Departamentit të Mjekësisë Ligjore nr. NA11-033;

    d. nga leximi i raportit të ekspertizës për armën e zjarrit;

    dh. nga leximi i raportit të ekspertizës daktiloskopike.

13. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës penale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Gjykata Themelore ia kishte mohuar atij mundësinë për t'i bërë pyetje ekspertit, që do të kishte kontribuar në gjetjen e së vërtetës së çështjes përmes pyetjeve.

14. Më 12 nëntor 2013, Gjykata Apelit (Aktgjykimi PAKR. nr. 303/2013) refuzoi ankesën dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit vlerësoi se parashtruesit të kërkesës nuk i ishte mohuar asnjë e drejtë e garantuar me Kodin Penal të Kosovës, që mund të vërtetohet nga shkresat e lëndës, veçanërisht me procesverbalin e shqyrtimit kryesor.

15. Parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes

thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e shkallëve të ulëta nuk kishin ofruar arsye për mosaprovimin e propozimit të parashtruesit të kërkesës për dëgjimin e ekspertit mjekoligjor, për të bërë rikonstruimin e vendit të ngjarjes dhe për dëgjimin e ekspertit balistik.

16. Më 10 qershor 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pml. nr. 99/2014) refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës. Gjykata Supreme konsideroi se ankesa e parashtruesit nuk përmbante ndonjë specifikim në lidhje me mënyrën se si shkeljet e pretenduara ishin manifestuar në vendimet e shkallëve më të ulëta.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon *"[...] në procedurën kundër tij u cenua Parimi i barazisë së armëve dhe se ky veprim u manifestua me refuzimin e propozimeve të Mbrojtjes së parashtruesit, për të marrë prova dhe dëgjuar dëshmitar në interes të Mbrojtjes, ndërsa në anën tjetër Prokurorisë iu mundësua dëgjimi i të gjithë dëshmitarëve dhe dorëzimi i provave edhe në shqyrtimin kryesor [...]".*

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

20. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullat 36 (1) d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, të cilat parashohin:

> *"Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

(ç) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

21. Gjykata vëren se në rastin konkret parashtruesi i kërkesës ankohet se gjykatat e rregullta kishin hedhur poshtë propozimin e tij për të dëgjuar ekspertin mjekoligjor dhe ekspertin balistik dhe për të bërë rikonstruimin e vendit të ngjarjes, pa dhënë ndonjë arsye të vetme për refuzimin.

22. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Ferizaj ka dhënë arsye të gjera për gjetjet e saj, dhe gjithashtu i është referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe dispozitave të Kushtetutës në lidhje me supozimin e pafajësisë. Për më tepër, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë arsyetuar vendimet e tyre dhe kanë argumentuar secilin nga pretendimet e parashtruesit në lidhje me refuzimin e propozimit të tij.

23. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj konstatoi që parashtruesi ka pasur mundësi të shumta për të mbrojtur veten e tij dhe se atij i është dhënë mundësia për të parë shkresat e lëndës. Përveç kësaj, ajo konstatoi se nuk është e mjaftueshme të thuhet, për shembull, se aktgjykimi nuk është i bazuar në përmbajtjen e shkresave të lëndës, ose se ai është i bazuar në supozime, por duhet të shpjegohet ku është kundërthënia dhe cilat janë të metat në arsyetimin e fakteve vendimtare. Për shkak të mungesës të saktësimit në dhënien e këtyre shpjegimeve, Gjykata Supreme vlerësoi se pretendimet në fjalë ishin të pabazuara. Gjykata Supreme, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se Gjykata Themelore nuk e ka arsyetuar refuzimin e propozimit të parashtruesit të kërkesës në lidhje me administrimin e provave, ka gjetur se në faqen 11 (njëmbëdhjetë) të aktgjykimit është shpjeguar pse kërkesa e parashtruesit ishte refuzuar.

Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës ka komentuar edhe shkresat e lëndës.

24. Gjykata rithekson që nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Detyra e Gjykatës është që të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, duke përfshirë mënyrën se si janë marrë provat, kanë qenë të drejta (Shih, rastin *Edwards kundër Mbretërisë* së *Bashkuar,* Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut e miratuar me 10 korrik 1991).

25. Në rastin konkret, Gjykata nuk gjen se procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub kunder Lituanisë,* Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

26. Prandaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar pretendimet e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar dëshmi, për të treguar si dhe pse të drejtat dhe liritë e tij, të mbrojtura me Kushtetutë, janë shkelur me vendimin e kontestuar.

27. Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, më 10 shkurt 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Arta Rama-Hajrizi	Prof. dr. Enver Hasani

KI109/14, Parashtrues Ahmet Krasniqi et al., Vlerësim i kushtetutshmërisë së konkluzionit të Kuvendit bazuar në transkriptin e seancës plenare të 10, 11 dhe 17 prillit 2014.

KI109/14, Aktvendim për papranueshmëri i 2 shkurtit 2015, publikuar më 20 shkurt 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit dhe mbrojtja gjyqësore e të drejtave, interpretim i kuorumit të Kuvendit, palë e paautorizuar, kërkesë qartazi e pabazuar*

Parashtruesit e kërkesës kontestuan veprimet e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Sabri Hamiti, gjatë seancës plenare të Kuvendit më 10, 11 dhe 17 prill 2014, kur ai konkludoi se nuk kishte kuorum të nevojshëm për të votuar për përbërjen e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të Kosovës.

Parashtruesit e kërkesës pretenduan se konkluzioni i z. Hamiti, se nuk ka pasur kuorum për nxjerrjen e vendimit është zbatim i gabuar dhe shkelje e nenit 80.1 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës. Ky gabim i z. Hamiti, sipas parashtruesve, kishte rezultuar me shkeljen e të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenet 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

Gjykata Kushtetuese së pari shpjegoi se kush është palë e autorizuar sipas Kushtetutës për të ngritur çështjen e interpretimit të kuorumit në Kuvendin e Kosovës, dhe pastaj vlerësoi se parashtruesit e kërkesës nuk janë palë të autorizuara përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 80.1 të Kushtetutës. Ndërsa, sa i përket pretendimeve për shkeljen e nenit 49 dhe nenit 54 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesit e kërkesës vetëm kanë numëruar dhe përshkruar përmbajtjen e dispozitave kushtetuese dhe nuk kanë paraqitur argumente bindëse për t'i mbështetur pretendimet e tyre. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar, siç përcaktohet me nenin 113.1 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullat 36 (1) a) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI109/14
Parashtrues
Ahmet Krasniqi *et al.*
Vlerësim i kushtetutshmërisë
së konkluzionit të Kuvendit bazuar në transkriptin e seancës plenare të 10, 11 dhe 17 prillit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar,
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Ahmet Krasniqi, Halit Shabani, Ramë Manaj dhe Arbnor Kastrati (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës). Në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), ata përfaqësohen nga parashtruesi i parë i kërkesës, z. Ahmet Krasniqi me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës nuk kontestojnë asnjë vendim të veçantë, në vend të kësaj, ata kontestojnë veprimet e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi) z. Sabri Hamiti, gjatë seancës plenare të Kuvendit më 10, 11 dhe 17 prill 2014, kur ai konkludoi se nuk kishte kuorum të nevojshëm për të votuar për përbërjen e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KMK).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së veprimeve të nënkryetarit të Kuvendit gjatë seancës plenare të Kuvendit më 10, 11

dhe 17 prill 2014, kur ai konkludoi se nuk kishte kuorum të nevojshëm për të votuar përbërjen e KMK-së. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se konkluzioni i z. Sabri Hamiti se nuk kishte kuorum për marrje të vendimit është një zbatim i gabuar dhe shkelje e nenit 80, paragrafi 1 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se kjo rezultoi në shkelje thelbësore të të drejtave të njeriut në bazë të nenit 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenit 54 të Kushtetutës [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 qershor 2014, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 7 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI109/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI109/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

7. Më 4 shtator 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 13 tetor 2014, parashtruesit e kërkesës dorëzuan dokumente shtesë në Gjykatë, të cilat ofruan një elaborim më të hollësishëm dhe më të gjerë të kërkesës ekzistuese, të dorëzuar më 27 qershor 2014.

9. Më 2 shkurt 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 19 shkurt 2014, Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Qeveria) miratoi Vendimin 02/171 me të cilin i ishin propozuar Kuvendit emrat e kryesuesit dhe anëtarëve të tjerë të KMK-

së: Ahmet Krasniqi (kryesues) dhe Halit Shabani, Ramë Manaj dhe Arbnor Kastrati (anëtarë).

11. Më 10, 11 dhe 17 prill 2014, Kuvendi mbajti seancën e tij të rregullt plenare, në të cilën si pikë e rendit të ditës, ndër të tjera, ishte shqyrtimi i propozim/vendimit të Qeverisë për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve tjerë të KMK-së. Kur propozim/vendimi ishte vënë në votim, nënkryetari i Kuvendit konkludoi se *"tash të pranishëm janë 82 deputetë krejt. Kemi votimin: 7 kundër, 36 për dhe 1 abstenim. Nuk ka kuorum për vendimmarrje."*

12. Më 19 maj 2014, parashtruesit dorëzuan kërkesë në Drejtorinë e përgjithshme për çështje ligjore dhe procedurale të Kuvendit, për interpretimin e votimit të propozim/vendimit të Qeverisë nga Kuvendi.

13. Më 21 maj 2014, Drejtori i Drejtorisë së përgjithshme për çështje ligjore dhe procedurale të Kuvendit iu përgjigj parashtruesve të kërkesës përmes një letre, në të cilën ai deklaroi:

    "Drejtoria e përgjithshme për çështje ligjore dhe procedurale, nuk është e autorizuar të bëjë interpretimin e votimit të seancës plenare.

    Për dijeninë e juaj, Kuvendi është shpërndarë më 7 maj 2014. Sipas Rregullores së Kuvendit, të gjitha çështjet që kanë mbetë në procedurë duhet të ri-procedohen nga propozuesi".

14. Më 21 maj 2014, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë edhe në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMK) *"në çështjen juridike "kontestim i vendimmarrjes", kundër Kuvendit të Republikës së Kosovës".*

15. Më 22 maj 2014, KPM-ja nxori Vendimin A/02/212/2014, duke shpallur veten jo kompetent që të vendosë lidhur me këtë çështje. KPM-ja konstatoi se:

    "Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të kësaj çështje konstatoi se Këshilli nuk është kompetent për ta shqyrtuar këtë çështje administrative sepse sipas nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-1 49 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës " Zyrtarët e zgjedhur ne pozita zgjedhëse në institucionet e administratës publike dhe zyrtarët e emëruar nga zyrtarët e zgjedhur në pozita të caktuara nuk janë nëpunës civil" si dhe mbështetur në nenin 10 paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 031 L -192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli ka kompetencë

që të "shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civilë kundër vendimeve të organit të punësimit në të gjitha institucionet e Shërbimit Civil në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara ne Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës".

16. Më 23 maj 2014, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Institucionin e Avokatit të Popullit *"Ankesë kundër shkeljes së të drejtës Kushtetuese me rastin e votimit lidhur me Propozim Vendimin për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës".*

17. Më 9 qershor 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit u dërgoi parashtruesve të kërkesës Njoftimin për papranueshmëri, në të cilin thuhet:

"[...] Avokati i Popullit vëren se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesën për ngritjen në Gjykatën Kushtetuese të çështjes së vlerësimit të kushtetutshmërisë në lidhje vendim-marrjen në seancën e Kuvendit [...]. Avokati i Popullit kujton se Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Avokati i Popullit e sheh të nevojshme që t'i referohet nenit 113 të Kushtetutës (Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i cili e legjitimon Avokati i Popullit që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, por vetëm për rastet si në vijim:

(1) Çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;

(2) Përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.

Në këto rrethana, Avokati i Popullit konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës me të cilën kontestohet vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk mund të procedohet në Gjykatë Kushtetuese, pasi që ,Avokati i Popullit nuk legjitimohet si palë e autorizuar për këtë çështje, në pajtueshmëri me nenin 113.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. [...]"

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se konkluzioni i z. Sabri Hamiti se nuk ka pasur kuorum për të nxjerrë vendim është zbatim i gabuar dhe shkelje e nenit 80, paragrafi 1 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës, i cili thotë si në vijim:

"Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë".

19. Sipas parashtruesve të kërkesës, numërimi i gabuar i kuorumit të nevojshëm kishte rezultuar në *"shkelje elementare e të drejtave të njeriut bazuar në nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, (e drejta e punës dhe ushtrimit te profesionit) dhe nenit 54 të Kushtetutës, (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave)".*

20. Parashtruesit e kërkesës më tej pretendojnë se*"[...] neni, 51. pika 3. paragrafi i dytë i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës thot citojmë "Vendimet e Mbledhjeve te Kuvendit janë të vlefshme në qoftë se në kohën kur ato janë marrë, në SALLË kanë qenë më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit. Ligjet, vendimet dhe aktet tjera të Kuvendit konsiderohen të miratuara nëse për to votojnë shumica e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë".*

21. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës më tej pretendojnë se "*Kushtetuta, e as Rregullorja e Punës së Kuvendit nuk bën dallim në mes të kuorumit për punë dhe kuorumit për vendimmarrje që do të thotë, se nëse në sallë janë të pranishëm 61 deputet, Kuvendi mund të zhvilloj seancë dhe të marrë vendime nëse nuk është ndryshe e përcaktuar me Kushtetutë [...]".*

22. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë më tej se *"Konstatimi* i *Kryesuesit z. Sabri Hamiti se* në *sallë prezent janë* 82 *deputet dhe se nuk ka kuorum për vendim-marrje bien ne kundërshtim me vetveten dhe me rregullat e përgjithshme, sepse nëse nuk ka kuorum seanca nuk do të mund të vazhdohej. Në rastin konkret seanca ka vazhduar dhe është hedhë ne votim. nëse deputeti nuk voton as për as kundër dhe është prezent konsiderohet* që *ka abstenua për ndryshe askund në dispozita të Kushtetutës dhe te Rregullores nuk përcaktohet* që *nëse deputeti është në sallë prezent mund të konsiderohet se nuk është."*

23. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata:

    i. *"Për këtë çështje Gjykata ta marr në shqyrtim dhe me aktgjykim të vendosë sipas dispozitave kushtetuese në fuqi;*

    ii. *Të jap interpretim të qartë se* çfarë *do të thotë kuorum dhe cila është shumica e thjeshtë dhe absolute;*

    iii. *Të bëj interpretimin* e *abstenimit nga votimi;*

iv. Të bëj interpretimin e numrit të votave për marrjen e një vendimi në Kuvend".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë në Gjykatë, në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës.

Neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

A. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 80.1 të Kushtetutës

25. Gjykata vëren se në rastin në fjalë, parashtruesit e kërkesës kërkojnë, *inter alia*, interpretimin e nenit 80.1 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se, në bazë të nenit 112.1 të Kushtetutës, ajo është "Gjykata Kushtetuese është *autoriteti përfundimtar për* interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën". Megjithatë, Gjykata ka autoritet të interpretojë Kushtetutën vetëm në qoftë se kërkesa është parashtruar nga një palë e autorizuar.

27. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës e parashtruan kërkesën e tyre në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, ata nuk e kontestojnë ndonjë vendim përfundimtar nga ndonjë autoritet publik. Në vend të kësaj, ata kërkojnë një interpretim nga Gjykata në lidhje me nenin 80.1 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës, për të qartësuar se çfarë do të thotë "*kuorumi* i nevojshëm për miratimin e një vendimi në Kuvend".

28. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se neni 113.5 i Kushtetutës parasheh dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.

29. Përveç kësaj, pas shpalljes së ligjit, neni 113.2 (1) autorizon Kuvendin e Kosovës, Presidentin e Republikës së Kosovës, Qeverinë dhe Avokatin

e Popullit të ngrenë çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën në Gjykatë.

30. Në fund, neni 113.8 i Kushtetutës parasheh që *"Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë".*

31. Kështu, Gjykata konkludon se kjo ankesë e parashtruesve të kërkesës nuk hyn në fushëveprimin e asnjërit prej neneve të lartpërmendura të Kushtetutës. Prandaj, parashtruesit e kërkesës nuk janë palë e autorizuar sipas Kushtetutës që të referojnë këtë çështje në Gjykatë. (Shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese, Rasti nr. KI207/13, parashtruesit e kërkesës Rexhep Kabashi et al., Aktvendim për papranueshmëri i 24 prillit 2014).

32. Rrjedhimisht, kjo pjese e kërkesës është e papranueshme, në bazë të nenit 113.1 të Kushtetutës.

B. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 49 dhe 54 të Kushtetutës

33. Gjykata më tej vëren se, parashtruesit e kërkesës gjithashtu i referohen nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], duke u ankuar në llogaritjen gabuar të kuorumit nga nënkryetari i Kuvendit, e cila rezultoi me shkelje të këtyre neneve.

34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenin 49 i cili parasheh:

"1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës" .

Neni 54 parasheh:

"Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur".

35. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës vetëm kanë numëruar dhe përshkruar përmbajtjen e dispozitave kushtetuese që garantojnë të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit dhe mbrojtjen gjyqësore të të drejtave. Megjithatë, ata nuk kanë paraqitur në mënyrë të qartë se si dhe pse këto të drejta janë shkelur.

36. Gjykata rithekson se pakënaqësia me vendimin ose thjesht përmendja e neneve dhe dispozitave të Kushtetutës nuk mjaftojnë që parashtruesi i kërkesës të pretendojë një shkelje kushtetuese. Kur pretendohet një shkelje e tillë, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë argumente bindëse dhe të pakontestueshme që të mbështesë pretendimet në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar (Shih Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KI198/13, parashtrues i kërkesës Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendim për papranueshmëri i 13 marsit 2014).

37. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur asnjë argument bindës për të vërtetuar se shkeljet e pretenduara të përmendura në kërkesë paraqesin shkelje kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Aktvendim për papranueshmëri, nr. 53363/99, i 31 majit 2005) dhe nuk kanë specifikuar se si nenet e përmendura të Kushtetutës mbështesin pretendimet e tyre, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) a) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës, më 2 shkurt 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën :

Nr.64. Në lidhje me pretendimet në pikën A), të papranueshme, sepse parashtruesit e kërkesës nuk janë palë e autorizuar për të kërkuar interpretimin e dispozite kushtetuese;

Nr.65. Në lidhje me pretendimet në pikën B), të papranueshme sepse parashtruesit e kërkesës nuk e kanë mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tyre.

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KO13/15, Kuvendi i Republikës së Kosovës, vlerësimi i një amendamenti të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga pesëdhjetë e pesë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe të referuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 6 shkurt 2015 me shkresën nr. 05-259/D0-179.

KO13/15, Aktgjykim i 10 marsit 2015, publikuar më 16 mars 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë institucionale, procedurë kushtetuese, kontroll preventiv kushtetues, parimi i barazisë gjinore, përparësi automatike, të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II dhe III të Kushtetutës*

Më 6 shkurt 2015, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës në pajtim me nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës i referoi Gjykatës Kushtetuese një amendament të propozuar nga 55 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Amendamenti i propozuar përcaktonte se asnjëra nga gjinitë nuk mund të përfaqësohet më pak se në masën 40% në postet e ministrave dhe zëvendësministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi paraprak nga Gjykata Kushtetuese që amendamenti i propozuar i Kushtetutës, nuk pakëson asnjë nga të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi së pari kriteret procedurale dhe konstatoi se ka juridiksion për ta gjykuar rastin, dhe se kërkesa është dorëzuar nga pala e autorizuar. Për sa i përket çështjes, nëse amendamenti i propozuar pakëson të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me kapitullin II dhe III të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese u shpreh ndër të tjera se: (i) duhet zbatuar parimin e mundësive të barabarta të të dyja gjinive, (ii) praktika kushtetuese nuk përcakton ndonjë formë të diskriminimit pozitiv, (iii) përparësia nuk mund të jepet pa kusht në baza gjinore pavarësisht kritereve të meritave profesionale, dhe (iv) deputetët nuk kanë ofruar ndonjë dëshmi që mbështetë pretendimin e tyre për diskriminim të rëndë gjinor. Gjykata Kushtetuese ndër të tjera mbështeti konstatimet e saj duke u bazuar në formulimet e kushtetutave të shteteve tjera, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe Këshillit Kushtetues të Francës. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se amendamenti i propozuar pakëson të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me kapitullin II dhe III të Kushtetutës si dhe shkronjën dhe frymën e saj, dhe rrjedhimisht, nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

AKTGJYKIM
në
Rastin nr. KO13/15
Vlerësim i një amendamenti të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga pesëdhjetë e pesë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe të referuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 6 shkurt 2015 me shkresën nr. 05-259/DO-179

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Më 6 shkurt 2015, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), në pajtim me nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), i referoi Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) një amendament të Kushtetutës, të propozuar nga 55 (pesëdhjetë e pesë) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: deputetët).

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi paraprak nga Gjykata që amendamenti i propozuar i Kushtetutës nuk pakëson asnjë nga të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës, në pajtim me nenin 113.9 të Kushtetutës.

3. Amendamenti i propozuar është për një paragraf të ri, 8 në nenin 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve]. Aty thuhet: *"8. Asnjëra nga gjinitë nuk mund të përfaqësohet më pak se në masën 40% në postet e ministrave dhe të zëvendësministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës"*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës dhe në nenet 20 dhe 54 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatë

5. Më 6 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës ia referoi Gjykatës amendamentin.

6. Më 6 shkurt 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KO13/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KO13/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 10 shkurt 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të ofronte një listë gjithëpërfshirëse me të gjithë emrat e deputetëve dhe me nënshkrimet e tyre. Gjykata, po ashtu, kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që t'i ofronte një kopje të njoftimit secilit prej deputetëve që kishin nënshkruar kërkesën dhe, nëse dëshironin, të dorëzonin komente shtesë.

8. Më 10 shkurt 2015, një kopje e kërkesës iu dërgua Presidentes së Republikës së Kosovës, Kryeministrit dhe Avokatit të Popullit.

9. Më 13 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi listën e kërkuar, të nënshkruar nga këta deputetë: Alma Lama, Shpejtim Bulliqi, Emilija Redžepi, Veton Berisha, Teuta Sahatqija, Doruntinë Maloku, Vjosa Osmani, Lirije Kajtazi, Synavere Rysha, Besa Gaxherri, Njomza Emini, Shaip Muja, Armend Zemaj, Anton Quni, Agim Kikaj, Fatmir Limaj, Valdete Bajrami, Shukrije Bytyqi, Haxhi Shala, Zafir Berisha, Sala Berisha Shala, Luljeta Veselaj Gotaj, Nait Hasani, Melihate Tërmkolli, Fadil Beka, Teuta Haxhiu, Fikrim Damka, Müfera Şinik, Time Kadrijaj, Puhie Demaku, Aida Dërguti, Shqipe Pantina, Besa Baftija, Mexhide Mjaku Topalli, Xhevahire Izmaku, Nuredin Ibishi, Ganimete Musliu, Pal Lekaj, Rexhep Selimi, Bekim Haxhiu, Kujtim Pacaku, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Enver Hoti, Mytaher Haskuka, Fisnik Ismaili, Glauk Konjufca, Berta Deliu Kodra, Blerim Grainca, Blerim Shala, Labinote Demi Murtezi, Naser Osmani, Hatim Baxhaku, Ilir Deda, Teuta Rugova.

10. Deputetët nuk dorëzuan asnjë koment si përgjigje ndaj njoftimit të Gjykatës, të 10 shkurtit 2015.

11. Më 10 mars 2015, gjyqtari raportues i paraqiti raportin Kolegjit shqyrtues. Kolegji shqyrtues e mbështeti atë dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që ta deklarojë kërkesën të pranueshme për shqyrtim dhe të deklarojë se amendamenti i propozuar pakëson të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II dhe me Kapitullin III të Kushtetutës, si dhe me shkronjën dhe frymën e saj, siç përcaktohet në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

12. Të njëjtën ditë, Gjykata mbajti këshillim dhe votoi për rastin.

13. Gjyqtari Kadri Kryeziu nuk mori pjesë në procedurat e Gjykatës dhe në marrjen e vendimit për rastin e tanishëm KO13/15, në bazë të vendimit KK124/14, të 19 gushtit 2014.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 29 dhjetor 2014, deputetët, në pajtim me nenin 144 [Amendamentimi], paragrafi 1 i Kushtetutës, i propozuan Kryetarit të Kuvendit një amendament të Kushtetutës.

15. Më 6 shkurt 2015, Kryetari i Kuvendit i referoi Gjykatës amendamentin e Kushtetutës, duke kërkuar nga Gjykata të bëjë vlerësim paraprak nëse amendamenti i propozuar pakëson ndonjë të drejtë dhe liri të përcaktuar me Kapitullin II të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Në mënyrë që të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj.

17. Së pari, Gjykata duhet të përcaktojë nëse kërkesa është dorëzuar nga një palë e autorizuar dhe, së dyti, duhet të përcaktojë nëse ka juridiksion për të vlerësuar amendamentin e Kushtetutës, të propozuar nga deputetët, në pajtim me nenin 113.9 të Kushtetutës.

18. Gjykata rikujton se, në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës, *"Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara [...]"*.

19. Gjykata vëren se Kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, referoi amendamentin e propozuar dhe, prandaj, kërkesa është dorëzuar nga pala e autorizuar në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës.

20. Më tej, Gjykata rikujton se, në bazë të nenit 113.9, ajo duhet *"[...] të konstatojë nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës"*.

21. Rrjedhimisht, Gjykata ka juridiksion për të vlerësuar nëse amendamenti i propozuar zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

22. Kështu, pasi që kërkesa është referuar nga pala e autorizuar dhe pasi që Gjykata ka juridiksion ta gjykojë rastin, kërkesa është e pranueshme.

Fushëveprimi i vlerësimit

23. Fushëveprimi i vlerësimit të amendamentit të propozuar bazohet në Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore], në Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] dhe në shkronjën e frymën e Kushtetutës (Shih rastet nr. KO29/12 dhe KO48/12, parashtrues i kërkesës: *Kryetari i Kuvendit i Republikës së Kosovës,* Aktgjykim i 20 korrikut 2012; shih, gjithashtu Rastin nr. KO61/12, parashtrues i kërkesës: *Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,* Aktgjykim i 31 tetorit 2012).

24. Gjykata, gjithashtu, konsideron se neni 21 [Parimet e Përgjithshme] i Kushtetutës duhet të lexohet në lidhje me nenin 7 [Vlerat], paragrafi 1, të Kushtetutës. Neni i fundit i përmendur përkufizon vlerat e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës që bazohen *"në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut"*.

Amendamenti i propozuar: paragrafi i ri 8, i nenit 96, të Kushtetutës

25. Amendamenti propozohet të jetë një paragraf i ri pas paragrafit 7 të nenit 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës, ku thuhet:

> *"8. Asnjëra nga gjinitë nuk mund të përfaqësohet më pak se në masën 40% në postet e ministrave dhe të zëvendësministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës"*.

Arsyet për amendamentin e propozuar

26. Deputetët pretendojnë se, deri më tani, gratë në qeveritë e pasluftës nuk janë përfaqësuar më shumë se në masën 10-15% në postet ministrore, edhe pse raporti gra/burra i popullsisë është 50% me 50%. Në bazë të kësaj, ato/ata konsiderojnë se është *"[...] e domosdoshme futja e kuotës gjinore edhe në pushtetin ekzekutiv, si mekanizëm afirmativ për ndryshimin e gjendjes së rëndë të diskriminimit"*. Sipas tyre, neni 24 [Barazia para Ligjit], paragrafi 3, i Kushtetutës arsyeton masat afirmative që duhet të merren ndaj "*grupeve më pak të përfaqësuara"*.

27. Deputetët janë të mendimit se imponimi i kuotës gjinore në Kushtetutë përbën një obligim që nuk mund të anashkalohet nga Qeveria dhe i cili është i ngjashëm me garancitë që Kushtetuta e Kosovës ua ofron minoriteteve.

28. Sipas deputetëve, eksperienca negative e mosimplementimit të Ligjit për barazi gjinore, Nr. 2004/2, të 19 shkurtit 2004, i cili përfshin të gjitha institucionet dhe organet udhëheqëse, është një arsye tjetër që kjo normë të bëhet normë kushtetuese dhe që Kushtetuta duhet të jetë garantuese e barazisë gjinore.

29. Deputetët, më tej, konsiderojnë se amendamenti i propozuar është në përputhje me objektivat e Rezolutës Nr. 04-R-09 të Kuvendit të Kosovës, të miratuar më 20 dhjetor 2012. Rezoluta mban titullin: *Parimet e Prishtinës nga Samiti Ndërkombëtar i Gruas: "Partneriteti për Ndryshim-Fuqizimin e Gruas"*, të mbajtur më 4-6 tetor 2012. Ato/ata citojnë paragrafin 4 të Rezolutës ku thuhet:

> *"4. Inkurajon institucionet e Republikës së Kosovës që të ndërmarrim veprime konkrete dhe të vendosin partneritete me institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare për të përmbushur objektivin e pjesëmarrjes së gruas në shërbimin civil deri në pesëdhjetë për qind deri në vitin 2050".*

Vlerësimi i amendamentit të propozuar

30. Amendamenti i propozuar do të shqyrtohet nga Gjykata në pajtim me fushëveprimin e vlerësimit të përkufizuar më lart.

31. Gjykata vëren se amendamenti i propozuar në nenin 96 të Kushtetutës përmban dy elemente. Elementi i parë është që ta futë kuotën gjinore prej 40% (dyzet për qind), e cila, sipas deputetëve, është e barasvlershme me përfaqësimin proporcional të popullatës. Elementi i

dytë ka të bëjë me kuotën prej 40% (dyzet për qind), të aplikueshme vetëm në postet ministrore dhe zëvendësministrore në Qeveri.

32. Gjykata më tej vëren se amendamenti i propozuar, siç arsyetohet nga deputetët, mund të konsiderohet të jetë formë e kualifikuar e diskriminimit pozitiv ose e veprimit afirmativ, me ç'rast grave u jepet përparësi në mënyrë automatike dhe pa kushte, pavarësisht kriterit të kualifikimeve profesionale.

33. Përveç kësaj, natyra e diskriminimit pozitiv ose e veprimit afirmativ, në përgjithësi, është e përkohshme, derisa të jetë arritur një qëllim i caktuar, sipas nenit 24.3 të Kushtetutës. Në anën tjetër, një normë kushtetuese perceptohet si diçka e natyrës së përhershme, me qëllim që të sigurojë një rend të qëndrueshëm kushtetues dhe juridik. Kjo është në harmoni me parimin e sigurisë juridike.

34. Gjykata, po ashtu, vëren se fushëveprimi i nenit të tanishëm 96 të Kushtetutës përfshin komunitetet joshumicë, siç janë ai *"serb, rom, ashkali, egjiptian, boshnjak, turk, goran dhe pjesëtarët e tyre"*, që qartazi përfshijnë pjesëtarët meshkuj dhe femra.

35. Prandaj, amendamenti i propozuar duhet të shqyrtohet në kontekstin e të drejtave të këtyre komuniteteve, të garantuara me Kushtetutë.

36. Siç u përmend më lart, fushëveprimi i zbatimit të amendamentit të propozuar aplikohet vetëm për postet ministrore dhe për ato zëvendësministrore brenda Qeverisë.

37. Gjykata thekson se përderisa Kapitulli I [Dispozitat Themelore] i Kushtetutës definon strukturën e shtetit të Republikës së Kosovës dhe vlerat e saj, neni 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 2, i Kushtetutës përcakton: "*Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre*". Prandaj, vetë organet shtetërore duhet të krijojnë mekanizma përkatës për realizimin e të drejtave të garantuara të qytetarëve.

38. Gjykata, gjithashtu, rikujton se neni 7 [Vlerat] i Kushtetutës, parasheh veçanërisht:

> *"1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës*

së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore".

39. Nga dispozitat e mësipërme rrjedh se barazia, mosdiskriminimi dhe barazia gjinore, inter alia, janë pjesë e rendit kushtetues dhe përbëjnë themelin demokratik të shoqërisë së Kosovës. Zbatimi i tyre praktik është me rëndësi jetike për zhvillimin e demokracisë.

40. Në mënyrë që të bëhet vlerësimi i plotë i amendamentit të propozuar, Gjykata gjithashtu merr parasysh instrumentet ndërkombëtare, të parapara në nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

41. Neni 22 i Kushtetutës parasheh:

"Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

(3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;

[...]

(6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;

[...]"

42. Marrëveshjet dhe instrumentet e lartpërmendura ndërkombëtare, që garantojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, përfshirë parimin e barazisë, janë pjesë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

43. Gjykata rithekson se parimi i barazisë është një nga parimet themelore të sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës dhe garanton barazinë gjinore të të gjithë qytetarëve në rendin e saj kushtetues dhe ligjor.

44. Në Kushtetutë ka edhe referenca të tjera në barazinë gjinore, për shembull:

a) në nenin 71 [Kualifikimet dhe Barazia Gjinore], paragrafi 2, të Kushtetutës: *"Përbërja e Kuvendit të Kosovës do të respektojë parimet e barazisë gjinore të cilat janë të pranuara në pajtim me parimet ndërkombëtare";*

b) në nenin 101 [Shërbimi Civil], paragrafi 1, të Kushtetutës: *"Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht";*

c) në nenin 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve], paragrafi 2, të Kushtetutës: *"Përbërja e gjyqësorit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Kosovës dhe parimet e pranuara ndërkombëtarisht të barazisë gjinore";*

ç) në nenin 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës], paragrafi 2, të Kushtetutës: *"[...] Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale e të paanshme, dhe të pasqyrojnë plotësisht natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës e të ndjekin parimet e barazisë gjinore. Këshilli do t'u japë përparësi për emërim si gjyqtarë, anëtarëve të komuniteteve të nën përfaqësuara në mënyrën e përcaktuar me ligj";*

d) në nenin 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës], paragrafi 4, të Kushtetutës: *"Propozimet për emërimin e gjyqtarëve duhet të bëhen në bazë të procesit të hapur për emërime, në bazë të meritave të kandidatëve, dhe ky propozim pasqyron parimin e barazisë gjinore dhe përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse. Të gjithë kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj";*

dh) në nenin 109 [Prokurori i Shtetit], paragrafi 4, të Kushtetutës: *"Prokurori i Shtetit pasqyron përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe respekton parimet e barazisë gjinore";*

e) në nenin 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës], paragrafi 1, të Kushtetutës: *"[...] Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë personat në Kosovë. Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, profesional, i paanshëm dhe pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore";*

ë) në nenin 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës], paragrafi 3, të Kushtetutës: *"Propozimet për emërimin e prokurorëve duhet të bëhen në bazë të procesit të hapur për emërime, në bazë të meritave të kandidatëve, dhe ky propozim pasqyron parimin e barazisë gjinore dhe përbërjen etnike të juridiksionit territorial përkatës";* dhe

f) në nenin 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese], paragrafi 1, të Kushtetutës: *"[...] Parimet e barazisë gjinore do të respektohen".*

45. Garancitë e lartpërmendura kushtetuese të barazisë gjinore janë në linjë me shumë kushtetuta të vendeve demokratike dhe me instrumente e rekomandime ndërkombëtare.

46. Në këtë drejtim, Kushtetuta e Republikës së Bullgarisë, në nenin 6 (2) parasheh: *"[...] Nuk ka privilegje dhe kufizime mbi bazën e racës, kombësisë, vetidentitetit etnik, gjinisë, origjinës, religjionit, arsimimit, mendimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror ose statusit të pronës*".

47. Kushtetuta e Republikës së Qipros, në nenin 28 (2), parasheh: "*Secili person gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parapara me këtë Kushtetutë pa asnjë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj ndonjë personi mbi bazën e komunitetit, racës, religjionit, gjuhës, gjinisë, bindjeve politike dhe të tjera, prejardhjes kombëtare apo sociale, lindjes, ngjyrës, pasurisë, klasës shoqërore, apo mbi çfarëdo baze tjetër, përveç shprehimisht nëse është përcaktuar ndryshe në këtë Kushtetutë*".

48. Kushtetuta e Republikës së Çekisë përfshin konceptin e barazisë dhe parimin e mosdiskriminimit në nenin 3 të saj [Karta e të Drejtave dhe Lirive Themelore], ku thuhet: "*Secilit i garantohet gëzimi i të drejtave dhe lirive themelore pa dallim të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, besimit dhe religjionit, bindjeve politike dhe të tjera, prejardhjes kombëtare dhe sociale, të qenit pjesëtar i një pakice nacionale apo etnike, pronës, lindjes ose statusit tjetër".*

49. Kushtetuta e Republikës së Letonisë, në nenin e saj 91, në një pjesë të saj parasheh: "*Të drejtat e njeriut realizohen pa diskriminim të çfarëdo lloji*".

50. Kushtetuta e Republikës së Sllovakisë, në nenin e saj 12, paragrafi 2, thotë si në vijim: "*Të drejtat dhe liritë themelore i garantohen secilit në territorin e Republikës Sllovake pavarësisht gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, besimit dhe religjionit, përkatësisë politike ose bindjeve tjera, prejardhjes nacionale ose sociale, kombësisë dhe prejardhjes etnike, pronës, prejardhjes, ose statusit tjetër. Askush nuk mund të dëmtohet, preferohet ose diskriminohet mbi këto baza*".

51. Kushtetuta e Republikës së Sllovenisë, në nenin 14, përcakton që secilit i garantohen barabar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore pa dallim të prejardhjes nacionale, racës, gjinisë, gjuhës, religjionit, bindjeve politike dhe të tjera, gjendjes materiale, lindjes, arsimimit, statusit social, aftësisë së kufizuar ose çfarëdo rrethane tjetër personale.

52. Përveç kësaj, Gjykata i referohet Rekomandimit Rec. (2003)3 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për "*Pjesëmarrjen e barabartë të femrave dhe meshkujve në sjelljen e vendimeve politike dhe publike*" (Miratuar nga Komiteti i Ministrave, më 12 mars 2003, në mbledhjen e 831-të të zëvendësministrave). Në Kapitullin e tij për Masat Legjislative dhe Administrative, ndër të tjera, ai parasheh:

"Vendet anëtare duhet:

a. Të marrin parasysh ndryshime kushtetuese dhe/ose legjislative, përfshirë masat e veprimit pozitiv, të cilat do të lehtësonin një pjesëmarrje më të baraspeshuar të meshkujve dhe femrave në vendimmarrjen politike dhe publike;

b. Të marrin parasysh miratimin e reformave legjislative për të vendosur pragje të barazisë për kandidatë në zgjedhjet e nivelit lokal, rajonal, nacional dhe supranacional. Aty ku ka lista proporcionale të merret parasysh vendosja e sistemit ziper (sistemi zik-zak);

c. Të marrin parasysh veprime ku nëpërmjet financimit publik të partive politike, ato inkurajohen për të promovuar barazinë gjinore;

ç. Atje ku është treguar se sistemet zgjedhore kanë ndikim negativ në përfaqësimin politik të femrave në organet e zgjedhura, duhet t'i përshtatin dhe reformojnë ato sisteme

me qëllim që të promovohet përfaqësimi i baraspeshuar gjinor;

d. Të marrin parasysh miratimin e masave legjislative dhe/ose administrative për t'u siguruar që ekziston përfaqësim i baraspeshuar gjinor në tërë emërimet e bëra nga një ministër apo nga qeveria në komisionet publike;

dh. Të sigurojnë se do të ketë përfaqësim të baraspeshuar gjinor në pozita ose funksione bartësit e të cilave emërohen nga qeveria ose autoritete tjera publike;

e. Të sigurojnë që proceset e përzgjedhjes, rekrutimit dhe emërimit për pozitat udhëheqëse në vendimmarrjen publike kanë parasysh gjininë dhe janë transparente;

ë. Të marrin parasysh masa legjislative dhe/ose administrative me qëllim të inkurajimit dhe të përkrahjes së punëdhënësve ashtu që ata të lejojnë personat që marrin pjesë vendimmarrje politike dhe publike, të kenë të drejtë të marrin kohë të lira nga puna, pa u ndëshkuar;

f. Të inkurajojnë parlamentet në të gjitha nivelet që të themelojnë komisione parlamentare ose delegacione për të drejtat e grave dhe mundësi të barabarta dhe të zbatojnë trendet kryesore gjinore në tërë punën e tyre".

53. Siç shihet nga referencat e lartpërmendura, Kushtetuta e Republikës së Kosovës në mënyrë të barabartë përmban garancitë e njohura ndërkombëtarisht për barazinë gjinore.

54. Bazuar në këtë, Gjykata konsideron se me futjen e kuotës së ndërlidhur me gjininë për postet ministrore dhe zëvendësministrore, amendamenti i propozuar ngushton zbatueshmërinë e garancive kushtetuese për barazinë gjinore. Prandaj, ai pakëson të drejtat për një pjesëmarrje më të baraspeshuar në organet publike.

55. Për më tepër, duhet të merret parasysh edhe neni 96, paragrafi 6, i Kushtetutës. Kjo dispozitë thekson në mënyrë të qartë se ministrat, në radhë të parë, mund të zgjidhen nga radhët e deputetëve të Kuvendit. Prandaj, deputetët e Kuvendit mund të aplikojnë parimin e barazisë gjinore dhe përfaqësimin proporcional përderisa votojnë për pozicionet ministrore. Kuvendi vetë përbën një njësi me prani të ndryshme gjinore. Së dyti, neni 96 parasheh mundësinë që ministrat të zgjidhen nga njerëz të kualifikuar, të cilët nuk janë deputetë të Kuvendit, përkatësisht, të bëhen nominime të bazuara në merita.

56. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se përbërja e Qeverisë reflekton vullnetin politik të Kuvendit, pa marrë parasysh nëse ministrat e zëvendësministrat janë figura publike, ose persona të kualifikuar.

57. Një rregullim kushtetues i kuotës gjinore për pozicionet ministrore dhe zëvendësministrore mundet më tej, në praktikë, të shndërrohet në një zëvendësim formal të një personi të gjinisë së njëjtë që mund t'i zvogëlojë të drejtat e njerëzve të tjerë, qoftë deputetë ose persona të kualifikuar, për t'u bërë pjesë e Qeverisë.

58. Gjykata Evropiane e Drejtësisë (Shih Rastin C-409/95, *Kalanke c Freie Hanstadt Bremen* (1995), Vendimi i 17 tetorit 1995), shqyrtoi një dispozitë të Shtetit të Bremenit, sipas së cilës grave duhej dhënë përparësi ndaj kandidatëve meshkuj me kualifikime të barabarta me rastin e avancimit në një sektor ku gratë ishin të nënpërfaqësuara. Gjykata Evropiane e Drejtësisë vendosi që, dispozita që u jepte grave përparësi absolute ndaj meshkujve për punësim ose për avancim, nuk përfshihet në qëllimin për mundësi të barabarta të përqafuar nga Direktiva 76/207 EEC. Problemi ishte se ligji i Shtetit të Bremenit, për dallim nga ligjet e ngjashme gjermane, nuk linte të hapur mundësinë për përjashtime përballë karakteristikave specifike të kandidatit që mund të jenë relevante për pozitën.

59. Gjithashtu, Këshilli Kushtetues i Francës, në një vendim të vitit 1982, refuzoi si jokushtetues një propozim për të kufizuar përqindjen maksimale të cilësdo gjini në listat e kandidatëve për zgjedhje lokale në 75 për qind. Këshilli konsideroi se kuotat binin ndesh me parimet kushtetuese të barazisë dhe të universalitetit që ndalonin çdo ndarje në kategori të zgjedhësve dhe të personave që do të zgjedhen.

60. Në bazë të shembujve të lartpërmendur, Gjykata vëren, *inter alia,* se nuk është praktikë e zakonshme ekzistimi i dispozitave kushtetuese që rregullojnë pjesëmarrjen në organe publike nëpërmjet kuotave gjinore. Në të vërtetë, duhet të zbatohet parimi i mundësive të barabarta, edhe të grave e edhe të burrave. Praktika kushtetuese nuk përcakton një formë të kualifikuar të diskriminimit pozitiv, ku përparësia jepet automatikisht dhe pa kusht në baza gjinore, pavarësisht kritereve të meritës profesionale.

61. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se deputetët nuk kanë dorëzuar ndonjë dëshmi mbështetëse që tregon se garancitë e tanishme kushtetuese të parimit të barazisë gjinore janë të pamjaftueshme për të garantuar barazinë gjinore dhe përbëjnë *"një situatë të rëndë të diskriminimit"*. Në të vërtetë, barra e të provuarit bie mbi deputetët, të cilët nuk kanë paraqitur ndonjë argument të arsyetuar dhe ndonjë provë relevante.

62. Deputetët konsiderojnë se eksperienca negative e mosimplementimit të Ligjit për barazi gjinore, Nr. 2004/2, të 19 shkurtit 2004, i cili përfshin të gjitha institucionet dhe organet udhëheqëse, është një arsye tjetër që kjo normë të bëhet dispozitë kushtetuese dhe që Kushtetuta të jetë garantuese e barazisë gjinore.

63. Përkitazi më këtë, Gjykata dëshiron t'i referohet nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafi 4, të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar".*

64. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata vëren se përgjegjësia për implementimin e Ligjit për barazinë gjinore, Nr. 2004/2, bie mbi Qeverinë, e cila i nënshtrohet kontrollit nga Kuvendi, por ajo përsërit se është Kuvendi ai që voton dhe e zgjedh Qeverinë.

65. Për më tepër, Gjykata vlerëson se deputetët i referohen nenit 24, paragrafi 3, të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata konsideron se referenca në këtë dispozitë kushtetuese nuk është mbështetur, pasi deputetët nuk kanë arsyetuar se amendamenti i propozuar do të ishte i nevojshëm për të mbrojtur dhe për të avancuar barazinë gjinore në Qeveri.

66. Duke u bazuar në përfundimin se Kushtetuta siguron garanci të mjaftueshme që gjinitë të përfaqësohen dhe të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në jetën publike, Gjykata më tej konsideron se gratë me kualifikime të barabarta me burrat, në shoqërinë kosovare duhet të përfshihen më gjerë në jetën publike, në formimin dhe funksionimin e organeve shtetërore. Kjo duhet të arrihet nëpërmjet zbatimit të parimeve, të vlerave dhe të mekanizmave kushtetues.

67. Për arsyet e lartcekura, Gjykata konkludon se amendamenti i propozuar pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara në Kapitullin II dhe në Kapitullin III të Kushtetutës si dhe shkronjën dhe frymën e saj, siç përcaktohet me praktikën gjyqësore të Gjykatës. Prandaj, amendamenti i propozuar nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në mbështetje të nenit 113.9 dhe të nenit 144.3 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullit 56 (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 mars 2015, njëzëri

VENDOS

I. TË SHPALLË të pranueshme kërkesën nga Kryetari i Kuvendit, të dorëzuar më 6 shkurt 2015, me amendamentin e propozuar të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

II. TË SHPALLË që amendamenti i propozuar pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara në Kapitullin II dhe në Kapitullin III të Kushtetutës, si dhe shkronjën e frymën e saj, siç përcaktohet në praktikën gjyqësore të Gjykatës;

III. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. dr. Enver Hasani

KI137/14, Parashtrues Shpejtim Ademaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 194/2013, i 2 prillit 2014.

KI137/14, Aktvendim për papranueshmëri i 21 janarit 2015, publikuar më 16 mars 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, krim i organizuar, kontrabandim të emigrantëve, dënim me burgim, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, barazia para ligjit, e drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër, kërkesë qartazi e pabazuar.*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin, Pml. nr. 194/2013, të 2 prillit 2014 kishte vërtetuar vendimet e gjykatave të instancës më të ulët, dhe refuzuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë përkitazi me dënimin e tij me burgim për shkak të kryerjes së veprave penale, të krimit të organizuar dhe kontrabandim të emigrantëve.

Parashtruesi pretendoi se Gjykata Supreme i kishte shkelur atij të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se kërkesa ngre çështje të ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë, dhe se gjykatat e rregullta kanë dhënë përgjigje të qarta ndaj pretendimeve të parashtruesit përkitazi me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Gjykata po ashtu vlerësoi, se pretendimet e parashtruesit për shkelje të neneve 24, 33 dhe 34 të Kushtetutës, vetëm sa janë përmendur nga parashtruesi dhe nuk janë mbështetur me argumente bindëse dhe prova të pakontestueshme. Kërkesa u shpall e papranueshme në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) d) dhe 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI137/14
Parashtrues
Shpejtim Ademaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
P.m.l. nr. 194/2013, të 2 prillit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar,
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Shpejtim Ademaj, me vendbanim në fshatin Jabllanicë, komuna e Gjakovës, i cili momentalisht është duke vuajtur dënimin e tij në burgun e Dubravës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës). Ai përfaqësohet nga z. Gafur Elshani, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, P.m.l. nr. 194/2013, të 2 prillit 2014, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 23 maj 2014, bazuar në informatat e pranuara nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, P.m.l. nr. 194/2013, të 2 prillit 2014. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, duke refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar, i ka shkelur të drejtat e tij për barazi para ligjit, gjykim të drejtë dhe të

paanshëm, ndalim të diskriminimit dhe mjetet juridike, siç garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 shtator 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 18 shtator 2014, parashtruesi dorëzoi, me iniciativën e tij, dokumente shtesë në Gjykatë.

7. Më 7 tetor 2014, Kryetari, me Vendimin GJR. KI137/14 caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI137/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

8. Më 27 tetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të dorëzojë autorizimin e përfaqësuesit në pajtim me nenin 21 të Ligjit, dhe me rregullin 29 (2) c) të Rregullores së punës. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që ta dorëzojë kopjen e fletëdërgesës, që tregon datën kur parashtruesit të kërkesës ose përfaqësuesve të tij u është dorëzuar aktgjykimi i kontestuar. Në fund, të njëjtën ditë, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës në Gjykatën Supreme.

9. Më 3 nëntor 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi autorizimin, siç ishte kërkuar nga Gjykata.

10. Më 4 nëntor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi dokumentin e kërkuar në Gjykatë, i cili dëshmon se parashtruesi i kërkesës ka pranuar aktgjykimin e kontestuar, më 23 maj 2014.

11. Më 21 janar 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Gjatë natës në mes të 14 dhe 15 tetorit 2009, një grup prej 18 (tetëmbëdhjetë) qytetarëve nga Kosova e kaloi kufirin ndërmjet Serbisë dhe Hungarisë me barkë në lumin Tisa, në afërsi të qytetit të Suboticës. Varka u përmbyt në rrugë e sipër dhe 15 (pesëmbëdhjetë) shtetas të Kosovës humbën jetën, ndërsa 3 (tre) prej tyre mbijetuan.

13. Më 7 tetor 2010, Zyra e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PSRK) bazuar në aktin PPS. nr. 422/09, ngriti aktakuzën kundër parashtruesit të kërkesës dhe 6 (gjashtë) personave të tjerë, duke i akuzuar ata për veprën penale të krimit të organizuar, nga neni 274, paragrafi 4, në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë : KPK), dhe veprën penale kontrabandim me emigrantë, nga neni 138, paragrafi 6 i po të njëjtit kod.

14. Më 17 qershor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë aprovoi Aktgjykimin P. nr. 244/10, me të cilin shpalli parashtruesin e kërkesës "*fajtor për dy vepra penale dhe e dënoi atë, për veprën e parë, me burgim prej 14 (katërmbëdhjetë) vjetësh dhe 200,000 €, ndërsa për veprën e dytë me burgim prej 2 (dy) vjetësh për çdo emigrant, domethënë me dënim unik në kohëzgjatje prej 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim dhe gjobë prej 200,000 €.*"

15. Më 30 tetor 2011, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut P. nr. 244/10, në të cilën ai pranoi përgjegjësinë për veprën penale të kontrabandimit të emigrantëve nga neni 138 i KPK-së, por i kundërshtoi akuzat për krim të organizuar. Kështu, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Supreme që rasti të kthehet në Gjykatën e Qarkut në rigjykim ose të nxirret një vendim i ri, me të cilin do të shpallej përgjegjës vetëm për kontrabandim të emigrantëve, por jo për krim të organizuar.

16. Të njëjtën ditë, avokati i parashtruesit të kërkesës parashtroi ankesë shtesë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut P. nr. 244/10 për shkak të "*shkeljeve substanciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të dispozitave të kodit penal, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe në lidhje me vendimin për dënimin penal*".

17. Më 2 tetor 2012, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin AP-Kz nr. 61/2012, me të cilin u refuzua ankesa e parashtruesit të kërkesës si e pabazuar dhe u konstatua se:

"[...] kolegji i Gjykatës së Qarkut ka vërtetuar në tërësi gjendjen faktike relevante për të gjithë të pandehurit. Për këtë qëllim, Gjykata Supreme e Kosovës i referohet arsyetimit të aktgjykimit në vërtetimin e saj te fakteve dhe të përgjegjësisë për secilin të pandehur. Nuk ekziston asnjë indikacion se Gjykata e Qarkut nuk ka eksploruar në mënyrë të sinqertë rrethanat e lëndës dhe ka zhvilluar procedurën në mënyrë të drejtë dhe objektive. Gjykata Supreme pajtohet se disa formulime të përdorura nga trupi gjykues mund të duken pak si të paqarta. Sidoqoftë, gjetjet e trupit gjykues nuk janë bazuar në supozime. Gjykata e shkallës së parë në të vërtetë ka arsyetuar mirë vlerësimin e saj të provave, përfshirë besueshmërinë e dëshmitarëve [...] dhe peshën e deklaratave të tyre, për të marrë vendimin mbi fajësinë [...]".

18. Më 8 dhjetor 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, në pajtim me nenin 451, paragrafi 1 dhe nenin 452, paragrafët 1 dhe 3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK), duke kontestuar aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 244/10 dhe të Gjykatës Supreme, AP-Kz nr. 61/2012, me pretendimin se këto aktgjykime përmbajnë "*shkelje esenciale të dispozitave të KPPK [...] shkelje tjera të dispozitave të KPK, të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve të gjykatës [...].*

19. Më 2 prill 2014, Gjykata Supreme aprovoi Aktgjykimin P.m.l. nr. 194/2013, me të cilin u refuzua kërkesa e parashtruesit për mbrojtën e ligjshmërisë si e pabazuar, dhe konstatoi:

"Gjykata Supreme e Kosovës paraprakisht i referohet nenit 432 të KPP (nenit 451 paragrafit 2 të KPPK-së), i cili përcakton se kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet mbi bazën e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj, kontestimi i gjendjes faktike në këtë fazë të procedurës është i papranueshëm dhe gjykata do të kufizohet vetëm në vlerësimin e shkeljeve eventuale në interpretimin apo zbatimin e ligjit.

[...]

Sipas nenit 436 të KPP-së (neni 451 i KPPK-së), Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve të ligjit material apo të procedurës të cilat avokatet mbrojtës i pretendojnë.

[...]

Përveç kësaj, gjatë vlerësimit të saj Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka gjetur shkelje procedurale në aktgjykimet e kundërshtuara të cilat duhet të merren parasysh ex officio".

Pretendimet e parashtruesit te kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme P.m.l. nr. 194/2013, i 2 prillit 2014, duke refuzuar kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër], të drejtat e tij të garantuara me nenin 6 të KEDNJ dhe me nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ).

21. Në lidhje me shkeljen e pretenduar të të drejtave nga neni 31 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon: *"Me vendimet e sipërcituara parashtruesi konsideron se i janë shkelë të drejtat në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ngase gjatë gjykimit nuk është provuar së parashtruesi i kërkesës me veprime apo mos veprime individuale, ka qenë pjese e krimit të organizuar apo ka bashkëpunuar në bashkëkryerje të veprës siç parashihet me nenet 274, par 4, e lidhur me nenin 23, të KPK-së, dhe në procedurën ankimore ka pranuar fajësinë dhe dënimin për vepër penale kontrabandim me emigrantë, kurse me aktgjykimet kontestuese është shpall fajtor edhe për vepër penale krim i organizuar".*

22. Në lidhje me shkeljet e dispozitave të tjera kushtetuese, përkatësisht nenin 24, nenin 33 dhe nenit 34, parashtruesi vetëm i përmend ato si shkelje të pretenduara, por nuk ofron argumente apo dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij.

23. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të konstatojë:

"[...] se me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. nr. 244/2010, të dt. 17. qershor 2011, dhe aktgjykimet e instancave më të larta Gjyqësore që e kanë vërtetuar lartësinë e dënimeve të shqiptuara edhe sipas mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike, ka shkelje të kushtetutës dhe të ligjit në aplikim, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe ekziston disproporcioni në ashpërsinë e dënimit me veprën penale, në dëm të ankuesit, dhe për veprën që i është vënë në barrë krim i organizuar nuk është provuar me prova se parashtruesi ka qenë pjesëtar i organizatës kriminale me ndonjë veprim apo mos veprim individual të tij.

Të njëjtat aktgjykime të shfuqizohen sa i përket krimit të organizuar nga neni 274, par. 4, e lidhur me nenin 23 të Kodit penal të Republikës së Kosovës, dhe rasti të ri gjykohet në mënyre të pa anshme dhe në pajtim me provat".

Pranueshmeria e kërkesës

24. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, në përputhje me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës.

Neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

25. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit përcakton se *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".*

26. Në rastin në fjalë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka filluar procedurat gjyqësore në gjykatat e rregullta, përkatësisht në Gjykatën e Qarkut dhe më vonë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar aktgjykimi i Gjykatës Supreme më 23 maj 2014, dhe ai paraqiti kërkesën e tij në Gjykatë, më 12 shtator 2014.

27. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe se ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion me ligjin e aplikueshëm, dhe se kërkesa është paraqitur brenda afatit kohor prej katër muajve.

28. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullave 36 (1) d) dhe 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese,

[...]

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

A. Sa i përket pretendimeve në bazë të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së

29. Siç u përmend më lart, parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të përballet me akuzat në të gjitha shkallët e gjykatave të rregullta, ku ai e ka ushtruar të drejtën për të paraqitur mbrojtjen e tij, dhe ka shfrytëzuar mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë nga Gjykata Supreme, në përgjigje ndaj pretendimeve të bëra nga parashtruesi i kërkesës në lidhje me vendimin për dënim, është i qartë, i arsyetuar dhe i drejtë.

30. Lidhur me pretendimet e parashtruesit që kanë të bëjnë me vlerësimin e provave dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohen të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërisë).

31. Gjykata Kushtetuese gjithashtu rithekson se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999; shih, gjithashtu, edhe rastin KI70/11, të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

32. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta në përgjithësi dhe shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 13071/87, e miratuar me 10 korrik 1991).

33. Gjykata konsideron se procedurat në gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme, kanë qenë të drejta dhe të

arsyetuara (Shih, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).

B. Sa i përket pretendimeve nga neni 24, 33 dhe 34 të Kushtetutës

34. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm i ka përmendur dhe ka përshkruar përmbajtjen e dispozitave kushtetuese që garantojnë barazinë para ligjit, parimin e Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale dhe E drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk paraqet qartë se si dhe pse ai është trajtuar ndryshe, si është shkelur parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit ose përse ai konsideron se ai është gjykuar dy herë për të njëjtën vepër penale.

35. Lidhur me këtë, Gjykata rithekson se pakënaqësia me vendimin ose thjesht përmendja e neneve dhe dispozitave të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme që parashtruesi të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendon për shkeljet e Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të ofrojë argumente bindëse dhe të pakontestueshme për pretendimet e tij, në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar. (Shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese, Nr. KI198/13, parashtrues *Agjencia e Privatizimit të Kosovës*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 marsit 2014).

36. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë argument bindës, që tregon se shkeljet e pretenduara të përmendura në kërkesë, përbëjnë shkelje të të drejtave kushtetuese (Shih, *Vanek kundër Republikës Sllovake*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005) dhe nuk ka saktësuar se si nenet e referuara të Kushtetutës, KEDNJ-së dhe DUDNJ-së mbështesin pretendimin e tij, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) d) dhe 36 (2) b dhe d) të Rregullores së punës, më 21 janar 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën :

a. Në lidhje me pretendimet në pikën A), të papranueshme sepse faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë shkeljen e pretenduar të të drejtave të tij kushtetuese;

b. Në lidhje me pretendimet në pikën B), të papranueshme sepse parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. dr. Enver Hasani

KI162/14, Parashtrues Shefki Hyseni, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 165/ 14, të 27 gushtit 2014.

KI162/14, Aktvendim për papranueshmëri i 22 janarit 2015, publikuar më 16 mars 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dënim me burgim, vepra penale e mashtrimit, mosshterje e mjeteve juridike.*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin, Pml. nr. 165/14, të 27 gushtit 2014 kishte hedhur poshtë kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të mos përmbushjes së kritereve procedurale të lejueshmërisë, dhe rrjedhimisht, nuk ishin vlerësuar vendimet e gjykatave të instancës më të ulët, përkitazi me dënimin me burgim të parashtruesit për shkak të kryerjes së veprës penale të mashtrimit.

Parashtruesi i kërkesës e kontestoi vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, duke pretenduar se ai nuk kishte pranuar vendimin e gjykatës së instancës së dytë, dhe me atë rast, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se parashtruesit i ishte dhënë mundësia për ta kërkuar vendimin e gjykatës së instancës së dytë – ku pas posedimit të atij vendimi – do të fillonte llogaritja e afatit ligjor dhe mundësia e ushtrimit të mjetit juridik në instancë më të lartë gjyqësore. Kërkesa u shpall e papranueshme për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI162/14
Parashtrues
Shefki Hyseni
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 165/14, të 27 gushtit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Shefki Hyseni, me vendbanim të përhershëm në Mitrovicë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 165/14, të 27 gushtit 2014 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 165/14, të 27 gushtit 2014, me të cilin parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 22 dhe 47 i Ligjit për Gjykatën

Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 30 tetor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI162/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI162/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 6 nëntor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga i njëjti plotësimin e kërkesës me dokumentacion relevant. Të njëjtën ditë është informuar edhe Gjykata Supreme, të cilës i është dërguar një kopje e kërkesës.

8. Më 8 dhjetor 2014, parashtruesi dorëzoi formularin e kërkesës të plotësuar dhe këtij formulari ia ka bashkëngjitur Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 165/14, të 27 gushtit 2014.

9. Më 22 janar 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 18 mars 2009, Gjykata Komunale në Ferizaj (Aktgjykimi, P. nr. 798/2006), shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale të mashtrimit nga nenin 261, paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK), duke i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 20 (njëzetë) muajve.

11. Më 23 tetor 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi, Ac. nr. 285/2009) ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Ferizajt, përkitazi me masën e dënimit të parashtruesit, duke ia ulur dënimin me burg nga 20 (njëzetë) muaj, në 1 (një) vit.

12. Më 20 korrik 2014, parashtruesi në Gjykatën Supreme parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të ligjit të procedurës penale.

13. Më 27 gusht 2014, Gjykata Supreme (Aktvendimi Pml. nr. 165/14) hodhi poshtë, si të palejuar, kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak se, sipas gjykatës në fjalë nuk ishin

përmbushur kriteret procedurale të lejueshmërisë, të përcaktuara me ligjin në fuqi.

14. Për më tepër, Gjykata Supreme arsyetoi:

[...]
"Nga përmbajtja e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk rezulton se me këtë mjet juridik është atakuar ndonjë vendim i gjykatës sepse në të nuk precizohet se cili vendim është atakuar apo procedura gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë.

Përkundrazi, në kërkesë potencohet vetëm fakti se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk i është dorëzuar të dënuarit dhe kështu është shkelur ligji meqë nuk i është mundësuar ushtrimi i mjetit juridik kundër vendimit të gjykatës së shkallës së dytë.
Qëndron fakti se në rastin konkret aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk i është dorëzuar të dënuarit meqë siç rezulton nga shkresat e çështjes -fletëkthesa, me datë 4. 3. 2013 është tentuar dorëzimi i shkresës të dënuarit mirëpo në fletëkthesë është konstatuar se pala është e panjohur. Megjithatë Gjykata Supreme vlerëson se në rastin konkret kërkesa e të dënuarit për mbrojtjen e ligjshmërisë është e parakohshme sepse në një situatë të tillë i dënuari do të duhej t'i drejtohej gjykatës së shkallës së parë me kërkesë që t'i dorëzohet në mënyrë të rregullt aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nga e cila ditë fillon të ecë afati e më pas duke respektuar afatin ligjor të ushtrohet ky mjet juridik".

[...]

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, për faktin se gjykata në fjalë hodhi poshtë, si të palejuar, kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, sepse sipas parashtruesit gjykata në fjalë nuk mori parasysh faktin se atij nuk i është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, Ac. nr. 285/2009, i 23 tetorit 2012.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

17. Në rastin konkret, Gjykata i referohet nenit 113.7, që përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

18. Përveç kësaj, neni 47. 2 i Ligjit gjithashtu përcakton:

"Individi mund ta ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

19. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, që përcakton:

1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar, ose

[...]

20. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 165/14, të 27 gushtit 2014, përkitazi me shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Në fakt, parashtruesi nuk ka specifikuar se cila dispozitë konkrete e Kushtetutës i është cenuar. Megjithatë, Gjykata *inter alia* ka kuptuar që bëhët fjalë për të drejtat që derivojnë nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, siç është e drejta për të poseduar vendimin e gjykatës, në mënyrë që palës a palëve t'iu jepet mundësia të kontestojnë një vendim gjyqësor të pafavorshëm dhe të përgatisin mbrojtjen e duhur, për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatat e instancës më të lartë.

21. Megjithatë, në këtë rast është e qartë, se parashtruesit i është dhënë mundësia nga Gjykata Supreme që aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës ta kërkojë dhe ta pranojë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, dhe pasi ta ketë pranuar, ka mundur të llogarisë afatin ligjor për të parashtruar kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë. Nuk ka asnjë provë që tregon se parashtruesi i kërkesës, kishte kërkuar t'i dorëzohej aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

22. Në rastin konkret, Gjykata nuk mund të konstatojë që, për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk e ka kërkuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe rrjedhimisht, me sa duket, nuk e ka pranuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, atij i është mohuar e

drejta e ushtrimit të mjetit juridik kundër këtij aktgjykimi apo që i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

23. Edhe nga arsyetimi i aktvendimit të Gjykatës Supreme vërehet qartë që kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë është hedhur poshtë si e palejuar, për shkak se është konsideruar e parakohshme. Gjykata në fjalë e ka këshilluar parashtruesin që t'i drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë, për ta kërkuar Aktgjykimin Ac. nr. 285/2009, të 23 tetorit 2014, ku pas posedimit të të cilit do fillonte llogaritja e afatit ligjor dhe mundësia e ushtrimit të mjetit juridik në instancë më të lartë.

24. Prandaj, në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, ashtu siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, për faktin së ai ka dështuar të provoj se i ka shfrytëzuar mundësitë e dhëna nga Gjykata Supreme.

25. Gjykata rithekson se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës, apo nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Ndryshe, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse ai ose ajo dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo nëse dështon të raportojë shkeljet e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Republikës së Kosovës siguron mjete efektive juridike për mbrojtje kundër shkeljeve të të drejtave kushtetuese (Shih Aktvendimin për papranueshmëri KI41/09, të 21 janarit 2010, *AAB-RIINVEST L.L.C. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës,* dhe shih, *mutatis mutandis,* ECHR, *Selmouni vs. Francë,* no. 25 803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).

26. Nga arsyet e cekura më lart, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, të përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores, për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b), si dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 22 janar 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. dr. Enver Hasani

KI118/14, Parashtrues Raiffeisen Bank Kosovo J. S. C, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 24/2013, të 5 shkurtit 2014.

KI118/14, Aktvendim për papranueshmëri i 23 shtatorit 2014, publikuar më 18 mars 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, kamatë ndëshkuese, ligjshmëri, kushtetutshmëri, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, kërkesë qartazi e pabazuar.*

Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme me arsyetimin se ka pasur shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga gjykatat e shkallëve më të ulëta, përkitazi me lartësinë e kamatës ndëshkuese që pala e tretë ishte e detyruar t'ia paguante parashtruesit për shkak të mosrespektimit të afateve kohore për pagimin e kryegjësë. Gjykata Supreme nëpërmjet Aktgjykimit, E. Rev. nr. 24/2013 kishte refuzuar, si të pathemeltë kërkesën për revizion të parashtruesit dhe kishte vërtetuar vendimet e gjykatave të instancës më të ulët.

Parashtruesi, ndër të tjera, pretendoi se: (i) vendimi i kontestuar nuk adreson çështjet kryesore të rastit, (ii) vendimi nuk përmban arsyetim koherent, (iii) vendimi i kontestuar është kontradiktor. Parashtruesi po ashtu iu referua shkeljeve të neneve 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe 10 [Ekonomia] të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se parashtruesi nuk është palë e autorizuar për të pretenduar shkelje të neneve 4 dhe 10 të Kushtetutës, dhe se parashtruesi ka të drejtë të ngre çështje kushtetuese vetëm në kuadër të nenit 113.7 të Kushtetutës. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit se vendimi i kontestuar ishte i paarsyetuar, Gjykata Kushtetuese ndër të tjera u shpreh se: (i) Gjykata Supreme kishte adresuar të gjitha çështjet qendrore të rastit të parashtruesit, (ii) vendimi i kontestuar ishte koherent dhe mjaftueshëm i arsyetuar, (iii) se pretendimet e parashtruesit në thelb ngrenë çështje të ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë dhe (iv) është detyrë dhe prerogativë kushtetuese e gjykatave të rregullta që t'i zgjidhin çështjet e ligjshmërisë. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) d) dhe 2 d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin KI118/14
Parashtrues
Raiffeisen Bank Kosovo J. S. C
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 24/2013, të 5 shkurtit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Raiffeisen Bank Kosovo J. S. C, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga z. Ilir Tahiri, udhëheqës i Zyrës ligjore (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 24/2013, të 5 shkurtit 2014, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 352/2012, të 7 qershorit 2013, dhe me Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Kosovës, II. C. nr. 272/2011, të 30 janarit 2012.

3. Vendimi i kontestuar i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 18 mars 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet se "*ka shkelur të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për*

Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Nenin 6. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut".

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe në nenin 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe në nenet 29 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 15 korrik 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Kadri Kryeziu.

8. Më 15 gusht 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.

9. Më 15 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan me gjyqtaren Snezhana Botusharova, si anëtare të Kolegjit shqyrtues.

10. Më 23 shtator 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në periudhën prej 12 korrikut 2005 e deri më 21 nëntor 2007, ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe një pale të tretë u nënshkruan marrëveshje për kredi, të cilat përfshinin klauzola të kamatëvonesës prej 3% për vonesë në pagesën e kësteve.

12. Më 27 prill 2009, parashtruesi i kërkesës, duke pasur parasysh se pala e tretë nuk i kishte respektuar afatet për pagesën e riprogramuar të kredisë, inicioi procedurë përmbarimore në Gjykatën Komunale në Prizren.

13. Më 3 korrik 2009, Gjykata Komunale në Prizren (Aktvendimi E. nr. 763/2009) lejoi shitjen e pronës së hipotekuar. Megjithatë, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktvendimi Ac. nr. 536/2009) prishi aktvendimin e Gjykatës Komunale dhe e ktheu lëndën në rigjykim.

14. Më 20 maj 2011, Gjykata Komunale, në bazë të propozimit të parashtruesit të kërkesës, caktoi masën e sigurisë dhe e urdhëroi palën e tretë t'ia dorëzojë hipotekën parashtruesit të kërkesës.

15. Ndërkohë, më 26 maj 2011, parashtruesi i kërkesës dhe pala e tretë arritën një marrëveshje jashtëgjyqësore "*për Kthimin e Borxhit në shkëmbim të heqjes së një pjese të kamatëvonesës dhe pezullimit të procedurës për përmbarimin e hipotekës*".

16. Më 30 shtator 2011, pala e tretë paraqiti padi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë kundër parashtruesit të kërkesës, për pagesën 44.640,54 euro, si fitim pa bazë, i cili pretendohet të jetë realizuar nga parashtruesi i kërkesës.

17. Më 19 tetor 2011, parashtruesi i kërkesës u përgjigj duke kërkuar që padia "*të hidhet poshtë për shkak se (i) paraqitja e padisë nuk lejohej sipas nenit 211 të LMD-së pasi që Carrera kishte përmbushur borxhin në mënyrë vullnetare sipas Marrëveshjes Jashtëgjyqësore e cila ishte arritur me propozimin e vet Carrera-së (ii) ushtrimi i të drejtave të patjetërsueshme ligjore të parashtruesit të kërkesës për përmbarimin e hipotekës nuk mund të konsiderohet si ushtrim i dhunës; dhe (iii) vjelja e kamatëvonesës është kontraktuar dhe realizuar në pajtim të plotë me nenin 277.2 të LMD-së në lidhje me Nenet 10 dhe 28 të LMD-së, të cilat parashohin instrumentin e kamatëvonesës dhe lejojnë kontraktimin e lartësisë së kamatëvonesës (paragrafi 14 i kërkesës)*".

18. Më 30 janar 2012, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi II. C., nr. 272/2011) konstatoi:

> *"APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, "CARRERA-R" Sh.p.k. -Prizren, detyrohet i padituri, RAIFFEISEN BANK-Prishtinë, që paditësit, në emër të fitimit pa bazë t'ia paguajë shumën prej 44.640,54 €, me kamatë vjetore, sipas normës prej 3.5%, duke filluar prej datës 30.05.2011, e deri në pagesën definitive, dhe t'ia kompenzoi shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë prej 1.123 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm*".

19. Më 24 shkurt 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut, duke e bazuar ankesën

e tij në tri pika kryesore: *"(i) shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, në kuptim të Nenit 182, paragrafi 2, pika (n), i LPK-së (...) (ii) vërtetim të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike pasi që aktgjykimi kishte nxjerrë faktet në lidhje me shumat e borxhit dhe kamatëvonesës së paguar dhe arsyet e pagesës që ishin në kundërshtim të plotë me provat e administruara gjatë procedurës; dhe (iii) zbatim të gabuar të së drejtës materiale, në atë që aktgjykimi kishte cilësuar kamatëvonesën e kontraktuar me nenin 4.1 (c) të Marrëveshjeve të Kredisë, të bazuar në nenin 277 të LMD-së, si 'ndëshkim kontraktues' sipas nenit 277.3 të LMD-së".*

20. Më 7 qershor 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës (Aktgjykimi Ac. nr. 352/2012), konstatoi:

    "REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, II. C. nr. 272/11 të datës 30.01.2012".

21. Më 6 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion dhe plotësim të revizionit në Gjykatën Supreme, "*për shkak të:*

    1) Shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore

    2) Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale".

22. Në revizion, parashtruesi i kërkesës deklaron si në vijim:

    a) Parashtruesi i kërkesës i ofroi Gjykatës Supreme *"një analizë gjithëpërfshirëse mbi teorinë dhe praktikën e zbatimit të instrumentit ligjor të kamatëvonesës sipas Nenit 277 dhe dallimeve qenësore ndërmjet këtij instrumenti ligjor dhe 'ndëshkimit kontraktues', të paraparë me nenin 270.3 të LMD-së".* Për më shumë, ofroi *"një analizë të hollësishme të teorisë dhe praktikës së Nenit 270.3 dhe 277 të LMD-së, përfshirë edhe dallimet esenciale ndërmjet ndëshkimit kontraktues dhe kamatëvonesës".*

    b) Parashtruesi i kërkesës theksoi se Gjykata e Apelit *"jo vetëm (...) nuk i kishte shqyrtuar fare pretendimet ankimore në lidhje me shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore sipas nenit 182, paragrafit 2, pika (n), por edhe kishte dështuar të shqyrtonte ankesën brenda kufijve të pretendimeve ankimore duke injoruar tërësisht dy nga tre kategoritë e pretendimeve ankimore të parashtruesit të kërkesës, në kundërshtim me nenin 194 të LPK-së".*

23. Në plotësimin e revizionit, parashtruesi i kërkesës arsyetoi bazën e zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale, duke arsyetuar si në vijim:

a) Gjykata e Apelit, shkeli "*rëndë parimin e ndarjes së pushteteve të mishëruar në Nenin 4 të Kushtetutës*" – duke mos marrë parasysh nenin 277 të LMD-së, *"në mënyrë arbitrare pa dhënë as edhe një arsye"*. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës thekson se "*Neni 4 i Kushtetutës përcakton qartë se Kuvendi i Kosovës ushtron pushtetin legjislativ në vend. Rrjedhimisht, (...) asnjë gjykatë në Kosovë nuk ka të drejtë që nëpërmjet vendimeve të veta të shpall nule dhe juridikisht të pavlefshme një dispozitë ligjore e cila është miratuar nga Kuvendi i Kosovës apo institucionet para-ardhëse të cilat e kanë ushtruar funksionin legjislativ në Kosovë. Aktgjykimi i ankimuar në arsyetimin e vet, duke shpallur si nule dhe juridikisht të pavlefshme kamatën ndëshkimore e cila është kontraktuar ndërmjet palëve ndërgjyqësore, në mënyrë të tërthortë po ashtu shpall nule dhe juridikisht të pavlefshme Nenin 277 të LMD-së (...) Në këtë mënyrë, Gjykata e Apelit, duke shkelur rëndë parimin e ndarjes së pushteteve - të mishëruar në Nenin 4 të Kushtetutës - vihet në rolin e pushtetit legjislativ me ç'rast anulon në mënyrë kundër-kushtetuese një dispozitë ligjore dhe me këtë rast prodhon efekt juridik që është i barasvlershëm me aktivitet legjislativ"*.

b) Përveç kësaj, "*arsyeja pse Neni 277 i RSFJ LMD-së nuk ka elaboruar mjaftueshëm lirinë e palëve për kontraktimin e shkallës së 'kamatës ndëshkimore' ka të bëjë me faktin se RSFJ LMD-ja është hartuar në një sistem të ekonomisë së planifikuar ku shteti ka pasur një rol vendimtar si rregullator i marrëdhënieve ekonomike. Duke qenë se në bazë të Nenit 10 të Kushtetutës ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të vendit, Neni 277.2 i RSFJ LMD-së duhet të interpretohet dhe zbatohet në bazë të këtij postulati kushtetues"*.

24. Më 5 shkurt 2014, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi E. Rev. nr. 24/2013) konstatoi si në vijim:

"REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i të paditurit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. nr. 352/2012 datë 07.06.2013, si dhe Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, II. C. nr. 272/2011 datë 30.01.2012, në pjesën që i referohet pagesës së shumës prej 44.640,54 €.

PRANOHET revizioni i të paditurit përkitazi me lartësinë e kamatës së gjykuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, II. C. nr. 27212011 datë 30.01.2012, në shumën prej 44.640,54 €, ashtu që në këtë pjesë të dy aktgjykimet NDRYSHOHEN dhe detyrohet i padituri që paditësit shumën e lartcekur t'ia paguajë me kamatë, në lartësi të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet të afatizuara për 1 vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 30.09.2011, e deri në pagesën definitive".

25. Gjykata Supreme e arsyetoi aktvendimin e saj si në vijim:

"*Thëniet në revizion se gjykata e shkallës së dytë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur ka cilësuar kamatën ndëshkuese si ndëshkim kontraktues, vetëm për faktin se kamata ndëshkuese është paraparë me kontrata, kjo Gjykatë i vlerësoi si të papranueshme pasi që, këto të dhëna janë në kundërshtim me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, ku konstatohet se kamata e kontraktuar me nenin 4.1 c) të marrëveshjeve mbi kredinë është në kundërshtim me dispozitën e nenit 270 par. 3 të LMD-së, për faktin se kamata ndëshkuese nuk mund të kontraktohet në detyrime në të holla, e jo si pa bazë parashtrohet në revizion, për shkak se kamata është kontraktuar me kontratë.*

Thëniet në revizion se kamata ndëshkuese e paraparë me nenin 4.1 c) të marrëveshjeve mbi kredinë është bazuar në Ligjin përkatësisht në nenin 277 të LMD-së, është e papranueshme dhe në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 277 të LMD-së, pasi që kamatëvonesa nuk ka nevojë të kontraktohet, baza e pagesës rrjedh në bazë të ligjit e jo në bazë të kontratës dhe lind në detyrimet në të holla. Kamata ndëshkuese ka efekt juridik vetëm nëse është përcaktuar me kontratë dhe nuk ka bazë ligjore për pagesë nëse me kontratë nuk është i përcaktuar. Kjo formë e kamatës nuk mund të kontraktohet në obligimet në të holla".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"vendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat kushtetuese, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e dhe Mbrojtjen e Lirive Themelore Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa)"*.

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*Gjykata Supreme dështoi jo vetëm që të arsyetojë Vendimin e Kontestuar por edhe në mënyrë të kundërligjshme injoroi në tërësi pretendimet faktike dhe juridike të Parashtruesit të Kërkesës të cilat ishin vendimtare për vendosjen e drejtë të kësaj çështje juridike*".

28. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se *"si pasojë e shkeljes së të drejtës kushtetuese të paraqitësit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Vendimi i Kontestuar privoi paraqitësin e kërkesës nga të drejtat kushtetuese të sanksionuara me Nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe Nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës"*.

29. Si përmbledhje, parashtruesi pretendon shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 6 të KEDNJ-së dhe me nenin 31 të Kushtetutës dhe, si pasojë, shkelje të së drejtës së tij për mbrojtjen e pronës sipas nenit 46 të Kushtetutës.

30. Parashtruesi i kërkesës mbështet pretendimet e tij duke iu referuar aktgjykimit të kësaj gjykate në Rastin nr. KI72/12, parashtrues të kërkesës *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, të 7 dhjetorit 2012.

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata, së pari, vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *(...)*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

33. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

34. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (1) d) dhe (2) d) të Rregullores së punës, që përcakton:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: ... (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: ... (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

Fushëveprimi i vlerësimit

35. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit mbi baza të "*Shkeljes së* dispozitave të procedurës kontestimore*;* Vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike*;* Zbatim i gabuar i së drejtës materiale".

36. Gjykata më tej rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata e Apelit iu përgjigj pretendimeve të tij "*pa asnjë analizë, duke lënë përshtypjen se fare nuk kishte shqyrtuar pretendimet e ngritura".*

37. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, rregulli i shterimit i ndjekur nga parashtruesi i kërkesës i ofroi mundësinë Gjykatës Supreme për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e pretenduar. "*Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih, Aktvendim për papranueshmëri: Universiteti AAB-RIINVEST L. L. C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI-41/09, i 21 janarit 2010, dhe shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999)".*

38. Prandaj, Gjykata konsideron se, në mënyrë që pretendimi i lartpërmendur të jetë i bazuar, parashtruesi i kërkesës i dha Gjykatës Supreme mundësinë për të rregulluar shkeljen nëpërmjet procesit të shterimit, siç do të shpjegohet më tej.

39. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi përqendron kërkesën e tij kryesisht në kontestimin e temës kryesore të diskutimit që ka zgjatur gjatë tërë procedurave në gjykatat e rregullta: "*Gjykata e shkallës së parë, duke u nisur nga gjendje e tillë e çështjes ka gjetur se: kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Kjo nga fakti se, shuma e paguar prej 44.640,54 €, ka të bëjë me kamatën ndëshkuese, e cila është marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, nga se me*

gjithë faktin që me dispozitën e nenit 4.1 nën pikave (c), të marrëveshjeve mbi kredinë, është kontraktuar shkalla e kamatës ndëshkuese mujore prej 3%, për çdo muaj vonesë, për kështet e papaguara të kredisë, këto dispozita janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 270 par. 3 të LMD, sipas të cilës ndëshkimi kontraktues nuk mund të kontraktohet në detyrime me të holla, e cila dispozitë është e natyrës imperative, kështu që, pasi qe kamata ndëshkuese përmban ndëshkim të kontraktuar, ajo nuk mund të ketë efekt juridik, andaj me ushtrimin e presionit, nëpërmes sekuestrimit të hipotekës, që paditësi dhe garantuesve në procedurë përmbarimore, shuma e paguar nga paditësi prej 44.640,54 €, me datën 30.05.2011, në emër të kamatës ndëshkuese paraqet fitim pa bazë nga ana e të padituri, dhe në mbështetje të dispozitës së nenit 210 par. 1 dhe 2 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit".

40. Gjykata vëren se, në këtë rast, pretendimi kryesor dhe i vazhdueshëm i parashtruesit të kërkesës në procedura pranë gjykatave të rregullta ka të bëjë me zbatueshmërinë e një çështjeje të ligjit: si të aplikohen dispozitat e nenit 270.3 dhe të nenit 277 të LMD-së, në paragrafin 4.1 c), të Marrëveshjes për Kredi.

41. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës kryesisht pretendon:

    i) Me vendimin e Gjykatës Supreme nuk janë shqyrtuar dhe adresuar çështjet kryesore, të ngritura nga ai, që ishin të domosdoshme për një zgjidhje meritore dhe të drejtë të çështjes ligjore në fjalë;

    ii) Vendimi i kontestuar nuk përmban arsyetim koherent;

    iii) Vendimi i kontestuar është kontradiktor, sepse, inter alia, Gjykata Supreme nuk shpjegoi se si është e mundur që neni 277 i LMD-së, i cili parasheh kamatë ndëshkuese, zbatohet me veprim automatik të ligjit dhe pa kontraktuar lartësinë e kamatës ndëshkuese.

42. Parashtruesi i kërkesës, në përgjithësi, pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme "*jo vetëm që dështoi t'i adresojë shkeljet e rënda të ngritura nga parashtruesi i kërkesës gjatë vendosjes së kësaj lënde nga gjykatat më të ulëta, por edhe vetë bëri shkelje të pashembullta të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të parashtruesit të kërkesës të cilat rrezikojnë përmbysjen e rendit juridik në vend".*

43. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme *"pa asnjë bazë kishte konstatuar se nuk kishte asnjë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se gjendja faktike në këtë*

çështje ishte vërtetuar drejt". Parashtruesi më tej konsideron se *"pjesa e arsyetimit të dhënë në lidhje me zbatimin e të drejtës materiale nuk kishte adresuar as edhe një pretendim ankimor thelbësor të Revizionit. Kjo shkelje shpalos më mirë se cilido fakt tjetër natyrën arbitrare të [aktgjykimit] të Gjykatës Supreme"*.

44. Gjykata vëren se Gjykata Supreme i ka plotësuar kërkesat e shqyrtimit të argumentit kryesor të parashtruesit të kërkesës, duke shpjeguar:

    i) pse kamata ndëshkuese e kontraktuar është në kundërshtim me ligjin;

    ii) pse përcaktimi i kamatës ndëshkuese si ndëshkim kontraktual nga ana e gjykatave të ulëta nuk ndryshon thelbin e çështjes ligjore, të lidhur nga palët; dhe

    iii) pse gjykatat e ulëta kanë zbatuar drejt të drejtën materiale, kur ato konstatuan se kamata ndëshkuese nuk mund të zbatohet vis-*à-vis* detyrimeve në të holla.

45. Gjykata konsideron se pretendimi kryesor për aplikim të gabuar të dispozitave ligjore të nenit 270.3 në vend të nenit 277 të LMD-së në nenin 4.1 c) të Marrëveshjes së Kredisë, ka të bëjë me domenin e ligjshmërisë që bie në kompetencë të gjykatave të rregullta.

46. Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës, në plotësimin e tij për revizion, arsyetoi bazën për aplikimin e gabuar të së drejtës materiale duke pretenduar se Gjykata e Apelit kishte shkelur "*rëndë parimin e ndarjes së pushteteve të mishëruar në Nenin 4 të Kushtetutës - duke mos marrë parasysh nenin 277 të LMD-së"*.

47. Përveç kësaj, në arsyetimin e plotësimit të revizionit, parashtruesi i kërkesës thirret në nenin 10 të Kushtetutës, i cili përcakton se *"ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës"*. Parashtruesi i kërkesës konsideron se *"Neni 277.2 i RSFJ LMD-së duhet të interpretohet dhe zbatohet në bazë të këtij postulati kushtetues"*.

48. Gjykata konsideron se referimi në nenet 4 dhe 10 të Kushtetutës, i përdorur nga parashtruesi i kërkesës për arsyetim të bazës lidhur me aplikimin e gabuar të ligjit, nuk përbën në vetvete një pretendim mbi kushtetutshmërinë. Në të vërtetë, kjo referencë paraqet një pjesë të argumenteve të tij të adresuara për të treguar se cila dispozitë ligjore është dashur të zbatohet dhe se ka pasur gabim në zbatimin e të drejtës materiale. Në këtë mënyrë, baza e ankesës ende i takon fushës së ligjshmërisë dhe jo asaj të kushtetutshmërisë.

49. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk do të ishte palë e autorizuar që t'i referojë Gjykatës Kushtetuese çështje të tilla që kanë të bëjnë me përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, ose çështjet e përputhshmërisë kushtetuese të një ligji, kur ajo është ngritur në një procedurë gjyqësore.

50. Në fakt, pajtueshmëra e ligjeve me Kushtetutën, ose çështjet kushtetuese të ngritura në procedura gjyqësore, janë çështje të cilat janë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, por vetëm nëse ato janë parashtruar nga pala e autorizuar, që në këtë rast janë vetëm Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit (neni 113.2.1) dhe gjykatat (neni 113.8). (Shih rastet e Gjykatës Kushtetuese KO04/11, parashtrues i kërkesës: Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës për vlerësim të kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për Ekspropriijimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139, Aktgjykim i 1 marsit 2012; KO43/10, parashtrues i kërkesës LDK-*AAK-LDD*, KK *Prizren*, Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2011, paragrafët 19-21; KI230/13, parashtrues i kërkesës Tefik Ibrahimi, Aktvendim për papranueshmëri i 19 majit 2014, paragrafët 25-27).

51. Në këtë drejtim, Gjykata Evropiane për Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), në përputhje me praktikën e saj të përcaktuar gjyqësore, ka vendosur se "*Konventa nuk* paraqet institut për individë, një lloj actio popularis për interpretimin e saj dhe në këtë mënyrë nuk u lejon individëve të ankohen kundër një ligji in abstracto thjesht pse ata konsiderojnë se ai është në kundërshtim me Konventën" (Shih, Monnat kundër Zvicrës, nr. 73604/01, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 shtatorit 2006, paragrafët 31-32 dhe shih, mutatis mutandis, Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë, nr. 5029/71, GJEDNJ, Aktgjykim i 6 shtatorit 1978, paragrafi 33).

52. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës që përcakton se "i*ndividët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë".* Prandaj, parashtruesi i kërkesës nuk mund të marrë vlerësim të kushtetutshmërisë së një ligji nëpërmjet nenit 113.7 dhe kjo është e mundur vetëm nëpërmjet nenit 113.2 1) dhe nenit 113.8 të Kushtetutës dhe nuk mund të përdorë shkeljen e pretenduar kushtetuese të neneve 4 dhe 10, si argument për të dëshmuar një aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

53. Gjykata pranon se interesat konkurruese që kontestohen në këtë rast janë të rëndësisë së madhe për të dy palët, mund të kenë jehonë dhe ndikim në lirinë dhe pavarësinë e individëve të tjerë dhe mund të

prekin të drejtat kushtetuese të palëve private në ndërgjygjësimet civile. Sidoqoftë, një pretendim dhe argument i tillë kushtetues nuk është ngritur as pranë Gjykatës Supreme e as pranë Gjykatës Kushtetuese.

54. Prandaj, Gjykata do të kufizohet në pretendimet dhe në argumentet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës:

(i) shkelja e nenit 6.1 dhe 13 të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës dhe

(ii) shkelja e nenit 46 të Kushtetutës.

Të dy pretendimet janë logjikisht të varura, pasi që i dyti është pasojë e të parit. Prandaj, Gjykata do të fillojë ta analizojë pretendimin e parë.

Shkelja e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

55. Pas identifikimit të çështjes kryesore të analizës, Gjykata rikujton se, në bazë të nenit 53 të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutë, në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së.

56. Në të vërtetë, roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

57. Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese rithekson se konstatimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike dhe i ligjit të aplikueshëm është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih, *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykim i 16 shtatorit 1996, paragrafi 65, shih gjithashtu, *mutatis mutandis*, Rasti nr. KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

58. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e gjetjeve faktike ose të ligjit të zbatueshëm, që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo gjatë zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

59. Në këtë mënyrë, Gjykata do të shqyrtojë nëse procedurat ishin në ndonjë mënyrë të padrejta ose arbitrare, në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, Vendim i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

60. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion për shkak të *"shkeljes së* dispozitave të procedurës kontestimore*;* zbatim i gabuar i së drejtës materiale" dhe jo për "*vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike",* të cilën e kishte pretenduar më parë në Gjykatën e Apelit.

61. Gjykata gjithashtu vëren se në aktgjykimin e Gjykatës Supreme theksohet se parashtruesi i kërkesës *"parashtroi revizionin për shkak të shkeljes së* dispozitave të procedurës kontestimore *dhe aplikimit të* gabuar të së drejtës materiale". Kështu, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme ishte në dijeni të bazave të revizionit që duhej të merreshin parasysh.

62. Gjykata Supreme gjeti se *"Aktgjykimi i goditur nuk është përfshirë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat revizioni pretendon. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe jo i përfshirë me kundërthënie dhe në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse ne arsyetim janë dhënë arsye të plota dhe të mjaftuara për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykim të kësaj çështjeje juridike. Prandaj, janë të pa bazuara thëniet e revizionit se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore".*

63. Gjykata Supreme më tej konstatoi lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale se "*thëniet në revizion se kamata ndëshkuese e paraparë me nenin 4.1 c) të marrëveshjeve mbi kredinë është bazuar në Ligjin përkatësisht në nenin 277 të LMD-së, është e papranueshme dhe në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 277 të LMD-së, pasi që kamatëvonesa nuk ka nevojë të kontraktohet, baza e pagesës rrjedh në bazë të ligjit e jo në bazë të kontratës dhe lind në detyrimet ne të holla. Kamata ndëshkuese ka efekt juridik vetëm nëse është përcaktuar me kontratë dhe nuk ka bazë ligjore për pagesë nëse me kontrate nuk është i përcaktuar. Kjo formë e kamatës nuk mund të kontraktohet në obligimet në të holla".*

64. Për më tepër, Gjykata Supreme gjeti se "*kamata e aprovuar në shumën e gjykuar është zbatuar në mënyrë jo të drejtë me dispozitën e nenit 277 të LMD-së, nga se, kjo kamatë nuk është caktuar në përputhshmëri me këtë dispozitë ligjore, pasi që kamata e pranuar në*

lartësi prej 3,5 % nuk është e thënë që të jetë e njëjtë në[të gjitha bankat vendore. Andaj, duke u nisur nga fakti se lidhur me kamatën e aprovuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë ma zbatim të gabuar të së drejtës materiale (me refuzimin si të pabazuar të revizionit të paditurit), i njëjti aktgjykim me këtë pjesë u ndryshua në bazë të nenit 224 par. 1 të LPK. Dhe paditësit i pranohet kamata prej momentit të paraqitjes së padisë (30.09.2011), konform dispozitës së nenit 279 par. 2 të LMD-së, i padituri ka ra në vonesë për kthimin e shumës kontraktuese, në emër të kompensimit të dëmit, andaj në kuptim të nenit 277 par. 1 të LMD-së, paditësi ka të drejtë dhe në kamatë në lartësinë e cila paguhet në bankën vendore për detyrimet në kursimin në afat mbi 1 vit, pa destinim të përcaktuar".

65. Për më tepër, Gjykata Supreme veçanërisht mori parasysh bazën e ankesës së paraqitur nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën e Apelit për "vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike", që do të thotë se "*aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim me procesverbalin kur konstatohet se nuk është kontestuese se paditësi e pagoi shumën prej 44.640,54 Euro".*

66. Në të vërtetë, Gjykata Supreme, në aktgjykimin e saj, shpjegoi se pretendimi për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike është *"i papranueshëm për faktin se, edhe pse nga përmbajtja e shkresave në lëndë rezulton se i padituri [këtu parashtruesi i kërkesës] gjatë gjithë procedurës e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit, nga pasqyra bankare e 1 janarit 2011 lëshuar nga I padituri del se, në shumën e kredisë prej 300.000 €, paditësit si debitor i është caktuar penalet-interesi në shumë prej 10,799.46 €, dhe 38.841,08 E, apo gjithsejte shuma prej 44.640,54 E, shumën të cilën paditësi e kërkon në emër të kamatës ndëshkuese. Për më tepër, këto të dhënat janë në kundërshtim edhe me përmbajtjen e shkresave të lëndës dhe të dhënat e të paditurit në seancën pranë gjykatës së shkallës së parë të datës 04 .11.2011, ku i padituri pohon se marrëveshja jashtëgjyqësore për pagesën e borxhit në pjesën e papaguar të borxhit, kamatës kontraktuese dhe asaj ndëshkuese,është lidhur pasi që është zbritur kamatëvonesa në shumën prej 55.657,47 €. Prandaj janë të pa pranueshme thëniet ne revizion se aktgjykimi i goditur është përfshirë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore".*

67. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, si përmbledhje, pretendon që Gjykata Supreme nuk ka shpjeguar se si është e mundur që neni 277 i LMD-së, i cili parasheh kamatë ndëshkuese, aplikohet me veprim automatik të ligjit dhe pa kontraktuar lartësinë e kamatës ndëshkuese.

68. Gjykata pranon se rëndësia e së drejtës për një vendim të arsyetuar është vendosur edhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. (Shih, ndër të tjera, rastet Garcia Ruiz kundër Spanjës, 1994; Pronia kundër Ukrainës, 2006; Nechiporuk dhe Tornkalo kundër Ukrainës, 2011; Hirvisaari kundër Finlandës, 2001; Hadijanastrassiou kundër Greqisë, 1992;. Hirvisaari kundër Finlandës, 2001).

69. Në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e drejta për një vendim të arsyetuar përfshin një kompleks të detyrimeve për aktgjykimet gjyqësore, përkatësisht që ato të ofrojnë arsyet mbi të cilat është bazuar vendimi, t'ua demonstrojnë palëve që ato janë dëgjuar, t'ua sigurojnë mundësinë për të apeluar vendimin dhe të sigurojnë qartësi të mjaftueshme të bazave mbi të cilat është nxjerrë vendimi.

70. Megjithatë, GJEDNJ gjithashtu ka pranuar se "s*htetet* kontraktuese kanë *liri* më të madhe *veprimi* kur kanë të bëjnë me çështjet civile *lidhur* me të drejtat dhe obligimet civile se sa kur kanë të bëjnë me lëndët penale" (Shih, Dombo Beheer B.V. kundër Holandës, paragrafi 32; Levages PRESTATIONS Services kundër Francës, paragrafi 46).

71. Edhe pse një gjykatë e rregullt ka një liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e argumenteve dhe në pranimin e provave, neni 6.1 nuk kërkon një përgjigje të detajuar për secilin argument (Shih, Suominen kundër Finlandës*, para.* 36;. Van de Hurk kundër Holandës, par. 61; Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], paragrafi 26; Jahnke dhe Lenoble kundër Francës (dec); Perez kundër Francës [DHM], paragrafi 81; Ruiz Torija kundër Spanjës, paragrafi 29; Hiro Balani kundër Spanjës, paragrafi 27).

72. Përveç kësaj, GJEDNJ-ja ka përcaktuar se neni 6.1 nuk kërkon nga Gjykata Supreme që të japë arsyetim më të detajuar kur thjesht zbaton një dispozitë të veçantë ligjore për të hedhur poshtë një kërkesë në çështje të ligjit (Burg dhe të tjerë kundër Francës, (dec); Gorou kundër Greqisë (nr. 2) [DHM], paragrafi 41).

73. Për më tepër, kur hedh poshtë ankesën, një gjykatë e apelit në parim mund të mbështesë arsyet e vendimit të gjykatës më të ulët (*Garcia* Ruiz kundër Spanjës [DHM] paragrafi 26). Megjithatë, nocioni i procedurës së drejtë përcakton që një gjykatë vendëse, e cila ka dhënë arsye të pakta për vendimet e saj, në të vërtetë ka adresuar çështjet themelore që i janë dorëzuar juridiksionit të saj (*Helle* kundër Finlandës, paragrafi 60).

74. Në rastin konkret, Gjykata vëren se çështja kontestuese është një rast civil në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile; Gjykata Supreme ka qenë e vetëdijshme për shkaqet e revizionit dhe i ka trajtuar ato, duke

përfshirë gabimet e faktit, të ngritura vetëm në Gjykatën e Apelit; çështja kryesore kontestuese ka të bëjë me aplikimin e dispozitave të veçanta ligjore; dhe Gjykata Supreme mbështeti disa arsye të shkallëve më të ulëta, por ajo gjithashtu adresoi çështjet thelbësore që kryesisht kanë të bëjnë me gabime lidhur me të gjeturat faktike dhe lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

75. Gjykata më tej rikujton se parashtruesi i kërkesës, në mbështetje të argumenteve të tij, i referohet Aktgjykimit të kësaj gjykate në Rastin nr. KI72/12, parashtrues të kërkesës *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, të 7 dhjetorit 2012. Gjykata rikujton se, në Rastin nr. KI72/12, gjykatat e rregullta i kishin shpërfillur plotësisht çështjet kyç dhe nuk ishin përgjigjur në to dhe në dëshmitë e paraqitura nga parashtruesi i atëhershëm i kërkesës.

76. Në këtë rast, Gjykata konsideron se parashtruesit të kërkesës i ishin ofruar përgjigje në pretendimet e tij ligjore për shkeljen e procedurës kontestimore, në zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe, gjithashtu, në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj, nuk mund të tërhiqen paralele ndërmjet dy rasteve: Rasti KI72/12 ngre çështje kushtetuese; Rasti i tanishëm KI118/14 ngre çështje të ligjshmërisë.

77. Parashtruesi i kërkesës vëren se "*nëse Aktgjykimi i ankimuar nuk do të prishet dhe po qe se shpallet si nule instrumenti i 'kamatës ndëshkimore' apo 'kamatëvonesës' do të rrënohej i gjithë sistemi i marrëdhënieve detyrimore në të holla në përgjithësi dhe sistemi financiar në Kosovë në veçanti*".

78. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është gjykatë e apelit ose gjykatë e cila mund të prishë vendimet e gjykatave të rregullta ose të rigjykojë rastet e shqyrtuara nga to, as nuk mund të rishqyrtojë rastet në të njëjtën mënyrë si Gjykata Supreme dhe as që ka për qëllim të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt apo si një organ legjislativ.

79. Prandaj, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të përcaktojë nëse kamata ndëshkimore mundet ose nuk mundet të zbatohet vis-*à-vis* detyrimeve në të holla dhe pastaj të kujdeset për "*gjithë sistemin në të holla (...) në përgjithësi dhe sistemi financiar në Kosovë në veçanti*", apo të veprojë si organ legjislativ në nxjerrjen e ligjit në mënyrë që të harmonizojë sistemin juridik.

80. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur dhe nuk ka dëshmuar pretendimin e tij se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtat e tij me moszbatimin e dispozitave të nenit 277, në vend të nenit 270 të LMD-së ndaj nenit 4. 1 c) të Marrëveshjes së Kredisë dhe

me mossqarimin nëse kamata ndëshkuese mund apo nuk mund të zbatohet vis-*à-vis* detyrimeve në të holla.

81. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk tregon bindshëm se Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë, duke mos dhënë përgjigje për çdo argument të paraqitur. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e gjykatave të rregullta të vlerësojnë provat e paraqitura dhe të përcaktojnë ligjin e zbatueshëm. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të konstatojë nëse procedurat e gjykatave të rregullta ishin të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë dhe paraqitur ato prova (Shih rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

82. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme e ka kryer procedurën në mënyrë të drejtë dhe ka arsyetuar vendimin në bazat e revizionit, duke përfshirë dhe ato, të cilat, sipas parashtruesit të kërkesës, nuk janë marrë parasysh nga Gjykata e Apelit.

83. Për më tepër, fakti se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e vlerësimit faktik dhe juridik të rastit nuk mund të ngrejë në vetvete një pretendim të argumentueshëm të shkeljes së nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

84. Në këto rrethana, parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar pretendimin e tij për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe, rrjedhimisht, të së drejtës së pronës, sepse ai nuk ka treguar se gjykatat e rregullta i kishin mohuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

Shkelja e të drejtës për mbrojtje të pronës

85. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës më tej pretendoi se "*vendimi i Kontestuar privoi Paraqitësin e Kërkesës nga të drejtat kushtetuese të sanksionuara me Nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës*".

86. Gjykata vëren se pretendimi ishte ngritur nga parashtruesi i kërkesës *"si pasojë e shkeljes së të drejtës kushtetuese të Paraqitësit të Kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm"*.

87. Gjykata tashmë ka konkluduar se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, është i papranueshëm.

88. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk është e nevojshme që të shqyrtohet veçmas pranueshmëria e pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij për mbrojtje të pronës nga neni 46 i Kushtetutës.

89. Si përmbledhje, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe si e tillë e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) d) dhe 2 d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 9 mars 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. dr. Enver Hasani

KI182/14, Parashtrues INTERPRESS R. COMPANY/Ruzhdi Kadriu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. MIc. nr. 22/2014, i 15 korrikut 2014.

KI182/14, Aktvendim për papranueshmëri i 6 marsit 2015, publikuar më 18 mars 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile dhe penale, përgjegjësia subjektive dhe objektive, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete juridike, Masë e përkohshme, përsëritje e procedurës, superekspertizë, kërkesë qartazi e pa bazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin, Rev. Mlc. nr. 22/2014, 15 korrikut 2014 kishte refuzuar të pabazuar revizionin e parashtruesit, përkitazi me ripërsëritjen e procedurës bazuar në konstatimet e reja me superekspertizë në rastin e tij. Ankesa në thelb, ndërlidhej me përgjegjësinë civile dhe penale të parashtruesit përkitazi me lëndimet e rënda trupore që i kishte pësuar dhe kompensimin që duhej paguar palës së tretë.

Parashtruesi ndër të tjera, pretendoi për shkelje të të drejtave të garantuara në nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Parashtruesi, po ashtu, kërkoi vënien e Masës së përkohshme ndaj vendimit të kontestuar.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se gjykatat e rregullta ishin përgjigjur ndaj të gjitha pretendimeve qendrore të parashtruesit, duke shpjeguar konceptin e përgjegjësisë penale dhe civile, dallimet dhe ngjashmëritë e këtyre përgjegjësive, dhe se mungesa e përgjegjësisë subjektive-penale nuk e përjashton përgjegjësinë objektive-civile të parashtruesit. Gjykata Kushtetuese më tej, u shpreh se procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta nuk kishin qenë të padrejta apo arbitrare. Kërkesa u shpall e papranueshme, si qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës. Gjykata Kushtetuese po ashtu, bazuar në rregullin 55 të Rregullores së punës refuzoi kërkesën e parashtruesit për vënien e Masës së përkohshme, për shkak se nuk ishte *prima facie* e arsyetuar dhe se nuk është provuar se me vënien e Masës së përkohshme shmanget dëmi i pariparueshëm, apo se vënia e masës së tillë është me interes publik.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI182/14
Parashtrues
INTERPRESS R. COMPANY/Ruzhdi Kadriu
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Mlc. nr. 22/2014, të 15 korrikut 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Ruzhdi Kadriu, pronar i INTERPRESS R. COMPANY, me vendbanim në Prishtinë, i përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve Sejdiu & Qerkini (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Mlc. nr. 22/2014, të 15 korrikut 2014.

3. Aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 20 gusht 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Mlc. nr. 22/2014, të 15 korrikut 2014, dhe pezullimi i të njëjtit.

5. Parashtruesi pretendon se aktvendimi i kontestuar është në kundërshtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

6. Njëkohësisht, parashtruesi kërkon që Gjykata të vendosë Masën e përkohshme dhe të pezullojë Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Mlc. nr. 22/2014, prej datës së parashtrimit të kërkesës e deri në marrjen e vendimit meritor për këtë rast.

Baza juridike

7. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

8. Më 16 dhjetor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

9. Më 13 janar 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin KSH. KI182/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

10. Më 23 janar 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI182/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues.

11. Më 3 shkurt 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.

12. Më 9 shkurt 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

13. Njëkohësisht, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, ta refuzojë kërkesën e parashtruesit për Masë të përkohshme, me arsyetimin se i njëjti nuk ka ofruar prova bindëse që do të justifikonin vënien e Masës së përkohshme si të domosdoshme për të shmangur dëme të pariparueshme, apo prova se një masë e tillë do të ishte në interes publik.

Përmbledhja e fakteve

14. Nga shkresat e lëndës rrjedh se në kompaninë, e cila është në pronësi të parashtruesit të kërkesës, më 12 tetor 2004, ka ndodhur një aksident në vendin e punës, me ç'rast një punëtor ka pësuar lëndime të rënda trupore.

15. Në vitin 2005, punëtori i lënduar inicioi proces gjyqësor civil kundër parashtruesit të kërkesës, në lidhje me këtë aksident, për kompensimin e dëmeve të shkaktuara në vendin e punës si rezultat i aksidentit. Krahas padisë për kompensimin e dëmit, në vitin 2007, punëtori i lënduar, paraqiti gjithashtu kallëzim penal kundër parashtruesit të kërkesës, duke pretenduar se parashtruesi i kërkesës do të duhej të shpallej penalisht i përgjegjshëm për aksidentin e sipërpërmendur në vendin e punës të parashtruesit të kërkesës.

Procedura para gjykatave të rregullta për kompensimin e dëmit

16. Më 27 prill 2006, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin *[*C. nr. *405/05], miratoi* pjesërisht *padinë civile të punëtorit të lënduar dhe detyroi parashtruesin e kërkesës që* punëtorit *të përmendur t'ia bëjë kompensimin monetar për dëmin e shkaktuar nga lëndimi në punë. Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata Komunale, ndër të tjera, theksoi:*

> *„Të tre ekspertet e caktuar nga kjo gjykatë për vlerësimet specifike të tyre lidhur me çështjen e paditësit janë ekspertë cilësor dhe kompetent për dhënjen e vlerësimeve që kanë dhënë – për çka gjykata ka vlerësuar se nuk ka nevojë të caktohen të tjerë, ashtu siç ka kërkuar e autorizuara e të paditurës për çka edhe nuk i ka miratuar aso lloj propozimesh sikurse nuk i ka miratuar propozimin për dëgjimin dy herë të të njajtit dëshmitarë."*

17. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, *C. nr. 405/05.*

18. Më 25 qershor 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë [AC. nr. 114/2007] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, mirëpo të njëjtin e ndryshoi në pjesën e cila ka të bëjë me shumën e kompensimit monetar që do t'i jepet punëtorit të lënduar dhe e ktheu çështjen në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje, në lidhje me aspektin e kompensimit të shpenzimeve dhe të rentës kapitale e cila më herët i ishte caktuar punëtorit të lënduar.

19. Më 11 shtator 2007, parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, [AC. nr. 114/2007].

20. Më 26 prill 2008, Gjykata Supreme e Kosovës [Rev. nr. 342/2007] refuzoi një pjesë të revizionit, ndërsa e pranoi pjesërisht revizionin e kërkuar duke e ndryshuar pjesërisht aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë në lidhje me aspektin e kompensimit të shpenzimeve dhe të rentës kapitale. Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata Supreme e Kosovës, ndër të tjera, theksoi:

> *„Thëniet e të padituës lidhur me ekzistimin e bazës juridike të përgjegjësisë janë të pabazuara, ngase, siç del nga provat e administruara – konstatimi dhe mendimi i ekspertit të makinerisë, deri te lëndimi i paditësit ka ardhur si pasojë e mos vlerësimit të rrezikut dhe mungesës së përgatitjes së paditësit lidhur me përdorimin e makinës me të cilën ka punuar paditësi dhe është lënduar, mossigurimin e udhëzimit të përdorimit të makinës në gjuhën e punëtorit, mos vendosjes së plakës mbrojtëse të cilindrave të makinës. Prandaj, për shkak të lëshimit të ndërmarrjes së këtyre masave ekziston përgjegjësia për shpërblimin e dëmit sipas fajësisë në kuptim të nenit 158 lidhur me nenin 18 të dhe 154 të LMD. Për faktin se nuk është siguruar pllaka mbrojtëse e cilindrave të makinës, makina si e tillë e cila përdoret në ushtrimin e veprimtarisë paraqet send të rrezikshëm, prandaj si e tillë, po qe se përdoret në ushtrimin e veprimtarisë së shtypshkronjës, përfaqëson rrezik të shtuar, për të cilin kërkohet kujdes i ekonomistit të mirë dhe për dëmin e shkaktuar nga sendi i tillë ose veprimtaria ekziston edhe përgjegjësia objektive në kuptim të nenit 173 dhe 174 të LMD, siç drejt kanë gjetur gjykatat e instancës më të ulët."*

Procedura sipas kallëzimit penal të palës së dëmtuar

21. Krahas padisë për kompensimin e dëmit, në vitin 2007, punëtori i lënduar paraqiti kallëzim penal kundër parashtruesit të kërkesës, duke e konsideruar parashtruesin e kërkesës penalisht përgjegjës për aksidentin e përmendur në punë.

22. *Ndërkohë, në procedurën penale,* gjyqtari *i procedurës paraprake kishte pranuar kërkesën e Prokurorit Publik për kryerjen e ekspertizës së re lidhur me hetimet që janë* zhvilluar *ndaj parashtruesit të kërkesës, ku më herët ishin kryer dy ekspertiza. Ekspertiza e parë ishte kryer nga eksperti Fehmi Bajrami, në shtator të vitit 2007, me shenjën GJPPN nr. 892/2007, dhe meqenëse kjo ekspertizë ishte në kundërshtim me ekspertizën e kryer nga eksperti*

Agim Millaku, Gjykata pranoi kërkesën e Prokurorit për kryerjen e një superekspertize nga prof. dr. Bajrush Bytyqi, prof. dr. Fehmi Krasniqi dhe prof. dr. Hysni Osmani, me shenjën GJPPN 892/07, të 22 shkurtit 2010. Më tej, pas kryerjes së këtyre ekspertizave, Prokurori Publik Komunal me Aktvendimin me numër PPN. nr. 518-8/2007, të 30 qershorit 2010, e hodhi poshtë kallëzimin penal të ushtruar nga paditësi, gjegjësisht, punëtori i lënduar, kundër Presidentit të Kompanisë „Interpress R. Company", sh.p.k. Në arsyetimin e vendimit të saj, Prokuroria Publike Komunale theksoi:

> *„Andaj pas analizimit të shkresave të kallëzimit penal, mbrojtjes së të dyshuarit, deklaratës së dëmtuarit, dëshmis së dëshmitarëve si dhe provave materiale - ekspertizave të ekspertëve të lartcekur, Prokurori nuk gjeti prova se në veprimet e dyshuarit manifestohen elementet e veprës së cekur si në diapozitiv të këtij Aktvendimi, sepse lëshimet e punëdhënësit të cekura në ekspertizën e fundit nga ekspertët, më tepër i përkasin lëmisë civile – kontest civil, për çka i dëmtuari ka iniciuar me padi procedurë për kompensim të dëmit pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë për shkak të lëndimit të rëndë të pësuar në vendin e punës tek punëdhënësi, siç shihet nga dëshmitë të cilat gjinden në shkresat e lëndës, prandaj në bazë të këtyre arsyeve u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi."*

23. Më 20 maj 2013, Gjykata Themelore në Ferizaj e hodhi poshtë aktakuzën e punëtorit të lënduar, si paditës subsidiar, të ngritur kundër parashtruesit të kërkesës. Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata Themelore në Ferizaj theksoi:

> *„I pandehuri në asnjë mënyrë nuk rezulton se të ketë dëshiruar kryerjen e kësaj vepre penale respektivisht nuk i ka dëshiruar pasojat (lëndimin e rëndë trupor të paditësit subsidiar Lulzim Rexha), e aq më tepër nuk ekzistonë ndonjë veprim që të ketë ndërmarrë i pandehuri në drejtim të kryerjes së kësaj vepre penale, megjithatë në rastin konkret kemi të bëjmë me çështje të natyrës civilo-juridike, përkatësisht të marrëdhënieve detyrimore nga se faktet e çështjes – mendimet e ekspertëve nuk kanë gjetur prova sa i përket përgjegjësisë penale të të pandehurit në drejtim të kësaj vepre penale, ngase lëshimet e të pandehurit si punëdhënës, të cekura në ekspertizë respektivisht super ekspertizë të ekspertëve i përkasin lëmisë civile."*

Procedura sipas kërkesës për përsëritjen e procedurës

24. Më 16 tetor 2007, parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, para Gjykatës Komunale në Prishtinë paraqiti kërkesë për përsëritjen e procedurës, duke e bazuar kërkesën në gjetjet e "superekspertizës" së re.

25. Më 23 gusht 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktvendimin, *C. nr. 1160/08, refuzoi* propozimin *e parashtruesit të kërkesës për përsëritjen e procedurës. Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata Komunale theksoi:*

> *„Gjykata e shkallës së parë vlerëson se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për lejimin e përsëritjes së procedurës, ashtu siq është përcaktuar me nenin 421 parag. 1 pika 9 të Ligjit për procedurën kontestimore, kjo për faktin se prej momentit të përfundimit të seancës së nxjerrjes së provës me dëgjimin e ekspertit të mbrojtjes në punë, më dt. 09.01.2006, kur ka bërë vërejtje në ekspertizë i padituri e deri më dt. 27.04.2007, kur ka përfunduar shqyrtimi kryesor para gjykatës së shkallës së parë, i padituri ka pasur mundësin e mjaftueshme kohore dhe të drejtën procedurale të provoj faktin, nëse e ka pasur provën, se i padituri ka marrë masat e nevojshme të mbrojtjes dhe sigurisë teknike në makinë ku është shkaktuar aksidenti, provën se e ka aftësuar paditësin në aspektin e mbrojtjes në punë, provën e përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësive në punë për paditësin dhe me këto prova të rrëzon mendimin e ekspertit Agim Millakut sa i përket çështjes së përgjegjësisë në aksident, sikundër këtë të drejtë procedurale ka pasur mundësinë ta shfrytëzoi edhe me ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, sa i përket provimit të faktit qensor, pasi kjo barr e provës e ngarkon të padituri. Po ashtu, fakti i marrjes së masave të sigurisë në punë para aksidentit, dt. 11.10.2004, nuk u provua, as me provën e re të super ekspertizë së dt. 20.02.2010 dhe nga kjo arsye u refuzua propozimi për përsëritjen e procedurës."*

26. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë [C. nr. *1160/08].*

27. Më 1 nëntor 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin [AC. nr. 5143/12], refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale, *C. nr. 1160/08. Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata e Apelit theksoi:*

„Gjykata konsideron se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore, si ai për ndërprerjen e procedurës kontestimore, për shkak të inicimit të procedurës penale..., për faktin sepse në procedurën kontestimore, gjykata vërtet është e lidhur për ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale, në kuptim të nenit 12 al. 3 të LPK, për aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, mirëpo, aktgjykimi i gjykatës penale nuk e zgjidh edhe çështjen e vëllimit të përgjegjësisë juridiko civile, veçse për këtë çështje duhet vendosur në procedurën kontestimore në të cilën mund të vërtetohen faktet që kanë të bëjnë me rrethanat rreth kompensimit të dëmit. Nuk qëndron as pretendimi ankimor nga p. 6 dhe 7 e ankesës, sepse gjykata e shkallës së parë seancën gjyqësore e ka mbajtur në kuptim të nenit 425 al. 3 të LPK-së, si kundër që nuk qëndrojnë as pretendimet ankimore nga p. 8, 9, 10 e ankesës, për faktin se përgjegjësia penale është përgjegjësi subjektive, kurse përgjegjësia civile (detyrimore) është edhe objektive siç është rasti konkret. Sa i përket pretendimeve tjera ankimore, kjo gjykatë konsideron se ato nuk kanë mundur dhe nuk kanë patur ndikim relevant në marjen e këtij aktvendimi."

28. Më 9 dhjetor 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër Aktvendimit [AC. nr. 5143/12*]* të Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

29. Më 20 janar 2014, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës paraqiti në Gjykatën Supreme të Kosovës kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të shkeljes së ligjit në Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AC. nr. 5143/12.

30. Më 15 korrik 2014, Gjykata Supreme, me Aktvendimin [Rev. Mlc. nr. 22/2014], e refuzoi si të *pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës si dhe kërkesën për mbrojtje të* ligjshmërisë *të Prokurorit të Shtetit të Kosovës, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me numër Ac. nr. 5143/12. Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata Supreme, ndër të tjera, theksoi:*

„Kjo gjykatë, vlerësoi thëniet e revizionit, se gjykata e shkallës së dytë, nuk ka zbatuar dispozitat e nenit 204 të LPK, nga se nuk ka vlerësuar ankesën për faktet me rëndësi vendimtare, dhe atë vlerësimin e ekspertizës së ekspertit gjyqësor Fehmi Bajramit, deklaratat e ekspertëve gjyqësor të dhëna në Prokurorinë Publike Komunale në Prishtinë, lidhur me zhvillimin e procedurës penale, ndaj përfaqësuesit ligjor të padituës, por gjeti se janë të pa bazuara, sepse gjykata e shkallës së dytë ka bërë vlerësimin e thënieve të ankesës që kanë qenë të rëndësisë vendimtare për dhënien e vendimit të saj në kuptim të nenit 204 të LPK, duke

dhënë arsye të mjaftuara në pajtim me ligjin, me vet faktin se gjykata e shkallës së dytë në arsyetimin e aktvendimit të saj ka pranuar në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e cila në aktvendimin e saj ka dhënë arsye të plota për faktet vendimtare lidhur me vlerësimin e provave të paraqitura me propozimin për përsëritjen e procedurës."

Pretendimet e parashtruesit

31. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev. Mlc. nr. 22/2014, të 15 korrikut 2014, e ka shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, dhe se i njëjti vendim e ka shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës në mjete efektive juridike, nga nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës, dhe nga neni 13 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

32. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që:

„I. Të shpallë se Kërkesa e Parashtruesit të kërkesës është e pranueshme;

II. Duke marrë parasysh shkeljet e të drejtave të garantuara me Kushtetutë të Parashtruesit të Kërkesës dhe dëmit të pariparueshëm që do të mund të shkaktohej, dhe në përputhje me nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Neneve 54 dhe 55 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të vendosë masë të përkohshme, pezullimin e Aktvendimit Rev. Mlc. nr. 22/2014 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës deri në vendosjen përfundimtare të këtij rasti;

III. Të konstaton se të drejtat kushtetuese për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut si dhe e drejta për mjete efektive juridike e garantuar me nenin 32 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut të Parashtruesit të kërkesës janë shkelur nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës përmes Aktvendimit Rev. Mlc. nr. 22/2014.

IV. Të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin Rev. Mlc. nr. 22/2014 të Gjykatës Supreme, të 15 korrikut 2014.

V. Të përcaktojë dhe vendosë çfarëdo mase tjetër juridike që Gjykata Kushtetuese e vlerëson si të bazuar në Kushtetutë dhe në Ligj dhe e cila është e arsyeshme për rastin në fjalë."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

33. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

34. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

35. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendohet se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

36. Gjykata më tej merr parasysh edhe rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi e pabazuar, nëse bindet se:

(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

(b) aktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

37. Gjykata vëren se, në këtë rast, parashtruesi i kërkesës ankohet për faktin se gjykatat e rregullta e kanë hedhur poshtë propozimin e tij për përsëritje të procedurës, dhe se ekspertiza shtesë dhe superekspertiza, nuk janë marrë parasysh gjatë tërë procedurës gjyqësore.

38. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Prishtinë, në procedurën për përsëritjen e procedurës, ka ofruar arsye të shumta për gjetjet e saj (shih paragrafin 23). Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme i kanë arsyetuar vendimet e veta dhe e kanë argumentuar çdo pretendim të parashtruesit të kërkesës në lidhje me refuzimin e propozimit të tij.

39. Gjykatat e rregullta në mënyrë specifike kanë përshkuar llojet e ndryshme të përgjegjësisë ligjore ndërmjet procedurave penale në rastin penal dhe procedurave civile në rastin civil, duke përmbledhur se barra e provës në rastin penal ka qenë objektive dhe subjektive, ndërsa në procedurën civile barra e provës ka qenë vetëm objektive.

40. Në procedurën kontestimore, gjykatat e rregullta kanë arsyetuar se e tëra që nevojitej të dëshmohej ishte se në procesin e punës të parashtruesit të kërkesës ishte neglizhuar rrezikshmëria dhe se ky rrezik ishte shkaku i drejtpërdrejtë i lëndimeve të punëtorit (vetëm standardi objektiv).

41. Në procedurën penale, gjykatat e rregullta kanë arsyetuar se para se të merrej një aktgjykim kundër parashtruesit të kërkesës, do të duhej të dëshmohej se vendi i punës ka qenë i rrezikshëm dhe se parashtruesi i kërkesës ka qenë në dijeni se ai është i rrezikshëm dhe që parashtruesi i kërkesës qëllimisht nuk ka ndërmarrë asnjë masë për ta larguar rrezikun apo për t'i mbrojtur punëtorët që punojnë aty (standardi objektiv dhe subjektiv). Vetëm pse prokurori dhe gjykatat e rregullta kanë konstatuar se nuk ka pasur asnjë dëshmi se parashtruesi i kërkesës ka shkelur qëllimisht standardet për sigurinë në punë, nuk ka nënkuptuar se vendi i punës së parashtruesit të kërkesës nuk ka qenë i rrezikshëm për punëtorët që kanë punuar aty dhe shkaku i

drejtpërdrejtë i lëndimeve të punëtorit. Pasi që këto dy standarde të provave janë të ndryshme për një procedurë kontestimore kundrejt një procedure penale, është e mundshme të ketë rezultate të ndryshme në procedurën kontestimore nga ajo penale, siç ka ndodhur në rastin e parashtruesit të kërkesës.

42. Gjykata Supreme, në vendimin e saj, thekson se përmbajtja e vlerësimit të ekspertizës së ekspertit gjyqësor në procedurën civile dhe e vlerësimit të dhënë nga ekspertët gjyqësorë në procedurën penale me superekspertizë, sa i përket përgjegjësisë objektive të parashtruesit, janë në tërësi në harmoni me njëra-tjetrën. Gjithashtu, Gjykata Supreme vlerësoi se ekspertiza e dhënë në procedurën penale nuk paraqet provë të re, ngase kjo provë ka qenë objekt shqyrtimi sipas revizionit dhe plotësimit të revizionit të 5 tetorit 2007, të parashtruesit të kërkesës kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë në procedurën për kompensimin e dëmit.

43. Gjykata ripërsërit se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e marra nga Gjykata Supreme. Është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.* 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

44. Në këtë rast, Gjykata nuk gjen se procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, GJEDNJ, Vendimi për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

45. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se si dhe pse të drejtat dhe liritë e tij, të mbrojtura me Kushtetutë, janë shkelur me vendimin e kontestuar.

46. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës.

Vlerësimi i kërkesës për Masë të përkohshme

47. Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesë kërkon që Gjykata të vendosë Masën e përkohshme dhe të pezullojë Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Mlc. nr. 22/2014, të 15 korrikut 2014, prej

datës së parashtrimit të kërkesës e deri në marrjen e vendimit meritor nga Gjykata Kushtetuese për këtë çështje, e cila është objekt i procedurës.

48. Në mënyrë që të lejojë Masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) (a) të Rregullores së punës, Gjykata duhet të konstatojë që:

"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; dhe

(c) Masa e përkohshme është me interes publik".

49. Siç është konstatuar paraprakisht, kërkesa është e papranueshme. Për këtë arsye, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe 36 (2) dhe me rregullin 55 (4) a), si dhe me atë 56 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 6 mars 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. Ky vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. dr. Enver Hasani

KI120/14, Parashtrues Agjencia Kosovare e Privatizimit, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, II. C. nr. 79/2009, të 27 tetorit 2009 dhe të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. Nr. 45/2012, të 20 majit 2013.

KI120/14, Aktvendim për Papranueshmëri i datës 12 shkurt 2015, publikuar më 19 mars 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkesë e paafatshme.*

Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin, Ae. nr. 45/2012, të 20 majit 2013 kishte vërtetuar vendimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe refuzuar ankesën e parashtruesit të pabazuar përkitazi me kompensimin e dëmeve të kooperativës bujqësore "Lavra" në Klinë.

Parashtruesi ndër të tjera, pretendoi se Gjykata e Apelit nëpërmjet vendimit të saj ka shkelur të drejtën tij të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se vendimi i fundit i dorëzuar nga gjykatat e rregullta, e deri në ditën e dorëzimit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese kanë kaluar më shumë se 4 (katër) muaj. Kërkesa u shpall e papranueshme për shkak se nuk është dorëzuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI120/14
Parashtrues
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, II. C. nr. 79/2009, të 27 tetorit 2009, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. nr. 45/2012, të 20 majit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Agjencia Kosovare e Privatizimit, Zyra Rajonale në Pejë (në tekstin e mëtejmë: AKP-ja), e cila përfaqësohet nga z. Gëzim Gjoshi, Zyrtar Ligjor në AKP.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, II. C. nr. 79/2009, të 27 tetorit 2009 dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. nr. 45/2012, të 20 majit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 17 qershor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, II. C. nr. 79/2009, të 27 tetorit 2009, me të cilin ishte refuzuar padia e parashtruar nga AKP-ja kundër Komunës së Klinës, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. nr. 45/2012, të 20 majit 2013, me

të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruar nga AKP-ja, si e pabazuar, dhe ishte vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 në lidhje me nenin 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 22 korrik 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI120/14 caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 20 gusht 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.

8. Më 17 nëntor 2014, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë që të dorëzojë një kopje të fletëkthesës, që tregon datën kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar aktgjykimin e kontestuar.

9. Më 1 dhjetor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi dokumentin e kërkuar në Gjykatë, i cili dëshmon se parashtruesi i kërkesës e ka pranuar aktgjykimin e kontestuar më 17 qershor 2013.

10. Më 12 shkurt 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 6 mars 2009, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar padi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë kundër Komunës së Klinës për kompensimin e dëmeve që janë shkaktuar nga rrënimi i Hotelit "Mirusha", pjesë e Kooperativës Bujqësore "Lavra", e cila si një ndërmarrje shoqërore në përputhje me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 03/L-067 (i miratuar më 21 maj 2008), është nën administrimin e AKP-së.

12. Më 27 tetor 2009, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë nxori Aktgjykimin II. C. nr. 79/2009, duke refuzuar padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, *inter alia*, thuhet se: "*Për tu sajuar përgjegjësia juridiko-civile e kompensimit të dëmit në bazë të nenit 154 dhe 158 të LMD-ës, duhet detyrimisht të përmbushen këto kritere dhe atë që paditësi pësoi dëm për shkak të veprimit të palejuar dhe kundërligjor të padituri, dhe i padituri për veprimin e tij të jetë përgjegjës për shkaktimin e dëmit me rrënimin e objektit dhe asgjësimin e gjësendeve, që këto veprime që janë ndërmarrë të jenë në kundërshtim me Ligjin, për dëmin e shkaktuar të jetë fajtor i padituri si dhe të ekziston lidhja e kauzave ndërmjet veprimeve kundërligjore, të padituri dhe dëmeve të shkaktuara. Duke i vlerësuar provat e nxjerra dhe faktet e vërtetuara Gjykata erdhi në përfundim se të gjitha veprimet juridike për rrënimin e motelit "Mirusha" në Klinë, janë marrë në vështrim të dispozitave të Ligjit për ndërtimet, me që komuna disponon dhe administron me tokën komunale publike urbane, dhe me të gjitha objektet që gjinden në të*".

13. Më 14 janar 2010, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës duke kontestuar Aktgjykimin II. C. nr. 79/, të 27 tetorit 2009, për shkak të *"shkeljes së dispozitave të së drejtës materiale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale"*.

14. Më 20 maj 2013, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin Ae. nr. 45/2012, duke e refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, Gjykata e Apelit konstatoi se: *"Gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar drejt të drejtën materiale, ngase paditësja as në procedurën e shkallës së parë, e as në procedurën ankimore nuk ka ofruar prova me të cilat do të kishte provuar bazueshmërinë e kërkesëpadisë, sipas dispozitës së nenit 319 të LPK, nëse gjykata në bazë të provave të administruara nuk mund të vërtetoj me siguri ndonjë fakt mbi ekzistimin e fakteve, ajo me zbatimin e rregullave të barrës së provave, në rastin konkret do të konkludojë se barrën e provave për të provuar bazueshmërinë e padisë e ka paditësi, prandaj gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur ka konkluduar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është nxjerrë me shkelje të së drejtës së tij të garantuar me Kushtetutë

dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), përkatësisht:

" i) Shkelje të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të përcaktuar me kapitullin VII, neni 102, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me të cilin përcaktohet se gjykatat gjykojnë në bazë të kushtetutës dhe ligjit;

ii) Shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me të cilën është përcaktuar e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm;

iii) Shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, (KEDNJ), nenit 6, me të cilën parashihet gjykim i drejtë dhe i paanshëm; dhe

iv) Shkelje të parimeve të përgjithshme juridike".

16. Parashtruesi po ashtu pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar, është zbatuar gabimisht e drejta materiale dhe se aktgjykimi përmban shkelje substanciale të dispozitave të procedurës kontestimore.

17. Parashtruesi i kërkesës më tej deklaroi se gjykatat e rregullta nuk e kanë aplikuar ligjin e duhur kur i kanë nxjerrë vendimet e tyre në lidhje me kontestin.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, së pari duhet të shqyrtohet nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Kushtetutës, e cila parasheh:

Neni 113.7

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Dhe neni 21.4

"Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".

20. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor…".*

21. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[…]*
>
> *c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi".*

22. Gjykata vëren se vendimi i fundit në procedurë në gjykata të rregullta ishte ai i Gjykatës së Apelit të Kosovës, i nxjerrë më 20 maj 2013 dhe i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 17 qershor 2013, ndërsa parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë më 22 korrik 2014, d.m.th. më shumë se katër muaj nga dita kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar vendimi i Gjykatës së Apelit.

23. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme si e paafatshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 12 shkurt 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. dr. Enver Hasani

KI158/14, Parashtrues Bahri Veseli, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 153/2014, të 4 gushtit 2014, Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR.nr.314/2013, të 29 prillit 2014 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Pn.nr.17/2013, të 7 majit 2013

KI158/14, Aktvendim për papranueshmëri i 22 janarit 2015, publikuar më 19 mars 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, dënim me burgim, shitje e paautorizuar e narkotikëve, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme me Aktgjykimin, Pml. nr. 153/2014 kishte ndryshuar vendimet e gjykatave të instancës më të ulët - vetëm sa i përket cilësimit juridik – kurse pjesën tjetër të vendimeve e kishte vërtetuar përkitazi me dënimin me burgim të parashtruesit për kryerjen e veprës penale posedim dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve dhe lëndëve psikotropike.

Parashtruesi pretendoi se gjykatat e rregullta të Kosovës kishin shkelur Ligjin penal dhe ligjin e procedurës penale në dëm të tij.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se parashtruesi ngre çështje të ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë, vendimet e gjykatave të rregullta ishin të arsyetuara dhe se procedurat nuk ishin të padrejta ose arbitrare. Kërkesa u shpall e papranueshme, si qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI158/14
Parashtrues
Bahri Veseli
Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PML. nr. 153/2014, të 4 gushtit 2014, Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 314/2013, të 29 prillit 2014 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren P. nr. 17/2013, të 7 majit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar i
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Bahri Veseli, me vendbanim në Prishtinë, të cilin e përfaqëson avokati z. Mentor Neziri nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PML. nr. 153/2014, të 4 gushtit 2014, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 314/2013, të 29 prillit 2014, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren P. nr. 17/2013, të 7 majit 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [PML. nr. 153/2014] të 4 gushtit 2014, Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 314/2013] të 29 prillit 2014 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren [P. nr. 17/2013] të 7 majit 2013, me të cilët pretendohet të jenë shkelur dispozitat e procedurës penale në dëm të parashtruesit të kërkesës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 49 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 tetor 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI158/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI158/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

7. Më 14 nëntor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 22 janar 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 7 maj 2013, Gjykata Themelore në Prizren nxori Aktgjykimin [P. nr. 17/2013] me të cilin e dënoi parashtruesin e kërkesës me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 2.500 euro për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229.2 lidhur me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

10. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë brenda afatit ligjor kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [P. nr. 17/2013], të 7 majit 2013.

11. Më 29 prill 2014, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [PAKR. 314/2013] me të cilin aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke e zvogëluar dënimin me burg prej 2 (dy) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj në 2 (dy) vjet burg, dhe vërtetoi dënimin me gjobë.

12. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale.

13. Më 4 gusht 2014, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [Pml. nr. 153/2014] me të cilin aprovoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë. Në aktgjykim, Gjykata Supreme theksoi që: *„Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit, NDYSHOHEN aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren Pn.nr.17/2013 date 7.5.2014 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.314/2013 date 29.4.2014, vetëm sa i parket cilësimit juridik, ashtu që Gjykata Supreme e Kosovës veprimet e të dënuarit juridikisht i cilëson si vepër penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në tentative, nga neni 229 par. 1 lidhur me nenin 20 të KPK... Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i paprekur".*

Ligji relevant

Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës

Neni 20. Tentativa: *„Kushdo që me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar, ai konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale".*

Neni 229: *Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike:*

[...]

Paragrafi 2: *„Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton ose dërgon substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë ose substanca psikotrope me qëllim shpërndarjeje, shitjeje ose oferte për shitje dënohet me gjobë dhe me burgim prej një deri në tetë vjet.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi në kërkesën e tij thekson se ai konsideron se të gjitha gjykatat kishin bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në dëm të të dënuarit, me çka është shkelur ligji penal dhe ligji i procedurës penale.

15. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesën:

„Që Gjykata ta aprovon si të bazuar Kërkesën për Vlersimin E Kushtetutshmeris së Aktgjykimeve të kundërshtuara, dhe të vlerson se që të tri Gjykatat kan bërë me Aktgjykimet e tyre Shkelje të Ligjit Penal dhe dispozitave kushtetuese qe ka te bëjn me të drejtat e të akuzuarve dhe për gjykim të drejt dhe të gjitha këto Aktgjykime të anulohen, dhe të dënuarin ta liroj nga akuza në mungesë të provave".

Pranueshmëria e kërkesës

16. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

17. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

18. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar"

19. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit shqyrtohet nga aspekti i shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka përmendur konkretisht në kërkesën e tij se cilat të drejta dhe liri kushtetuese i janë shkelur me aktgjykimet, të cilat ai i konteston, edhe pse me nenin 48 të Ligjit parashihet:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

20. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi ka bazuar kërkesën e tij në shkelje të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale, prandaj Gjykata konstaton se ajo çfarë parashtruesi ngre në kërkesë është çështje e ligjshmërisë, dhe jo e kushtetutshmërisë.

21. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme në Aktgjykimin [PML. nr. 153/2014] i ishte përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të Kodit penal dhe të Kodit të procedurës penale, kur theksoi:... *„se në dem të dënuarit (parashtruesit të kërkesës) është shkelur ligji penal, meqenëse është shpallur fajtor për veprën penale blerja, posedimi , shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par. 2 të KPK lidhur me nenin 23 të KPK, andaj dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi".* Gjykata Supreme konkludoi në Aktgjykim se*: „... edhe pse e ka ndryshuar cilësimin juridik të veprave penale për të cilët janë dënuar të dënuarit, sa i përket dënimeve nuk ka gjet rrethana të cilat do të ndikonin në uljen e dënimeve të shqiptuar andaj edhe në këtë drejtim aktgjykimet kane mbet të pandryshuara".*

22. Bazuar në këtë, Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe në aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta është i qartë dhe i argumentuar mirë, dhe se procedurat nuk ishin të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).

23. Gjykata Kushtetuese më tej thekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu Rastin KI70/11 parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

24. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës në rastin e tij nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e dispozitave kushtetuese (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

25. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kërkesat për pranueshmëri, duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se vendimi i kontestuar cenon të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë ose KEDNJ.

26. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 22 janar 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetueses**
Snezhana Botusharova	Prof. dr. Enver Hasani

KI186/14, Parashtrues Sahit Kurti, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 153/2014, të 17 qershorit 2014

KI186/14, Aktvendim për papranueshmëri i 6 shkurtit 2015, publikuar më 30 mars 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, kontest pune, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete juridike, kërkesë qartazi e pabazuar.*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin, Rev. nr. 153/2014 refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion përkitazi me ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Parashtruesi ndër të tjera pretendoi se atij i ishin shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe e drejta për mjete juridike siç garantohen me nenin 31 dhe nenin 32 të Kushtetutës, sepse Gjykata Supreme kishte llogaritur gabimisht afatet për paraqitje të ankesës të përcaktuara me Ligjin e punës.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi nuk ka arritur të tregojë dhe të mbështesë me prova, se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese, dhe se ai është i pakënaqur me kualifikimin juridik të fakteve dhe zbatim të ligjit nga gjykatat e rregullta. Kërkesa u shpall e papranueshme, si qartazi e pabazuar ashtu siç është paraparë në rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI186/14
Parashtrues
Sahit Kurti
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 153/2014, të 17 qershorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Sahit Kurti (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) nga Mitrovica, i cili përfaqësohet nga Shoqëria e Avokatëve „Sejdiu & Qerkini“ SH.P.K. nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 153/2014, të 17 qershorit 2014. Me këtë aktvendim është refuzuar si i pabazuar revizioni i parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit CA. nr. 3986/2012 të 16 shtatorit 2013. Aktvendimi i kontestuar i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 15 tetor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat e rregullta kanë llogaritur gabimisht afatet kohore për parashtrim të padisë, dhe në këtë mënyrë janë shkelur

nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 31 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 13 janar 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI186/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI186/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.

7. Më 23 janar 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 6 shkurt 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës ka qenë në marrëdhënie pune si oficer policie në Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK) prej 24 dhjetorit 2000 deri më 4 gusht 2005, kur marrëdhënia e tij e punës ishte ndërprerë me Vendimin Ref. 459 - KPS – 2004, të 4 gushtit 2005.

10. Kundër këtij vendimi, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Komisionin e ankesave në SHPK, e cila ishte refuzuar si e pabazuar.

11. Më 6 tetor 2005, parashtruesi i kërkesës ishte njoftuar për vendimin e Komisionit për ankesa, përmes shkresës së SHPK-së, e cila i ishte dorëzuar atij më 14 tetor 2005.

12. Më 25 nëntor 2005, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, kundër vendimit të Komisionit për ankesa të SHPK-së.

13. Më 14 mars 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktvendimin C1. nr. 264/07, të 14 marsit 2012, i cili ishte bazuar në nenin 83 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës si të palejueshme, pasi ajo ishte paraqitur pas afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh.

14. Më 20 korrik 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë.

15. Më 16 shtator 2013, Gjykata e Apelit në Prishtinë, me Aktvendimin Ca. nr. 3986/2012, refuzoi ankesën si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C1. nr. 264/07, të 14 marsit 2012. Arsyetimi ishte se *„gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se paditësi padinë e ka paraqitur pas afatit të paraparë ligjor, me ç'rast ka humbur të drejtën të kërkojë mbrojtje gjyqësore nga marrëdhënia e punës”.*

16. Më 11 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ca. nr. 3986/2012, të 16 shtatorit 2013.

17. Më 17 qershor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev. nr. 153/2014 e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion, me arsyetimin si në vijim:

> *“... Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitën e nenit 83 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës, për arsye se ky afat është prekluziv dhe pas skadimit të tij punëtori e humbë të drejtën e mbrojtjes gjyqësore, prandaj, padia e paraqitur pas këtij afati doemos duhet të hidhet poshtë si e pasafatshme, andaj gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi se thëniet e cekura në revizion janë të pabazuara. Në revizion nuk është cekur asnjë rrethanë e cila do ta vente në dyshim ligjshmërinë e aktvendimit të kundërshtuar”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës konsideron se për shkak të llogaritjes së gabueshme të afateve kohore nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete

Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

19. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata si në vijim:

" I. Që të shpallë se Kërkesa e Parashtruesit të Kërkesës është e pranueshme;

II. të konstaton se e drejta kushtetuese e parashtruesit të kërkesës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut e ndërlidhur edhe me të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe të drejtën për mjete efektive juridike e garantuar me nenin 54 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut është shkelur nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës përmes Aktvendimit Rev. nr. 153/2014;

III. të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin Rev. nr. 153/2014 të Gjykatës Supreme, të datës 17.06.2014

V. të përcaktojë dhe vendosë çfarëdo mase tjetër juridike që Gjykata Kushtetuese e vlerëson si të bazuar në Kushtetutë dhe në Ligj dhe e cila është e arsyeshme për rastin në fjalë".

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

21. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

22. Gjykata gjithashtu thekson nenin 48 të Ligjit, i cili thotë:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

23. Përveç kësaj, Gjykata përkujton rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili thotë:

> *„(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> ...
>
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese“.*

24. Duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me aplikimin e gabuar të së drejtës procedurale dhe materiale nga ana e gjykatave të rregullta, Gjykata ripërsërit se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse juridike. (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

25. Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 153/2014, i 17 qershorit 2014, jep përgjigje të arsyetuar në të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës, lidhur me mënyrën e llogaritjes së afateve si dhe arsyet e aplikimit të rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale.

26. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kryesisht nuk është i kënaqur me kualifikimin juridik të fakteve dhe të ligjit të zbatuar nga gjykatat e rregullta. Kualifikimi juridik i fakteve dhe ligji i zbatuar janë çështje të ligjshmërisë.

27. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese (Shih, *Vanek kundër Republikës Sllovake*, vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).

28. Edhe pse parashtruesi i kërkesës pretendon se të drejtat e tij janë shkelur me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta, ai nuk ka treguar se si këto vendime kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese.

29. Gjykata në vazhdim thekson se fakti i thjeshtë, se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës në rastin e tij nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e Kushtetutës (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykim i GJEDNJ-së,

kërkesa nr. 5503/02, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

30. Parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që të paraqes rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit si të pasaktë, para Gjykatës Themelore në Prishtinë, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës.

31. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata nuk gjen se procedurat përkatëse, në ndonjë mënyrë, janë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

32. Gjykata konsideron se nuk janë plotësuar kushtet për pranueshmëri. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të tregojë dhe të mbështesë me prova se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese.

33. Nga kjo rrjedh se kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e
papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 6 shkurt 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. dr. Enver Hasani

KI26/14, Parashtrues Bajrush Gashi, Vlerësim i kërkesës për rishqyrtim të Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese KI75/13, të 29 janarit 2013

KI26/14, Vendim për hedhje poshtë të kërkesës i 11 shkurt 2015, publikuar më 2 prill 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, përsëritje e procedurave, hedhje poshtë e kërkesës*

Parashtruesi ndër të tjera kërkoi nga Gjykata Kushtetuese, që t'i rishqyrtojë dhe t'i rivlerësojë edhe një herë vendimet e saj KI123/12 dhe KI75/13, përkitazi me shkeljet që sipas tij janë evidente në vendimet e gjykatave të rregullta.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkesa e parashtruesit, në fakt, ishte kërkesë për përsëritjen e procedurave të mëhershme, tashmë të vendosura nga Gjykata. Kërkesa e parashtruesit u shpall e papranueshme duke u hedhur poshtë ashtu siç është përcaktuar me nenin 116.1 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës dhe specifikuar më tej me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës.

VENDIM
PËR HEDHJE POSHTË TË KËRKESËS
në
Rastin nr. KI26/14
Parashtrues
Bajrush Gashi
Kërkesë për rishqyrtim të Aktvendimit për papranueshmëri KI75/13, të 29 janarit 2013, të Gjykatës Kushtetuese

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Bajrush Gashi, nga fshati Hoçë e Vogël, komuna e Rahovecit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi shpreh pakënaqësi ndaj Aktvendimit për papranueshmëri (Rasti KI75/13) të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), si dhe ndaj vendimeve të gjykatave të rregullta në përgjithësi.

3. Kërkesës së tij, parashtruesi ia ka bashkëngjitur Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 67/2011, të 12 dhjetorit 2011; Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, Kp. nr. 265/2008, të 4 nëntorit 2011; Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, P. nr. 26/2009, të 19 majit 2009; Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, Ka. nr. 231/2008, të 22 janarit 2009; dhe Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut të Prizrenit, Kp. nr. 309/2008, të 26 dhjetorit 2008.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është rishqyrtimi i vendimeve të lartcekura, përkitazi me shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatë

6. Më 10 shkurt 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 6 mars 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI26/14 caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI26/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 14 janar 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 11 shkurt 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Përkitazi me pretendimet e njëjta, të ngritura nga parashtruesi, Gjykata tashmë ka vendosur në Rastin KI123/12, të 29 janarit 2013, dhe në Rastin KI75/13, të 29 janarit 2013.

Përmbledhja e fakteve lidhur me Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, në Rastin KI123/12, të 29 janarit 2013

11. Më 4 dhjetor 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 65/2012, të 10 shtatorit 2012.

12. Parashtruesi, në Rastin KI123/12, pretendonte se me Aktvendimin (Pzd. nr. 65/2012) e Gjykatës Supreme, i ishin shkelur të drejtat e

garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.

13. Gjykata, në Rastin KI123/12, vlerësoi se Gjykata Supreme, me Aktvendimin Pzd. nr. 65/2012, të 10 shtatorit 2012, i korrigjoi shkeljet e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe të nenit 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] të KEDNJ-së, të cilat Gjykata i kishte gjetur në Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 67/12, të 12 dhjetorit 2011, kur shqyrtoi kërkesën e parashtruesit nr. KI06/12, të 9 majit 2012.

14. Parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur fakte ose dëshmi të reja në Gjykatë, të cilat do të paraqisnin bazë të mirë për një vendim të ri.

15. Rrjedhimisht, Gjykata nuk gjeti shkelje të të drejtave të parashtruesit, të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, në Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 65/2012, të 10 shtatorit 2012.

16. Në bazë të fakteve dhe rrethanave që janë paraqitur në kërkesën nr. KI123/12, Gjykata, më 29 janar 2013, përfundoi se kërkesa e parashtruesit ishte e papranueshme.

Përmbledhja e fakteve lidhur me Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, në Rastin KI75/13, të 29 janarit 2013

17. Më 28 maj 2013, parashtruesi sërish dorëzoi kërkesë të re, e cila u regjistrua në Gjykatë, me nr. KI75/13. Nëpërmjet kësaj kërkese, parashtruesi kërkoi sqarim të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht të Aktgjykimit nr. KI06/12, të 9 majit 2012, si dhe të Aktvendimit për papranueshmëri, nr. KI123/12, të 29 janarit 2013.

18. Parashtruesi, në Rastin KI75/13, pretendonte se Gjykata në Aktgjykimin nr. KI06/12, të 9 majit 2012, kishte vlerësuar se ekzistonin shkelje të natyrave të ndryshme, të cilat Gjykata Supreme do të duhej t'i merrte parasysh në ndonjë nga procedurat e ardhshme dhe do të duhej t'i mënjanonte në mënyrë meritore. Parashtruesi më tej në kërkesë theksoi se *"Gjykata Kushtetuese, pas kësaj nxori një vendim tjetër me të cilin kërkesa e tij ishte refuzuar si e pabazuar, pa dhënë ndonjë arsyetim"*.

19. Përkitazi me pretendimet e ngritura, në Rastin KI75/13, Gjykata vlerësoi: *"me qëllim të sqarimit të vendimeve, Gjykata rikujton se, në Aktgjykimin KI06/12, të 9 majit 2012, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje procedurale të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të*

Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së", ndërsa si bazë për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjeti se "*i njëjti gjyqtar që kryesonte Trupin gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren, ka marrë pjesë në Trupin gjykues të Gjykatës Supreme me kërkesë për zbutje të dënimit*".

20. Duke pasur parasysh të gjitha faktet e shtjelluara, në Rastin KI75/13, Gjykata erdhi në përfundim se kërkesa e parashtruesit ishte qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme.

Pretendimet e parashtruesit

21. Në kërkesën e tanishme, parashtruesi nuk ka specifikuar ndonjë shkelje të Kushtetutës, por në fakt kërkon nga Gjykata që t'i rishqyrtojë dhe t'i rivlerësojë edhe një herë shkeljet që, sipas tij, janë evidente në vendimet e bashkëngjitura në këtë kërkesë.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata Kushtetuese, para se ta shqyrtojë kërkesën e parashtruar, së pari vlerëson nëse kërkesa e parashtruesit i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

23. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet rregullit 32 (5) të Rregullores së punës, që përcakton: *"Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose ta qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkese të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze. (Ndryshuar më 28 tetor 2014)"*.

24. Gjykata vëren se parashtruesi, në kërkesën e tanishme, nuk ka paraqitur asnjë fakt të ri a provë të re, në bazë të së cilës do të trajtohej një çështje e cila nuk është trajtuar, ose është anashkaluar të trajtohet në procedurat e mëhershme në Gjykatë. Për të gjitha çështjet e ngritura në këtë kërkesë, Gjykata tashmë ka vendosur.

25. Prandaj, kërkesa e tanishme është kërkesë për përsëritjen e procedurave të shqyrtuara më parë nga Gjykata. Gjykata nuk ka juridiksion të vendosë për çështjet e njëjta juridike për të cilat ka vendosur një herë. Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese, përkitazi me kërkesat individuale, është përcaktuar qartë me nenin 113.7 të Kushtetutës. Me akte individuale të autoriteteve publike në kuptim të nenit 113.7, duhet nënkuptuar të gjitha aktet individuale të

autoriteteve publike të Republikës së Kosovës, që paraqesin objekt të vlerësimit të kushtetutshmërisë, sipas kuptimit të këtij neni, përveç atyre të vetë Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, duhet kuptuar qartë dhe drejtë se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion t'i rihapë dhe t'i gjykojë vendimet e saj, për të cilat ka vendosur një herë.

26. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese dëshiron të rikujtojë se vendimet e saj janë vendime të formës së prerë dhe të detyrueshme për gjyqësorin, për të gjithë personat dhe për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.

27. Përkitazi me këtë, neni 116.1 [Efekti Juridik i Vendimeve] i Kushtetutës, përcakton: *"Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës"*.

28. Si përfundim, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit, në fakt, është kërkesë për përsëritjen e procedurave të mëhershme, tashmë të vendosura nga Gjykata. Prandaj, në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores, kërkesa duhet të hedhet poshtë, si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7, me nenin 116.1 të Kushtetutës, si dhe me rregullin 32 (5) dhe 56 të Rregullores së punës, më 26 mars 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Prof. dr. Enver Hasani

KI64/14, Parashtrues Afrim Nuredini, Vlerësim i kushtetutshmërisë së listës së punëtorëve me të drejtë të kompensimit, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. nr. 340/2001, të 11 janarit 2002, me të cilin ishte aprovuar kërkesa për kompensim të pagave të papaguara të 572 punëtorëve të ndërmarrjes shoqërore të Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK

KI64/14, Aktvendim për papranueshmëri i 11 shkurtit 2015, publikuar më 2 prill 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, e drejta në kompensim, paga të papaguara, mosshterje e mjeteve juridike*

Gjykata Komunale në Ferizaj me Aktgjykimin, C. nr. 340/2001, aprovoi kërkesën për kompensim të pagave të papaguara të Sindikatës së Punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore të Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK, me ç'rast parashtruesi nuk ishte përfshirë në listën e punëtorëve për kompensim.

Parashtruesi pretendoi ndër të tjera, se ai nuk ishte përfshirë në listën e punëtorëve me të drejtë në kompensim, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj për arsye se ai nuk ishte informuar për këtë pasi që ka qenë jashtë Kosovës.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi nuk ka treguar nëse i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, si kusht për dorëzimin e kërkesës së tij siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit. Kërkesa u shpall e papranueshme për shkak të mos shterjes së të gjitha mjeteve juridike.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI64/14
Parashtrues
Afrim Nuredini
Vlerësim i kushtetutshmërisë së listës së punëtorëve me të drejtë të kompensimit, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. nr. 340/2001, të 11 janarit 2002, me të cilin ishte aprovuar kërkesa për kompensim të pagave të papaguara të 572 punëtorëve të ndërmarrjes shoqërore të Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Afrim Nuredini (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me banim në fshatin Sllatinë e Epërme.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi, në kërkesën e tij, në mënyrë eksplicite kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) *"[...] INICIMIN E LIGJSHMËRISË kundër Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Kushtetuese në Prishtinë KI08/09 [...]",* të 17 dhjetorit 2010.

Objekti i çështjes

3. Pretendimi i parashtruesit të kërkesës i është drejtuar Sindikatës së Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK, sepse nuk e ka përfshirë emrin e tij në listën e punëtorëve me të drejtë në kompensim, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. nr. 340/2001, të 11

janarit 2002, me të cilin është aprovuar kërkesa për kompensim të pagave të papaguara të 572 punëtorëve të ndërmarrjes shoqërore Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK.

4. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe kërkon "*Nga Gjykata Kushtetuese të marr aktgjykim qe edhe un si ish puntor te me jepet e drejta ne kompenzim dhe te kompenzohem aq sa me takon per nente vite ne baz te rroges qe e kam pas ne ate koh si ish puntor I ksaj ndërmarrje*".

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 4 prill 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 6 maj 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI64/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI64/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 27 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 15 shtator 2014, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI64/14, zëvendësoi gjyqtarin raportues Robert Carolan me gjyqtarin Ivan Čukalović.

10. Më 11 shkurt 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 19 shkurt 1990, parashtruesit të kërkesës i ndërpritet marrëdhënia e punës me ndërmarrjen shoqërore Fabrikën e Tubave të Çelikut, me arsyetimin se ai ka munguar nga puna për 5 (pesë) ditë pune pa

ndërprerje. Ndërprerja e marrëdhënies së punës ishte bazuar në nenin 75, paragrafi 2, pika 3 të Ligjit mbi të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës, Gazeta Zyrtare RSFJ nr. 60/89 (Vendimi nr. 1386).

12. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën me vetëm 3 (tri) faqe të përbërë nga: 1. Kërkesa për *"[...] INICIMIN E LIGJSHMËRISË kundër Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Kushtetuese në Prishtinë, KI08/09 [...]"*; 2. Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nr. 1386 të 19 shkurtit 1990.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai nuk ishte në listën e punëtorëve me të drejtë në kompensim, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. nr. 340/2001, të 11 janarit 2002, me të cilin ishte aprovuar kërkesa për kompensim të pagave të papaguara të 572 punëtorëve të ndërmarrjes shoqërore Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai nuk ishte informuar për këtë pasi që ka qenë jashtë Kosovës.

14. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se *"Shkelja e ligjit te punes konsideroj se asht bere sepse edhe un si ish puntor i ksaj ndermarrje kam te drejt ne kompenzim per ate para te cilat edhe ligjerisht me takojn"*.

15. Prandaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që *"[...] edhe une si ish puntor te me jepet e drejta ne kompenzim dhe te kompenzohem aq sa me takon per nente vite ne baz te rroges qe e kam pas ne ate koh si ish puntor I ksaj ndermarrje"* .

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që parasheh:

> *"Individët janë autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

18. Përveç kësaj, neni 47.2 i Ligjit gjithashtu parasheh:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

19. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) (b) i Rregullores së punës, parasheh:

"Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar".

20. Në rastin konkret, kërkesa e parashtruesit i drejtohet Sindikatës së Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK, sepse nuk e ka përfshirë emrin e tij në listën e punëtorëve me të drejtë në kompensim, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. nr. 340/2001, të 11 janarit 2002, me të cilin ishte aprovuar kërkesa për kompensim të pagave të papaguara të 572 punëtorëve të ndërmarrjes shoqërore Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK.

21. Gjykata thekson që parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedura të rregullta për ta parandaluar shkeljen e Kushtetutës, nëse ka, ose, për ta korrigjuar shkeljen e një të drejte themelore.

22. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, t'iu ofrohet mundësia për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih, Aktvendimin për papranueshmëri, *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë* së *Republikës* së *Kosovës,* KI41/09, i 21 janarit 2010, dhe shih *mutatis mutandis, Selmouni kundër Francës,* Nr. 25 803/94, GJEDNJ, Vendimi i 28 korrikut 1999).

23. Parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar nëse i ka shteruar të gjitha mjetet juridike dhe kushtetuese në dispozicion si kusht për dorëzimin e kërkesës së tij, siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit.

24. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (b) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 11 shkurt 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Prof. dr. Enver Hasani

KI89/14, Parashtrues Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Pyjore e Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 287/2013, të 18 dhjetorit 2013

KI89/14, Aktvendim për papranueshmëri i 11 shkurtit 2014, publikuar më 2 prill 2015.

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, interpretim i dispozitave ligjore, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme aprovoi revizionin e palës së tretë përkitazi me obligimin e parashtruesit, që atë ta kthej në vendin dhe detyrat e punës si përgjegjëse financiare.

Parashtruesi pretendoi ndër të tjera, se Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi në mënyrë të gabuar gjendjen faktike dhe zbatoi në mënyrë të gabuar ligjin material.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi nuk argumentoi pretendimin në baza kushtetuese, dhe nuk ka ofruar dëshmi që tregojnë si dhe pse të drejtat dhe liritë e tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur me vendimin e kontestuar. Kërkesa u shpall e papranueshme, si qartazi e pabazuar, ashtu siç është paraparë në rregullat 36 (1) d) dhe (2) d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI89/14
Parashtrues
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Pyjore e Kosovës
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 287/2013, të 18 dhjetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Pyjore e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), përfaqësuar nga z. Murat Lepaja.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 287/2013, të 18 dhjetorit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 7 mars 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 287/2013, të 18 dhjetorit 2013, për të cilin parashtruesi nuk ka cekur ndonjë shkelje të dispozitave kushtetuese.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 21.4 të Kushtetutës dhe nenet 20 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë, Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 maj 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI89/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI89/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Altay Suroy dhe Snezhana Botusharova.

7. Më 19 qershor 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës dhe znj. M. G. si palë e tretë në procedurë.

8. Më 23 korrik 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 25 korrik 2014, Gjykata kërkoi nga parashtruesi dorëzimin e fletëkthesës që dëshmon datën kur parashtruesi ka pranuar Aktgjykimin Rev. nr. 287/2013 të Gjykatës Supreme të Kosovës.

10. Më 1 gusht 2014, parashtruesi dorëzoi dokumentacionin e kërkuar nga Gjykata.

11. Më 19 shtator 2014, Gjykata kërkoi nga parashtruesi dorëzimin e padisë për Konflikt Administrativ Ref. SP-575/06, të 2 nëntorit 2006 të parashtruar në Gjykatën Supreme të Kosovës, Aktvendimin e Gjykatës Supreme A. nr. 28881/2006, të 14 marsit 2007, dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ca. nr. 34441/2012 të 14 qershorit 2013, si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Pejë C. nr. 340/2008, të 26 prillit 2012.

12. Më 26 shtator 2014, parashtruesi dorëzoi dokumentacionin e kërkuar nga Gjykata, si dhe Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës A, 02, 100/2006 të 8 korrikut 2006, dhe Formularin e vlerësimit të kryerjes së punës për znj. M. G. të 23 nëntorit 2007.

13. Më 11 shkurt 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve në procedurën administrative

14. Znj. M. G. ka qenë e punësuar nga 5 prilli 2001 deri më 31 dhjetor 2007, si zyrtare Ekonomiko - Financiare pranë Agjencisë Pyjore – Zyra regjionale në Pejë, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës.

15. Më 28 shkurt 2006, parashtruesi me Vendimin Ref. KE-61/06 suspendoi znj. M. G., me largim të përkohshëm nga puna. Parashtruesi i kërkesës konstatoi se znj. M. G. *"[...] gjatë kohës së* punës *nuk i ka përfill obligimet dhe detyrat punonjëse nga neni 30.1 paragrafi (b), (c), (d), (e) dhe (j) të Udhëzimit Administrativ nr. 2013/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës [...]".*

16. Më 18 maj 2006, Komisioni Disiplinor i parashtruesit (Organi punëdhënës i Agjencisë Pyjore të Kosovës) mori Vendim Ref. KE-02/2/166/06 për ndërprerjen e punës së znj. M. G. duke vërtetuar: *"[...] se pas administrimit të provave shtesë e lartpërmendura ka rënë ndesh me Kodin e Shërbimit Civil të Kosovës, dhe është vërtetuar se nuk ka përfillur udhëzimet e arsyeshme të udhëheqësit të organit të punësimit, refuzon dhe saboton punën në shërbimin ekonomiko financiar të specifikacioneve, faturave për fletëpagesa për pyjet publike dhe private, si dhe bënë shpifje dhe përdor fjalor banal dhe i fyen kolegët e vet të stafit teknik por nënçmon e fyen stafin e lartë të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural përkatësisht Zyrën Rajonale të AKP-së në Pejë [...]".*

17. Në një datë të pacaktuar znj. M. G. parashtroi ankesë në Komisionin për Ankesa të parashtruesit (Organit Punëdhënës të Agjencisë Pyjore të Kosovës).

18. Më 8 qershor 2006, Komisioni për Ankesa i parashtruesit të kërkesës mori Vendim nr. 02/2/174/06, për refuzimin e ankesës së znj. M. G.

19. Më 22 qershor 2006, znj. M. G. parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, kundër Vendimit (02/2/174/06), të Komisionit për Ankesa të parashtruesit të kërkesës.

20. Më 8 korrik 2006, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës me Vendimin A, 02, 100/2006 aprovoi ankesën e znj. M. G., si të bazuar dhe anuloi

Vendimin (02/2/174/06) e Komisionit për ankesa të parashtruesit si dhe Vendimin (Ref. 02/2/166/06) e Komisionit disiplinor të parashtruesit të kërkesës.

21. Më 2 nëntor 2006, parashtruesi ka ngritur Kontest Administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër Vendimit (A, 02, 100/2006) të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.

22. Më 14 mars 2007, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin A. nr. 2881/2006 në konfliktin administrativ sipas padisë së parashtruesit, hedh poshtë padinë e parashtruesit si të palejuar duke vlerësuar *[...] se vendimi i kontestuar dhe procedura e cila i ka paraprirë marrjes së atij vendimi nuk e kanë karakterin e aktit dhe procedurës Administrative si parashifet me nenin 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative e duke pasur parasysh dispozitat e ligjeve të cekura më lartë gjen se kompetente për të vendosur në këtë kontest është Gjykata Komunale në Prishtinë [...]".*

23. Më 26 nëntor 2007, znj. M. G. parashtroi ankesë në Komisionin për Ankesa të parashtruesit kundër vlerësimit të kryerjes së punës të 23 nëntorit 2007.

24. Më 30 nëntor 2007, parashtruesi i kërkesës me shkresën Ref. KE 934/07 njoftoi znj. M. G. për mosvazhdimin e kontratës duke u mbështetur në Rregulloren nr. 2001/36 mbi Shërbimin civil të Kosovës dhe Urdhëresën administrative nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së cekur, dhe vlerësimin e punës nga shefi i Zyrës së AKP-së në Pejë.

25. Më 31 dhjetor 2007, Komisioni për Ankesa mori Vendim nr. 1604/13 për refuzimin e ankesës së znj. M. G. si të pabazuar dhe të paargumentuar.

26. Më 24 janar 2008, znj. M. G. parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

27. Më 24 prill 2008, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës me Vendimin Nr. 815/08, refuzoi ankesën e znj. M. G. si të pabazuar dhe vërtetoi njoftimin Ref. KE-934/07, të 30 nëntorit 2007 dhe po ashtu vërtetoi Vendimin (nr. 1604/13) e Komisionit të Ankesave të parashtruesit.

Përmbledhja e fakteve në procedurën gjyqësore

28. Znj. M. G. pasi kishte shterur të gjitha mjetet juridike në procedurë administrative, ka parashtruar kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Pejë, me të cilën ka kërkuar: *"[...] që të anulohet vendimi i të paditurës*

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës në Prishtinë nr. 1604/13 të dt. 31.12.2007 dhe vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, nr. 815/08 të dt. 24.04.2008 si të kundërligjshme dhe të detyrohet e paditura Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës, Agjensioni Pyjor – Zyra Regjionale në Pejë, që paditësen ta kthej në marrëdhënie pune, në punë dhe detyrat e punës që i ka kryer më parë, si përgjegjëse financiare [...]".

29. Më 26 prill 2012, Gjykata Komunale në Pejë me Aktgjykimin C. Nr. 340/2008, refuzoi të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses znj. M .G.

30. Në afatin e paraparë ligjor znj. M. G. parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit C. Nr. 340/08, të Gjykatës Komunale në Pejë.

31. Më 14 qershor 2013, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin Ca. Nr. 3441/2012, refuzoi të pabazuar ankesën e të paditurës znj. M. G. duke vërtetuar Aktgjykimin C. Nr. 340/08, të Gjykatës Komunale në Pejë.

32. Në një datë të pacaktuar, znj. M. G. parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit Ca. Nr. 3441/2012, të Gjykatës së Apelit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të ligjit material.

33. Më 18 dhjetor 2013, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. nr. 287/2013, aprovoi, si të bazuar, revizionin e paditëses znj. M. G., dhe vendosi për ndryshimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ca. nr. 3441/2012, të 14 qershorit 2013 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë, C. nr. 340/2008, të 26 prillit 2012.

34. Duke iu referuar pjesës së vendimit për pranimin, si të bazuar të revizionit, Gjykata Supreme arsyetoi:

> *"[...] gjykatat e instancës më të ulët mbi gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë të drejtë, të drejtën materiale e kanë zbatuar në mënyrë të gabuar kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar në pjesën që ka të bëjë me obligimin e të paditurës që paditësen ta kthejë në marrëdhënie pune, në punët dhe detyrat e punës që i ka kryer më parë si përgjegjëse financiare.*
>
> *Paditësja te e paditura ka punuar që nga data 5. 4. 2001 në kohë të caktuar, në punët dhe detyrat e përcaktuara sipas përgatitjes profesionale. Punët të cilat i ka kryer paditësja në vendin e punës Zyrtare për çështje ekonomiko – financiare nuk kanë karakter të*

natyrës së përkohshme apo të kohë pas kohëshme, por të natyrës së përhershme, çka rezulton se në atë vend të punës është pranuar person tjetër.

Faktin se, mos vazhdimit të kontratës i ka paraprirë vlerësimi negativ i kryerjes së detyrave të punës nga ana e Shefit të Zyrës së AKP-së, Gjykata Supreme vlerësoi, por sipas nenit 12 të Urdhëresës Administrative nr. 2003/2 për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, vlerësimi i punës së çdo nëpunësi civil i nënshtrohet një diskutimi zyrtar së bashku me vlerësimin e menaxherit të saj në baza vjetore si dhe me miratimin e mëpasshëm të menaxherit më të lartë në përputhje me procedurat e vlerësimit të punës që do ti përcaktoi ministria, ndërsa sipas nenit 13 të Ligjit të cekur, organi i punësimit duhet të siguroi aftësim adekuat për nëpunësit civil përfshirë edhe vlerësimin e përmbushjes së detyrave.

35. Duke iu referuar pjesës së vendimit me të cilin çështja kthehet në rigjykim, Gjykata Supreme arsyetoi:

[...] Sa i përket pjesës që ka të bëjë me obligimin e të paditurës që paditëses t'ia kompensojë pagën sikur të jetë në marrëdhënie pune prej 1.1.2008 e tutje, dhe lidhur me caktimin e kamatës në shumën e cekur, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt dhe për këtë arsye nuk ka kushte për ndryshimin e aktgjykimit, kështu që dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët në këtë pjesë janë prishur dhe lënda i është kthye gjykatës së shkallës së parë për rigjykim [...]".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

36. Parashtruesi i kërkesës pretendon *"[...] se Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar gabimisht se në rastin e paditëses kemi të bëjmë thjesht me mosvazhdimin e kontratës së punës, kjo nuk qëndron fare, sepse mosvazhdimit i ka paraprirë masa paraprake e organit kompetent të paditurës, Komisionit Disiplinor, i cili duke shqyrtuar kërkesën për zhvillim të procedurës disiplinore ndaj saj, konform dispozitave në fuqi ka marrë vendim meritor kur e ka shpall përgjegjëse dhe i ka shqiptuar masën adekuate – ndërprerje e marrëdhënies së punës. Zaten këtu qëndron poenta kryesore e kësaj kërkese drejtuar këtij institucioni të respektuar të Republikës së Kosovës, që është përgjegjëse për interpretimin e çdo dispozite ligjore nga të gjitha lëmitë e jetës, në kushtet dhe rrethanat specifike ekzistuese në Kosovë".*

Pranueshmëria e kërkesës

37. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

39. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) i Rregullores së punës, parasheh:

> *(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar..*
>
> *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...]*
>
> *faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*
>
> *[...]*
>
> *d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

40. Gjykata, në rastin konkret vëren se parashtruesi ankohet kryesisht përkitazi me vlerësimin e gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimin e gabuar të ligjit material (ligjshmërinë) dhe në asnjë mënyrë nuk argumenton pretendimin e tij në baza kushtetuese (S*hih pretendimet e parashtruesit në paragrafin 35 të këtij dokumenti*).

41. Gjykata vëren se, pretendimet e parashtruesit të cekura më lart janë të natyrës së ligjshmërisë, për të cilat Gjykata vlerëson se bien në

kompetencë të plotë të Gjykatës Supreme, e cila sipas detyrës zyrtare ka vlerësuar ligjshmërinë e vendimeve të instancave më të ulëta.

42. Për më tepër, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me aktgjykimin e nxjerrë nga Gjykata Supreme. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Detyra e Gjykatës është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato dëshmi (Shih, rasti *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Nr. 13071/87 Raport i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).

43. Në rastin konkret, Gjykata nuk konsideron që procedurat në Gjykatën Supreme, kanë qenë të njëanshme ose në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,* Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

44. Sa i përket pjesës së vendimit me të cilin çështja kthehet në rigjykim, Gjykata vlerëson se rasti është ende në pritje për t'u zgjidhur në procedurë të rregullt gjyqësore (*shih arsyetimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme në paragrafin 33 të këtij dokumenti*).

45. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesi nuk argumentoi pretendimin në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar dëshmi që tregojnë, si dhe pse, të drejtat dhe liritë e tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur me vendimin e kontestuar.

46. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe rregullin 36 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d), 36 (2) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 11 shkurt 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Prof. dr. Enver Hasani

KI127/14, Parashtrues Agron Latifaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 57/2014, të 25 marsit 2014

KI127/14, Aktvendim për papranueshmëri i 30 marsit 2015, publikuar më 2 prill 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, armëmbajtje e paautorizuar, dënim me burgim, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, vepra penale e vrasjes, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin, PML. nr. 57/2014 refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar, dhe vërtetoi aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, ku parashtruesi ishte shpallur fajtor për vrasje dhe armëmbajtje të paautorizuar dhe ishte dënuar me 10 (dhjetë) vjet burgim.

Parashtruesi pretendoi se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

Gjykata Kushtetuese konstatoi se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë shkeljen e pretenduar të të drejtave kushtetuese, dhe se kërkesa ngre çështje të ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë. Kërkesa e parashtruesit u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar, ashtu siç është paraparë në rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI127/14
Parashtrues
Agron Latifaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Pml. nr. 57/2014, të 25 marsit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama- Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Agron Latifaj nga fshati Kllodernicë, komuna e Skënderajt, aktualisht ndodhet në vuajtje të dënimit në burgun e Dubravës, i përfaqësuar nga z. Mahmut Halimi, avokat nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PML. nr. 57/2014, të 25 marsit 2014, me të cilin Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar, dhe vërtetoi aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

3. Ky aktgjykim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 2 maj 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 57/2014 të 25 marsit 2014, me të cilin

pretendohet shkelja e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] paragrafi 2 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenit 3, paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK-së).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 6 gusht 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 5 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI127/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari me Vendimin nr. KSH. KI127/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 15 shtator 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 24 shtator 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 6 shkurt 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 25 maj 2012, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë me Aktgjykimin P. nr. 43/2010 shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale të vrasjes dhe mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve. Gjykata e Qarkut e dënoi atë me 10 (dhjetë) vjet burgim për veprën penale të paraparë me nenin 146 të KPK-së (dispozitivi II), dhe 3 (tre) vjet burgim për veprën penale të paraparë me nenin 328 para. 2 të KPK-së (dispozitivi II), me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) vjetësh.

12. Më 18 tetor 2013, Gjykata e Apelit të Kosovës me Aktgjykimin PAKR. nr. 1108/2012, duke vendosur për ankesat e palës së dëmtuar E.N. dhe të parashtruesit të kërkesës (i pandehuri), dhe në përgjigjen ndaj ankesave të parashtruara nga Prokurori Special, e aprovoi ankesën e palës së dëmtuar, E.N., dhe në Aktgjykimin P. nr. 43/2010 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë ndryshoi vendimin për dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjetësh. Në dënimin e ndryshuar të pandehurit/parashtruesit të kërkesës i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 5 marsit 2010. Ankesa e parashtruar nga mbrojtja e të akuzuarit Agron Latifaj, u refuzua si e pabazuar.

13. Pas kësaj, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, kundër Aktgjykimit PAKR. nr. 1108/2012, të 18 tetorit 2013, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke pretenduar shkelje esenciale të ligjit penal dhe kërkoi që aktgjykimet e ankimuara të ndryshohen ashtu që të vërtetohet se për shkak të afektit mendor, të vuajtur nga i pandehuri në këtë rast, sipas nenit 148 të Kodit Penal, atij duhet t'i shqiptohet një dënim më i butë, dhe ankesa e palës së dëmtuar të konsiderohet si e paafatshme.

14. Më 25 mars 2014, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin PML. nr. 57/2014 e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar.

15. Gjykata Supreme konstatoi që:

> "*Pretendimet në kërkesë për mungesën e arsyetimit të mbrojtësit të të dënuarit për atë se gjykata e shkallës së dytë ka vepruar në kundërshtim me nenin 400 par. 2 të KPPK, kur ankesën e palës së dëmtuar nuk e ka hudh nga se e njëjta nuk ka qenë e paralajmëruar është pretendim i pabazuar. Gjykata e shkallës së dytë drejt ka vepruar kur e ka marrë në shqyrtim ankesën e palës së dëmtuar edhe se e njëjta nuk ka qenë e paralajmëruar nga se sipas nenit 400 par.2 të KPPK, është paraparë se kur personi me të drejtë ankese nuk e paralajmëron të njëjtën brenda afatit të paraparë ligjor konsiderohet se i njëjti ka hequr dorë nga ankesa përpos në rastin e paraparë me par. 4 të të njëjtit nen kur të akuzuarit i shqiptohet dënimi me burgim. Në këtë rast ankesa e Enver Nikës si palë e dëmtuar e autorizuar për ushtrimin e ankesës është e lejuar edhe pse nuk ka qenë e paralajmëruar. Qëndron konstatimi i mbrojtësit se pala e dëmtuar në ankesë ka bërë fjalë edhe për rrjedhjen e ngjarjes mirëpo ato pretendime me të drejtë nga gjykata e shkallës së dytë nuk janë vlerësuar por janë vlerësuar vetëm pretendimet lidhur me dënimin e shqiptuar për të cilin edhe është ushtruar ankesa*".

16. Përkitazi me kërkesën e parashtruesit për një dënim më të butë, Gjykata Supreme vlerësoi:

> *"Pretendimet e mbrojtësit në kërkesë për shqiptimin e një dënimi më të butë për të dënuarin janë të pabazuara nga se në aktgjykimin e shkallës së dytë janë dhënë rrethanat e vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë lidhur me matjen e dënimit, si dhe rrethanat të cilat e kane udhëhequr gjykatën e shkallës së dytë qe me aktgjykim ta ndryshojë vendimin mbi dënimin ashtu që të akuzuarin ta dënojë me dënim unik burgu prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjetëve duke e arsyetuar të njëjtin me rrethanat rënduese dhe duke i arsyetuar të njëjtat. Ankesa e mbrojtësit nga gjykata e shkallës së dytë është refuzuar si e pabazuar nga se e njëjta nuk ka paraqitur ndonjë rrethanë të pavlerësuar nga gjykata e shkallës së parë. Ne arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së dytë janë dhënë arsyet e duhura dhe të bollshme e të cilat e arsyetojnë marrjen e vendimit mbi dënimin.*
>
> *Nga sa u parashtrua e në kuptim të nenit 456 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit".*

17. Aktualisht, parashtruesi i kërkesës është duke vuajtur dënimin e tij me burg i cili ishte vërtetuar dhe në këtë mënyrë u bë i formës së prerë me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës PML. nr. 57/2014, të 25 marsit 2014.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] par. 2 dhe 3 të Kushtetutës së Kosovës, dhe me nenin 3, par. 2 të KPPK-së.

19. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: *"Ti shpalle si kunderkushtetuese aktgjykimet e Gjykates së Apelit në Prishtinë PAKR. nr. 1108/2012 dhe Gjykatës Supreme të Kosovës PML. nr. 57/2014, dhe të urdheroi që ato aktgjykime të prishen dhe çështja te kthehet në rigjykim dhe vendosje pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë".*

20. Parashtruesi, gjithashtu, kërkon në fund të kërkesës: *"Që ankesa e palës së dëmtuar e ushtruar kundër aktgjykimit të shkallës së parë, të konsiderohet e palejuar, pasi është paraqitur në kundërshtim me nenin 400, par. 1 dhe 2 të KPPK-së, e që prek dispozitën e nenit 102, par. 2 dhe 3, të Kushtetutës, si dhe nenit 31".*

Pranueshmëria e kërkesës

21. Para së gjithash, për të qenë në gjendje që të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...]*
>
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese,*
>
> *[...]"*

23. Siç u cek më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme PML. nr. 57/2014 dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 1108/2012, janë nxjerrë në kundërshtim me nenet 31 [E Drejta Për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] par. 2 dhe 3 të Kushtetutës.

24. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme në përgjigje ndaj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të ligjit, dhe shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale (Shih, paragrafin 15).

25. Gjykata gjithashtu vëren se pretendimet e parashtruesit në kërkesën e tij për shpalljen e një dënimi më të butë për palën e dënuar, u arsyetuan nga Gjykata Supreme (Shih, paragrafin 16).

26. Në këtë rast, Gjykata gjen se çështja e ngritur nga parashtruesi i kërkesës është çështje e ligjshmërisë, jo e kushtetutshmërisë.

27. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërisë).

28. Gjykata Kushtetuese po ashtu ripërsërit se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale, si
edhe të asaj materiale (Shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri,
i 16 dhjetorit 2011). Fakti i thjeshtë se parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës në rastin e tij, nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave të tij të mbrojtura me Kushtetutë. Gjykata vëren se parashtruesi ka pasur mundësi të shumta t'i paraqesë pretendimet e tij në gjykatat e rregullta.

29. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të trajtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e
tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, App. nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut i 10 korrikut 1991).

30. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se arsyetimi, që i referohet kërkesës që ankesa e palës së dëmtuar kundër aktgjykimit të shkallës së parë të konsiderohet e papranueshme dhe kërkesës për shpallje të një dënimi më të butë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, është i qartë. Pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjeti se procedurat në Gjykatën e Apelit nuk ishin të padrejta apo arbitrare (Shih, rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009)·

31. Për arsyet e lartcekura, Gjykata konkludon se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë shkeljen e pretenduar të të drejtave kushtetuese në të cilat thirret parashtruesi.

32. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 30 mars 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit, dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof . dr. Enver Hasani

KI183/14, Parashtrues Ilir Berisha, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Njoftimit të Komisionit për Emërim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ref. ZVVGJ/0389/14, të 22 shtatorit 2014

KI183/14, Aktvendim për papranueshmëri i 12 shkurtit 2015, publikuar më 2 prill 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, e drejta për mjete juridike, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit, parimi i subsidiaritetit, mosshterje e mjeteve juridike*

Komisioni për Emërim i Këshillit Gjyqësor të Kosovës refuzoi aplikacionin e parashtruesit për pozitën e gjyqtarit në Gjykatën Komunale në Pejë.

Parashtruesi ndër të tjera, pretendoi se Komisioni për Emërim i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i kishte shkelur atij të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutën e Kosovës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se në këtë rast, nuk ka vendim përfundimtar nga organi kompetent i cili do të mund të shqyrtohej, dhe më tej theksoi se parimi i subsidiaritetit kërkon nga parashtruesi që t'i shterojë të gjitha mundësitë në procedurë të rregullt.

Kërkesa u shpall e papranueshme për shkak të mosshterjes së të gjitha mjeteve siç është përcaktuar me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe specifikuar më tej me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI183/14
Parashtrues
Ilir Berisha
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Njoftimit të Komisionit për Emërim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ref. ZVVGJ/0389/14, të 22 shtatorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Ilir Berisha (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Pejë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Njoftimit Ref. ZVVGJ/0389/14 të Komisionit për Emërim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KGJK), të 22 shtatorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së Njoftimit [Ref. ZVVGJ/0389/14] të KGJK-së, të 22 shtatorit 2014, me të cilin pretendohet shkelja e të drejtave dhe lirive të parashtruesit të kërkesës, të garantuara me: nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe të neneve 6, 7 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 dhjetor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 13 janar 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI183/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI183/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 27 janar 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe KGJK-në për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 12 shkurt 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 4 shkurt 2014, KGJK-ja kishte shpallur konkurs për pranimin e një numri të caktuar të gjyqtarëve. Në konkurs, KGJK-ja kishte përcaktuar kushtet që kandidatët duhet t'i përmbushnin gjatë aplikimit, të cilat janë të përcaktuara në nenin 26, paragrafi 1 i Ligjit për gjykatat.

10. Parashtruesi i kërkesës, në afatin e paraparë në konkurs, aplikoi për pozitën e gjyqtarit të Gjykatës Komunale në Pejë.

11. Më 25 shtator 2014, KGJK-ja vendosi ta refuzojë aplikacionin e parashtruesit të kërkesës për pozitën e gjyqtarit në Gjykatën Komunale në Pejë. KGJK-ja i dërgoi njoftimin [Ref. ZVVGJ/0389/14], duke e informuar parashtruesin e kërkesës lidhur me arsyet për vendimin e saj. Aplikacioni ishte refuzuar, për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk e ka përmbushur kriterin e përvojës së punës, siç parashihet me Ligj (Neni 26, paragrafi 1 i Ligjit për gjykatat).

12. Më 29 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës, konsideron se KGJK-ja kishte bërë gabim në vërtetimin e fakteve lidhur me përvojën e tij të

punës. Prandaj, ai ka paraqitur kundërshtim pranë Komisionit të shkallës së dytë të KGJK-së, duke kërkuar rishqyrtimin e aplikacionit të tij.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi në kërkesë deklaroi: "*... se ai konsideron se në rastin e tij janë shkelur të drejtat dhe liritë nga neni 3 [Barazia para Ligjit], neni 7 [Vlerat], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Kosovës; si dhe neneve 6, 7 dhe 14 të KEDNJ, si dhe shkeljet ende vazhdojnë*".

14. Parashtruesi në kërkesën e tij kërkon nga Gjykata:

- *„Të deklaroj kërkesën të pranueshme,*
- *Të konstatohet se ka shkelje të dispozitave të neneve 3, 7, 24, 32 dhe 49 të Kushtetutës, si dhe neneve 6, 7 dhe 14 të KEDNJ,*
- *Të anuloj Njoftimin Ref. ZVVGJ/0389/14 të datës 22 shtator 2014 të Komisionit për Emërim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si kundërkushtetues,*
- *Të urdhëroj KGJK-në, eliminimin e shkeljeve të dispozitave të cekura më lart".*

Pranueshmëria e kërkesës

15. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *„Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

17. Përveç kësaj, neni 47.2 i Ligjit, gjithashtu, përcakton se:

> *"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

18. Për më tepër, rregulli 36 (1) b) përcakton:

> *"Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar".*

19. Parashtruesi në kërkesë thekson se me Njoftimin [Ref. ZVVGJ/0389/14] të KGJK-së të 22 shtatorit 2014, i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutën e Kosovës dhe KEDNJ, të cituara në paragrafin 12 të këtij raporti.

20. Parashtruesi nuk ka dorëzuar në Gjykatë përgjigjen e KGJK-së, nëse ka, ndaj kundërshtimit të tij dhe kërkesën e 29 shtatorit 2014. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar nëse ai ka bërë ndonjë përpjekje tjetër përmes mjeteve të tjera juridike për t'i siguruar të drejtat, si ato ligjore ashtu edhe ato kushtetuese, të cilat ai tani pretendon se i ishin shkelur, para parashtrimit të kërkesës së tij në Gjykatë.

21. Prandaj, Gjykata konsideron se në këtë rast, kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, pasi që procedura e parashtruesit për rishqyrtim të aplikacionit të tij para organit të shkallës së dytë të KGJK-së është ende në pritje.

22. Përveç kësaj, Gjykata vëren se ekzistojnë mjete tjera administrative, të cilat ai mund t'i shterë lidhur me ankesat e tij.

23. Gjykata thekson se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi t'i shterë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalojë shkeljen e Kushtetutës, nëse ka, apo të korrigjojë shkeljet e tilla të të drejtave themelore të njeriut.

24. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që t'iu lejojë autoriteteve kompetente, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë të parandalojnë apo korrigjojnë shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin që rendi juridik i Kosovës ofron mjete efektive juridike për mbrojtje kundër shkeljeve të të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih Aktvendimin për papranueshmëri: *AAB-RIINVEST Universiteti SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, të 21 janarit 2010, dhe shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, vendim i 28 korrikut 1999).

25. Në përfundim, Gjykata konsideron se në këtë rast nuk ka vendim përfundimtar nga organi kompetent i cili do të mund të shqyrtohej, dhe i cili mund të ishte bazë për shkeljet e pretenduara.

26. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 26 mars 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. dr. Enver Hasani

KO26/15, Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës me shkresën nr. 05-433/DO-318

KO26/15, Aktgjykim i 14 prillit 2015, publikuar më 15 prill 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë institucionale, kontroll preventiv kushtetues, amendamentet kushtetuese, Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, të drejtat dhe liritë e garantuara në Kapitullin II dhe III të Kushtetutës*

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës në pajtim me nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës i referoi Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Amendamentin nr. 24 të Kushtetutës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Amendamenti i propozuar konsiston me shtimin e një neni të ri, nenit 162, pas nenit 161 [Transicioni i Institucioneve] të Kushtetutës. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi paraprak nga Gjykata nëse amendamenti i propozuar i Kushtetutës zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II dhe III të Kushtetutës.

Amendamenti i propozuar i Kushtetutës përmban katër elemente strukturore që ndërlidhen me sistemin e drejtësisë të Republikës së Kosovës përkatësisht me themelimin e Dhomave të Specializuara, Zyrës së Prokurorit të Specializuar, Dhoma e Specializuar në kuadër të Gjykatës Kushtetuese, emërimi i Ombudspersonit të veçantë me përgjegjësi ekskluzive për Dhomat e Specializuara dhe për Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se katër elementet e reja strukturore të futura në Kushtetutë me amendament: (a) do të themelohen me ligj, (b) do të jenë në pajtim me strukturën ekzistuese të sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës, (c) do të kenë fushëveprim specifik të juridiksionit, (ç) do të funksionojnë në kuadër të kornizës juridike të drejtësisë penale, dhe (d) janë të nevojshme për Republikën e Kosovës ashtu që ajo të përmbushë obligimet e saj ndërkombëtare.

Gjykata Kushtetuese konfirmoi se Amendamenti i propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II dhe III të Kushtetutës dhe se është në harmoni me shkronjën e me frymën e saj siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese konkludoi se amendamenti i propozuar është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

AKTGJYKIM
në
Rastin nr. KO26/15
Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
me Shkresën nr. 05-433/DO-318

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Më 9 mars 2015, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), në pajtim me nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), i referoi Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) një amendament (Amendamenti nr. 24) të Kushtetutës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Qeveria).

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi paraprak nga Gjykata nëse amendamenti i propozuar i Kushtetutës "*[...] zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës*", në pajtim me nenin 113.9 të Kushtetutës.

3. Amendamenti i propozuar konsiston në shtimin e një neni të ri, nenit 162, pas nenit 161 [Transicioni i Institucioneve] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës dhe në nenet 20 dhe 54 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatë

5. Më 9 mars 2015, parashtruesi i kërkesës e referoi amendamentin në Gjykatë.

6. Më 10 mars 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KO26/15, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KO26/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 11 mars 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe nga një kopje e kërkesës iu dërgua Presidentes së Republikës së Kosovës, Kryeministrit, deputetëve të Kuvendit dhe Avokatit të Popullit.

8. Më 18 mars 2015, Grupi parlamentar i Vetëvendosjes dorëzoi komentet lidhur me Rastin KO26/15.

9. Më 14 prill 2015, Gjyqtari raportues i paraqiti raportin Kolegjit shqyrtues. Kolegji shqyrtues e miratoi atë dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që kërkesa të deklarohej e pranueshme për shqyrtim dhe të konfirmohej se amendamenti i propozuar nuk pakëson të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me frymën e me shkronjën e saj, siç është përcaktuar me praktikën gjyqësore të Gjykatës.

10. Në të njëjtën ditë, Gjykata mbajti këshillime dhe votoi për rastin.

11. Gjyqtari Kadri Kryeziu nuk mori pjesë në procedurat dhe në vendimin e Gjykatës përkitazi me rastin e tanishëm KO26/15, në bazë të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese, KK124/14, të 19 gushtit 2014.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 7 mars 2015, Qeveria vendosi t'i propozojë Kuvendit të Republikës së Kosovës një amendament të Kushtetutës.

13. Të njëjtën ditë, Qeveria, në bazë të nenit 144 [Amendamentimi], paragrafi 1, të Kushtetutës, i propozoi Kryetarit të Kuvendit amendamentimin e Kushtetutës.

14. Më 9 mars 2015, Kryetari i Kuvendit i referoi Gjykatës amendamentin e Kushtetutës, duke kërkuar nga Gjykata që ajo të bëjë vlerësim paraprak nëse amendamenti i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

15. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj.

16. Së pari, Gjykata duhet të përcaktojë nëse kërkesa është dorëzuar nga pala e autorizuar dhe, së dyti, duhet të përcaktojë nëse ka juridiksion për të vlerësuar amendamentin e Kushtetutës të propozuar nga Qeveria, në pajtim me nenin 113.9 të Kushtetutës.

17. Gjykata rikujton se, në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës, "*Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara [...]*".

18. Gjykata vëren se kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, e referoi amendamentin e propozuar. Kësisoj, Gjykata konkludon se kërkesa është dorëzuar nga pala e autorizuar në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës.

19. Prandaj, në bazë të të njëjtit nen, 113.9, Gjykata duhet "*[...] të konstatojë nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës*".

20. Rrjedhimisht, Gjykata ka juridiksion të vlerësojë nëse amendamenti i propozuar zvogëlon ose jo të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

21. Meqë është dorëzuar nga pala e autorizuar dhe meqë Gjykata ka juridiksion të gjykojë lidhur me rastin, kërkesa është e pranueshme.

Fushëveprimi i vlerësimit

22. Fushëveprimi i vlerësimit të amendamentit të propozuar bazohet në Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore], në Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] dhe në shkronjën e

frymën e Kushtetutës (Shih rastet KO29/12 dhe KO48/12, parashtrues i kërkesës *Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,* Aktgjykim i 20 korrikut 2012; dhe shih, gjithashtu, Rastin nr. KO61/12, parashtrues i kërkesës *Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 31 tetorit 2012).

Amendamenti i propozuar nr. 24: Neni i ri 162 i Kushtetutës që do të shtohet pas nenit 161 të Kushtetutës

23. Amendamenti i propozuar konsiston në shtimin e një neni të ri, të nenit 162, në Kushtetutë, ku thuhet si vijon:

"…

Neni 162 [Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar]

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute:

1. *Për t'i përmbushur obligimet ndërkombëtare në lidhje me Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Dokumenti 12462, datë 7 janar 2011, Republika e Kosovës mund të themelojë Dhoma të specializuara* [N. B.: fjala "specialist" në tekstin anglisht thuhet "e specializuar" në tekstin në shqip, ndërsa "specijalne" në tekstin serbisht] *dhe një Zyrë të Prokurorit të specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës. Organizimi funksionimi dhe juridiksioni i Dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të specializuar rregullohen me këtë nen dhe me ligj të veçantë.*

2. *Dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të specializuar do të garantojnë të drejtat që i përmban Kapitulli II i Kushtetutës dhe në veçanti do të veprojnë në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që janë të garantuara me Nenin 22 dhe në varshmëri me Nenin 55.*

3. *Një Dhomë e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, e përbërë nga tre gjyqtarë ndërkombëtarë të emëruar shtesë krahas gjyqtarëve të referuar sipas Nenit 114 (I), do të vendosë ekskluzivisht mbi referimet kushtetuese sipas Nenit 113 të Kushtetutës në lidhje me Dhomat e specializuara dhe me Zyrën e Prokurorit të Specializuar në përputhje me ligjin e veçantë.*

4. *Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar do të kenë zotësi të plotë ligjore dhe juridike dhe do të kenë të gjitha kompetencat e nevojshme dhe mandatin për veprim bashkëpunim juridik, asistencë, mbrojtje të dëshmitarëve, siguri, paraburgim dhe vuajtje të dënimit jashtë territorit të Kosovës për këdo që dënohet, si dhe ne lidhje me menaxhimin e ndonjë çështjeje të mbetur pas përfundimit të mandatit. Aranzhimet që dalin nga ushtrimi i këtyre kompetencave nuk i nënshtrohen Nenit 18.*

5. *Para hyrjes në ndonjë marrëveshje ndërkombëtare me një shtet të tretë në lidhje me bashkëpunimin juridik, që përndryshe do të kërkonte ratifikim sipas Nenit 18, Dhomat e specializuara do të kërkojnë pajtimin paraprak të Qeverisë.*

6. *Dhomat e specializuara mund t'i përcaktojnë Rregullat e veta të Procedurës dhe Provave, në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të përfshira në Nenin 22 dhe të udhëzuara nga Kodi i Procedurës Penale. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese do të rishikojë këto Rregulla për të siguruar pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.*

7. *Dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të specializuar mund të kenë seli në Kosovë dhe seli jashtë Kosovës. Dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të specializuar mund të ushtrojnë funksionet e tyre në të dyja selitë apo diku tjetër, sipas nevojës.*

8. *Në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare, çdo person i akuzuar për krime nga Dhomat e specializuara mund të paraburgoset dhe të transferohet në Dhomat e Specializuara që ndodhen jashtë territorit të Kosovës. Nëse shpallen fajtorë dhe dënohen me burgim, këta persona mund të transferohen për ta vuajnë dënimin e tyre në një shtet të tretë, jashtë territorit të Kosovës, në pajtim me marrëveshjet arritura sipas paragrafit 4.*

9. *Gjuhët zyrtare të Dhomave të specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të specializuar do të jenë gjuha shqipe, serbe dhe ajo angleze. Dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të specializuar mund të vendosin mbi përdorimin zyrtar të gjuhës apo gjuhëve për ta ushtruar mandatin e tyre.*

10. Emërimi dhe mbikëqyrja e gjyqtarëve dhe prokuroreve, si dhe mbikëqyrja dhe administrimi i Dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të specializuar bëhet në pajtim me ligjin e veçantë.

11. Do të emërohet një Ombudsperson i veçantë i Dhomave të specializuara, me përgjegjësi ekskluzive për Dhomat e specializuara dhe për Zyrën e Prokurorit të specializuar. Funksioni dhe obligimet e tij/saj për raportim do të përcaktohen me [ligjin e veçantë]. Nenet 133 (2), 134, 135 (1) dhe (2) nuk do të aplikohen ndaj Ombudspersonit të Dhomave të specializuara. Ombudspersoni i Kosovës gjithashtu mund të referojë çështje në përputhje me Nenin 135 (4).

12. Procedurat e veçanta administrative, modalitetet, organizimi dhe funksionimi i Dhomave të specializuara dhe Zyrës së Prokurorisë së specializuar, mbikëqyrja, buxheti, auditimi dhe funksionet tjera, do të rregullohen me marrëveshje ndërkombëtare, me ligjin e veçantë dhe përmes aranzhimeve të bëra sipas paragrafit 4.

13. Mandati i Dhomave të specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të specializuar do të zgjasë për një periudhë pesëvjeçare përveç nëse njoftimi i përfundimit të mandatit në pajtim me Ligjin No. 04/L. 274 bëhet me herët.

14. Në mungesë të njoftimit për përfundim të mandatit sipas paragrafit 12, mandati i Dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të specializuar do të vazhdojë deri kur njoftimi i përfundimit të mandatit të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 04/L-274 dhe në konsultim me Qeverinë.

II.

Ndryshimet kushtetuese hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

...".

Komentet e Grupit parlamentar të Vetëvendosjes

24. Më 18 mars 2015, Grupi parlamentar i Vetëvendosjes i dorëzoi Gjykatës komentet përkitazi me amendamentin e Kushtetutës. Në komente thuhet se amendamenti është në kundërshtim me karakterin dhe me subjektivitetin e Republikës së Kosovës dhe nuk është në

përputhje me nenin 1 [Përkufizimi i Shtetit], paragrafët 1 dhe 2; me nenin 3 [Barazia para Ligjit]; me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 7 të Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut; me nenin 24 [Barazia para Ligjit]; me nenin 35 [Liria e Lëvizjes]; me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]; me nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit], pika 4, të Kushtetutës, në lidhje me nenin 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare]; me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]; me nenin 103 [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave]; me nenin 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve]; me nenin 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese]; me nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit]; me nenin 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit] dhe me nenin 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit] të Kushtetutës.

25. Ata pretendojnë se projektamendamenti ka për qëllim të krijojë organe paralele gjyqësore, ndërsa askund në projektamendament nuk specifikohen *"[...] elemente të varësisë së këtyre organeve paralele gjyqësore [...]"* në raport me organet kushtetuese. Pra, emërimi, përzgjedhja dhe përgjegjësia nuk janë sanksionuar në projektamendament.

26. Sipas Grupit parlamentar të Vetëvendosjes, projektamendamenti është duke krijuar *"[...] bazën kushtetuese që në sistemin juridik të gjyqësisë së Republikës së Kosovës të krijohen normat ligjore të natyrës sui generis të cilat do ta njohin të drejtën e një organizimi tërësisht të veçantë i cili nuk do t'i nënshtrohet rregullimit generalis të Kosovës"*.

27. Ata konsiderojnë se *"Dhoma e specializuar siç është quajtur nga sponzorizuesi është në kundërshtim të plotë me dispozitat e Nenit 114 të Kushtetutës për sa i përket përbërjes së saj. Elementi tjetër sa i përket kolizionit që janë duke krijuar këto norma në këtë draft-amendament është edhe kompetenca lëndore e kësaj dhome të 'specializuar' në raport me Nenin 112 dhe 113 të Kushtetutës"*.

28. Për më tepër, sipas Grupit parlamentar të Vetëvendosjes, *"sipas paragrafit 4, Dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të specializuar do të kenë aftësi*
të plotë juridike që në kuptimin e përgjithshëm të hynë në marrëdhënie ndërkombëtare dhe kështu [...] Kuvendi i Kosovës është përjashtuar nga ratifikimi, apo dhënia e instrumentit të brendshëm (pëlqimit) për lidhjen e këtyre marrëveshjeve me karakter ndërkombëtar".

29. Grupi parlamentar i Vetëvendosjes, sa i përket amendamentit të propozuar, nenit 162, paragrafi 5, të Kushtetutës, konsideron se *"[...] me këtë draft-amendament, dispozitat e paragrafit 5 i cenojnë kompetencat e Kuvendit të Kosovës siç janë paraparë me Nenin 65, pikës 4 të Kushtetutës përkitazi me kompetencën për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Pra pëlqimi për lidhje të marrëveshjeve ndërkombëtare që do t'i lidhin dhomat e specializuara dhe zyra e prokurorit të specializuar do të merret vetëm nga Qeveria dhe jo nga Kuvendi i Kosovës siç, është paraparë me Nenin 18 të Kushtetutës".*

30. Ata pretendojnë se *"sipas paragrafit 6 të draft-amendamentit [...] Me dhënien e autorizimit kushtetues që këto dhoma dhe zyra e Prokurorit të kenë të drejtën që të nxjerrin rregulla të reja procedurale, të akuzuarit në procedurat e zhvilluara pranë tyre i bën të diskriminuar në kuptimin e mbrojtjes së tyre nga ligji dhe shfrytëzimit të mjeteve juridike përmes rregullave që janë të parapara me ligjet në fuqi të shtetit, shtetas të të cilit janë".*

31. Përkitazi me amendamentin e propozuar, nenin 162, paragrafët 7 dhe 8, të Kushtetutës, ai *"[...] ndërlidhet me ekstradimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës e që sipas Nenit 35, paragrafit 4, ekstradimi i qytetarëve të Kosovës në kuadër të së drejtës themelore të njeriut përkitazi me lirinë e lëvizjes, ndalohet ekstradimi i tij, përjashtimisht kur kjo është e rregulluar me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare".*

32. Grupi parlamentar i Vetëvendosjes konsideron se *"paragrafi 10 i draft-amendamentit përjashton në tërësi aplikimin e dispozitave të Nenit 104 të Kushtetutës së Kosovës. Vënia në dispozicion që çështja e emërimit të gjyqtarëve t'i lihet në dispozicion rregullimit ligjor i cili prapë nën klauzolën përjashtuese të rregullojë emërimin e gjyqtarëve jashtë standardit të përcaktuar me Nenin 104 të Kushtetutës dhe dispozitat e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës [...]."*

33. Ata më tej pretendojnë se *"sipas paragrafit 11 të draft-amendamentit është paraparë themelimi i një Ombudspersoni të veçantë i Dhomave të Specializuara, i cili nuk do të zgjidhet dhe as nuk do t'i raportojë Kuvendit të Kosovës sipas dispozitave të Neneve 132, par. 2 dhe Neneve 134 dhe 135 par. 1 dhe 2 të Kushtetutës së Kosovës".*

34. Si përfundim, Grupi parlamentar i Vetëvendosjes konsideron se *"nuk është e paraparë as në teorinë e as në praktikën e hartimit të normimit kushtetues që dispozita kushtetuese t'i referohet një akti ligjor i cili i subordinohet aktit kushtetues. Kjo krijon pasiguri juridike dhe kushtetuese dhe një normim i tillë e cenon rendin juridik në përgjithësi sepse përderisa dispozitat kushtetuese kalojnë nëpër*

një procedurë të veçantë kushtetuese dhe miratimin sipas shumicës së dyfishtë të kualifikuar në pajtim me Nenin 144, par. 2 të Kushtetutës, [...]".

Vlerësimi i amendamentit të propozuar

35. Amendamenti i propozuar do të vlerësohet nga Gjykata në pajtim me fushëveprimin e vlerësimit të përkufizuar më lart. Fillimisht, Gjykata do të ekzaminojë elementet strukturore të krijuara me këtë amendament, përkitazi me marrëdhënien e tyre me strukturat ekzistuese të sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës.

36. Gjykata vëren se amendamenti i propozuar i Kushtetutës përmban katër elemente strukturore që ndërlidhen me sistemin e drejtësisë të Republikës së Kosovës.

    a. Elementi i parë është themelimi i dhomave të specializuara në kuadër të sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës;

    b. Elementi i dytë është krijimi i Zyrës së Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës;

    c. Elementi i tretë është themelimi i një dhome të specializuar në kuadër të Gjykatës Kushtetuese, të përbërë nga tre gjyqtarë ndërkombëtarë, të cilët vendosin ekskluzivisht për kërkesat kushtetuese sipas nenit 113 të Kushtetutës, në lidhje me dhomat e specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar;

    ç. Elementi i katërt është emërimi i Ombudspersonit të veçantë të dhomave të specializuara me përgjegjësi ekskluzive për dhomat e specializuara dhe për Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

37. Gjykata rikujton se propozimi i amendamenteve të lartpërmendura kushtetuese buron nga Marrëveshja Ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, e 14 prillit 2014.

38. Më 23 prill 2014, Kuvendi, me shumicën e dy të tretave, miratoi Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, nr. 04/L-274 (në tekstin e mëtejmë: Ligji nr. 04/L-274). Ky ligj hyri në fuqi më 30 maj 2014.

39. Gjykata vëren se amendamenti thekson që themelimi i dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës është kërkesë për Republikën e Kosovës që ajo të përmbushë obligimet e saj ndërkombëtare në lidhje me Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (Dokumenti 12467), të 7 janarit 2011.

40. Për të ekzaminuar marrëdhënien ndërmjet elementeve strukturore të amendamentit dhe të sistemit të drejtësisë, Gjykata i referohet nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafi 5, të Kushtetutës, që përcakton se *"pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat"*.

41. Natyra e ushtrimit të pushtetit gjyqësor elaborohet më tej në Kapitullin VII të Kushtetutës, që përcakton strukturën e sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës. Në nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës thuhet si në vijim:

> *"1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat.*
>
> *2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.*
>
> *3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.*
>
> *4. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.*
>
> *5. Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese".*

42. Gjithashtu, neni 103 [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave], paragrafi 7, i Kushtetutës, parasheh të drejtën kushtetuese të Republikës së Kosovës për të themeluar gjykata të specializuara. Aty thuhet: *"Gjykata të specializuara mund të themelohen me ligj kur kjo të jetë e nevojshme, por në asnjë mënyrë nuk mund të themelohen gjykata të jashtëzakonshme"*.

43. Gjykata konsideron se gjykata e specializuar, siç është paraparë me këtë dispozitë, do të thotë gjykatë me fushëveprim të specifikuar të juridiksionit që mbetet brenda kornizës ekzistuese të sistemit gjyqësor

të Republikës së Kosovës dhe që vepron në përputhje me parimet e atij sistemi. Për dallim nga gjykata e specializuar, një "gjykatë e jashtëzakonshme" do të vendosej jashtë strukturës së sistemit ekzistues gjyqësor dhe do të vepronte pa iu referuar sistemeve ekzistuese.

44. Si e tillë, Gjykata gjen se, në mënyrë që një gjykatë e specializuar të jetë në përputhje me dispozitat kushtetuese që autorizojnë themelimin e gjykatave të tilla, struktura, fushëveprimi i juridiksionit dhe metoda e funksionimit të një gjykate të tillë, duhet të jenë në pajtueshmëri me të drejtat e përcaktuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese përkitazi me kornizën e përgjithshme të sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës.

45. Po ashtu, Gjykata vëren se janë dy kërkesa formale të parapara me nenin 103, paragrafi 7, të Kushtetutës, për krijimin e një gjykate të specializuar. E para, ajo duhet të jetë e bazuar në ligj dhe, e dyta, duhet të ekzistojë nevoja për themelimin e saj.

46. Sa i përket kërkesës së parë, Gjykata vëren se amendamenti i propozuar parasheh në nenin 162, paragrafi 1, që

    a. Dhomat e specializuara do të themelohen në kuadër të gjykatave tashmë të themeluara brenda sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës, ngjashëm me Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Kjo dhomë e posaçme u themelua me Ligjin për Dhomën e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nr. 04/L-033, të 31 gushtit 2011, e cila në bazë të nenit 21.2 të Ligjit për Gjykatat, nr. 03/L-199, është pjesë e Gjykatës Supreme.

    b. Themelimi i dhomave të specializuara do të bëhet nëpërmjet miratimit të një ligji të veçantë nga Kuvendi, i cili do të rregullojë *"[...] organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e tyre [...]."*

47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) në rastin *Fruni kundër Sllovakisë* (Shih Rastin *Fruni kundër Sllovakisë,* kërkesa nr. 8014/07, Aktgjykim i 21 qershorit 2011).

48. Në këtë rast, GJEDNJ-ja konstatoi që *"[...] Neni 6 § 1 nuk mund të lexohet ashtu që ndalon themelimin e gjykatave speciale penale nëse ato kanë bazën në ligj* (Shih *Erdem kundër Gjermanisë* (dec.), nr. 38321/97, 9 dhjetor 1999). GJEDNJ-ja ritheksoi se *"[...] objekti i termit 'e themeluar me ligj' në nenin 6 të Konventës është të sigurojë 'që organizimi gjyqësor në një shoqëri demokratike të mos varet nga diskrecioni i ekzekutivit, por që të rregullohet me ligj që buron nga Parlamenti'"*.

49. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh që amendamenti i propozuar ka për qëllim të themelojë me ligj dhomat e specializuara, ai është në përputhje me atë kërkesë të nenit 103, paragrafi 7, të Kushtetutës.

50. Sa i përket kërkesës së dytë në nenin 103, paragrafi 7, konkretisht që Gjykata e Specializuar duhet të jetë "e nevojshme", Gjykata vëren se në amendamentin e propozuar thuhet se themelimi i dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës është kërkesë për Republikën e Kosovës që ajo të përmbushë obligimet e saj ndërkombëtare.

51. Këto obligime ndërkombëtare burojnë nga Raporti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (Dokumenti 12462), i 7 janarit 2011, që përmbledh një numër të pretendimeve penale shumë specifike dhe që rekomandon që ato të hetohen dhe të ndiqen penalisht. Këto obligime u inkorporuan në kornizën juridike të Republikës së Kosovës nëpërmjet miratimit të Ligjit nr. 04/L-274 nga shumica e dy të tretave të Kuvendit.

52. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rastit të lartpërmendur të GJEDNJ-së, *Fruni kundër Sllovakisë*, ku GJEDNJ-ja pranoi se *"[...] luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar mund të kërkojë masa, procedura dhe institucione të karakterit të specializuar"*.

53. Prandaj, Gjykata gjen se fushëveprimi i juridiksionit të dhomave të specializuara, siç parashihet me amendament, është gjithashtu në pajtueshmëri me kërkesën e "nevojës" që e përmban neni 103, paragrafi 7, i Kushtetutës.

54. Përveç kësaj, në bazë të jurisprudencës së GJEDNJ-së, të cituar më lart, dhomat e specializuara gjyqësore që do të themelohen me amendamentin, janë po ashtu në pajtueshmëri me kërkesën për të qenë të bazuara në ligj dhe për të qenë brenda fushëveprimit të specializuar të juridiksionit. Prandaj, amendamenti përmbush kërkesat për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, siç përcaktohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së.

55. Gjithashtu, amendamenti përcakton që procedurat e veçanta administrative, modalitetet, organizimi dhe funksionimi i dhomave të specializuara, mbikëqyrja, buxheti, auditimi dhe funksionet e tjera, do të rregullohen, *inter alia*, me ligj të veçantë. Dhomat e specializuara mund t'i përcaktojnë rregullat e veta të procedurës dhe të provave, në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës, të cilat do të vlerësohen nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese për të siguruar pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës. Këto rregulla do të udhëhiqen nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

56. Gjykata po ashtu vëren se në paragrafët 13 dhe 14 të Amendamentit nr. 24 është paraparë që mandati i dhomave të specializuara të jetë për një periudhë pesëvjeçare, përveç nëse bëhet njoftimi për përfundimin e mandatit në pajtim me Ligjin nr. 04/L-274 dhe në konsultim me Qeverinë.

57. Për me tepër, Gjykata vëren se, në bazë të amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 2, Kushtetuta do të respektohet nga dhomat e specializuara të themeluara, posaçërisht do të respektohen mbrojtjet e sanksionuara në Kapitullin II, dhe ato do të veprojnë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të garantuara me nenin 22 dhe në varshmëri të nenit 55. Këto janë garanci procedurale për ata që do t'i nënshtrohen juridiksionit të dhomave të specializuara.

58. Prandaj, Gjykata gjen se metodat e funksionimit të dhomave të specializuara janë brenda kornizës së sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës.

59. Gjykata konkludon se dhomat e specializuara do të themelohen në kuadër të *pushtetit gjyqësor unik dhe të pavarur që ushtrohet nga gjykatat* në bazë të Kushtetutës. Struktura, fushëveprimi i juridiksionit dhe funksionimi i dhomave të specializuara do të rregullohen me ligje të tjera, në pajtim me Kushtetutën. Rrjedhimisht, dhomat e specializuara nuk pakësojnë të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

60. Sa i përket propozimit për themelimin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, Gjykata vëren se themelimi i saj ndjek të njëjtin parim sikurse dhomat e specializuara. Fushëveprimi i juridiksionit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar do të jetë për të njëjtat krime specifike sikurse për dhomat e specializuara. Për më tepër, ashtu sikurse

dhomat e specializuara, sipas paragrafit 2 të amendamentit, edhe Zyra e Prokurorit të Specializuar duhet të zbatojë dhe të respektojë standardet dhe parimet e sanksionuara në Kapitullin II dhe të veprojë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të garantuara me nenin 22 dhe me nenin 55 të Kushtetutës.

61. Gjykata gjithashtu vëren se në paragrafët 13 dhe 14 të Amendamentit nr. 24 është paraparë që mandati i Zyrës së Prokurorit të Specializuar të jetë për një periudhë pesëvjeçare, përveç nëse bëhet njoftimi për përfundimin e mandatit në pajtim me Ligjin nr. 04/L-274 dhe në konsultim me Qeverinë.

62. Si e tillë, Zyra e Prokurorit të Specializuar do të themelohet në kuadër të sistemit ekzistues prokurorial të Republikës së Kosovës. Zyra e Prokurorit të Specializuar do të themelohet me ligj, i cili do të rregullojë *"[...] organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e saj [...]."*

63. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se amendamenti i propozuar është në pajtim me garancitë kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe se ligje e rregullore të tjera do të hartohen brenda kornizës së sistemit të drejtësisë për të mbrojtur më tej të drejtat themelore të personave që hyjnë në juridiksionin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

64. Gjykata konkludon se amendamenti për themelimin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

65. Sa i përket amendamentit të propozuar për themelimin e një dhome të specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata rithekson të gjeturat e saj të mësipërme dhe vëren se Dhoma e Specializuar do të themelohet në kuadër të Gjykatës Kushtetuese ekzistuese. Kjo dhomë e specializuar, nëpërmjet vlerësimit të saj kushtetues të rregullave të procedurës dhe të provave, dhe nëpërmjet mekanizimit të ankesave individuale kushtetuese, do të ushtrojë juridiksion mbikëqyrës mbi dhomat e specializuara në kuadër të gjykatave të rregullta dhe mbi Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

66. Prandaj, Gjykata konkludon se amendamenti i propozuar për themelimin e Dhomës së Specializuar në kuadër të Gjykatës Kushtetuese nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe

me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

67. Sa i përket amendamentit të propozuar për themelimin e një ombudspersoni të veçantë të dhomave të specializuara, me përgjegjësi ekskluzive për dhomat e specializuara dhe për Zyrën e Prokurorit të specializuar, Gjykata rithekson të gjeturat e saj të mësipërme dhe konkludon se amendamenti i propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

68. Si përfundim, Gjykata gjen se katër elementet e reja strukturore të futura në Kushtetutë me amendament: (a) do të themelohen me ligj, (b) do të jenë në pajtim me strukturën ekzistuese të sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës, (c) do të kenë fushëveprim specifik të juridiksionit, (ç) do të funksionojnë në kuadër të kornizës juridike të drejtësisë penale, dhe (d) janë të nevojshme për Republikën e Kosovës ashtu që ajo të përmbushë obligimet e saj ndërkombëtare. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se themelimi i katër elementeve strukturore në sistemin e drejtësisë të Republikës së Kosovës hyn në kuadër të sistemit ekzistues të drejtësisë të Kosovës dhe i përgjigjet karakteristikave të sistemit kushtetues të pushtetit të pavarur gjyqësor.

69. Sa i përket komenteve të dorëzuara nga Grupi parlamentar i Vetëvendosjes, Gjykata vëren se këto komente janë ekskluzivisht të drejtuara në faktin se amendamenti themelon elemente të reja strukturale që nuk janë paraparë më herët me Kushtetutë. Megjithatë, Gjykata ka gjetur se themelimi i këtyre elementeve të reja strukturore, në vetvete, nuk krijon ndonjë kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës, sepse struktura, fushëveprimi dhe funksionimi i tyre janë në pajtueshmëri me Kapitullin II si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën dhe frymën e Kushtetutës, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

70. Gjykata do të vlerësojë amendamentin e nenit të propozuar 162, paragraf për paragraf.

Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 1

71. Sa i përket amendamentit të nenit 162, paragrafi 1, të Kushtetutës, Gjykata vëren se krijimi i katër elementeve strukturore në kuadër të sistemit të drejtësisë buron nga sovraniteti i Republikës së Kosovës, ku Kuvendi, me shumicën e dy të tretave, miratoi Ligjin nr. 04/L-274. Kjo është në pajtueshmëri me nenin 103, paragrafi 7, dhe me nenin 31 të

Kushtetutës, sepse këto elemente të reja strukturore në sistemin e drejtësisë të Kosovës bëhen me ligj dhe me qëllim të luftimit të krimeve specifike, të cilat në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së kërkojnë masa, procedura dhe institucione të karakterit të specializuar.

72. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 1 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 2

73. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 2, të Kushtetutës, Gjykata vëren se ai përfshin garancitë procedurale për personat që do t'i nënshtrohen juridiksionit të dhomave të specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

74. Paragrafi 2 obligon dhomat e specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar që të respektojnë mbrojtjet e sanksionuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Lidhur me këtë, vërehet se, nëpërmjet nenit 53 të Kushtetutës, duhet të zbatohet edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së.

75. Përveç këtyre garancive procedurale, të sanksionuara në Kapitullin II të Kushtetutës, vërehet se dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar duhet të veprojnë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të garantuara me nenet 22 dhe 55 të Kushtetutës, që do të thotë se çdo kufizim i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore duhet të bëhet në pajtim me nenin 55. Sidoqoftë, siç parashihet me nenin 56 të Kushtetutës, shmangia nga disa të drejta të njeriut dhe liri themelore të sanksionuara në Kapitullin II të Kushtetutës nuk lejohet në asnjë rrethanë.

76. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 2 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 3

77. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 3, të Kushtetutës, Gjykata vëren se krijimi i Dhomës së Specializuar në kuadër të Gjykatës Kushtetuese është një garantues shtesë i

Kushtetutës. Dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar do të jenë nën juridiksionin e saj mbikëqyrës nëpërmjet ankesave të mundshme kushtetuese në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës.

78. Dhoma e Specializuar në kuadër të Gjykatës Kushtetuese do të respektojë të njëjtat standarde dhe parime të sanksionuara në Kushtetutë, sikurse Gjykata Kushtetuese ekzistuese. Megjithatë, fushëveprimi i kërkesave që mund të paraqiten pranë kësaj dhome do të jetë ekskluzivisht në lidhje me dhomat e specializuara dhe me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

79. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 3 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 4

80. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 4, të Kushtetutës, Gjykata vëren se ai siguron që dhomat e specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar do të përkujdesen plotësisht për të gjitha elementet e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për garancitë e tjera procedurale ndaj personave që do t'i nënshtrohen juridiksionit të dhomave të specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Kjo do të bëhet nëpërmjet kompetencave të nevojshme dhe mandatit për veprim, për bashkëpunim juridik, për asistencë, për mbrojtje të dëshmitarëve, për siguri, për paraburgim dhe për vuajtje të dënimit jashtë territorit të Republikës së Kosovës për këdo që dënohet, si dhe për menaxhimin e ndonjë çështjeje të mbetur pas përfundimit të mandatit.

81. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 4 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 5

82. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 5, të Kushtetutës, Gjykata vëren se, edhe pse aranzhimet që dalin nga ushtrimi i kompetencave të përmendura në paragrafin 4 nuk i nënshtrohen nenit 18, megjithatë, për këto aranzhime, do të kërkohet pajtimi i Qeverisë. Prandaj, para lidhjes së ndonjë traktati

ndërkombëtar për bashkëpunimin gjyqësor, procedura për kërkimin e pajtimit të Qeverisë do të jetë në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

83. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 5 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 6

84. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 6, të Kushtetutës, Gjykata vëren se këto janë garanci shtesë që do të përfshihen në rregullat e procedurës dhe të provave të dhomave të specializuara. Rregullat e procedurës dhe të provave do të respektojnë standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe legjislacionin ekzistues të Kosovës, Kodin e Procedurës Penale.

85. Për më tepër, rregullat e procedurës dhe të provave do t'i nënshtrohen vlerësimit nga Dhoma e Specializuar në kuadër të Gjykatës Kushtetuese përkitazi me pajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën, si një garanci shtesë që do të respektohen të drejtat procedurale nga Kapitulli II i Kushtetutës.

86. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 6 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 7

87. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 7, të Kushtetutës, Gjykata vëren se ai është i ndërlidhur me elementet e themeluara strukturore në kuadër të sistemit të drejtësisë të Republikës së Kosovës dhe me garancitë e vendosura procedurale.

88. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 7 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 8

89. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 8, të Kushtetutës, Gjykata vëren se çdo veprim që do të ndërmerret në raport me ndonjë person që do t'i nënshtrohet juridiksionit të dhomave të specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar duhet të jetë në harmoni me standardet e vendosura me të drejtën ndërkombëtare.

90. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 8 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 9

91. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 9, të Kushtetutës, Gjykata vëren se përdorimi i gjuhës është një nga garancitë e të drejtës për gjykim të drejtë. Kësisoj, parashikohet përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe dhe i gjuhës serbe, të cilat janë gjuhë zyrtare kushtetuese të Kosovës.

92. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 9 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 10

93. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 10, të Kushtetutës, Gjykata vëren se emërimi dhe mbikëqyrja e gjyqtarëve dhe e prokurorëve do të përcaktohet me ligj.

94. Si të tilla, të gjitha ligjet i nënshtrohen parimeve të sanksionuara në Kushtetutë gjatë miratimit nga Kuvendi.

95. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 10 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 11

96. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 11, të Kushtetutës, Gjykata vëren se është një garanci shtesë që do të mbrohen vlerat, parimet dhe standardet e Kushtetutës. Përjashtimi i paraparë i disa dispozitave kushtetuese që kanë të bëjnë me Avokatin e Popullit të Kosovës është pasojë e kompetencës ekskluzive të Ombudspersonit të veçantë për t'u marrë me dhomat e specializuara dhe me Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Kompetencat specifike të këtij ombudspersoni do të përcaktohen me ligj.

97. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 11 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafi 12

98. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafi 12, të Kushtetutës, Gjykata vëren se ky amendament është i natyrës teknike, që do të parashihet në ligjin që do të miratohet nga Kuvendi.

99. Gjykata rithekson se ligji do t'i nënshtrohet parimeve të Kushtetutës gjatë miratimit nga Kuvendi.

100. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 12 i amendamentit të propozuar nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

Amendamenti i Kushtetutës, neni 162, paragrafët 13 dhe 14

101. Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 162, paragrafët 13 dhe 14, të Kushtetutës, Gjykata vëren se ky është në pajtueshmëri me parimin e sigurisë juridike.

102. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafët 13 dhe 14 të amendamentit të propozuar nuk pakësojnë të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

Hyrja në fuqi e Amendamentit nr. 24

103. Sa i përket hyrjes në fuqi të amendamentit nr. 24, Gjykata vëren se, teksti nën numrin romak II, që rregullon atë, është identik me nenin 144, paragrafi 4, të Kushtetutës, ku thuhet:

> *"Ndryshimet e Kushtetutës hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës".*

104. Prandaj, Gjykata konfirmon se ky tekst i amendamentit nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

105. Si konkludim, për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konfirmon se Amendamenti i propozuar nr. 24 nuk pakëson të drejtat kushtetuese të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës si dhe me Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës. Rrjedhimisht, amendamenti i propozuar është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në mbështetje të nenit 113.9 dhe të nenit 144.3 të Kushtetutës, në mbështetje të nenit 20 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullit 56 (1) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur më 14 prill 2015, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË të pranueshme kërkesën e Kryetarit të Kuvendit, të dorëzuar më 9 mars 2015, me Amendamentin nr. 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

II. TË KONFIRMOJË që Amendamenti nr. 24 nuk pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës si dhe në Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës;

III. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve dhe ta publikojë atë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

IV. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. dr. Enver Hasani

KI159/14, Parashtrues Elife Murseli, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1235/2014, të 5 majit 2014

KI159/14, Aktvendim për papranueshmëri i 11 shkurtit 2015, publikuar më 16 prill 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata e Apelit të Kosovës, me Aktvendimin, Ac. nr. 1235/2014, kishte vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj përkitazi me kthim në vend të punës dhe pagat e papaguara ndaj parashtrueses.

Parashtruesja ndër të tjera, pretendoi se në rastin e saj, gjykatat e rregullta gabimisht kanë interpretuar ligjin për vetëqeverisje lokale përkitazi me kthimin e saj në vend të punës dhe pagesën e pagave të papaguara.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtrueses i ishte dhënë mundësia për ta kontestuar interpretimin e ligjit që ajo e konsideron të pasaktë në gjykatat e rregullta, dhe për më tepër, procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta nuk kishin qenë të padrejta apo arbitrare. Kërkesa e parashtruesit u shpall e papranueshme, si qartazi e pabazuar, ashtu siç është paraparë në rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI159/14
Parashtrues
Elife Murseli
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1235/2014, të 5 majit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Elife Murseli (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës) nga fshati Doganaj, Komuna e Kaçanikut, e cila përfaqësohet nga avokati z. Rifat Abdullahi nga Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1235/2014, të 5 majit 2014, i cili i ishte dorëzuar asaj më 4 gusht 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1235/2014 të 5 majit 2014, me të cilin sipas pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, janë shkelur nenet 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) dhe 49 (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 47.1 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 tetor 2014, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI159/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI159/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 10 nëntor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesen dhe Gjykatën e Apelit të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 11 shkurt 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 16 dhjetor 2008, me Aktvendimin e kryetarit të Komunës së Kaçanikut 01 nr. 8467/08 ishte urdhëruar që nga 15 dhjetori 2008 parashtrueses së kërkesës t'i ndërpritej marrëdhënia e punës në vendin e punës drejtor në Qendrën e Edukimit dhe Arsimit Parashkollor "Agimi" në Kaçanik.

10. Aktvendimi i kryetarit të Komunës së Kaçanikut 01 nr. 8467/08, i 16 dhjetorit 2008, u vërtetua me Vendimin e Komisionit të ankesave në Komunën e Kaçanikut, 01 nr. 8550/08, të 5 shkurtit 2009.

11. Më 6 shkurt 2009, parashtruesja e kërkesës ushtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMK) kundër Aktvendimit të kryetarit të Komunës së Kaçanikut 01 nr. 8467/08, të 16 dhjetorit 2008 dhe Vendimit të Komisionit të ankesave në Komunën e Kaçanikut, 01 nr. 8550/08, të 5 shkurtit 2009.

12. Më 21 prill 2009, me Vendimin e KPMK-së nr. 794/09 u aprovua ankesa e parashtrueses së kërkesës dhe u prish Aktvendimi 01 nr. 8467/08, i 16 dhjetorit 2008, dhe Vendimi i Komisionit të ankesave në Komunën e Kaçanikut, 01 nr. 8550/08, i 5 shkurtit 2009.

13. Me Vendimin e KPMK-së nr. 794/09, të 21 prillit 2009, në paragrafin II të dispozitivit Komunës së Kaçanikut i urdhërohet si në vijim: "*Obligohet Drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Shefi për Administratë dhe Personel në Komunën e Kaçanikut, që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi ta kthejë ankuesen në vendin e punës Drejtor/e në Qendrën e Edukimit dhe Arsimit Parashkollor "Agimi" në Kaçanik dhe të ja bëjë kompensimin e të ardhurave personale në mënyrë retroaktive nga dt 15. 12. 2008 deri sa nga autoriteti punëdhënës të bëhet përsëritja e konkursit dhe tërë procedura intervistuese dhe zgjedhja e kandidatit/ës në bazë të meritës sipas vendimit te KPMK-së të dt. 15.04.2009 nr. 782/09*".

14. Më 21 shtator 2010, parashtruesja e kërkesës paraqiti propozim në Gjykatën Komunale në Kaçanik për lejimin e përmbarimit të Vendimit të KPMK-së nr. 794/09, të 21 prillit 2009.

15. Më 17 janar 2011, me Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Kaçanik E. nr. 390/2010, u refuzua propozimi për lejimin e përmbarimit të Vendimit të KPMK-së, si i palejueshëm.

16. Më 28 qershor 2011, me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 89/2011, u vërtetua Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Kaçanik E. nr. 390/2010.

17. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Kaçanik, E. nr. 390/2010, të 17 janarit 2011 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 89/2011, të 28 qershorit 2011, Prokurori i Shtetit të Kosovës ka paraqitur me kohë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të prishen të dy aktvendimet e lartpërmendura dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rivendosje.

18. Më 16 janar 2013, me procesverbalin për pranimin e detyrës nr. 19/2013, Komuna e Kaçanikut përmbaroi vendimin e KPMK-së nr. 794/09 dhe ktheu parashtruesen e kërkesës në vendin e punës drejtor në Qendrën për Edukim dhe Arsim Parashkollor "Agimi" në Kaçanik.

19. Më 3 qershor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin MLC. nr. 2/2012 pranoi si të bazuar kërkesën e Prokurorit të Shtetit të

Kosovës, dhe prishi Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 89/2011, të 28 qershorit 2011 dhe Aktvendimin e Gjykatës Komunale të Kaçanikut, E. nr. 390/2010, të 17 janarit 2011, dhe lëndën ia ktheu gjykatës së shkallës së parë për rivendosje.

20. Më 4 mars 2014, Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, Aktvendimi E. nr. 269/13 vendosi si në vijim:

"I. APROVOHET, pjesërishtë si i bazuar Propzimi për përmbarim i Kreditorës Elife Murseli, nga fshati Doganaj Komuna e Kaçanikut dhe DETYROHET, debitori Komuna e Kaçanikut që kreditorës të ia paguaj shumën prej 6.522.35 €, këtë shumë me kamat si për mjetet e deponuara në bankë pa destinacion të caktuar më shumë se një vit duke filluar prej datës 01.01.2009 e deri më 16.01.2013, në emër të pagave të pa paguar...

II. REFUZOHET, si e pa bazuar shuma prej 9.351.30, sepse këtë shumë kreditorja e ka marrë, po ashtu refuzohet edhe kërkesa për kthimin në vendin e punës ku ka punuar më parë SI E PA BAZUAR

III. REFUZOHET si i pa bazuar kundërshtimi i debitorit Komuna e Kaçanikut-Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, i ushtruar më dt.01.06.2009, kundër aktvendimit mbi lejimin e ekzekutimit E.nr.229/09, prej datës 15.05.2009.

IV. DETYROHET, debitori qe kreditorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore në shumë prej 927 €, e cila pagesë do te bëhet në llogarin e të autorizuarit të Kreditorit me nr 1170172318000108 , ne Pro Credit bank në Ferizaj, te gjtha këto pagesa do të bëhen në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi".

21. Kundër këtij Aktvendimi, brenda afatit ligjor, kreditorja ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar.

22. Më 5 maj 2014, Gjykata e Apelit të Kosovës, me Aktvendimin Ac. nr. 1235/2014, refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, E. nr. 269/2013, të 4 marsit 2014, me arsyetim:

"Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë, kur pas nxjerrjes së provës me Ekspertizë financiare të datës 26.12.2013, me të cilën janë vërtetuar shumat që i përkasin

kreditores Elife, e ka miratuar pjesërisht si të bazuar propozimin e saj për përmbarim, dhe ka detyruar debitoren Komuna e Kaçanikut, qe t'ia paguaj shumën prej 6.522,35 €, në emër te pagave të pa paguara, me kamatë si për mjetet e deponuara në banke pa destinim të caktuar më shumë se një vit duke filluar prej datës 1.1.2009 e deri me 16.1.2013, e në këtë shume ta paguaj edhe kontributin për Trustin Pensional, duke e refuzuar si te pabazuar për shumën prej 9.351,30 € (që i është zbritur nga shuma e neto kompensimit të tërësishëm në shumë prej 15.873,65 € për kohën kontestuese 1.1.2009-16.1.2013), me konstatimin dhe arsyetimin e drejtë se këtë shumë kreditorja e ka realizuar te debitorja, si delegate e Asamblesë Komunale (gjatë kohës sa ka qenë jashtë marrëdhënies së punës), bashkë me kërkesën e saj për kthim në vendin e punës ku ka punuar më parë, pasi që debitoja është kthyer në punë nga vet debitorja, prandaj kjo kërkesë e saj tani është jo lëndore, prandaj të gjitha pretendimet ankimore të kreditores rezultojnë si të pa qëndrueshme dhe të pa argumentuara me asgjë".

23. Parashtruesja e kërkesës si dëshmi, se procedura e emërimit të drejtorit në Qendrën për Edukim dhe Arsim Parashkollor "Agimi" - Kaçanik nuk është përmbyllur, i dorëzon dy vendimet e KPMK-së nr. 02/370/2013, të 20 nëntorit 2013 dhe nr. A/02/46/2014, të 17 prillit 2014.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesja e kërkesës pretendon se "*qëndrimi i Gjykatave të instancave gjyqsore të gjykatave të rregullta se sipas njoftimit nga Debitori, kreditorja është kthyer ne pune me dt.16.01.2013 dhe se kerkesa per kthim ne pune eshte jo lendore, nuk ka mbeshtetje ne ligj dhe ne esence eshte qendrim I gabuar,sepse kthimi ne punesipas vendimit te KPMK dot zgjaste deri sa te merret vendim i formes se prere lidhur me zjgjedhjen e kandidatit per Drejtor te QEAP "Agimi" ne Kcanik e jo siq eshte vepru ndaj kreditores kur ende pa perfundu zgjedhja e Drejtorit, kreditorja me force largohet nga vendi i punes. Vlene te theksohet se me vendimin e kryetarit te Komunes as qe permendet kohezgjatja e vlefshmerise se atij vendimi*".

25. Parashtruesja e kërkesës më tej pretendon se "*sa i perket refuzimit te kerkeses se kreditores lidhur me pagesen e Shumes prej 9.351,30 euro, parashtrusit e kesaj kerkese konsiderojne se me vendimet gjyqsore gabimisht eshte apliku ne rastin konkret neni 65 i ligjit mbi veteqeverisjen lokale,kete sepse,kreditorja ne menyre te paligjshme eshte largu nga detyra e Drejtorit te QEAP,pastaj si person i papune ka patur te drejte te zgjdhet si delegate ne Kuvendit Komunal.*

Prandaj edhe sa i perket refuzimit te pageses se kesaj shume,Gjykatat e permendur a kane shkelur ligjin lidhur me pagesen e shumave qe kane te bejne me pagat e papaguara, te drejta te cilat iu jane shkelur me vendimet e kundershtuara te Gjykatave te rregullta ".

26. Parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese si në vijim:

"I. TË SHPALLË, kerkesen te pranueshme.

II. TË KONSTATOJË qe ka patur shkelje te nenit 31 (e drejta per gjykim te drejte dhe te papanshem) nenit49 (e drejta e punes dhe ushtrimit te profesionit dhe te drjtat ne kompenzimin e pagave te papaguara) te Kushtetutes se Republikes se Kosoves.

III. TË ANULOJË Aktvendimin i Gjykates se Apelit te Kosoves Ac.nr. 1235/14 dt. 05.05.2014 dhe Aktvendimin e Gjykates Themelore ne Ferizaj - Dega ne Kacanik ne pjesen nen II. te diapozitivit E.nr.269/13 dt. 04.03.2014.

IV. TË DETYROJË Komunën e Kacanikut qe kreditoren Elife Murseli ta kthej ne vendin e punes se Drejtores se QEAP "Agimi" ne Kacanik qe te ushtroj detyren e Drejtoreshes deri sa te shpallet konkursi per ate vend pune dhe zbatohet procedura deri ne vendim te forms se prere per zgjedhjen e kandidatit per Drejtor te QEAP dhe kreditores ti paguaj ne menyre retroaktive pagat e papaguara prej 01.10.2013 e deri sa ne procedure te ligjshme dhe perfundimtare te zgjedhet Drejtori I QEAP "Agimi" ne Kacanik, kete sipas vendimit te KPMK nr. 794/2009 dt. 21.04.2009.

V. TË DETYROJË Komunën e Kacanikut qe kreditores te ia paguaj Shumen prej 9.351,30 euro ne emer te shumes nga pagat e papaguara prej 01.01.2009 e deri me dt. 16.01.2013".

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara

me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

29. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj ".

30. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

„(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

...

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

31. Duke shqyrtuar pretendimet e parashtrueses lidhur me kërkesën për kthim në vendin e punës, Gjykata vëren se Vendimi i KPMK-së numër 794/09, i 21 prillit 2009, e obligon Komunën e Kaçanikut që *"ta kthejë ankuesen në vendin e punës Drejtor/e në Qendrën e Edukimit dhe Arsimit Parashkollor "Agimi"në Kaçanik, dhe të ja bëjë kompensimin e të ardhurave personale në mënyrë retroaktive nga dt. 15.12. 2008 deri sa nga autoriteti punëdhënës të bëhet përsëritja e konkursit".*

32. Komuna e Kaçanikut me procesverbalin e pranimit të detyrës nr. 19/2013, të 16 janarit 2013, ka vepruar në përputhje me Vendimin e KPMK-së nr. 794/09, duke e kthyer parashtruesen e kërkesës në vendin e punës drejtor në Qendrën për Edukim dhe Arsim Parashkollor "Agimi" në Kaçanik.

33. Kjo gjendje faktike është konstatuar me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, E. nr. 269/13, të 4 marsit 2014.

34. Duke shqyrtuar pretendimet e parashtrueses për refuzimin e kërkesës pronësore lidhur me pagesën në shumë prej €9.351,30 dhe pretendimit se në rastin në fjalë, në vendimet gjyqësore është aplikuar gabimisht neni 65 i Ligjit për vetëqeverisje lokale, Gjykata Kushtetuese thekson se ajo nuk është Gjykatë e Apelit, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta.

35. Roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I) .

36. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. nr. 1235/2014, i 5 majit 2014 dhe Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, E. nr. 269/13, i 4 marsit 2014, në arsyetimet e tyre të hollësishme japin përgjigje në pretendimet e parashtrueses përkitazi me kërkesën për kthim në vendin e punës dhe kërkesën pronësore në shumë prej €9.351,30, si dhe arsyet për aplikimin e rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale, të cilat parashtruesja e kërkesës i përsërit edhe në Gjykatën Kushtetuese.

37. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk i konteston vendimet e KPMK-së nr. 02/370/2013, të 20 nëntorit 2013 dhe nr. A/02/46/2014, të 17 prillit 2014, por këto dy vendime të KPMK-së ajo i ka bashkëngjitur si dëshmi se procedura e emërimit të drejtorit në Qendrën për Edukim dhe Arsim Parashkollor "Agimi" në Kaçanik ende nuk ka përfunduar.

38. Pasi që kushtetutshmëria e këtyre vendimeve nuk është kontestuar nga parashtruesja e kërkesës, Gjykata konsideron se vlerësimi i kushtetutshmërisë së këtyre dy vendimeve të KPMK-së nuk është objekt i çështjes në Gjykatën Kushtetuese dhe ajo nuk do ta bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së tyre.

39. Gjykata Kushtetuese thekson se parashtruesja e kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të saj kushtetuese (Shih, *Vanek kundër Republikës Sllovake*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

40. Në këtë rast, parashtrueses së kërkesës i janë dhënë mundësitë për ta paraqitur rastin e saj dhe për ta kontestuar interpretimin e ligjit që ajo konsideron se është i pasaktë, në KPMK, Gjykatën Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës.

41. Pas shqyrtimit të procedurave në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

42. Përfundimisht, në këtë kërkesë nuk janë plotësuar kushtet për pranueshmëri. Parashtruesja e kërkesës nuk ka treguar dhe nuk ka mbështetur me prova se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të pretenduara.

43. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 prill 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Prof. dr. Enver Hasani

KK109/15 Zbatimi i Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Rastin KI99/14 dhe KI100/14, të 8 korrikut 2014

Z. Sylë Hoxha
Ushtrues i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryetar i Këshillit Prokurorial të Kosovës
Prishtinë, Republika e Kosovës

Re: Zbatimi i Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Rastin KI99/14 dhe KI100/14, të 8 korrikut 2014

I nderuari z. Hoxha,

Në vijim të komunikimit, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), përsërit se kërkimi i informatave është në pajtim me autoritetin e Gjykatës për të monitoruar zbatimin e vendimeve të saj, në pajtim me nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe me rregullin 63 [Zbatimi i vendimeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me praktikën e saj konstante kushtetuese.

Pas shqyrtimit të tërë dokumenteve të dorëzuara nga ju, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Rastin KI99/14 dhe KI100/14, i 8 korrikut 2014, është zbatuar me anulimin e vendimeve të kontestuara KPK nr. 146/2014 dhe KPK nr. 151/2014 për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit dhe me përsëritjen e procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit.

Sa i përket ndonjë çështjeje tjetër që mund të ketë dalë nga procedura e përsëritur e zgjedhjes, ato nuk janë brenda juridiksionit të Gjykatës, pasi asnjë kërkesë në Gjykatë nuk është parashtruar nga një palë e autorizuar.

Prandaj, Gjykata nuk mund të komentojë lidhur me ndonjë aspekt të mundshëm kushtetues të procedurës së përsëritur të zgjedhjes.

Në këtë mënyrë, Gjykata rikujton se çdo çështje lidhur me procedurën e përsëritur, e cila mund të ketë bazë kushtetuese për t'u diskutuar, duhet t'i referohet Gjykatës në mënyrë ligjore, pasi Gjykata nuk mund të veprojë *ex officio*.

Gjykata rithekson se ajo është një organ i pavarur për mbrojtjen e Kushtetutës dhe për sigurimin e respektimit të ndarjes së pushteteve dhe të sundimit të ligjit.

Kjo letër është diskutuar dhe është vendosur nga Gjykata në përbërje të plotë në seancën e saj të 17 prillit 2015.

Sinqerisht juaji,

Prof. dr. Enver Hasani
Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

KO22/15, Parashtrues i kërkesës Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, Kërkesë për rishqyrtimin e rastit KO155/14 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 13 nëntorit 2014

KO 22/15, Aktvendim për papranueshmëri i mbështetur nga Kolegji shqyrtues i Gjykatës Kushtetuese më 17 prill 2015 dhe i miratuar dhe publikuar nga Gjykata Kushtetuese më 30 prill 2015

Fjalët kyçe: *Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, kërkesë për rishqyrtim të Aktvendimit, kuorumit dhe ligjshmërisë në vendim-marrje, kërkesë e pabazuar*

Thelbi i kësaj kërkese qëndron në pretendimin e parashtruesit të kërkesës se Aktvendimi për papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KO 155/14 është i pavlefshëm dhe i pavendosur pasi është marrë pa kuorum dhe rrjedhimisht në kundërshtim me nenin 19 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121.

Gjykata shtjelloi (i) detyrat dhe prerogativat e dhëna parashtruesit të kërkesës me Kushtetutë përkitazi me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, (ii) vuri në dukje caktimin e kufijve të prerogativave dhe detyrave të parashtruesit të kërkesës me Kushtetutë vis-a- vis degëve të tjera të qeverisë dhe në veçanti të organeve gjyqësore në procesin e vendim-marrjes, (iii) bëri një analizë krahasuese të të detyrave dhe prerogativave të homologëve të parashtruesit në lidhje me vendet e rajonit, (iv) shpjegoi mungesën e lidhjes mes të detyrave dhe prerogativave të parashtruesit dhe kërkesës së tanishme dhe (v) shpjegoi në hollësi procesin e vet vendimmarrës në mënyrë që ta kundërshtojë pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me pavlefshmërinë e Aktvendimit për papranueshmëri KO 155/14. Duke pasur parasysh arsyetimin e lartpërmendur, Gjykata e refuzoi kërkesën e parashtruesit si qartazi të pabazuar, në pajtim me nenin 29 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KO22/15
Parashtrues
Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës
Kërkesë për rishqyrtim të Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Rastin KO155/14,
të 13 nëntorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, z. Sami Kurteshi.

Vendimi kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) në Rastin KO155/14, të 13 nëntorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon rishqyrtimin e Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës në Rastin KO155/14. Ai pretendon se Aktvendimi është i pavlefshëm dhe i pavendosur, pasi është marrë pa kuorum dhe rrjedhimisht në kundërshtim me nenin 19 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenet 113.2 (1) dhe 135.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenet 29 e 30 të Ligjit.

Procedura në Gjykatë

5. Më 26 shkurt 2015 parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

6. Më 27 shkurt 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KO22/15, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KO22/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

7. Në të njëjtën datë, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Presidentes së Republikës së Kosovës.

8. Më 2 mars 2015, gjyqtari Robert Carolan kërkoi me shkrim nga Kryetari i Gjykatës, që t'i lejohej përjashtimi "*nga pjesëmarrja në këshillime dhe në votim për këtë rast",* në pajtim me nenin 18, paragrafi 1.1, të Ligjit dhe në pajtim me nenet 1 dhe 2 të Kodit të mirësjelljes për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.

9. Më 17 prill 2015, Gjykata, pa praninë e Kryetarit të Gjykatës, shqyrtoi kërkesën e parashtruesit për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës dhe vendosi, njëzëri, ta refuzojë atë (*Shih Vendimin lidhur me kërkesën për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 17 prillit 2015*).

10. Në të njëjtën datë, Gjykata, në respektim të dispozitave të Ligjit dhe të Rregullores së punës dhe të praktikës së saj të vendosur, shqyrtoi kërkesën e gjyqtarit Robert Carolan për përjashtimin e tij dhe vendosi, me shumicë votash, që të lejojë kërkesën e tij dhe ta përjashtojë atë nga pjesëmarrja në Kërkesën KO22/15, pasi gjyqtari Robert Carolan mund të përballet me konflikt interesi.

11. Neni 18 (Përjashtimi i gjyqtarit), paragrafët 4 dhe 5, i Ligjit, thotë:

    [...]

    "4. Vendimi për përjashtimin e gjyqtarit duhet të jetë i arsyetuar.

5. Gjyqtari i cili ka njohuri se plotëson të paktën njërin prej kushteve për përjashtim nga procedura, ka për detyrë ta njoftojë me shkrim Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese dhe të kërkojë përjashtimin e tij/saj nga procedura. Në këtë rast, paragrafët 3 dhe 4 zbatohen përshtatshmërish".

12. Për më tepër, rregulli 7 [Procedurat e përjashtimit], paragrafët 1 dhe 6, të Rregullores së punës, thotë:

"(1) Sapo gjyqtari të mësojë ndonjë arsye për përjashtim, të paraparë me nenin 18 të Ligjit për Gjykatën, ose nëse gjyqtari beson që ekzistojnë rrethana të tjera që ngrenë dyshim të arsyeshëm përkitazi me paanësinë e tij/saj, ai/ajo do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurë dhe do t'ia shpjegojë arsyen me shkrim Kryetarit të Gjykatës. Nga një kopje e atij shpjegimi do t'i dërgohet të gjithë gjyqtarëve".

[...]

(6) Kur gjyqtari përjashtohet nga procedura, Gjykata shënon në çdo vendim me shkrim apo në çdo aktgjykim se gjyqtari i përjashtuar nuk kishte marrë pjesë në procedurë".

13. Sipas praktikës së vendosur të Gjykatës, në bazë të Ligjit dhe Rregullores së punës, kërkesa për përjashtim bëhet sapo të mësojë gjyqtari ndonjë arsye për përjashtim. Kërkesa për përjashtim të një gjyqtari nga procedura diskutohet dhe votohet pa praninë e gjyqtarit në fjalë. Nëse kërkesa lejohet, gjyqtari nuk merr pjesë në këshillimet dhe në votimin për rastin dhe emri i tij/saj nuk paraqitet në përbërjen e Gjykatës në vendimin përfundimtar (Shih Rastet KI88/10 parashtrues *Agim Paca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 dhjetorit 2010; KI70/11 parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima, Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011; dhe KI79/12 parashtrues *Tanasko Djordjević dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 dhjetorit 2013).

14. Më 17 prill 2015, Kolegji shqyrtues mbështeti raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që kërkesa të shpallet e papranueshme.

15. Më 20 prill 2015, Aktvendimi për papranueshmëri iu shpërnda gjyqtarëve të Gjykatës.

Përmbledhja e fakteve

16. Më 13 nëntor 2014, Gjykata nxori Aktvendimin e kontestuar për papranueshmëri në Rastin KO155/14, të parashtruar nga Avokati i Popullit, i cili është parashtrues edhe në kërkesën e tanishme. Gjykata konstatoi se Rasti KO155/14 ishte i papranueshëm si qartazi i pabazuar, në pajtim me rregullin 36, paragrafët 1.c dhe 2, të Rregullores së punës. Gjykata gjithashtu refuzoi kërkesën për Masë të përkohshme.

17. Objekti i çështjes i kërkesës në Rastin KO155/14 ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentes së Republikës së Kosovës, nr. DKGJK-001-2014, të 31 gushtit 2014, për konfirmimin e vazhdimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Dekreti). Parashtruesi i kërkesës pretendonte se Dekreti ishte në kundërshtim me procedurën kushtetuese për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të përcaktuar në nenin 114.2 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese], në nenin 65 (11) [Kompetencat e Kuvendit] dhe në nenin 84 (19) [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës.

18. Parashtruesi i kërkesës thekson se ka filluar një hetim *ex officio* për procedurën që çoi deri te vendimi i Gjykatës Kushtetuese për Rastin e tij KO155/14. Gjatë hetimit, parashtruesi i kërkesës mori një letër nga gjyqtari Robert Carolan (Shih Kapitullin – Pretendimet e parashtruesit të kërkesës).

19. Më 26 shkurt 2015, parashtruesi e dorëzoi në Gjykatë Kërkesën KO22/15.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar për papranueshmëri KO155/14 nuk ishte marrë në pajtim me nenin 19 [Marrja e vendimeve], paragrafi 2, të Ligjit që përcakton se *"Gjykata Kushtetuese ka kuorum nëse janë të pranishëm shtatë (7) gjyqtarë"*.

21. Duket se parashtruesi i kërkesës filloi një hetim *ex officio* lidhur me procedurat që çuan deri te Aktvendimi për papranueshmëri dhe, si përgjigje, gjyqtari Carolan e informoi atë si në vijim:

> *"Nuk kam marrë pjesë në shqyrtimin ose në vendimin e Gjykatës sepse e kisha përjashtuar veten paraprakisht nga pjesëmarrja në shqyrtimin dhe vendimin e Gjykatës lidhur me Rastin KO155/14"*.

22. Sipas parashtruesit të kërkesës, *"Gjyqtari Carolan ka dërguar, gjithashtu, një kopje të një komunikimi të brendshëm të Gjykatës Kushtetuese, i cili, sipas tij, konfirmon përjashtimin e tij prej procedurës së rastit"*.

23. Në këtë letër, gjyqtari Robert Carolan, po ashtu informon:

> *"Unë isha i pranishëm në Gjykatë kur u parashtrua dhe u diskutua Kërkesa KO155/14 në Gjykatë"*.

24. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon që Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurat e reja që ndërlidhen me Kërkesën e tanishme. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Kryetari i Gjykatës duhet të përjashtohet, siç pretendohet *"[...] për shkak të (1) angazhimit të tij në diskutime të brendshme të EULEX-it mbi procedurën e emërimit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë, dhe (2) pohimit të tij eksplicit që anashkalimi i Kuvendit nuk do të paraqiste shkelje kushtetuese ne këtë rast"*.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Për të gjykuar lidhur me ankesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse ai i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

26. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që nuk është marrë një vendim i vlefshëm nga Gjykata në rastin e tij të mëparshëm KO155/14 për shkak të mungesës së kuorumit në kohën kur Gjykata vendosi lidhur më të.

27. Gjykata rithekson se ajo merret me kërkesa të parashtruara sipas nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 2, të Kushtetutës që parasheh:

> *"2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:*
>
> > *(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;*
> >
> > *(2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën"*.

28. Nga kjo dispozitë kushtetuese del se Gjykata, në parim, mund të merret me kërkesa të parashtruara nga Avokati i Popullit.

29. Sidoqoftë, kjo ankesë nuk hyn në fushëveprimin e kësaj dispozite kushtetuese siç mund të konkludohet nga analiza dhe nga praktika gjyqësore e Gjykatës (Shih Rastin KO97/12, parashtrues i kërkesës: *Avokati i Popullit*, Aktgjykimi i 12 prillit 2013).

30. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës, që parasheh:

> *"1. Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.*
>
> *2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës".*

31. Prandaj, Gjykata konkludon se, në kërkesën e tanishme KO22/15, parashtruesi i kërkesës nuk ngre ndonjë çështje që eventualisht do të hynte në kuadër të kompetencës së tij, siç parashihet me dispozitat kushtetuese. Prandaj, me parashtrimin e kësaj kërkese, parashtruesi nuk ka ushtruar funksionet dhe kompetencat e tij kushtetuese. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës dështon të pohojë ndonjë shkelje të dispozitave specifike kushtetuese lidhur me të drejtat dhe liritë themelore të tij, ose të ndonjë individi a grupi të individëve.

32. Gjykata rikujton se çdo parashtrues i kërkesës, përfshirë parashtruesin në kërkesën e tanishme, duhet të parashtrojë kërkesë brenda kompetencave dhe fushëveprimit të tij, të parapara me Kushtetutë dhe me Ligj.

33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet një vendimi (Nr. 29, i 31 majit 2010) të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e cila kishte shqyrtuar një kërkesë të paraqitur nga Avokati i Popullit i Republikës së Shqipërisë, me të cilën kërkohej shfuqizimi i një ligji që kishte të bënte me shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore.

34. Në këtë rast, Gjykata vëren se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë konstatoi:

> *"Sipas nenit 60 të Kushtetutës, Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose*

mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Pra, edhe interesi i tij për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese duhet të lidhet me funksionin kushtetues që ushtron kur, si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, aktit normativ nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike, janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individëve. Këto shkelje duhet të evidentohen në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij".

35. Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë konstatoi se inicimi i procedurës nga Avokati i Popullit *"[...] do të quhet i justifikuar nëse arrin të provohet nga vetë kërkuesi se pasoja është e drejtpërdrejtë, pra rrjedh direkt nga akti objekt shqyrtimi, është aktuale dhe, sipas rastit, është e lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e institucionit ose organizatës respektive".*

36. Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë konstatoi:

"Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të njërit prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që sipas rastit do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese".

[...]

"Kjo do të thotë se, në aspektin kushtetues e ligjor, pushteti për dhënien e drejtësisë, domethënë pushteti për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile u është dhënë gjykatave".

37. Gjykata gjithashtu i referohet Vendimit (Nr. 40, të 16 nëntorit 2007) të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, ku Avokati i Popullit i Republikës së Shqipërisë kishte kontestuar kushtetutshmërinë e nocionit "vendbanim" në "Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

38. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë konstatoi:

"Siç është theksuar edhe në praktikën e mëparshme të kësaj Gjykate, Avokati i Popullit, si një nga subjektet që mund ta vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në bazë të nenit 134/2 të Kushtetutës, duhet të justifikojë interesin e tij në çështjen konkrete. Interesi i tij duhet të lidhet me funksionin kushtetues që ushtron kur si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, aktit normativ nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike, janë cenuar të

drejtat dhe liritë themelore të individëve. Këto shkelje duhet të evidentohen në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij".

[...]

"Gjykata Kushtetuese e sheh me vend të ndalet edhe një herë në përcaktimin e konceptit 'interes' në çështjen me kërkues Avokatin e Popullit, sipas nenit 134/2 të Kushtetutës, ku parashikohet se ky organ mund të bëjë kërkesë para kësaj Gjykate vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tij. Sipas nenit 60 të Kushtetutës, Avokati i Popullit është organ kushtetues i krijuar për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të administratës publike".

39. Po ashtu, në atë vendim të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë theksohet se *"nuk është rol i Avokatit të Popullit të veprojë në emër të një individi në gjykatë. Mjetet juridike duhet të shfrytëzohen së pari dhe para së gjithash nga vetë individi në fjalë. Mirëpo, sa herë që një individ për çfarëdo arsye nuk ka qasje efektive në mjete të tilla, është me vend që Avokati i Popullit të ketë kapacitetin për të verifikuar nëse ka pasur ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut. Një mundësi e tillë parashikohet në disa vende me anë të ankesës kushtetuese".* (Shih *"Marrëdhëniet ndërmjet avokatëve të popullit dhe organeve gjyqësore"*, Konferencë e avokatëve të popullit të vendeve evropiane, mbajtur në Lubjanë në vitin 2001).

40. Gjykata po ashtu vëren se *"kompetencat e Avokatit të Popullit në raport me degën gjyqësore të pushtetit mund të jenë vetëm në atë masë sa nuk e rrezikojnë pavarësinë e gjyqtarëve dhe paanshmërinë e tyre në marrjen e vendimeve gjyqësore".* (Shih *"Marrëdhëniet ndërmjet avokatëve të popullit dhe organeve gjyqësore"*, Konferencë e avokatëve të popullit të vendeve evropiane, mbajtur në Lubjanë në vitin 2001).

41. Gjykata vëren se Avokati i Popullit dhe autoritetet e tjera publike nuk kanë kompetenca kushtetuese për të hetuar procesin e vendimmarrjes së organeve të pavarura gjyqësore.

42. Sipas Avokatit të Popullit, hetimi *ex officio* u iniciua lidhur me procedurën që çoi deri në marrjen e Aktvendimit për papranueshmëri në Rastin KO155/14.

43. Gjykata rithekson se është organ i pavarur në mbrojtje të Kushtetutës dhe është interpretuesi përfundimtar i Kushtetutës. Në fakt, neni 112 i Kushtetutës përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.*
>
> *2. Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësive të saj".*

44. Gjykata gjithashtu rikujton se "*Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë"* (Shih nenin 4.1 të Kushtetutës).

45. Roli i Gjykatës Kushtetuese *vis-a-vis* legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit është të sigurojë që veprimet e tyre janë në përputhshmëri me Kushtetutën.

46. Më tej, Gjykata rithekson se Kushtetuta u jep gjyqtarëve të Gjykatës imunitet për vendimet e marra apo për mendimet e shprehura brenda fushëveprimit të mandatit të tyre. Në fakt, neni 117 [Imuniteti] i Kushtetutës parasheh: *"Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga detyra për vendimet e marra, mendimet e shprehura dhe veprimet e marra brenda fushës së përgjegjësive si gjykatës të Gjykatës Kushtetuese".*

47. Gjykata gjithashtu i referohet praktikës së saj gjyqësore, ku kishte konstatuar: "*Sipas teorisë dhe praktikës kushtetuese, sistemet e ndryshme juridike njohin dhe zbatojnë dy kategori, ose anë, të konceptit të imunitetit parlamentar. Kategoria e parë është lirimi nga përgjegjësia në procedura gjyqësore të çfarëdo natyre mbi pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre si deputetë dhe veprimet e tjera të ndërmarra gjatë kohës që janë duke kryer detyrat e tyre. Ky lloj imuniteti vazhdon edhe pasi mandati i tyre të mbarojë dhe ka kohëzgjatje të pakufizuar. Ata kurrë nuk do të jenë të detyruar t'i përgjigjen askujt apo ndonjë gjykate për veprime dhe vendime të tilla. Kjo është përcaktuar në mënyrë të qartë në Kushtetutën e Kosovës. Ky është imuniteti funksional*" (Shih Rastin KO98/11, parashtrues i kërkesës: *Qeveria e Republikës së Kosovës,* Aktgjykimi i 20 shtatorit 2011). Ky imunitet funksional gjithashtu garanton pavarësinë e Gjykatës.

48. Gjykata rikujton: *"Në kryerjen e funksioneve të tyre gjyqësore, gjyqtarët janë të pavarur në bazë të ligjit, dhe vendimet e tyre nuk*

duhet të jenë objekt i çfarëdo rishqyrtimi jashtë procedurave ankimore të parapara me ligj. Pushtetet ekzekutive dhe legjislative duhet të sigurojnë që gjyqtarët të jenë të pavarur dhe të mos bëhen hapa që do të rrezikonin pavarësinë e gjyqtarëve. Po ashtu duhet theksuar se gjyqtarët janë të pavarur në interesin e publikut" (Shih "*Marrëdhëniet ndërmjet avokatëve të popullit dhe organeve gjyqësore*", Konferencë e avokatëve të popullit të vendeve evropiane, mbajtur në Lubjanë në vitin 2001).

49. Gjykata rikujton se pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës për rishqyrtimin e Rastit KO155/14 është mungesa e kuorumit kur është marrë Aktvendimi.

50. Gjykata rikujton se neni 22 i Ligjit rregullon procedurat që duhet të ndjekë Gjykata kur vendos për pranueshmërinë dhe për papranueshmërinë e kërkesave.

51. Në fakt, pasi Kryetari i Gjykatës ia cakton kërkesën një gjyqtari raportues dhe një Kolegji shqyrtues prej tre gjyqtarësh, gjyqtari raportues i paraqet raportin Kolegjit shqyrtues për papranueshmërinë e kërkesës. Kolegji shqyrtues diskuton për të dhe i rekomandon Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës. Nuk mbahet këshillim dhe votim i mëtejshëm.

52. Në këtë fazë të procedurave, pasi nuk mbahet këshillim dhe votim i mëtejshëm, me Ligj nuk kërkohet kuorumi prej 7 (shtatë) gjyqtarësh. Procedura zhvillohet ndërmjet gjyqtarit raportues dhe Kolegjit shqyrtues prej tre gjyqtarësh që janë të pranishëm, që mbajnë këshillime dhe që votojnë.

53. Nëse papranueshmëria e propozuar e kërkesës njëzëri mbështetet nga Kolegji shqyrtues, atëherë Aktvendimi për papranueshmëri u dorëzohet të gjithë gjyqtarëve.

54. Më tej, sipas nenit 22, paragrafët 8 dhe 9, gjyqtarët që nuk janë anëtarë të Kolegjit shqyrtues, brenda dhjetë ditësh nga dorëzimi i projektaktvendimit, mund të kundërshtojnë propozimin për papranueshmëri. Aktvendimi miratohet nëse asnjë nga gjyqtarët e Gjykatës nuk e kundërshton papranueshmërinë.

55. Kur miratohet Aktvendimi për papanueshmëri, gjyqtari raportues dhe Kryetari i Gjykatës e nënshkruajnë Aktvendimin, i cili publikohet dhe merr formë të prerë.

56. Gjykata rikujton nenin 22, paragrafët 6 deri në 9, të Ligjit, që përcakton:

"[...]

6. Kolegji shqyrtues vlerëson lejueshmërinë e kërkesës. Kolegji shqyrtues përbëhet nga tre gjyqtarë të caktuar nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese sipas procedurës së përcaktuar në Rregulloren e punës.

7. Nëse Kolegji shqyrtues unanimisht vjen në përfundim se kërkesa nuk i plotëson kushtet formale për procedim të mëtutjeshëm dhe për këtë shkak nuk është e lejueshme, Kolegji ia dërgon të gjithë gjyqtarëve propozim-vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa për shkak të mungesës së lejueshmërisë. Kolegji shqyrtues merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të sigurojë se kopja e propozimvendimit i është dërguar gjyqtarëve që mund të mos jenë në territorin e Republikës së Kosovës.

8. Nëse brenda afatit prej dhjetë (10) ditësh prej pranimit të propozimvendimit gjyqtarët që nuk kanë qenë anëtarë të Kolegjit shqyrtues nuk kundërshtojnë këtë propozimvendim, atëherë Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e nënshkruan dhe e shpall vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa për shkak të mungesës së lejueshmërisë.

9. Në rast se Kolegji shqyrtues vjen në përfundim se kërkesa është e lejueshme apo nëse të paktën njëri prej gjyqtarëve që nuk ka qenë anëtar i Kolegjit shqyrtues kundërshton propozimvendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa, lënda i dërgohet trupit gjykues. Trupi gjykues, gjatë shqyrtimit verbal, shqyrton në tërësi lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës dhe merr vendim sipas dispozitave të këtij ligji".

57. Gjykata specifikon se Rasti KO155/14 është diskutuar paraprakisht më 27 tetor 2014 dhe, më 4 nëntor 2014, Kolegji shqyrtues njëzëri miratoi raportin e gjyqtarit raportues dhe Projektaktvendimin për papranueshmëri.

58. Të njëjtën datë, Aktvendimi për papranueshmëri iu dërgua për komente në afatin dhjetëditor të gjithë gjyqtarëve në pajtim me nenin 22, paragrafët 7 dhe 8, të Ligjit. Pasi kaloi koha për kundërshtime ndaj Aktvendimit për papranueshmëri, ai u nënshkrua nga Kryetari i Gjykatës dhe nga gjyqtari raportues. Aktvendimi për papranueshmëri u publikua në Gazetën Zyrtare më 17 nëntor 2014.

59. Rrjedhimisht, procedura e ndjekur në Rastin KO155/14 ishte në pajtueshmëri me nenet 19 dhe 22 të Ligjit.

60. Prandaj, Gjykata thekson se vendimi i saj lidhur me Kërkesën KO155/14 është i formës së prerë dhe i detyrueshëm për gjyqësorin, për të gjithë personat dhe për institucionet e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 116.1 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës.

61. Gjykata rikujton se Dekreti i Presidentes së Republikës së Kosovës është kushtetues, pasi është nxjerrë në bazë të obligimeve ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, siç është definuar në marrëveshjen bilaterale. Kushtetutshmëria e përmbajtjes së kësaj marrëveshjeje nuk mund të vlerësohet nga Gjykata. (Shih Rastin KO95/13, parashtrues: *Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,* Aktgjykimi i 9 shtatorit 2013).

62. Përmbajtja e Dekretit të Presidentes së Republikës së Kosovës është përcaktuar me marrëveshjen bilaterale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Dekreti u ratifikua me shumicën e 2/3 të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Është obligim kushtetues i Presidentes së Republikës së Kosovës që ta bartë këtë tekst, ashtu siç është, nga marrëveshja bilaterale në Dekretin e saj dhe ta ekzekutojë atë nëpërmjet Dekretit të saj.

63. Dekreti i Presidentes së Republikës së Kosovës u shpall se ishte në pajtueshmëri me Kushtetutën. Pra, çështja e kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentes së Republikës së Kosovës është bërë *res judicata*.

64. Në këto rrethana, Gjykata rikujton se ajo tashmë ka vendosur për Rastin KO155/14. Ajo kishte konkluduar se Dekreti i Presidentes së Republikës së Kosovës ishte në pajtueshmëri me Kushtetutën.

65. Nga sa u tha më lart, Gjykata refuzon Kërkesën KO22/15 si qartazi të pabazuar, në bazë të nenit 29 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (d) dhe (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 29 të Ligjit dhe të rregullit 36 (1) (d) dhe (2) dhe të rregullit 56 të Rregullores së punës, më 30 prill 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim Parashtruesit të kërkesës dhe Presidentes së Republikës së Kosovës;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Arta Rama-Hajrizi	Prof. dr. Enver Hasani

KO22/15, Parashtrues i kërkesës Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, Kërkesë për përjashtim të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

KO 22/15, Vendim i 17 prillit 2015, publikuar më 30 prill 2015

Fjalët kyç*: Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, kërkesë për përjashtim, kërkesë e papranueshme*

Në këtë kërkesë, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës ka kërkuar përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, për shkak të angazhimit të tij të pretenduar në procedurën për emërimin e tre gjyqtarëve ndërkombëtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Gjykata vërejti se Avokati i Popullit nuk ka dorëzuar ndonjë provë apo argumente që do të tregonin se ekziston ndonjë arsye e vlefshme për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata e refuzoi kërkesën e Avokatit të Popullit për shkak se është e paarsyetuar, irelevante dhe e paargumentuar.

VENDIM
në
Rastin nr. KO22/15
Parashtrues
Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës
Kërkesë për përjashtim të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, z. Sami Kurteshi.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon rishqyrtimin e Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Rastin KO155/14.

3. Në këtë kërkesë, parashtruesi gjithashtu kërkon përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 18 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), Nr. 03/L-121, dhe me rregullin 7 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 18 [Përjashtimi i gjyqtarit] të Ligjit dhe në rregullin 7 [Procedurat për përjashtim], paragrafët 2, 3 dhe 4, të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 26 shkurt 2015, parashtruesi dorëzoi kërkesën KO22/15, që përmbante kërkesën për përjashtim të Kryetarit të Gjykatës.

6. Më 17 prill 2015, Gjykata ndoqi procedurën e paraparë me rregullin 7.4 të Rregullores së punës, i cili parasheh si në vijim:

> *"[...] Gjykata, me shumicën e votave të gjyqtarëve, vendos për peticionin për përjashtim. Para marrjes së vendimit për përjashtimin e kërkuar, merret një deklaratë nga gjyqtari, përjashtimi i të cilit kërkohet dhe, nëse është nevoja, do të sigurohen edhe sqarime të tjera. Gjyqtari, përjashtimi i të cilit kërkohet, nuk mund marrë pjesë në procedurën e marrjes së vendimit. Vendimi i Gjykatës i dorëzohet palëve në procedurë".*

7. Më 17 prill 2015, Gjykata mori një deklaratë nga Kryetari i Gjykatës në pajtim me rregullin 7.4 të Rregullores së punës.

8. Të njëjtën ditë, Gjykata, pa praninë e Kryetarit të Gjykatës, shqyrtoi kërkesën e parashtruesit dhe votoi njëzëri që ta refuzojë atë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

9. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Kryetari i Gjykatës duhet të përjashtohet, ku pretendohet se *"[...] për shkak të (1) angazhimit të tij në diskutimet e brendshme të EULEX-it në lidhje me procedurën për emërimin e tre gjyqtarëve ndërkombëtarë; dhe (2) deklaratës së tij të qartë sipas të cilës anashkalimi i Kuvendit nuk do të përbënte shkelje kushtetuese në këtë rast".*

Pranueshmëria e kërkesës

10. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë provë apo argumente që do të tregonin se ekziston ndonjë arsye e vlefshme për përjashtimin e tij.

11. Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit është e paarsyetuar, irelevante dhe e paargumentuar.

12. Prandaj, Gjykata e refuzon kërkesën e parashtruesit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 29 të Ligjit, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) dhe në pajtim me rregullin 56 të Rregullores së punës, më 17 prill 2015, njëzëri,

VENDOS

I. TA REFUZOJË kërkesën e parashtruesit për përjashtim të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim parashtruesit të kërkesës dhe Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas votimit.

Zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Ivan Čukalović

KI175/14, Parashtrues Sylejman (Daut) Dibra, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0095-A0001-A0005, i 20 majit 2014

KI175/14, Aktvendim për papranueshmëri i 27 marsit 2015, publikuar më 6 maj 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, e drejta në punë dhe ushtrim të profesionit, privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore, kërkesë e paafatshme*

Kolegji i Ankesave të Dhomës së Posaçme refuzoi, si të pabazuar ankesën e parashtruesit, dhe vërtetoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar përkitazi me të drejtën e parashtruesit për një pjesë të të ardhurave nga 20% i privatizimit të NSH "Liria" në Prizren. Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme konstatoi se parashtruesi i kërkesës, nuk kishte paraqitur prova tjera që dëshmojnë se ai ishte në listën e pagave në kohën e privatizimit.

Parashtruesi pretendon se Kolegji i Ankesave kishte shkelur të drejtën e tij për punë dhe ushtrim të profesionit të garantuar me nenin 49 të Kushtetutës, me ç'rast i është ndërprerë marrëdhënja e punës pa kurrfarë baze ligjore.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte dorëzuar jashtë afatit ligjor. Kërkesa u shpall e papranueshme sepse nuk ishte dorëzuar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe specifikuar më tej me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI175/14
Parashtrues
Sylejman (Daut) Dibra
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0095-A0001-A0005, të 20 majit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Sylejman (Daut) Dibra (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me banim në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Ankesave), AC-I-13-0095-A0001-A0005, të 20 majit 2014, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 22 maj 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), *"[...] kur më është ndërprer marrëdhënja e punës pa kurrëfarë baze ligjore"*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 13 janar 2015, Kryetari i Gjykatës me Vendimin GJR. KI175/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI175/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 20 janar 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Ankesave dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP).

8. Më 12 shkurt 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 10 maj 2013, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit, për t'u regjistruar në listën e të punësuarve që gëzojnë të drejtën për një pjesë të 20% nga të ardhurat e privatizimit të Ndërmarrjes Shoqërore "Liria" nga Prizreni (Aktgjykimi C-II-12-0007-C9). Kolegji i Specializuar konstatoi se parashtruesi i kërkesës, nuk i ka përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 mbi transformimin e të drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13). Parashtruesi parashtroi ankesë ndaj këtij Aktgjykimi në Kolegjin e Ankesave.

10. Më 20 maj 2014, Kolegji i Ankesave (Aktgjykimi AC-I-13-0095-A0001-A0005) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, të 10 majit 2013. Kolegji i Ankesave konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur prova tjera, të cilat dëshmojnë se ai ishte në listën e pagave në kohën e privatizimit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

11. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kontrata e punës nuk i është ndërprerë në pajtim me ligjin në fuqi, për shkak se ai kurrë nuk kishte marrë një vendim për ndërprerjen e kontratës së punës, të cilin ai do të mund ta kishte kontestuar në përputhje me ligjin në fuqi. Ai pretendon se ishte i njoftuar vetëm gojarisht se i ishte ndërprerë kontrata e tij e punës.

Pranueshmëria e kërkesës

12. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

13. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. […]".*

14. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: (c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi; ose […]".*

15. Aktgjykimi përfundimtar i Kolegjit të Ankesave, AC-I-13-0095-A0001-A00051, ishte nxjerrë më 20 maj 2014 dhe i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 22 maj 2014, ndërsa parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë më 9 dhjetor 2014, d.m.th. më shumë se 4 muaj nga dita kur parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar Aktgjykimi i Kolegjit të Ankesave.

16. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme si e paafatshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (c) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 27 mars 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË ketë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Arta Rama-Hajrizi	Prof. dr. Enver Hasani

KI160/14, Parashtrues Ejup Jakupi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr. 215/2014, të 1 shtatorit 2014

KI160/14, Aktvendim për papranueshmëri i 15 prillit 2015, publikuar më 14 maj 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, pension jubilar, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin, Rev.nr 215/2014, të 1 shtatorit 2014 hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për revizion sepse vlera e kontestit ishte nën limitin e përcaktuar me ligj. Thelbi i ankesës së parashtruesit ndaj vendimeve të gjykatave të instancës më të ulët kishte të bënte me të drejtën e parashtruesit për pension jubilar.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Gjykata Supreme kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, por pa iu referuar ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi nuk ka arritur të ofrojë ndonjë dëshmi *prima facie* për të arsyetuar pretendimet e tij, dhe se procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta nuk ishin të padrejta apo arbitrare. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar, në përputhje me rregullat 36 (1) d), 36 (2) b) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI160/14
Parashtrues
Ejup Jakupi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
Rev. 215/2014, të 1 shtatorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Ejup Jakupi, me vendbanim në Gjilan (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), Rev. nr. 215/2014, të 1 shtatorit 2014, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 21 tetor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 215/2014, të 1 shtatorit 2014. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, duke refuzuar revizionin si të palejuar, i ka shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta). Parashtruesi nuk ka specifikuar asnjë dispozite konkrete të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 tetor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 7 nëntor 2014, Kryetari, me Vendimin GJR. KI160/14 caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI160/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

7. Më 18 nëntor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës në Gjykatën Supreme.

8. Më 25 nëntor 2014, parashtruesi dorëzoi, me iniciativën e tij, dokumente shtesë në Gjykatë.

9. Më 15 prill 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës ka punuar si regjistrues i pronës në Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Gjilanit, prej 20 gushtit 2002 deri më 1 qershor 2011, kur është pensionuar.

11. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Gjilan, duke kërkuar që Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Gjilanit t'i paguajë një shumë të caktuar, në emër të pagës jubilare, me rastin e pensionimit të tij.

12. Më 9 shtator 2013, Gjykata Themelore në Gjilan nxori Aktgjykimin C. nr. 794/2012, duke aprovuar pjesërisht padinë e parashtruesit përkitazi me kërkesën e shpërblimit jubilar në një shumë të caktuar të hollash, me kamatë vjetore 3.5%, ndërsa refuzoi kërkesën e

parashtruesit, që pala e paditur t'i paguajë një shumë tjetër të caktuar të hollash, në emër të regresit.

13. Më 30 shtator 2013, Komuna e Gjilanit ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) kundër Aktgjykimit C. nr. 794/2012 të Gjykatës Themelore në Gjilan për shkak të " *1. Shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; 2. Konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe 3. Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale".*

14. Më 8 prill 2013, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin AC. nr. 3310/13, me të cilin pranoi ankesën e Komunës së Gjilanit. Gjykata e Apelit vendosi që të marrëveshja kolektive, në të cilën Parashtruesi bazonte kërkesën e tij për pagë jubilare, ishte lidhur në vitin 2005 dhe ishte në në fuqi për 3 (tre) vite, gjegjësisht skadoi në vitin 2008. Prandaj Aktgjykimi i Gjykatës Themelore u anulua.

15. Më 20 maj 2013, parashtruesi dorëzoi një kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër Aktgjykimit AC. nr. 3310/13 të Gjykatës së Apelit. Sipas parashtruesit, Gjykata e Apelit me rastin e marrjes së Aktgjykimit AC. nr. 3310/13 kishte bërë *"shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 parag. 2, shkronja n etj. të LPK-së dhe aplikim të gabuar të të drejtës materiale".*

16. Më 1 shtator 2014, Aktvendimi i Gjykatës Supreme (Rev. 215/2014) hodhi si të palejuar kërkesën e parashtruesit për revizion, sepse vlera e kontestit ishte nën limitin ligjor në bazë të të cilin mund të shqyrtohen kërkesat për revizion.

17. Në pjesën e arsyetimit të aktvendimit të saj, Gjykata Supreme theksoi:

> *" Nga shkresat e lëndës rezulton se vlera e këtij kontesti në padinë e paditësit, të paraqitur me datën 06.10.2011, është caktuar në shumën prej 1.664,25 €, dhe se më vonë nga ana e palës paditëse nuk është ndryshuar kjo vlerë e kontestit.*
>
> *Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, pasi e shqyrtoi lejueshmërinë e paraqitjes së këtij revizioni, gjeti se i njëjti është i palejuar. Sipas nenit 211.2 të LPK, revizioni nuk është i lejuar në kontestet pasurore-juridike, në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit ose me kryerjen e ndonjë veprimi, nëse vlera e objektit të kontestit të cilën paditësi e ka përcaktuar në padi, nuk kalon shumën prej 3000 €".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin Rev. 215/2014, të 1 shtatorit 2014, duke ia hedhur poshtë si të palejueshëm revizionin, Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë, por pa specifikuar dispozitat përkatëse kushtetuese.

19. Në shkresën e tij të dorëzuar më 25 nëntor 2014, parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta "*nuk kanë punuar në mënyrë të drejt ligjore, por kanë punuar në mënyrë jo të drejt, por kanë punuar me njoftësi familjare, shoqërore, miqësore etj*".

Vlerësimi i pranueshmerisë së kërkesës

20. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, në përputhje me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës.

Neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar (...)*".

22. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) d), 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...]*
>
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*

[...], ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

23. Parashtruesi pretendon se Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. 215/2014, i 1 shtatorit 2014, i ka shkelur të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetutë, pa specifikuar ndonjë dispozitë konkrete të Kushtetutës, por duke aluduar në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë.

24. Në lidhje me këtë, parashtruesi fare nuk ka shpjeguar si dhe pse Aktvendimi i Gjykatës Supreme kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

25. Gjykata Kushtetuese ripërsërit se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

26. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).

27. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktvendimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat në gjykatat e rregullta nuk ishin të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).

28. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi, nuk i ka mbështetur pretendimet e tij dhe as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie,* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo

Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (Shih, rastin Nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla,* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013, dhe të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

29. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e tij për shkeljen e të drejtave kushtetuese, dhe parashtruesi nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme, si dhe pse Aktvendimi i Gjykatës Supreme i kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) d), 36 (2) b) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës, më 7 maj 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Kadri Kryeziu	Prof. dr. Enver Hasani

KI149/14, 150/14 , 151/14, Parashtrues Liridon Aliu, kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së punës të disa institucioneve në Republikën e Kosovës

KI149/14, 150/14, 151/14, Vendim për Heqje të Kërkesës nga Lista i 16 prillit 2015, publikuar më 21 maj 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, actio popularis, heqje e kërkesës nga lista*

Parashtruesi në kërkesën e tij konteston punën e institucioneve të rendit dhe të Ligjit, gjykatave dhe të Kuvendit të Kosovës, mirëpo nuk i është referuar asnjë dispozite kushtetuese dhe nuk ka treguar se si atij personalisht i ishin shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.

Gjykata theksoi se sistemi kushtetues i Kosovës, nuk lejon *actio popularis* ku individët mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese përkitazi me çështjet e interesit të përgjithshëm, dhe për më tepër, konstatoi se kjo kërkesë nuk kalon pragun minimal për t'u konsideruar e tillë. Kërkesa u shpall e papranueshme për shkak se nuk paraqet rast apo kontest siç parashihet me rregullin 32 (4) të Rregullores së punës.

VENDIM PËR HEQJEN E KËRKESËS NGA LISTA
në
Rastin nr. KI149/14, KI150/14 dhe KI151/14
Parashtrues
Liridon Aliu
Kërkesë për vlerësimin kushtetues të punës të disa institucioneve të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Liridon Aliu, kryetar i organizatës joqeveritare (OJQ) "Ngrite zërin dhe ti" (NZT), nga fshati Hajvali, komuna e Prishtinës. Ai nuk kishte sqaruar nëse kërkesën e ka parashtruar në emër të tij apo të OJQ-së që ai drejton.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston ndonjë vendim të caktuar të ndonjë autoriteti publik.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon nga Gjykata vlerësimin e punës së disa prej institucioneve të Kosovës, sidomos të atyre të rendit dhe të ligjit, të gjykatave si dhe të Kuvendit të Kosovës. Parashtruesi nuk ka theksuar shkeljen e ndonjë dispozite kushtetuese.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 7 tetor 2014, parashtruesi dorëzoi tri kërkesa në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 30 tetor 2014, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë dokumentacion shtesë në mbështetje të kërkesës së tij.

7. Më 6 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI149/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

8. Të njëjtën ditë, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, Kryetari urdhëroi që kërkesat KI150/14 dhe KI151/14 të bashkohen me kërkesën KI149/14 dhe që gjyqtari raportues dhe Kolegji shqyrtues për të dy rastet (KI150 dhe KI151/14) të jenë të njëjtë, ashtu siç ishte vendosur për kërkesën KI149/14.

9. Më 24 mars 2015, Gjykata Kushtetuese e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 16 prill 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës nuk i ka paraqitur Gjykatës fakte konkrete lidhur me kërkesën, por udhëzon Gjykatën në një numër të madh ueb-faqesh dhe në ekstrakte gazetash të ilustruara me fotografi dhe shpreh gatishmërinë ta ndihmojë Gjykatën në gjetjen e fakteve për të cilat pretendon se janë objekt i ankimit.

Pretendimet e parashtruesit

12. Parashtruesi i kërkesës pretendon se institucionet e vendit, sidomos ato të ndjekjes, të rendit e të ligjit dhe gjykatat kanë dështuar në parandalimin dhe ndëshkimin e veprave korruptive, "hajnisë dhe vjedhjeve", pra veprave penale. Ndërsa pohon se Kuvendi i Kosovës nxjerr ligje kundërkushtetuese e të panevojshme, duke iu referuar në veçanti Ligjit për parandalimin e pjesëmarrjes në luftëra të huaja, i cili në kohën e paraqitjes së kërkesës ishte në fazën e shqyrtimit.

13. Parashtruesi më tej pretendon se në Kosovë individë të caktuar janë arrestuar paligjshëm nga Policia e Kosovës. Parashtruesi nuk ka theksuar që atij drejtpërsëdrejti t'i jetë shkelur ndonjë e drejtë e garantuar me Kushtetutë.

Pranueshmëria e kërkesës

14. Për të gjykuar lidhur me kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, i cili përcakton:

    "Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës ne mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

16. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 32 par. 4 të Rregullores së punës në fuqi në kohën e kërkesës, i cili përcakton:

    <u>Rregulli 32</u>

    <u>Tërheqja e kërkesës dhe përgjigjes</u>

    (4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme ose që nuk përfaqësojnë një rast ose kontest.

17. Siç është cekur më lart, parashtruesi nuk konteston asnjë akt specifik të ndonjë autoriteti publik, nuk përcakton asnjë shkelje të ndonjë të drejte kushtetuese ndaj tij, nuk precizon cila është baza e kontestit por, në mënyrë të përgjithësuar, nisur nga këndvështrimi i tij, kërkon vlerësimin abstrakt të kushtetutshmërisë së veprimeve apo të

mosveprimeve të organeve dhe të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës.

18. Gjykata përkujton se sistemi kushtetues juridik i Kosovës nuk parasheh *actio popularis*, që është modalitet i ankesave individuale që i mundësojnë cilitdo individ, i cili tenton të mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese lidhur me shkeljet e tilla, edhe pse nuk e ka statusin e viktimës apo interesin e drejtpërdrejtë.

19. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e lartpërmendur nuk e kalon pragun minimal që të konsiderohet si kërkesë (Shih Rastin KI143/13, parashtrues i kërkesës *Nebih Sejdiu,* Vendimi për heqjen e kërkesës nga lista, i 24 prillit 2014; shih gjithashtu, *mutatis mutandis,* rastin *Starodub kundër Ukrainës,* Nr. 5483/02, GJEDNJ, Vendimi i 7 qershorit 2005). Prandaj konsideron se kjo kërkesë nuk paraqet rast apo kontest dhe duhet të deklarohet e papranueshme dhe, në pajtim me rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, të hiqet nga lista.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 23 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe të rregullit 32 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 18 maj 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA HEQË NGA LISTA kërkesën e parashtruar;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafin 4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Prof. dr. Enver Hasani

KI02/15, Parashtrues Qendra shoqërore, kulturore, sportive, ekonomike "Pallati i Rinisë", Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-1-14-0077-AOOOI, AC-I-14-0078-AOOOI, AC-1-14-0079-AOOOI dhe AC-I-14-0080-AOOOI, të 15 shtatorit 2014

KI02/15, Aktvendim për papranueshmëri i 14 prillit 2015, publikuar më 21 maj 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete juridike, barazia para ligjit, Masë e përkohshme, qartazi e pabazuar*

Kolegji i Apelit i DHPGJS-së ka nxjerrë aktvendimet AC-I-14-0077-AOOOI; AC-I-14-0078-AOOOI, AC-I,-14-0079-AOOOI, AC-I-14-0080-AOOOI me anë të të cilave ka hedhur poshtë si të papranueshme kërkesën për revizion dhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, me arsyetimin se të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së janë të prera dhe të paapelueshme. Thelbi i vendimeve të kontestuara kishte të bënte me urdhrin për kompensimin e dëmit nga parashtruesi ndaj palëve të treta.

Parashtruesi ndër të tjera pretendoi, se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm kur ka vendosur se vendimet e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së janë të paapelueshme, pra, ndaj tyre nuk mund të ushtrohet asnjë mjet i jashtëzakonshëm juridik. Parashtruesi, po ashtu, kërkoi nga Gjykata vendosjen e Masës së përkohshme deri në vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktvendimeve të kontestuara, në mënyrë që të shmangë pagesën e papërballueshme të kompenzimit.

Gjykata konstatoi se vendimet e DHPGJS-së nuk mund të jenë objekt i asnjë lloj procedure tjetër qoftë edhe gjyqësore, përveç objekt i trajtimit në Gjykatën Kushtetuese. Parashtruesi nuk kishte ofruar ndonjë provë konkrete për ta mbështetur rastin e tij apo se procesi gjyqësor kishte qenë i padrejtë apo arbitrar. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar. Gjykata, po ashtu hodhi poshtë kërkesën për Masë të përkohshme për shkak se nuk ishte *prima facie* e arsyetuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI02/15
Parashtrues
Qendra Shoqërore, Kulturore, Sportive, Ekonomike "Pallati i Rinisë",
Prishtinë
Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme: AC-I.-14-0077-AOOOI, AC-I.-14-0078-AOOOI, AC-I.-14-0079-AOOOI dhe AC-I.-14-0080-AOOOI, të 15 shtatorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan,gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Qendra Shoqërore, Sportive dhe Ekonomike në Prishtinë, e përfaqësuar nga ushtruesi i detyrës së drejtorit, z. Fatmir Gashi, jurist nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës i konteston aktgjykimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS): AC-I.-14-0077-AOOOI, AC-I.-14-0078-AOOOI, AC-I.-14-0079-AOOOI, të dhe AC-I.-14-0080-AOOOI, të 15 shtatorit 2014. Parashtruesi i kërkesës i rithekson si të kontestueshme edhe aktgjykimet SCC-05-0080; SCC-06-0029; SCC-06-0470; SCC-06-0482; SCC-06-0524, të gjitha të 15 tetorit 2009; SCC-04-00 10; SCC-04-0011; SCC-04-0012; SCC-04-0098; SCC-04-0116; SCC-04-0121; SCC-04-0199; SCC-05-0028; SCC-05-0067; SCC-05-0072; SCC-05-0073, të gjitha të 29 tetorit 2009; dhe

ASC-09-0084; ASC-09-0101, të 13 shtatorit 2012, për të cilat kishte vendosur Gjykata me Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin KI23/14, të paraqitur nga i njëjti parashtrues.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të përmendura si më lart të DHPGJS-së, me të cilat parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), dhe me Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut. Me këto aktgjykime parashtruesi urdhërohej që t'ua kompensojë dëmin material 16 (gjashtëmbëdhjetë) paditësve, të shkaktuar nga zjarri në ndërtesën e Qendrës Shoqërore, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike në Prishtinë. Ndërsa me aktgjykimet e Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, ankesat e parashtruesit ndaj vendimeve të shkallës së parë ishin refuzuar.

4. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të caktojë Masën e përkohshme që të pezullojë përmbarimin e aktgjykimeve të DHPGJS-së derisa të merret vendimi nga Gjykata.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 21.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 54, 55, dhe 56 të Rregullores.

Procedura në Gjykatë

6. Më 9 janar 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 13 janar 2015, Kryetari, me Vendimin GJR. KI02/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI02/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

8. Më 19 shkurt 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës DHPGJS-së.

9. Më 14 prill 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 7 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur në Gjykatë edhe një kërkesë, e cila ishte regjistruar si Rasti KI23/14, me po të njëjtat pretendime ankimore dhe shumicën e provave të njëjta në të cilën nuk përfshiheshin vetëm aktgjykimet e fundit të kontestuara të vitit 2014.

11. Përmbledhja e plotë e fakteve, përpos fakteve të reja lidhur me aktgjykimet AC-I.-14-0077-AOOOI AC-I.-14-0078-AOOOI të 15 shtatorit 2014; AC-I.-14-0079-AOOOI, të 15 shtatorit 2014; AC-I.-14-0080-AOOOI, të 15 shtatorit 2014, është trajtuar dhe paraqitur në mënyrë kronologjike në Aktvendimin për papranueshmëri KI23/14, të 3 marsit 2014.

12. Gjykata megjithatë rikujton se çështja bazë e kërkesës, është fakti se ndërmjet vitit 2004 dhe 2005, 16 (gjashtëmbëdhjetë) paditës paraqitën paditë e tyre në DHPGJS-së, duke kërkuar kompensimin e dëmeve nga parashtruesi, për mallrat që ishin brenda depove të marra me qira, të cilat ishin shkatërruar nga zjarri.

13. Me aktgjykimet si në pikën 2 të këtij raporti, DHPGJS-së në vitin 2009 ka aprovuar paditë individuale të paditësve dhe ka akorduar shumën e kompensimit që duhet t`u paguhet paditësve, ndërsa Kolegji i ankesave i DHPGJ-së pas ankesës së parashtruesit në vitin 2012 i ka ndryshuar pjesërisht aktgjykimet, vetëm sa i përket pjesës së shumës së kompensimit duke e zvogëluar atë.

14. Më 18 tetor 2012, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në DHPGJS-së për Gjykatën Supreme, me pretendim për zbatimin e gabueshëm të së drejtës materiale, në aktgjykimet e Kolegjit të Ankesave (ASC-09-0101 dhe ASC- ASC-09-0084).

15. Më 23 tetor 2012, bazuar në propozimin e parashtruesit, Prokurori i Shtetit ka paraqitur në Gjykatën Supreme kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë KMLC. nr. 101/12-1 dhe KLMC. nr. 101/12-2 kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për të gjitha vendimet e DHPGJS-së që lidhen me këtë rast.

16. Më 15 shtator 2014, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së ka nxjerrë aktvendimet AC-I.-14-0077-AOOOI; AC-I.-14-0078-AOOOI, AC-I,-14-0079-AOOOI, AC-I.-14-0080-AOOOI me anë të të cilave i ka hedhur

poshtë si të papranueshme kërkesën për revizion dhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

17. Të katër aktvendimet kishin një arsyetim thuajse të njëjtë, ku theksohej:

> *"Sipas nenit 10 paragrafi 14 i Ligjit nr. 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme te Gjykatës Supreme për çështje qe lidhen me Agjencinë Kosovare te Privatizimit (LDHP), te gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit te Apelit te DHPGJS-se janë te prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër"* dhe se "*LDHP-ja dhe Shtojca e saj nuk përmbajnë një referim ndonjë mjeti te jashtëzakonshëm juridik kundër aktvendimeve apo aktgjykimeve te Kolegjit te Apelit. Mjete te tilla te jashtëzakonshme juridike nuk janë parapare as me Rregulloren e UNMIK-ut 2008/4 e as me Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut 2008/6".*

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi pretendon se aktgjykimet dhe aktvendimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me nenin 24 [Barazia para Ligjit] lidhur me nenin 7 të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] lidhur me nenin 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNJ), nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] lidhur me nenin 8 të (DUDNJ) dhe me nenin 41, par 1 dhe 2, të Kushtetutës [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike].

19. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon si në vijim:

> *"Gjykata Supreme e Kosovës, ne kuptim te dispozitës se nenit 21 dhe neni 22, paragrafi 1, nen paragrafi 1.1. te Ligjit Për Gjykata (ligj nr. 03/L-199), ka kompetence ekskluzive për te shqyrtuar dhe vendosur për mjetet e jashtëzakonshme juridike te paraqitura KUNDER vendimeve gjyqësore të formës se prere. Andaj ne rastin konkret Dhoma e Posaçme te Gjykatës Supreme te Kosovës për çështje qe lidhen me Agjencinë Kosovare te Privatizimit, ka pasur për obligim qe kërkesën për REVIZION dhe kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë te parashtruar nga Prokurori i Shtetit, qe ta dërgoj se bashku me lenden tek Gjykata Supreme e Kosovës, e jo ne te kundërtën te vendos një vendim për te cilin nuk e autorizon ligji ne shqyrtimin e saj".*

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje që të shqyrtoj kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

22. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(2) Gjykata do të deklaroj një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> > *[...]*
> >
> > *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

23. Gjykata konstaton se për të gjitha aktgjykimet e DHPGJS-së të vitit 2009 dhe 2012, e që kontestohen prapë nga parashtruesi, ajo tashmë ka dhënë një vlerësim kushtetues dhe me Aktvendimin KI23/14 për papranueshmëri rastin e ka vendosur dhe nuk mund ta rishqyrtojë atë.

24. Në këto rrethana, Gjykata do të vlerësojë çështjen kryesore lidhur me ekzistencën e mjetit juridik ndaj vendimeve të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së dhe efektivitetin eventual të tij në dritën e aktvendimeve të fundit të Kolegjit të Apelit të DHPGJ-së, në lidhshmëri me shkeljet e pretenduara nga parashtruesi.

25. Lidhur me sa u tha më lart, Gjykata i referohet Kushtetutës së Kosovës e cila parasheh:

> **Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]**
>
> *"Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj".*

Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

"Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur".

26. Gjykata gjithashtu merr parasysh ligjin për DHPGJS-së për çështjet që kanë të bëjnë me AKP, Ligji Nr. 04/L-033 i publikuar në Gazetën Zyrtare, nr. 20, më 22 shtator 2011, i cili parasheh:

Neni 1, paragrafi 3

"Dhoma e Posaçme është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 21 të Ligjit nr. 03/L-199 mbi Gjykatat".

Neni 3, paragrafi 14

"*Kolegji i Apelit do të ketë kompetencë ekskluzive të apelit në shkallë të fundit mbi të gjitha apelet nga Aktvendimet apo Aktgjykimet e kolegjeve të specializuara, apo nga cilado gjykatë në lidhje me lëndët apo rastet që i janë referuar më herët një gjykate të tillë nga Dhoma e Posaçme".*

Neni 10, paragrafët 14 dhe 15

"14. Të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e kolegjit të apelit janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër.

15. Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk do të interpretohet ose zbatohet për të kufizuar ose për të tentuar për të kufizuar të drejtën kushtetuese të çdo personi për të paraqitur kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në pajtim me ligjin dhe rregullat procedurale për një kërkese të këtillë, për shqyrtimin e kushtetutshmërisë e cilitdo Vendim ose Aktgjykim të lëshuar nga Dhoma e Posaçme ose cilado gjykatë tjetër".

27. Nga sa u tha më lart, rrjedh se parashtruesi kishte paraqitur kërkesë për revizion ndaj vendimeve të formës së prerë të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, dhe se Prokurori i Shtetit kishte ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj po atyre vendimeve, ndërsa DHPGJS - Kolegji i Apelit këto kërkesa i ka hedhur poshtë si të papranueshme.

28. Gjykata vë në dukje se Kushtetuta e Kosovës në nenin 32 ka përcaktuar "*Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike... në*

mënyrën e përcaktuar me ligj" dhe rikujton se Ligji për DHPGJS për çështjet që lidhen me AKP-në në nenin 10 par. 14 shprehimisht ka paraparë se *"aktgjykimet dhe aktvendimet e kolegjit të apelit janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër"*.

29. Është tërësisht e qartë se vendimet e DHPGJS-së nuk mund të jenë objekt i asnjë lloj procedure të mëtutjeshme qoftë edhe gjyqësore, përveç objekt i trajtimit në Gjykatën Kushtetuese, andaj si të tilla janë të implementueshme dhe DHPGJS-së me aktgjykimet e veta vetëm sa e ka rikonfirmuar këtë fakt. Parashtruesi i kërkesës këtë fakt e ka pasur të ditur edhe nga aktvendimi për papranueshmëri i kësaj Gjykate për Rastin KI23/14, kur u trajtua kjo çështje (Shih, Aktvendimi për Rastin KI23/14, par. 31, i 3 marsit 2014 i të njëjtit parashtrues).

30. Gjykata, thekson se për të çmuar efektivitetin e mjetit juridik "*Ekzistimi i mjeteve të tilla juridike duhet të jetë në masë të mjaftueshme e disponueshme jo vetëm në pikëpamje teorike por edhe praktike* (Shih, *Vernillo v. France*, Aktgjykimi i 20 shkurtit 1991, Seria A nr. 198, st. 27). Ndërsa në rastin konkret, mjeti juridik nuk ishte i paraparë në pikëpamje teorike me ligj, dhe nuk ishte provuar në praktikë dhe nuk mund të prodhonte efekte juridike lidhur me aspektet substanciale të rastit.

31. Në fakt, parashtruesi nuk dëshmoi para Gjykatës me asnjë provë konkrete se Gjykata Supreme ka trajtuar raste të revizionit ndaj vendimeve të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së në mënyrë që të ishin tregues i trajtimit jo të barabartë të tij para ligjit, dhe në rrethana të tilla Gjykata nuk gjen fakte se procesi gjyqësor ka qenë i padrejtë apo arbitrar, dhe se atij i është cenuar e drejta në mjet juridik.

32. Rrjedhimisht, në kushtet kur parashtruesi nuk arsyeton mjaftueshëm shkeljet e pretenduara, Gjykata nuk mund të gjejë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenet 6 e 13 të KEDNJ-së.

33. Për më tepër sa i përket pretendimit të shkeljes së nenit 54 të Kushtetutës, Gjykata konsideron se parashtruesit iu mundësua "mbrojtja gjyqësore e të drejtave të tij" sepse një gjykatë e themeluar me ligj dhe në procedura të parapara me ligj i vlerësoi ankesat e tij, dhe nxori vendimin përfundimtar.

34. Duke marrë parasysh faktin se sipas nenit 1 të Ligjit për DHPGJS-së ajo është pjesë e Gjykatës Supreme, dhe duke marrë për bazë edhe specifikat e saj të veçanta në funksionimin e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës, gjithashtu duke marrë në konsideratë edhe procedurat të cilat zhvillohen në këtë institucion gjyqësor, Gjykata nuk

gjen se me aktvendimet me të cilat janë hedhur poshtë Revizioni dhe Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë të jenë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, DUDNJ dhe KEDNJ.

35. Në përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij.

36. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar, dhe rrjedhimisht e papranueshme.

Kërkesa për Masë të përkohshme

37. Parashtruesi kërkon nga Gjykata *"të merr vendim për lejimin e masës së përkohshme deri në Vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktvendimeve të kontestuara, në mënyrë që të shmangë pagesën e kompensimit nga ana e parashtruesit në shumën e caktuar nga DHPGJS, pasi që kjo shumë është shumë e madhe dhe e papërballueshme, duke marrë parasysh se tashmë janë nxjerrë urdhra për përmbarim nga përmbaruesit privat".*

38. Për më tepër, parashtruesi pretendon se *"përmbarimi i aktgjykimeve të lartcekura do t'i shkaktojë parashtruesit të kërkesës vështirësi financiare dhe mund të vijë edhe deri te privatizimi i ndërmarrjes, nëse nuk lejohet masa e përkohshme".*

39. Në mënyrë që Gjykata të lejojë Masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, është e nevojshme të vërtetohet se:

> *"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
>
> *(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme.*
>
> *(...)*
>
> *Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".*

40. Siç u cek më lart, kërkesa është e papranueshme dhe, për këtë arsye, nuk ka rast *prima facie* për shqiptimin e Masës së përkohshme. Prandaj refuzohet kërkesa për Masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe të rregullit 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 18 maj 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA SHPALLË kërkesën si të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Prof. dr. Enver Hasani

KI166/14, Parashtrues Mentor Paqak , Kërkesë për rishqyrtim të lëndës KI 78/14

KI166/14, Vendim për hedhje poshtë të kërkesës, i 16 prillit 2015, publikuar më 28 maj 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, rishqyrtim i vendimit, diskriminim etnik, efekti juridik i vendimeve, hedhje poshtë e kërkesës*

Gjykata Kushtetuese e kishte shpallur Rastin KI78/14, si kërkesë të papranueshme pasi që ishte paraqitur nga i biri i parashtruesit jashtë afatit ligjor. Parashtruesi në kërkesën e tij kërkoi rishqyrtimin e rastit, me arsyetimin që gjendja shëndetësore e të birit është keqësuar dhe se të drejtat e tyre janë cenuar për shkak se janë minoritet.

Gjykata Kushtetuese u shpreh se vendimi i nxjerrë në Rastin KI78/14, është përfundimtar dhe detyrues dhe se gjendja shëndetësore e djalit të tij, nuk ndikon apo ndryshon rrethanat e kërkesës. Kërkesa u refuzua me procedurë të shkurtër në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës dhe 32 (5) të Rregullores së punës.

VENDIM PËR HEDHJE POSHTË TË KËRKESËS
në
Rastin Nr. KI166/14
Parashtrues
Mentor Paqak
Kërkesë për rishqyrtim të lëndës KI78/14

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Z. Ibrahim Paqaku dorëzoi padi në Gjykatë, në emër të djalit të tij z. Mentor Paqaku nga Prizreni. Z. Ibrahim Paqaku gjithashtu përfaqësoi djalin e tij (atëherë parashtrues i kërkesës) në Rastin KI78/14.

Vendimi i kontestuar

2. Z. Ibrahim Paqaku nuk i referohet në mënyrë specifike ndonjë vendimi të Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, si duket parashtruesi kërkon rishqyrtimin e aktvendimit të nxjerrë në Rastin KI78/14.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për rishqyrtim të Rastit KI78/14.

Baza juridike

4. Letra e dorëzuar nga z. Ibrahim Paqaku është vazhdim i kërkesës KI78/14, e cila bazohej në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 47.1 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 nëntor 2014, z. Ibrahim Paqaku e dorëzoi kërkesën për rishqyrtim në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 5 dhjetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI166/14 caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI166/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 17 dhjetor 2014, Gjykata ia dërgoi parashtruesit të kërkesës formularin zyrtar të Gjykatës, duke kërkuar nga ai që të saktësojë se cili vendim dëshiron të rishqyrtohet dhe të dorëzojë dokumente shtesë për të mbështetur kërkesën e tij.

8. Më 16 prill 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 5 maj 2014, z. Ibrahim Paqaku, në emër të djalit të tij Mentor Paqaku, parashtroi në Gjykatë kërkesën KI78/14, duke kontestuar Vendimin e Gjykatës së Apelit, PN. nr. 637/2013, të 16 tetorit 2013, i cili i ishte dorëzuar atij në nëntor të vitit 2013.

10. Më 20 tetor 2014, Gjykata, deklaroi të papranueshme kërkesën KI78/14, sepse ishte parashtruar jashtë afatit ligjor.

Pretendimet e z. Ibrahim Paqaku

11. Z. Ibrahim Paqaku kërkon rishqyrtimin e rastit, pasi që djali i tij tani ka probleme shëndetësore.

12. Z. Ibrahim Paqaku thekson se "*tre avokat i kanë pasur në lënd gjdo dosje dhe raport mjekësor por pse nuk është cek në seancat gjyqësore nuk e di*".

13. Z. Ibrahim Paqaku më tej thekson se "*ndoshta na cenohet e drejta si qenie njerzore vetëm e vetëm pse jemi minoritet*".

Pranueshmëria e kërkesës

14. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.1 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.*

15. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 32 (5) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër (...) nëse kërkesa është përsëritje e një kërkese të mëparshme të vendosur nga Gjykata".*

16. Gjykata vëren se z. Ibrahim Paqaku thekson problemet shëndetësore të djalit të tij, si bazë për rishqyrtimin e vendimit të nxjerrë në Rastin KI78/14.

17. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se gjendja shëndetësore e djalit të tij nuk ndikon apo ndryshon rrethanat e kërkesës, e cila është parashtruar jashtë afatit ligjor, që ishte arsyeja për papranueshmëri.

18. Prandaj, Gjykata konstaton se vendimi i nxjerrë në Rastin KI78/14 është përfundimtar dhe detyrues dhe arsyeja e pretenduar për rishqyrtim është pa ndikim në vendimin e mëparshëm.

19. Si përmbledhje, në pajtim me nenin 116 të Kushtetutës dhe rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, Gjykata refuzon kërkesën me procedurë të shkurtër, dhe për këtë arsye, ajo duhet të hiqet nga lista.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës dhe rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 22 maj 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën me procedurë të shkurtër;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Prof. dr. Enver Hasani

KI171/14, Parashtrues Agim Vuniqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale/ Departamentit të Pensioneve, Nr. 919, i 24 tetorit 2014

KI171/14, Aktvendim për papranueshmëri i 15 prillit 2015, publikuar më 28 maj 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, pezullim i pensioneve, palë e paautorizuar, përfaqësim i paautorizuar*

Parashtruesi kishte parashtruar kërkesë në Departamentin e Pensioneve duke kërkuar suspendimin e pezullimit të pagesës së pensioneve të prindërve të tij. Departamenti i Pensioneve kishte pezulluar pagesat e pensioneve të prindërve të parashtruesit, me arsyetimin e mospërmbajtjes së rregullave ligjore për lajmërim.

Parashtruesi pa iu referuar shkeljes së ndonjë dispozite kushtetuese, pretendoi se Departamenti i Pensioneve pranë MPMS-së kishte shkelur ligjin në mënyrë drastike pa kontrolluar linjat buxhetore duke iu ndaluar pensionet dy prindërve të tij.

Gjykata Kushtetuese theksoi se parashtruesi nuk kishte dorëzuar autorizimin për të përfaqësuar në Gjykatë dy prindërit e tij, dhe rrjedhimisht, nuk ishte "palë e autorizuar" as në cilësinë personale, as si përfaqësues i autorizuar i prindërve të tij. Kërkesa u shpall e papranueshme për shkak se nuk ishte dorëzuar në mënyrë ligjore, siç përcaktohet me nenin 113.1 të Kushtetutës dhe specifikohet më tej me rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI171/14
Parashtrues
Agim Vuniqi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale/Departamentit të Pensioneve, nr. 919, të 24 tetorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Agim Vuniqi me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), në emër të prindërve të tij z. Hafir Vuniqi dhe znj. Qamile Vuniqi, me vendbanim të njëjtë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Njoftimi [nr. 919] i Departamentit të Pensioneve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë: Departamenti i Pensioneve) i 24 tetorit 2014, me të cilin ishin njoftuar prindërit e parashtruesit të kërkesës se pagesa e pensioneve është suspenduar për shkak të mospërmbushjes së kushteve formale.

3. Njoftimi i është dorëzuar prindërve të parashtruesit të kërkesës, më 4 nëntor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar. Parashtruesi i kërkesës nuk i përmend nenet konkrete, të Kushtetutës, të cilat mund të jenë shkelur.

Baza juridike

5. Kërkesa është bazuar në nenin 113. (7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 26 nëntor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 8 dhjetor 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 23 janar 2015, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Departamentit të Pensioneve. Më 28 janar 2015, Gjykata pranoi përgjigje nga Departamenti i Pensioneve.

9. Më 23 janar 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të paraqes në Gjykatë autorizimin, me të cilin z. Hafir Vuniqi dhe znj. Qamile Vuniqi e autorizojnë djalin e tyre z. Agim Vuniqi që t'i përfaqësojë ata në Gjykatë.

10. Parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar asnjë përgjigje.

11. Më 15 prill 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Në një datë të pacaktuar në vitin 2002, Departamenti i Pensioneve e miratoi pensionin bazë për prindërit e parashtruesit të kërkesës. Prindërit e parashtruesit të kërkesës e kanë pranuar rregullisht pensionin deri në tetor 2013, kur pagesa e pensioneve të tyre është pezulluar.

13. Më 30 shtator 2014, parashtruesi parashtroi kërkesë në Departamentin e Pensioneve, duke kërkuar suspendimin e pezullimit të pagesës së pensioneve dhe pagesën retroaktive për periudhën nga muaji nëntor 2013 e tutje.

14. Më 24 tetor 2014, Departamenti i Pensioneve është përgjigjur se *"meqenëse ju nuk iu keni përmbajtur rregullave ligjore për lajmërim, andaj jeni suspenduar nga pagesa e pensionit ndërsa pagesa e mëtutjeshme zbatohet pasi që ju të lajmëroheni gjegjësisht prej muajit që ju jeni lajmëruar".*

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *"konsideroj se gjatë procedimit dhe shpërndarjes së mjeteve janë bërë shkelje drastike ligjore, nuk është përcjellur linja buxhetore, mjetet e dedikuara për pensionistët, rasti konkret i nënës dhe babait tim, Qamile dhe Hafir Vuniqi, ato janë ndaluar dhe konfiskuar në mënyrë të panatyrshme nga xhepi i tyre".*

16. Parashtruesi i kërkesës kërkon *"që të kthehet dinjiteti dhe të vendoset ligjshmëria që pensionistëve Qamile dhe Hafir Vuniqit t'u kthehet buzëqeshja, të paguhen për dy muajt nëntor dhe dhjetor 2014, duke përfshirë edhe kamatat komerciale".*

Pranueshmëria e kërkesës

17. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 (1). të Kushtetutës, i cili përcakton:

    "1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

19. Neni 21 i Ligjit, gjithashtu përcakton se:

    "Palët gjatë procesit para Gjykatës Kushtetuese përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala".

20. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (a) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: (a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar.

21. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar autorizimin e kërkuar me të cilin prindërit e tij z. Hafir Vuniqi dhe znj. Qamile Vuniqi,do ta autorizonin parashtruesin e kërkesës që t'i përfaqësojë ata në Gjykatë.

22. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk është "palë e autorizuar" as në cilësinë personale, as si përfaqësues i autorizuar i prindërve të tij.

23. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk mund të shqyrtohet dhe, në pajtim me nenin 113. (1) të Kushtetutës, nenin 21 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 21 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 22 maj 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. dr. Enver Hasani

KI157/14, Parashtrues Hajriz Alidemaj, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 1579/2014, të 8 shtatorit 2014

KI157/14, Aktvendim për papranueshmëri i 16 prillit 2015, publikuar më 1 qershor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë administrative, afatshmëria e kërkesëpadisë, e drejta e punës dhe e ushtrimit të profesionit, mosshterje e mjeteve juridike.*

Gjykata Komunale, në Prishtinë, me Aktvendimin C. nr. 1579/2014, të 8 shtatorit 2014, e kishte refuzuar ankesën e parashtruesit kundër Komunës së Prishtinës si të paafatshme, përkitazi me kthim në vendin e mëparshëm të punës dhe kompensim retroaktiv të pagave të papaguara.

Parashtruesi i kërkesës ndër të tjera, pretendoi se Komuna e Prishtinës kishte shkelur të drejtën e tij në punë, dhe në ushtrim të profesionit, të garantuar me nenin 49 të Kushtetutës së Kosovës.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, dhe se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi t'i shterojë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Kërkesa u shpall e papranueshme për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI157/14
Parashtrues
Hajriz Alidemaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 1579/2014, të 8 shtatorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Hajriz Alidemaj me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë [C. nr. 1579/2014], i 8 shtatorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jetë shkelur neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit

për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 tetor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 6 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 8 dhjetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 16 prill 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Prej 1 shtatorit 1981 deri më 31 gusht 2003, parashtruesi i kërkesës ka qenë i punësuar si mësimdhënës i gjuhës shqipe në shkollën "28 Nëntori" në Prishtinë. Pas 31 gushtit 2003, Komuna e Prishtinës ia ka ndërruar shkollën ku ka punuar parashtruesi i kërkesës, dhe me këtë edhe pagën bazë.

10. Parashtruesi i kërkesës disa herë i është drejtuar Ministrisë së Arsimit të Kosovës dhe Komunës së Prishtinës lidhur me këtë çështje, por nuk ka marrë asnjë përgjigje.

11. Më 6 qershor 2006, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMK), kundër vendimeve të Komunës së Prishtinës për transferimet e lartpërmendura dhe ndryshimet e pagës bazë.

12. Më 21 mars 2007, KPMK-ja [Vendimi A 02 114/2006] aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës. Në arsyetimin e vendimit të tij, KPMK-ja theksoi:

> *„Këshilli duke u bazuar në provat shkresore të prezantuara ka konkluduar se kërkesa e ankuesit lidhur me koeficientin e pagës është e bazuar dhe duhet aprovuar, ndërsa kërkesa për tu kthyer në vendin e mëparshëm të punës, varet nga nevojat e organit të*

punësimit në bazë të organizimit të punës dhe sistemimit të punësuarve".

13. Më 24 janar 2011, parashtruesi i kërkesës kërkoi përmbarim nga Gjykata Themelore në Prishtinë, duke kërkuar që të kthehet në vendin e mëparshëm të punës.

14. Më 17 nëntor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë [Aktgjykimi C. nr. 122/2011] aprovoi padinë e parashtruesit dhe urdhëroi Komunën e Prishtinës - Drejtorinë për Arsim dhe Shkencë, që ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin dhe detyrat e punës në të cilat ai ka punuar si mësimdhënës i gjuhës shqipe në shkollën "28 Nëntori" në Prishtinë, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, dhe të paguajë diferencën e të ardhurave personale për periudhën prej 1 shtatorit 2003 deri më 30 shtator 2011.

15. Komuna e Prishtinës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë.

16. Më 13 maj 2014, Gjykata e Apelit [Aktvendimi Ac. nr. 3142/2012] anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe ktheu rastin në Gjykatën Themelore për rigjykim.

17. Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata e Apelit theksoi:

„Gjykata e shkallës së parë në ri procedurë do të eliminoj të cekurat si më lartë, ashtu që do të vërtetoj sipas detyrës zyrtare afatshmërinë e kërkesëpadisë, duke pasur parasysh faktin se vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës është i datës 21.03 .2007, ndërsa padia kësaj gjykate është dorëzuar me datë 24.01.2011 dhe pas vlerësimit do të merr një vendim të drejtë e të ligjshëm".

18. Më 8 shtator 2014, Gjykata Komunale [Aktvendimi C. nr. 1579/2014] refuzoi ankesën e parashtruesit si të paafatshme, me arsyetimin:

„Me provat e administruara gjykata gjeti se paditësi padinë e ka parashtruar me datë 24.01.2011. Me datë 21.03.2007 e ka pranuar aktvendimin me të cilin i ndërprehet marrëdhënia e punës. Afati i parashkrimit për të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës, ndërsa paditësi është pensionuar me datë 21.03.2007 kurse padinë e ka bërë me datën 24.01.2011 pas tre vite e nëntë muajve".

19. Më 10 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktvendimit [C. nr. 1579/2014] të Gjykatës Komunale. Procedura në Gjykatën e Apelit është ende në zhvillim e sipër.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Komuna e Prishtinës ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Kosovës.

21. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

> *„kërkoj vazhdimin e pagesës në mënyrë retroaktive nga paga prof. i shkollës m. në pagën mësues në shk. fillore (...) dhe kthimin në vendin e mëparshëm të punës prof. i gjuhës shqipe“.*

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 (7) të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

24. Gjykata i referohet edhe nenit 47. 2 të Ligjit, i cili parasheh:

> *„Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj“.*

25. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *„Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar“.*

26. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës deklaroi se Komuna e Prishtinës ka shkelur të drejtën e tij të punës dhe ushtrimit të profesionit, të garantuar me nenin 49 të Kushtetutës së Kosovës.

27. Gjykata vëren se më 10 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës inicioi padi në Gjykatën e Apelit ku procedura është ende në zhvillim e sipër.

28. Gjykata më tej rikujton se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës të shterojë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.

29. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih: Aktvendim për papranueshmëri: *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, i 27 janarit 2010, dhe *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).

30. Prandaj, Gjykata konsideron që kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në dispozicion, në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

31. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 maj 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. dr. Enver Hasani

KI178/14, Parashtrues Xufe Racaj, Kërkesë për përmirësimin e Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Rastin KI107/14, të 26 nëntorit 2014.

KI178/14, Vendim për heqje të kërkesës nga lista i 15 prillit 2015, publikuar më 1 qershor 2015.

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, refuzim i kërkesës, efekti juridik i vendimeve, procedurë e shkurtër, heqje e kërkesës nga lista.*

Gjykata Kushtetuese me Aktvendimin në Rastin nr. KI107/14, të 26 nëntorit 2014 kishte shpallur të papranueshme kërkesën e parashtrueses për shkak se ishte qartazi e pabazuar. Parashtruesja pretendoi se vendimi të cilin e konteston, i ka shkelur asaj të drejtat e garantuara me nenet 5 (E drejta për liri dhe siguri) dhe 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesë për përmirësim të Aktvendimit në Rastin nr. KI107/14, me pretendimin se Gjykata Kushtetuese kishte nxjerr vendim duke u bazuar në nenet 5 dhe 6 të Kushtetutës së Kosovës, e jo në nenet 5 dhe 6 të Konventës, në të cilën parashtruesja e kishte bazuar pretendimin e vet.

Gjykata Kushtetuese në vendimin e vet ka sqaruar se Aktvendimi nr. KI107/14, është nxjerrë duke u bazuar në nenet 5 dhe 6 të Konventës, dhe se nuk ka ndonjë gabim që duhet të korrigjohet. Gjykata Kushtetuese më tej, vlerësoi, se parashtruesja e kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë pretendim apo shkelje të re. Kërkesa u shpall e papranueshme me procedurë të shkurtër, dhe u hoq nga lista në pajtim me 116.1 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës dhe rregullat 32 (4) dhe 61 (1) të Rregullores së punës.

VENDIM PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA
në
Rastin nr. KI178/14
Parashtrues
Xufe Racaj
Kërkesë për përmirësimin e Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në Rastin KI107/14, të 26 nëntorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI178/14 është dorëzuar nga znj. Xufe Racaj, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Në kërkesën KI178/14, parashtruesja e kërkesës i referohet Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) në Rastin nr. KI107/14, të 26 nëntorit 2014, i cili i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 27 nëntor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës KI178/14 është kërkesa për përmirësimin dhe rishqyrtimin eventual pasues të Aktvendimit për papranueshmëri nr. KI107/14, të 26 nëntorit 2014.

Baza juridike

4. Kërkesa KI178/14 është vazhdim i kërkesës KI107/14, e cila ishte bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

5. Kërkesa KI178/14 në mënyrë të posaçme duhet të shihet si e bazuar në rregullin 61 (Përmirësimi i aktgjykimeve dhe i vendimeve) të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

6. Më 12 dhjetor 2014, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 13 janar 2015, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 12 shkurt 2015, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës KI178/14.

9. Më 15 prill 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës ta heqë kërkesën nga lista.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 23 qershor 2014, parashtruesja e dorëzoi në Gjykatë kërkesën KI107/14 në gjuhën shqipe, duke pretenduar shkelje të *"neneve 5 dhe 6 të Konventës"*. Referenca në nenin 5 dhe 6 të Konventës është përkthyer në gjuhën angleze si pretendim për shkelje të *"neneve 5 dhe 6 të Kushtetutës"*. Versioni në gjuhën angleze ishte baza origjinale e punës për Aktvendimin e 26 nëntorit 2014, në Rastin nr. KI107/14.

11. Paragrafi 4, i atij aktvendimi thotë "*objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës, të garantuara me "nenin 6 (. ..) dhe nenin 5 të Kushtetutës"*.

12. Megjithatë, në arsyetimin e aktvendimit të lartpërmendur (në paragrafin 24), Gjykata vërejti se "*parashtruesja e kërkesës, duke arsyetuar kërkesën e saj, pretendon shkelje të neneve 5 dhe 6 të Kushtetutës. Këto nene kanë të bëjnë me gjuhët dhe simbolet e Republikës së Kosovës dhe asgjë me faktet e kërkesës"*.

13. Në ndërkohë, Gjykata konsideroi se (në paragrafin 25), "*Objekti i çështjes ka të bëjë me shkeljen e së drejtës së parashtrueses së*

kërkesës për gjykim të drejtë" prandaj vendosi në bazë të nenit 5 dhe 6 të Konventës.

14. Gjykata më tej vlerësoi (në paragrafin 26) se *"parashtruesja e kërkesës nuk ka shpjeguar dhe nuk ka treguar si dhe pse pretendohet të jenë shkelur të drejtat e saj [...] për gjykim të drejtë [...].*

15. Përfundimisht, Gjykata konkludoi (në paragrafin 29) se *"në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës, Gjykata konsideron se kërkesa është qartazi e pabazuar"*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Në kërkesën KI178/14, parashtruesja e kërkesës pretendon se "*nga Gjykata Kushtetuese ka kërkuar zbatimin e n. 5 dhe 6 të Konventës (e jo të Kushtetutës së R.K.-së), ndërsa Gjykata Kushtetuese e Kosovës në lajthim (error in materiae) ka bazuar Aktvendimin nr. KI107/14 të 25.11.2014 në n. 5 & 6 të Kushtetutës"*.

17. Parashtruesja e kërkesës kërkon që nëpërmjet kërkesës KI178/14 *"të rishikohet Aktvendimi KI107/14 – dt. 7.11.2014 i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, gabimisht (...) është bazuar në nenet inadekuate (5 &6) të Kushtetutës në vend të po atyre neneve por të Konventës"*.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.1 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili parasheh:

    Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.

19. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 32 (4) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

    Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme, ose që nuk përfaqësojnë një rast ose një kontest.

20. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 61 (Përmirësimi i aktgjykimeve dhe i vendimeve), i cili parasheh:

    (1) Gjykata, ex officio, ose pas kërkesës nga pala, e cila bëhet brenda dy javësh nga dërgimi i aktgjykimit apo i vendimit, mund

ta korrigjojë ndonjë gabim teknik ose numerik që është bërë në aktgjykim ose në vendim.

21. Gjykata rikujton se parashtruesja bazon kërkesën e saj KI178/14 në një gabim të pretenduar teknik të Gjykatës.

22. Në të vërtetë, parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata në Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin nr. KI107/14, të 26 nëntorit 2014, i është referuar *"nenit 6 (...) dhe nenit 5 të Kushtetutës"* në vend të *"nenit 6 (...) dhe 5 të Konventës"*.

23. Megjithatë, në Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin nr. KI107/14, Gjykata vlerësoi dhe vendosi për kërkesën në bazë të neneve 5 dhe 6 të Konventës, siç ishte pretenduar fillimisht nga parashtruesja e kërkesës. Pra, nuk ka gabim që duhet të korrigjohet, sepse ai tanimë ishte korrigjuar në aktvendimin e nxjerrë.

24. Përveç kësaj, Gjykata vëren se në kërkesën KI178/14 nuk paraqitet ndonjë pretendim ose dëshmi e re për shkelje të pretenduar nga parashtruesja e kërkesës në Rastin KI107/14; në të vërtetë, parashtruesja ka dorëzuar vetëm një kërkesë për përmirësimin e Aktvendimit për papranueshmëri.

25. Prandaj, Gjykata vlerëson se të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesës ishin adresuar dhe arsyetuar plotësisht në Rastin KI107/14, siç ishte kërkuar nga parashtruesja e kërkesës, dhe gabimi i pretenduar ishte përmirësuar në vendimin e mëparshëm të Gjykatës.

26. Gjykata, më tej, konsideron se aktvendimi i nxjerrë në Rastin KI107/14 është përfundimtar dhe detyrues dhe korrigjimi i pretenduar nuk ka ndikim në vendimin e mëparshëm.

27. Prandaj, Gjykata konkludon se nuk ka rast apo kontest në pritje lidhur me çështjen e mësipërme dhe, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës, rregullat 32 (4) dhe 61 (1) të Rregullores së punës, "kërkesa" duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër dhe të hiqet nga lista.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, më 25 maj 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA HEQË kërkesën nga lista;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. dr. Enver Hasani

KI164/14, Parashtrues Shpëtim Halimi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. Nr. 223/2014, të 1 shtatorit 2014

KI164/14, Aktvendim për papranueshmëri i 13 majit 2015, publikuar më 5 qershor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, përsëritje e procedurës, barazia para ligjit, mbrojtja e pronës, kërkesë qartazi e pabazuar.*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin, Rev. Nr. 223/2014, të 1 shtatorit 2014 kishte hedhur poshtë kërkesën e parashtruesit për revizion, përkitazi me rihapjen e procedurës dhe vendosjen në themelësi të rastit të tij nga gjykatat e instancës më të ulët. Ankesa e parashtruesit, në thelb, ndërlidhej me të drejtën e parablerjes dhe anulimin e kontratës së shitjes së paluajtshmërisë.

Parashtruesi pretendoi se gjykatat e rregullta me vendimet e tyre i kishin mohuar dhe shkelur atij të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi, se parashtruesi argumenton në mënyrë të përgjithshme se nuk i është dhënë mundësia për të mbrojtur rastin e tij në gjykatat e rregullta, dhe se nuk ofron asnjë arsyetim procedural ose material për të shpjeguar se si kanë ndodhur shkeljet e pretenduara. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI164/14
Parashtrues
Shpëtim Halimi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës,
Rev. nr. 223/2014, të 1 shtatorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Shpëtim Halimi, nga Livoqi i Ulët, komuna e Gjilanit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), i cili përfaqësohet nga z. Skënder Zenuni, avokat në Gjilan.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin (Rev. nr. 223/2014, të 1 shtatorit 2014) të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), me të cilin ishte refuzuar kërkesa e parashtruesit për revizion.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se "*janë shkelur të drejtat e parashtruesit, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës* (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta)*, më saktësisht neni 24, [Barazia para Ligjit] paragrafi 1 dhe 2, dhe neni 46 [Mbrojtja e Pronës]*".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) lidhur me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe me rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 6 nëntor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 5 dhjetor 2014, Kryetari caktoi gjyqtarin Judge Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 20 janar 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj Gjykatës Supreme.

8. Më 13 maj 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Gjilan, me të cilën kërkoi t'i konfirmohej e drejta e parablerjes si dhe të anulohej kontrata e shitjes lidhur me pronën e paluajtshme.

10. Më 27 dhjetor 2005, Gjykata Komunale (Aktvendimi C. nr. 636/2004) konstatoi se padia e parashtruesit ishte tërhequr dhe kështu e mbylli çështjen pa vendosur për meritat e rastit.

11. Parashtruesi nuk kishte parashtruar ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale.

12. Më 23 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Komunale në Gjilan një kërkesë për përsëritje të procedurës, me pretendimin se *"[...] e gjithë procedura është mbështetur në deklarata të rreme si dhe në dokumente të rreme [....]"*.

13. Më 11 dhjetor 2012, Gjykata Komunale (Aktvendimi C. nr. 636/2004) e hodhi poshtë si të palejuar dhe jo të plotë propozimin e parashtruesit

për përsëritjen e procedurës, meqenëse "*[...] ka kaluar afati subjektiv prej 30 ditësh dhe afati objektiv prej 5 vitesh [...]*". Gjykata Komunale thekson gjithashtu se parashtruesi kërkesës së tij për përsëritjen e procedurës "*[...]nuk i ka bashkangjitur asnjë provë për të vërtetuar bazueshmërinë e saj*".

14. Parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale.

15. Më 15 maj 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendimi Ac. nr. 4943/2012) e hodhi poshtë si të pabazë ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale.

16. Parashtruesi parashtroi kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme kundër aktvendimeve të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Komunale.

17. Më 1 shtator 2014, Gjykata Supreme (Aktvendimi Rev. nr. 223/2014) e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për revizion, duke konfirmuar:

> *"[...] në rastin konkret nuk ka përfundim meritor të çështjes kontestuese, nga se procedura kontestimore ka përfunduar me aktvendim me të cilin* [nga ana e parashtruesit] *është tërhequr padia [...].*
> *Për rastet që është paraqitur propozimi për përsëritje të procedurës nga neni 232 pika c) dhe d) të LPK-së* [Ligji për Procedurën Kontestimore], *afati për paraqitjen e propozimit në kuptim të nenit 234, pika d) dhe e) të LPK-së është 30 ditë nga dita kur propozuesi ka kuptuar për aktgjykimin e formës së prerë. Propozuesi propozimin e ka paraqitur nga kjo bazë juridike, por jo vetëm që propozimit nuk i ka bashkangjitur një aktgjykim të tillë, por në arsyetim të propozimit as që përmendet një aktgjykim i tillë [...]. Procedura, përsëritja e së cilës është kërkuar, ka përfunduar me aktvendimin e plotfuqishëm C. nr. 636/04 të datës 27.12.2005, kurse propozimi për përsëritje të procedurës është paraqitur më datën 24.11.2010".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta, duke hedhur poshtë kërkesën e tij për përsëritje të procedurës, kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, domethënë, të drejtat që lidhen me "*barazinë para ligjit dhe mbrojtjen e pronës*".

19. Parashtruesi pretendon se i është shkelur e drejta e tij për barazi, e cila garantohet me nenin 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës sepse atij

nuk "[...] *i është dhënë mundësia e shprehjes para gjyqtarit të çështjes* [...]".

20. Parashtruesi gjithashtu pretendon se i është shkelur e drejta e tij në mbrojtjen e pronës, e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, sepse *"[...] gjyqtari i çështjes [...] më ka mohuar të drejtën e babagjyshit në pronën [...]"*.

21. Parashtruesi përfundon duke iu drejtuar Gjykatës me deklaratën e mëposhtme:

> *"[...] Shpëtim Halimi është i vullnetit të mirë që ky kontest civilo-juridik të përfundojë në atë mënyrë që prona e stërgjyshërve të kthehet te pronari gjegjësisht nipit të tyre, Shpëtim Halimi.*
> *Kjo paluajtshmëri është marrë në mënyrë të njëanshme e arbitrare nga gjyqtari i çështjes i cili, sipas thënieve të Shpëtim Halimit, e ka detyruar që të deponojë për tokën e stërgjyshërve [...] DM [Marka Gjermane]. [...]"*.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuarara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 të Rregullores së punës.

Neni 48 i Ligjit

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj"*.

Rregulli 36 i Rregullores së punës

> *"[...] (1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: [...] (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...] (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij"*.

24. Gjykata rikujton se parashtruesi konteston Vendimin (Rev. nr. 223/2014, të 1 shtatorit 2014) të Gjykatës Supreme, me pretendimin

se me anë të tij i është shkelur e drejta për barazi para ligjit dhe mbrojtje të pronës, të garantuara me Kushtetutë.

25. Në të vërtetë, parashtruesi argumenton në mënyrë të përgjithshme dhe pa iu referuar ndonjë vendimi specifik të gjykatave më të ulëta, se nuk i është dhënë "*mundësia për të paraqitur rastin e tij*" përpara gjykatave të rregullta dhe se i është shkelur e drejta e pretenduar si "*pasardhës*" i pasurisë së paluajtshme të stërgjyshit të tij.

26. Gjykata vëren se në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës nuk ka dhënë asnjë arsyetim procedural ose material: ai vetëm pohon pretendimet e lartpërmendura pa shpjeguar më tej se si kanë ndodhur ato shkelje.

27. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Gjykata Komunale e ka hedhur poshtë kërkesën e parashtruesit për rihapjen e procedurës, duke vlerësuar se ka kaluar afati për dorëzimin e asaj kërkese dhe se, përveç kësaj, parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë provë që e mbështet kërkesën e tij.

28. Gjykata gjithashtu vëren se Gjykata e Apelit e ka arsyetuar vendimin e saj në lidhje me pretendimet e parashtruesit për "*shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe shkelje të së drejtës materiale*", duke vërtetuar se Gjykata Komunale e ka zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale me rastin e hedhjes poshtë të kërkesës së parashtruesit për rihapjen e procedurës.

29. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e ka hedhur poshtë si të pabazë kërkesën e parashtruesit për revizion, me arsyetimin se: "*[...] e pranon në tërësi një qëndrim të tillë të gjykatave të shkallës më të ulët lidhur me hedhjen si të palejuar të propozimit për përsëritjen e procedurës, pasi që aktvendimet e goditura nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare*".

30. Gjykata vlerëson se procedurat në Gjykatën Komunale, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme, kanë qenë të drejta dhe se vendimet janë thellësisht të arsyetuara dhe argumentuara.

31. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstaton se procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesit i është ofruar gjykim i drejtë. (Shih, *inter alia*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Ap. Nr. 13071/87, i 10 korrikut 1991;

dhe, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

32. Për më tepër, parashtruesi nuk e ka treguar me qartësi si dhe pse vendimet e kontestuara, me të cilat është hedhur poshtë kërkesa e tij për përsëritje të procedurës, përbëjnë shkelje të të drejtave dhe lirive të tij individuale, të garantuara me Kushtetutë, dhe as nuk ka paraqitur prova të cilat arsyetojnë pretendimin për një shkelje të tillë.

33. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabime të fakteve apo të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë bërë nga autoritetet publike, përveç nëse dhe për aq sa ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).

34. Gjykata Kushtetuese përsërit se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt për sa i përket vendimeve të gjykatave të rregullta apo autoriteteve të tjera publike. Është detyrë e gjykatave të rregullta ose autoriteteve të tjera publike, aty ku është e mundshme, t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ], Aktvendim i 21 janarit 1999. *S*hih, gjithashtu Gjykata Kushtetuese në Rastin nr. KI70/11, *Parashtrues*: *Faik Hima, Magbule Hima, dhe Bestar Hima* Aktvendimin për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

35. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie*, e cila dëshmon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë (Shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, Vendim i GJEDNJ-së, Nr. 53363/99, i 31 majit 2005) dhe nuk ka treguar se si nenet e Kushtetutës, të cilëve u referohet, e mbështesin pretendimin e tij, ashtu siç kërkohet nga neni 113.7 i Kushtetutës dhe neni 48 i Ligjit.

36. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të tij për barazi para ligjit dhe për mbrojtje të pasurisë janë të paargumentuara dhe të padëshmuara, dhe për këtë arsye janë qartazi të pabazuara.

37. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullave 36 (2) (d) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 1 qershor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. dr. Enver Hasani

KI169/14, Parashtrues Osman Osmanaj, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 124/2014, i 2 korrikut 2014

KI169/14, Aktvendim për papranueshmëri i 15 prillit 2015, publikuar më 5 qershor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë penale, dënim me burgim, lajmërim i rrejshëm, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkesë qartazi e pabazuar.*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin, nr. 124/2014, të 2 korrikut 2014 kishte vërtetuar vendimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe kishte hedhur poshtë kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë, përkitazi me dënimin me burgim të tij për kryerjen e veprës penale, lajmërim i rrejshëm.
Parashtruesi pretendoi se atij ishte mohuar ballafaqimi me dëshmitarë, nuk janë pranuar provat e ofruara nga ai, dhe se procedura e formimit të trupi gjykues të Gjykatës së Apelit ishte e parregullt.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se arsyetimi i Gjykatës Supreme për ballafaqimin me dëshmitarë, për përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës së Apelit dhe për pranimin e provave është i qartë, dhe për më tepër, kishte rezultuar se procedura në Gjykatën e Apelit nuk kishte qenë e padrejtë ose arbitrare. Kërkesa u shpall e papranueshme si qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) b) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI169/14
Parashtrues
Osman Osmanaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
PML. nr. 124/2014, të 2 korrikut 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama- Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Osman Osmanaj me vendbanim në Istog (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, PML. nr. 124/2014 i 2 korrikut 2014, me të cilin Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar, dhe vërtetoi aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore.

3. Ky aktgjykim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 23 korrik 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 124/2014 të 2 korrikut 2014, me të cilin, siç pretendohet, janë shkelur neni 31, paragrafi 4 [E Drejta për Gjykim

të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 102, paragrafi 1 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 (7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 24 nëntor 2014, në ditën e parë të punës pas të dielës, më 23 nëntor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 8 dhjetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI169/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI169/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 26 janar 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 15 prill 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 28 maj 2013, Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Istog [P. nr. 463/2011] e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale të lajmërimit të rrejshëm. Gjykata Themelore me këtë Aktgjykim e dënoi parashtruesin e kërkesës me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajsh, me kusht për 2 (dy) vjet.

11. Parashtruesi paraqiti ankesë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Istog [P. nr. 463/2011], të 28 majit 2013.

12. Më 21 tetor 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës [PA1. nr. 771/2013] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit konsideron se parashtruesit të

kërkesës nuk i është mohuar asnjë e drejtë e garantuar me Kodin Penal të Kosovës, dhe kjo mund të konfirmohet me shikimin e shkresave të lëndës, e në veçanti me procesverbalin e shqyrtimit kryesor.

13. Pas kësaj, parashtruesi paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke pretenduar shkelje esenciale të ligjit penal, me propozimin që aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë të ndryshohen, dhe të hedhet poshtë aktakuza e ngritur ndaj tij.

14. Më 2 korrik 2014, Gjykata Supreme e Kosovës, [PML. nr. 124/2014] refuzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar.

15. Gjykata Supreme në arsyetimin e saj thekson:

> "*Pretendimi në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë se dëshmitari, pa specifikuar se cili dëshmitar, nuk është përgjigjur në "pyetjet e avokatit dhe këtë e ka lejuar gjykata", nuk qëndron ngase nga procesverbali i seancës kryesore vërtetohet se dëshmitarët Tahir Jahaj, Bashkim Blakaj dhe Besim Osmanaj, janë përgjigjur në të gjitha pyetjet e mbrojtësit dhe se pas marrjes në pyetje në procesverbal është konstatuar se mbrojtësi nuk ka pyetje tjera për dëshmitarin.*
>
> *Nga procesverbali i seancës kryesore pas marrjes në pyetje të dëshmitarit Bashkim Blakaj nga mbrojtësi dhe i akuzuari Osman Osmanaj, mbrojtësi ka propozuar që të bëhet "krahasimi në mes të dy deklaratave (ajo e Tahir Jahajt dhe Bashkim Blakaj)", të cilin propozim me aktvendim gjykata e ka refuzuar me arsyetim të duhur se gjykata bënë vlerësimin e deklaratave të dëshmitarëve dhe pastaj vendos se cilës do t'i falë besimin.*
>
> *Sa i përket refuzimit që të nxirret si provë listingu i thirrjeve telefonike të datës 28.10.2011, gjykata ka marrë vendim të arsyetuar mirë kur është thirr në pamundësinë e sigurimit të kësaj prove për shkak të kalimit të gjatë të kohës (propozimi është bërë në seancën e datës 23.05.2013) dhe pamundësisë të sigurimit të kësaj prove".*

16. Për sa i përket ankesës së parashtruesit në lidhje me përbërjen e Kolegjit të Gjykatës së Apelit, në arsyetimin e Gjykatës Supreme thuhet:

"Shkeljet e pretenduara ligjore të bëra nga gjykata e shkallës së dytë, nga se gjyqtarja Mejreme Memaj nuk i plotëson kushtet për ushtrimin e profesionit të gjyqtares të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë. Kryetari i Gjykatës së Apelit sipas nenit 20 par. 3 nën par. 3.1 të Rregullores mbi Organizimin e Gjykatës së Apelit cakton gjyqtarët në departamente për të siguruar gjykim efikas të lëndëve, dhe sipas nevojës mund t'i përcaktojë gjyqtarët përkohësisht ndërmjet departamenteve për zgjidhjen e lëndëve të pazgjidhura apo për të siguruar zgjidhjen e lëndëve me kohë".

Pretendimet e parashtruesit

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në procedurë gjyqësore me nxjerrjen e vendimit të kontestuar i janë cenuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë në tri mënyra të ndryshme: (1) Parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk i është mundësuar ballafaqimi me dëshmitarë, me ç'rast i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 31, paragrafi 4 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; (2) Parashtruesi i kërkesës më tej pohon se një nga gjyqtarët në procedurën gjyqësore në fjalë nuk i kishte kualifikimet minimale juridike për kryerjen e funksionit të gjyqtarit në atë gjykatë dhe në atë procedurë gjyqësore gjë që ka shkelur të drejtën e garantuar me nenin 102, paragrafi 1 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe (3) Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pohon se Gjykata Themelore duke mos marrë parasysh provën, pra një listë të thirrjeve të caktuara telefonike, i ka shkelur të drejtën e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

18. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: *"...që aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, me numër PML. nr. 124/14 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, me numër PA1. nr. 771/13 të shpallen të pavlefshme dhe që lënda t'i kthehet në shqyrtim Gjykatës së Apelit të Kosovës, me kolegj në përbërje sipas ligjit".*

Pranueshmëria e kërkesës

19. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

21. Gjykata më tej merr parasysh rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi e pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.

[...]"

22. Siç është theksuar më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [PML. nr. 124/14] dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit [PA1. nr. 771/2013] kanë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31, paragrafi 4 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe nenin 102, paragrafi 1 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

23. Në lidhje me këtë, Gjykata përkujton arsyetimin e Gjykatës Supreme, në përgjigje ndaj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e ligjit dhe shkeljen esenciale të dispozitave procedurale në kërkesën e tij për ballafaqimin e dëshmitarëve, si dhe nxjerrjen e provës të listës së thirrjeve telefonike (Shih, paragrafin 15).

24. Gjykata gjithashtu vëren se pretendimet e parashtruesit në lidhje me parregullsitë e pretenduara në procedurën për formimin e Kolegjit të Gjykatës së Apelit janë arsyetuar nga Gjykata Supreme (Shih, paragrafin 16).

25. Në këtë kuptim, Gjykata gjen se çështja e ngritur nga parashtruesi i kërkesës është çështje e ligjshmërisë, jo e kushtetutshmërisë.

26. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërisë).

27. Gjykata Kushtetuese më tej thekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës,* nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih, gjithashtu, Rastin KI70/11, të parashtruesve të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, të Gjykatës Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011). Fakti i thjeshtë se parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës në rastin e tij, nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave të tij të mbrojtura me Kushtetutë. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte pasur mundësi të shumta për të paraqitur rastin e tij në gjykatat e rregullta.

28. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar,* kërkesa nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).

29. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se arsyetimi në lidhje me kërkesën për ballafaqimin e dëshmitarëve, parregullsitë e pretenduara në procedurën për formimin e Kolegjit të Gjykatës së Apelit, si dhe me provën e listës së thirrjeve telefonike, në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë. Pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu vërtetoi se procedura në Gjykatën e Apelit nuk ka qenë e padrejtë apo arbitrare (Shih, rastin *Shub kundër Lituanisë,* nr. 17064/06, GJEDNJ, vendimi i 30 qershorit 2009).

30. Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë shkeljen e pretenduar të të drejtave kushtetuese në të cilat është thirrur parashtruesi i kërkesës.

31. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me rregullat 36 (1) (d) i 36 (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 28 maj 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. dr. Enver Hasani

KI176/14, Parashtrues Sekule Stanković, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 233/2014, i 3 shtatorit 2014.

KI176/14, Aktvendim për papranueshmëri i 15 prillit 2015, publikuar më 5 qershor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë kontestimore, afatshmëria e kërkesëpadisë, mbrojtja e pronës, ndërrim i paluajtshmërisë, kërkesë qartazi e pabazuar*

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin, Rev. nr. 233/2014, të 3 shtatorit 2014 kishte ndryshuar aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, dhe refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit si të paafatshme përkitazi me anulimin e kontratave për ndërrim të paluajtshmërisë.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Gjykata Supreme kishte vendosur në kundërshtim me provat materiale dhe rrjedhimisht, kishte shkelur të drejtën të tij për mbrojtjen e pronës, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për mbrojtjen e pronës, nuk paraqesin bazë kushtetuese të argumentueshme, sepse ngrenë çështje të ligjshmërisë të cilat bien nën juridiksionin e gjykatave të rregullta, dhe për më tepër, Gjykata Supreme kishte arsyetuar përse janë ndryshuar vendimet e gjykatave të instancës më të ulët, dhe pse është refuzuar kërkesëpadia e parashtruesit si e paafatshme. Kërkesa u shpall e papranueshme, si qartazi e pabazuar siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullat 36 (1) d) dhe 36 (2) b) të Rregullores së punës

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI176/14
Parashtruesi
Sekule Stanković
Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 233/2014, të 3 shtatorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Sekule Stanković nga Prishtina, me banim në Medvegjë, Republika e Serbisë, i cili përfaqësohet në Gjykatë nga z. Visar Ahmeti dhe z. Ekrem Agushi, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 233/2014, të 3 shtatorit 2014 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme). Me këtë aktgjykim ishte aprovuar revizioni i znj. V.B. (e paditura) dhe ishte refuzuar kërkesëpadia e parashtruesit (paditësit) për anulimin e kontratës dhe ndërrimin e paluajtshmërive.

3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit, më 8 dhjetor 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar Rev. nr. 233/2014, për shkak të shkeljes së pretenduar të të

drejtave të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Bazë juridike për procedimin e kësaj kërkese është neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 dhe 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 10 dhjetor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 6 janar 2015, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. GJR. KI176/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI176/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu (anëtar) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtare).

8. Më 20 janar 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kësaj kërkese iu dërgua Gjykatës Supreme.

9. Më 15 prill 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 1 gusht 1999, parashtruesi lidhi kontratë me znj. V.B. (e paditura) për ndërrimin e paluajtshmërive, një banese e cila ndodhet në lagjen Dardania SUII/1, hyrja 1, në Prishtinë, me shtëpinë prej 124 m2 (metër katrorë) dhe me oborr prej 12 ari e 17 m2, e përshkruar si ngastër me nr. 1946, në Medvegjë.

11. Më 11 tetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë, dega në Graçanicë (Aktgjykimi, C. nr. 863/11), aprovoi, si të bazuar, kërkesëpadinë e parashtruesit dhe vërtetoi se kontrata për ndërrimin e paluajtshmërive, e lidhur më 1 gusht 1999, ndërmjet parashtruesit dhe të padituës, ishte e pavlefshme dhe pa efekt juridik.

12. Kundër këtij aktgjykimi, e paditura ka ushtruar të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), duke i kundërshtuar të gjitha pikat e aktgjykimit.

13. Më 18 shtator 2013, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi, Ac. nr. 58/2013), refuzoi, si të pabazuar, ankesën e të padituës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës, dega në Graçanicë.

14. Më 12 dhjetor 2013, e paditura ushtroi revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke e kontestuar aktgjykimin si të padrejtë.

15. Më 3 shtator 2014, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Rev. nr. 233/2014), aprovoi, si të bazuar, revizionin e ushtruar nga e paditura, ndryshoi aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, duke refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit si të paafatshme.

16. Për më tepër, Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj e arsyetoi si në vijim: "*Në rastin konkret, bazuar në faktin se kontrata për ndërrimin e paluajtshmërive në mes të ndërgjyqësve nuk është formalizuar në aspektin ligjor, nuk ndodhemi para një kontratë dhe nëse nuk kemi një kontratë ajo as që mund të anulohet, siç gabimisht ka vepruar gjykata e shkallës së parë, por edhe sikur të ekzistonte kontrata legale e vërtetuar në gjykatë, ka kaluar afati për të kërkuar nulitetin e saj, ngase kontrata interne është lidhur me 1. 8. 1999 ndërsa padia në Gjykatë është paraqitur më 10. 11. 2004, ndërsa sipas dispozitës ligjore nga neni 117 i LMD-së, anulimi i kontratës mund të kërkohet në afat prej një viti nga dita e marrjes në dijeni të shkakut të rrezikshmërisë, respektivisht pushimit të dhunës, ndërsa në rastin konkret kanë kaluar 5 vjet e 3 muaj e 9 ditë, andaj edhe pretendimin e cekur në revizion, se padia është e pasafatshme Gjykata Supreme e Kosovës e maur si të bazuar*".

Pretendimet e parashtruesit

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, duke e aprovuar si të bazuar revizionin e ushtruar nga e paditura dhe duke e refuzuar si të pa bazë, kërkesëpadinë e tij për anulimin e kontratës për ndërrimin e paluajtshmërive, ka shkelur të drejtën e tij në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës.

18. Pretendimin e tij për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, parashtruesi e bazon në faktin se: *"Gjykata Supreme në arsyetimin e paraqitur, ndër të tjera paraqet arsye të cilat janë plotësisht në kundërthënie me provat materiale, këtë sepse padia e paditësit në rastin konkret është paraqitur brenda afatit ligjor i cili është paraparë me dispozitat e nenit 117 të LMD-së"*.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata Kushtetuese, para se ta shqyrtojë kërkesën e parashtruar, së pari vlerëson nëse kërkesa e parashtruesit i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Për këtë kërkesë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh: *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

21. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) d) i Rregullores së punës, parasheh:

    (1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

    [...]

    (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

22. Për më tepër, rregulli 36 (2) i Rregullores së punës parasheh:

    (2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

    [...]

    (b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

    [...]

23. Në këtë rast, objekt i çështjes para gjykatave të rregullta ishte kërkesa e parashtruesit përkitazi me anulimin e kontratës për ndërrimin e paluajtshmërive. Gjykata e instancës së parë dhe ajo e instancës së dytë aprovuan kërkesëpadinë e parashtruesit dhe vendosën për anulimin e kontratës. Megjithatë, Gjykata Supreme në bazë të revizionit të ushtruar nga e paditura, i ndryshoi aktgjykimet e gjykatave në fjalë, duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit, nga shkaku se kërkesëpadia ishte ushtruar pas afatit të përcaktuar me ligj.

24. Parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme, duke refuzuar si të paafatshme, kërkesëpadinë për anulimin e kontratës për ndërrimin e paluajtshmërive, shkeli të drejtën e tij në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës.

25. Përkitazi me të drejtën në pronë, neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës përcakton:

> *1. E drejta e pronës është e garantuar.*
>
> *2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
>
> *3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.*
>
> *4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*

26. Sa i përket pretendimit të parashtruesit për shkeljen e të drejtës në pronë, Gjykata bazuar në shkresat lëndës, konsideron se një pretendim i tillë nuk paraqet bazë kushtetuese të argumentueshme, sepse ndërlidhet me çështje të ligjshmërisë të cilat bien nën juridiksionin e gjykatave të rregullta.

27. Gjykata vëren se Gjykata Supreme, sipas detyrës zyrtare, ka vlerësuar ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave të instancës më të ulët dhe ka ardhur në përfundim se aplikimi i ligjit material nga ana e tyre është zbatuar në mënyrë të gabuar. Kjo për faktin se, afati për ushtrimin e kërkesëpadisë, e cila për objekt të çështjes kishte kërkesën për anulimin e kontratës dhe ndërrimin e paluajtshmërive kishte kaluar afatin e paraparë me ligj.

28. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të lëshohet në çështjet e ligjshmërisë, siç është në këtë rast verifikimi i faktit, nëse kërkesëpadia e parashtruesit është ushtruar në afatin e paraparë me ligj.

29. Gjykata rithekson se interpretimi i dispozitave të ligjit material dhe atij procedural është detyrë e gjykatave të rregullta dhe bie nën juridiksionin e tyre.

30. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë, saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur një gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).

31. Gjykata konsideron se, Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj ka arsyetuar se përse është dashur që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen dhe kërkesëpadia e parashtruesit të refuzohet.

32. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih*, mutatis mutandis, Shub vs. Lithuania*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

33. Nga të gjitha arsyet e shtjelluara më lart, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) d), 36 (2) b), dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 28 maj 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. dr. Enver Hasani

KI03/15, Parashtrues Hasan Beqiri, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, API-KZI nr. 2/2011 , të 25 majit 2012.

KI03/15, Vendim për hedhje poshtë të kërkesës i 13 majit 2015, publikuar më 5 qershor 2015

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, barra e provës, dënim me burgim, procedurë penale, mospërmbushje të kritereve procedurale, kërkesë e papranueshme.*

Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, API-KZI nr. 2/2011, të 25 majit 2012. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Gjykata Supreme i ka shkelur atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me Konventat ndërkombëtare, pa iu referuar ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se kërkesa e parashtruesit nuk i ka përmbushur kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejmë, për shkak të moskompletimit të kërkesës me dokumentacion relevant, dhe se barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e kërkesës. Kërkesa u shpall e papranueshme me procedurë të shkurtër ashtu siç përcaktohet me nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit, dhe specifikohet më tej me rregullat 29 (2) (h) dhe 32 (5) të Rregullores së punës.

VENDIM PËR HEDHJE POSHTË TË KËRKESËS
në
Rastin nr. KI03/15
Parashtrues
Hasan Beqiri
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
API-KZI nr. 2/2011, të 25 majit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Hasan Beqiri, i cili ndodhet në vuajtje të dënimit në burgun e Dubravës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, API-KZI nr. 2/2011, të 25 majit 2012 që, sipas informacioneve të parashtruesit, atij i është dorëzuar më 22 dhjetor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohen shkeljet e të drejtave të parashtruesit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 janar 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 9 shkurt 2015, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 19 shkurt 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga i njëjti kompletimin e kërkesës me dokumentacion relevant.

8. Më 13 maj 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës është akuzuar për një vepër penale, është shpallur fajtor dhe është dënuar me burgim. Parashtruesi është duke e vuajtur dënimin në burgun e Dubravës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

10. Parashtruesi pohon se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare, pa specifikuar ndonjë dispozitë kushtetuese konkrete.

11. Parashtruesi pohon se gjykatat e rregullta nuk administruan në mënyrën e duhur provat dhe faktet e rastit, për çfarë edhe cilësimi i veprës penale ka qenë i gabuar.

12. Për më tepër, parashtruesi kërkon që shkelja e pretenduar e të drejtave të njeriut të vlerësohen nga Gjykata, duke u bazuar në pretendimet e tij të ngritura në kërkesë.

Pranueshmëria e kërkesës

13. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe me Rregullore të punës.

14. Kësisoj, Gjykata i referohet dispozitave vijuese të Ligjit:

Neni 22.4 [Procedimi i Kërkesave]

"4. Nëse kërkesa ... nuk është e ... kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të... plotësuar kërkesën (...)".

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar (...)".

15. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 29 (2) [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] dhe rregullit 32 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, që përcakton:

29 (2) "Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

[...]"

32 (5) "Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose ta qartësojë kërkesën (...)".

16. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare, pasi që faktet dhe provat nuk ishin paraqitur në mënyrën e duhur, ku për pasojë kualifikimi i veprës penale ishte i gabuar.

17. Gjykata, bazuar në nenin 22. 4 të Ligjit, kërkoi nga parashtruesi që të dorëzonte vendimin e kontestuar dhe vendimet tjera të gjykatave të rregullta.

18. Megjithatë, brenda afatit të përcaktuar, Gjykata nuk ka pranuar asnjë vendim të gjykatave të rregullta.

19. Gjykata konsideron se nuk mund t'i marrë për bazë pretendimet e parashtruesit, pa dokumente dhe prova materiale mbështetëse, në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit dhe me rregullat 29 (2) (h) dhe 32 (5) të Rregullores së punës.

20. Gjykata më tej konsideron se, parashtruesi nuk ka treguar rast *prima facie,* në mënyrë që Gjykata të vlerësojë përmbushjen e të gjitha kritereve procedurale të pranueshmërisë.

21. Përveç kësaj, Gjykata thekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se barra e përgjegjësisë, bie mbi parashtruesin e kërkesës që nuk ka arritur të përmbushë kriteret procedurale të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

22. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejmë, për shkak të moskompletimit të kërkesës me dokumentacion relevant, ashtu siç kërkohet me nenin 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 29 (2) (h) të Rregullores së punës.

23. Prandaj, Gjykata përfundon se kërkesa me procedurë të shkurtër hedhet poshtë dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 22. 4 dhe 48 të Ligjit, si dhe në pajtim me rregullat 29 (2) (h), 32 (5) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 1 qershor 2015, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. dr. Enver Hasani

INDEKSI I SHPREHJEVE LIGJORE

TERMAT	NUMRI I FAQËS
A	
Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit	162, 163,
Agjencioni Kosovar i Privatizimit	61, 62, 63, 64, 140, 141, 142, 143, 160, 161, 162, 164, 165, 286, 311, 352, 353, 354, 388, 389, 391, 420, 461, 462, 463, 464, 465, 483, 484, 486,
Agjencia Pyjore e Kosovës	385, 386, 388,
Aktgjykim	16, 20, 21, 25, 35, 36, 37, 45, 58, 59, 65, 66, 67, 68, 70, 73, 82, 83, 85, 86, 89, 95, 110, 111, 122, 123, 124, 125, 126, 127, 129, 133, 137, 138, 142, 145, 149, 150, 151, 155, 165, 166, 167, 171, 174, 175, 176, 186, 187, 188, 189, 195, 196, 197, 202, 207, 211, 213, 214, 215, 216, 217, 219, 220, 221, 222, 232, 240, 244, 245, 248, 256, 259, 261, 263, 264, 271, 272, 273, 274, 275, 283, 288, 289, 292, 302, 305, 308, 309, 310, 315, 316, 317, 318, 323, 324, 325, 329, 331, 333, 334, 336, 337, 346, 349, 353, 354, 355, 356, 362, 364, 371, 372, 381, 396, 399, 400, 401, 409, 410, 413, 420, 431, 442, 447, 450, 453, 456, 464, 465, 466, 470, 472, 485, 486, 502, 509, 514, 520, 521, 523, 524, 525, 528, 529, 530,
Aktvendimi	13, 14, 17, 18, 19, 20, 21, 25, 27, 28, 30, 31, 33, 34, 35, 37, 39, 40, 42, 43, 45, 50, 53, 54, 59, 61, 62, 64, 65, 66, 67, 69, 72, 73, 78, 79, 86, 87, 88, 89, 98, 99, 103, 105, 106, 111, 113, 114, 116, 119, 121, 122, 124, 130, 131, 133, 134,

	137, 140, 141, 147, 148, 153, 154, 156, 157, 160, 161, 165, 166, 168, 169, 172, 176, 177, 178, 183, 184, 191, 192, 197, 199, 200, 202, 203, 207, 210, 211, 213, 216, 218, 219, 225, 226, 230, 235, 236, 238, 240, 242, 243, 245, 246, 247, 248, 249, 251, 252, 253, 254, 255, 257, 258, 259, 264, 270, 271, 278, 279, 285, 286, 303, 304, 311, 313, 314, 315, 320, 321, 323, 328, 331, 332, 339, 340, 341, 344, 346, 352, 353, 359, 360, 364, 366, 367, 371, 379, 380, 385, 386, 395, 396, 401, 403, 404, 432, 433, 434, 435, 436, 440, 444, 445, 447, 448, 454, 455, 462, 463, 467, 468, 471, 472, 473, 479, 480, 486, 494, 495, 499, 500, 502, 504, 505, 507, 508, 509, 511, 512, 513, 514, 517, 519, 520, 522, 525, 527, 528,
Amendamentim	288, 289, 291, 292, 293, 294, 299, 301, 302, 409, 410, 411, 412, 413, 415, 416, 417, 418, 419, 420, 421, 422, 423, 424, 425, 426, 427, 428, 429, 430, 431,
Ankesë	15, 23, 28, 30, 42, 50, 55, 58, 65, 66, 72, 81, 82, 91, 113, 116, 123, 133, 143, 150, 156, 160, 163, 164, 171, 179, 180, 202, 203, 213, 216, 221, 222, 226, 228, 229, 230, 231, 232, 237, 238, 244, 254, 260, 261, 273, 274, 281, 282, 285, 306, 323, 324, 328, 339, 342, 345, 354, 355, 361, 368, 369, 388, 389, 390, 398, 399, 401, 419, 434, 435, 436, 450, 464, 470, 501, 502, 503, 511, 513, 514, 521,
Ankesë kushtetuese	19,
Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës	50, 282, 331, 444, 445, 448, 449, 450, 451, 452, 458, 459,
Avokat	89, 141, 161, 178, 184, 186, 192, 211, 219, 236, 271, 282, 304, 306, 340, 360, 367, 396, 433, 444, 452, 454, 491, 512, 528,

B

Barazia para Ligjit 14, 24, 89, 93, 101, 112, 117, 127, 131, 136, 137, 169, 218, 220, 222, 226, 229, 235, 236, 239, 293, 294, 303, 308, 404, 406, 416, 479, 483, 511, 512, 514,

Baza Juridike 15, 22, 29, 35, 41, 49, 54, 63, 79, 90, 100, 106, 112, 132, 142, 149, 154, 162, 170, 179, 185, 193, 201, 212, 220, 227, 236, 244, 253, 260, 267, 272, 280, 290, 305, 314, 322, 341, 354, 361, 368, 375, 381, 387, 397, 405, 411, 434, 446, 459, 464, 469, 476, 481, 490, 496, 500, 506, 513, 521, 529, 536,

D

Deklarata Universale për të Drejta të Njeriut 295, 308, 416, 473, 481, 483,

Deputetët e Kuvendit të Kosovës 281, 283, 284, 288, 289, 290, 291, 293, 294, 299, 300, 301, 411, 453, 456,

DH

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme 65, 66, 71, 143, 163, 164, 479, 483, 485,

E

E Drejta Ndërkombëtare 127, 131, 132, 136, 137, 161, 218, 220, 222, 242, 244, 246, 247, 293, 295, 296, 297,

E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike 483,

E Drejta e Pronës 16, 126, 227, 532,

E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit 39, 88, 89, 93, 96, 258, 259, 263, 278, 280, 283, 285, 381, 403, 404, 406, 432, 433, 463, 499, 500, 503,

E Drejta për Pension 130, 133, 136, 467, 497,

Ex officio 308, 442, 448, 452, 508,

G

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 19, 26, 30, 32, 36, 38, 46, 52, 60, 77, 87, 97, 100, 109, 116, 129, 135, 146, 152, 159, 167, 176, 182, 190, 198, 209, 217, 224, 234, 241, 250, 257, 265, 269, 277, 287, 302, 312, 319, 338, 351, 358, 365, 372, 378, 384, 394, 402, 408, 431, 455, 457, 461, 466, 473, 476, 478, 485, 488, 493, 498, 504, 510, 518, 526, 533, 539,

Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 382,

GJ

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës 13, 14, 17, 19, 20, 25, 26, 27, 32, 34, 37, 40, 46, 48, 51, 52, 54, 58, 59, 62, 63, 68, 69, 77, 78, 79, 87, 89, 96, 97, 98, 99, 102, 104, 106, 109, 111, 118, 123, 124, 125, 127, 128, 130, 131, 137, 138, 140, 141, 146, 147, 148, 152, 153, 154, 157, 158, 160, 161, 166, 167, 168, 169, 176, 177, 178, 182, 183, 184, 187, 188, 189, 190, 191, 192, 196, 197, 198, 199, 200, 205, 207, 208, 210, 211, 216, 217, 218, 219, 224, 225, 233, 235, 236, 240, 241, 242, 243, 248, 249, 251, 252, 253, 256, 257, 258, 259, 264, 266, 267, 269, 270, 271, 276, 278, 279, 282, 284, 285, 286, 288, 289, 303, 304, 310, 311, 313, 314, 318, 320, 321, 327, 332, 338, 339, 340, 348, 351, 352, 353, 357, 359, 360, 364, 365, 366, 367, 370, 372, 373, 374, 376, 377, 378, 379, 380, 381, 384, 385, 386, 393, 395, 396, 401, 402, 403, 404, 408, 409, 410, 426,

	432, 433, 438, 439, 440, 441, 442, 444, 445, 448, 450, 451, 452, 453, 456, 459, 461, 462, 463, 466, 467, 468, 472, 473, 475, 476, 477, 478, 480, 481, 488, 489, 490, 492, 494, 495, 497, 498, 499, 500, 504, 505, 506, 508, 509, 511, 512, 516, 517, 518, 519, 520, 525, 526, 527, 528, 531, 533, 534, 535, 538,
Gjykata Supreme e Kosovës	16, 20, 23, 39, 40, 43, 44, 61, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 72, 74, 81, 82, 83, 85, 86, 88, 93, 94, 96, 114, 130, 134, 137, 147, 148, 150, 153, 156, 157, 168, 169, 171, 172, 173, 174, 175, 180, 183, 186, 191, 194, 197, 202, 203, 210, 211, 214, 215, 216, 218, 219, 221, 222, 235, 238, 239, 240, 245, 251, 255, 256, 258, 261, 262, 263, 270, 274, 275, 303, 304, 306, 307, 308, 311, 313, 314, 315, 316, 317, 318, 320, 325, 326, 327, 329, 330, 331, 333, 334, 335, 336, 337, 339, 343, 346, 347, 349, 350, 359, 362, 364, 366, 369, 370, 375, 376, 385, 389, 390, 391, 393, 395, 396, 398, 399, 400, 401, 435, 467, 468, 470, 471, 483, 486, 511, 512, 514, 516, 519, 522, 524, 525, 527, 528, 530, 531, 532, 533, 534,
Gjykata e Apelit e Kosovës	23, 27, 30, 40, 42, 53, 56, 57, 58, 59, 78, 83, 84, 85, 92, 110, 116, 121, 124, 125, 133, 134, 156, 157, 179, 180, 185, 188, 199, 203, 204, 206, 210, 211, 213, 214, 215, 225, 229, 231, 238, 254, 261, 274, 275, 324, 325, 328, 330, 338, 345, 349, 352, 355, 361, 369, 390, 398, 432, 436, 470, 502, 514, 516, 521, 529, 530,
Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)	45, 58, 59, 82, 86, 95, 96, 117, 122, 125, 126, 127, 137, 138, 145, 151, 166, 167, 176, 188, 189, 196, 197, 207, 208, 212, 216, 217, 223, 232, 440, 472, 478, 504, 517, 525, 533,
Gjykata e Qarkut në Gjilan	171,
Gjykata e Qarkut në	397, 398,

Mitrovicë	
Gjykata e Qarkut në Prishtinë	149, 150, 193, 202, 244, 245, 306, 307, 308, 315, 317, 342, 343, 435, 436,
Gjykata e Qarkut në Pejë	15, 16, 185, 186, 188, 189, 221,
Gjykata e Qarkut në Prizren	323, 377,
Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë	355, 323,
Gjykata Komunale në Viti	227, 228,
Gjykata Komunale në Gjilan	29, 170, 173, 513,
Gjykata Komunale në Ferizaj	254, 255, 315, 379, 380, 382, 383,
Gjykata Komunale në Istog	15, 16,
Gjykata Komunale në Prishtinë	65, 66, 67, 68, 72, 73, 110, 114, 121, 122, 154, 155, 156, 179, 180, 259, 261, 342, 343, 345, 369, 389, 499, 500, 502, 529,
Gjykata Komunale në Prizren	322, 323,
Gjykata Komunale në Pejë	387, 390, 403, 405,
Gjykata Themelore në Gjilan	28, 29, 30, 228, 469, 470,
Gjykata Themelore në Prishtinë	22, 23, 41, 42, 55, 56, 58, 61, 80, 82, 115, 116, 124, 133, 149, 155, 156, 177, 180, 188, 193, 237, 304, 305, 317, 349, 354, 502,
Gjykata Themelore në Pejë	13, 17, 221, 521,
Gjykata Themelore në Ferizaj	272, 273, 275, 344, 432, 436, 439, 440,
Gjykata Themelore në Prizren	359, 360, 361, 362,
Gjykata Themelore në	210, 213, 214, 395, 396,

Mitrovicë

Gjyqtar 14, 15, 21, 22, 28, 29, 34, 35, 40, 41, 48, 49, 54, 55, 62, 63, 67, 79, 80, 89, 90, 99, 100, 106, 107, 111, 112, 131, 141, 142, 148, 149, 154, 155, 161, 162, 168, 169, 173, 178, 179, 184, 185, 192, 193, 200, 201, 211, 212, 219, 220, 226, 227, 236, 237, 243, 244, 252, 253, 259, 267, 271, 272, 279, 289, 290, 296, 304, 305, 314, 315, 321, 322, 340, 341, 353, 354, 360, 361, 367, 368, 374, 375, 377, 380, 381, 386, 387, 390, 397, 404, 405, 410, 411, 413, 415, 417, 419, 428, 433, 434, 445, 446, 447, 448, 453, 454, 455, 459, 460, 463, 464, 468, 469, 475, 476, 480, 481, 490, 491, 495, 496, 500, 501, 506, 507, 512, 513, 520, 521, 523, 528, 530, 535, 536,

Gjyqtari raportues 19, 39, 46, 60, 77, 97, 104, 109, 129, 152, 159, 167, 190, 209, 220, 224, 250, 265, 269, 287, 291, 319, 338, 351, 358, 378, 384, 394, 402, 408, 411, 441, 454, 455, 474, 476, 478, 488, 493, 498, 504, 510, 518, 526, 533, 537, 539,

I

Inter alia 13, 20, 27, 39, 50, 53, 58, 78, 81, 83, 91, 110, 138, 197, 207, 216, 248, 284, 295, 300, 310, 317, 329, 355, 401, 422, 516, 525,

J

Juridiksion i Gjykatës Kushtetuese 108, 288, 291, 292, 377, 378, 412, 423,

Juridiksion i Gjykatave të Rregullta 58, 196, 332,

K

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Republikës së 113, 114, 388,

Kosovës	
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	296, 404, 405, 406, 407,
Këshilli Prokurorial i Kosovës	297,
Këshilli Kushtetues i Francës	300,
Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut	18, 59, 95, 113, 114, 115, 123, 138, 167, 197, 208, 216, 240, 248, 256, 264, 276, 310, 350, 393, 401, 472, 516, 525, 533,
Komisioni për Emërim i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	403,
Komisioni Disiplinor i Agjencisë Pyjore të Kosovës	388,
Komisioni për Ankesa i Agjencisë Pyjore të Kosovës	389,
Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)	260, ,262,
Kodi Penal i Kosovës (KPK)	22, 23, 150, 185, 186, 194, 222, 226, 246, 248, 273, 306, 307, 308, 309, 315, 362, 364, 397, 398, 442, 522,
Kodi i Procedurës Penale të Kosovës	23, 150, 194, 307, 397, 399,
Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK)	362,
Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme	62, 67, 69, 73, 74, 161, 164, 166, 479, 482, 485,
Kolegji i Apelit i Gjykatës Supreme të Kosovës	160,

Kolegji shqyrtues	15, 22, 29, 35, 41, 49, 55, 63, 64, 77, 80, 90, 100, 107, 112, 132, 142, 149, 155, 162, 170, 179, 185, 190, 193, 201, 212, 220, 221, 227, 237, 244, 253, 260, 268, 272, 280, 291, 305, 315, 322, 341, 354, 15, 22, 29, 35, 41, 55, 64, 77, 80, 90, 100, 107, 112, 132, 142, 149, 155, 162, 361, 368, 375, 381, 388, 397, 405, 411, 434, 444, 447, 454, 455, 464, 469, 476, 482, 487, 491, 496, 501, 507, 513, 521, 529, 536,
Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës	298,
Kompensim	49, 50, 110, 111, 115, 117, 122, 123, 124, 126, 127, 128, 172, 232, 334, 339, 342, 343, 344, 346, 350, 352, 354, 355, 379, 380, 381, 382, 383, 435, 437, 439, 479, 482, 487, 499, 532,
Komuna e Ferizajt	252, 271,
Komuna e Istogut	14, 219,
Komuna e Fushë Kosovës	259,
Komuna e Gjakovës	304,
Komuna e Gjilanit	169, 470, 512,
Komuna e Klinës	48,
Komuna e Kaçanikut	433, 435, 436, 437, 439,
Komuna e Skënderajt	396,
Komuna e Gracanicës	76, 236,
Komuna e Mitrovicës	81, 82,
Komuna e Rahovecit	374,
Komuna e Prishtinës	56, 58, 156, 243, 355, 475, 499, 501, 502, 503,
Komuna e Prizrenit	106, 141,

Komuna e Podujevës 42, 178,

Kontrata e Punës 55, 80, 115, 123, 170, 172, 465,

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut 23, 35, 36, 112, 117, 118, 121, 122, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 136, 137, 144, 162, 174, 184, 201, 204, 206, 208, 214, 226, 229, 230, 231, 232, 233, 271, 305, 308, 310, 311, 317, 327, 332, 356, 363, 364, 368, 370, 376, 377, 404, 406, 407, 422, 481, 483, 486, 487,

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj 192, 195, 212, 214, 295,

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas 295,

Kryeministri i Kosovës 114, 282, 290, 411, 449,

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës 288, 289, 291, 292, 302, 409, 410, 412, 413, 431,

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese 15, 19, 26, 32, 38, 46, 52, 60, 77, 88, 97, 104, 129, 132, 139, 152, 159, 167, 176, 182, 198, 209, 217, 224, 234, 241, 250, 257, 265, 269, 277, 287, 302, 312, 319, 322, 338, 351, 358, 372, 378, 384, 394, 402, 408, 432, 441, 449, 455, 457, 466, 473, 478, 488, 493, 498, 504, 510, 518, 526, 529, 533, 539,

Kryetari i Gjykatës së Apelit 523,

Kuvendi i Republikës së Kosovës 288, 415, 430, 456,

L

Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës 29, 100, 112, 132, 142, 149, 155, 162, 170, 185, 193, 201, 212, 220, 227, 237, 244, 253, 260, 268, 272, 280, 290, 305, 315, 322, 341, 354, 361, 368, 375, 381, 387, 397, 405, 411, 434, 445, 459, 464, 469, 476, 481, 490, 496, 501,

	507, 513, 521, 529, 536,
Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë	418,
Ligji për Dhomën e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës	73, 485, 486,
Ligji për Konflikte Administrative	84,
Ligji për Gjykatat	17, 82, 114, 405, 420, 485,
Ligji për Policinë	91, 99,
Ligji për lojërat e fatit	99, 100, 101,
Ligjit kundër diskriminimit	145,
Ligji për Marrëdhëniet Detyrimore	204,
Ligji për Procedurën Kontestimore	207, 238, 514,
Ligji për Fondin Pensional të Kosovës	135,
Ligji për Procedurën Përmbarimore	118,
Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	119
Ligji i Punës	251

M

Masa e Përkohshme	76, 77, 189, 351, 487,
Mjetet Juridike (e Drejta **për Mjete Juridike)**	18, 51, 57, 64, 71, 73, 85, 86, 95, 102, 120, 121, 125, 144, 158, 165, 181, 187, 197, 205, 230, 239, 246, 247, 266, 268, 284, 305, 309, 317, 327, 348, 356, 363, 370, 379, 382, 383, 389, 406, 407, 439, 452, 471, 484, 485, 499, 503, 504,
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	385, 386, 390,
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	55, 501
Ministria e Punëve të Brendshme	90, 92,
Ministria e Financave	98, 99,
Ministria për Komunitete dhe Kthim	111, 117,
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	133,
Ministria e Drejtësisë	90,
Mutatis mutandis	19, 45, 46, 58, 59, 86, 95, 96, 125, 127, 138, 145, 166, 175, 176, 182, 188, 189, 207, 208, 240, 241, 248, 276, 318, 328, 331, 332, 333, 350, 364, 371, 372, 383, 393, 407, 440, 478, 504, 517, 533,

N

Ndalimi i Diskriminimit	131, 132, 136, 137, 201, 204,
Nule (Null)	325, 336,
Ndërmarrje Shoqërore	76, 143, 354, 381,

O

Organizatë joqeveritare (OJQ) 475,

P

Palë e Autorizuar 98, 102, 103, 120, 121, 205, 247, 278, 282, 284, 287, 291, 309, 320, 331, 442, 449, 471, 494, 498,

Parashtruesi i kërkesës 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 21, 27, 28, 29, 31, 34, 35, 36, 37, 39, 40, 41, 43, 44, 48, 49, 50, 51, 53, 54, 55, 57, 58, 59, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 86, 87, 88, 89, 90, 92, 93, 94, 95, 96, 99, 120, 131, 132, 133, 135, 136, 137, 138, 141, 142, 143, 144, 145, 148, 149, 150, 154, 155, 157, 158, 161, 162, 163, 164, 165, 166, 167, 169, 173, 174, 178, 181, 184, 185, 186, 187, 188, 189, 192, 197, 200, 201, 202, 203, 204, 205, 206, 207, 208, 211, 213, 214, 215, 216, 217, 219, 227, 228, 229, 230, 231, 232, 236, 237, 238, 239, 240, 241, 242, 243, 245, 246, 247, 249, 252, 253, 255, 256, 257, 259, 260, 261, 262, 263, 264, 267, 268, 270, 271, 273, 274, 275, 276, 279, 282, 286, 289, 290, 304, 305, 306, 307, 308, 309, 310, 311, 312, 313, 314, 316, 317, 318, 320, 321, 322, 323, 324, 325, 326, 327, 328, 329, 330, 331, 332, 333, 334, 336, 337, 340, 342, 343, 345, 346, 347, 348, 349, 350, 353, 354, 355, 356, 360, 361, 362, 363, 364, 367, 368, 369, 370, 371, 372, 374, 376, 382, 383, 386, 388, 389, 391, 392, 396, 398, 399, 400, 401, 404, 405, 407, 410, 411, 412, 433, 439, 445, 448, 444, 450, 459, 460, 462, 463, 464, 465, 467, 468, 469, 471, 475, 476, 477, 480, 482, 486, 487, 490, 495, 496, 497, 498, 499, 500, 501, 502, 503, 504, 506, 512, 513, 515, 516, 520, 523, 524, 525,

527, 528, 530, 531, 534, 535, 536, 537,

Pretendimet e parashtruesit 17, 24, 30, 36, 43, 50, 57, 67, 83, 93, 96, 101, 107, 117, 135, 144, 150, 157, 163, 164, 168, 173, 180, 186, 188, 194, 204, 206, 208, 214, 215, 216, 222, 229, 238, 245, 255, 262, 274, 275, 282, 303, 308, 310, 316, 320, 326, 347, 355, 362, 369, 371, 377, 382, 391, 392, 399, 400, 406, 437, 448, 460, 465, 471, 477, 483, 497, 503, 508, 514, 516, 517, 523, 524, 527, 530, 536, 538,

Pranueshmëria e kërkesës 17, 18, 24, 31, 36, 43, 50, 57, 66, 73, 76, 85, 94, 96, 102, 108, 112, 120, 121, 136, 144, 151, 157, 165, 167, 173, 181, 182, 187, 189, 195, 205, 215, 223, 229, 239, 241, 246, 255, 262, 268, 274, 276, 291, 311, 316, 318, 327, 333, 338, 348, 350, 351, 356, 363, 364, 370, 371, 372, 377, 382, 392, 393, 400, 406, 412, 438, 440, 441, 449, 454, 460, 465, 477, 484, 487, 492, 497, 503, 508, 515, 523, 531, 537, 538,

Presidenti i Republikës së Kosovës 282, 284, 331, 344, 448, 449,

Prokurori i Shtetit 14, 23, 65, 186, 199, 203, 204, 206, 296, 297, 435, 482, 483, 485,

Prokurori Publik 61, 68, 69, 74, 83, 221, 344,

Procedura në Gjykatën Kushtetuese 15, 22, 29, 35, 41, 49, 55, 64, 80, 90, 100, 107, 112, 132, 142, 149, 155, 162, 170, 179, 185, 193, 201, 212, 227, 237, 253, 260, 268, 272, 280, 305, 322, 341, 354, 361, 368, 387, 397, 405, 434, 464, 469, 476, 491, 496, 501, 521, 529, 536,

Prima facie 44, 61, 76, 77, 121, 174, 181, 189, 190, 208, 249, 274, 275, 309, 328, 339, 348, 349, 351, 363, 371, 392, 400, 440, 467, 471, 472, 479, 487, 488, 515, 517, 524, 531, 538,

Q

Qeveria e Republikës së Kosovës 99, 131, 134, 182, 238, 239, 280, 281, 282, 284, 288, 292, 293, 294, 299, 300, 301, 318, 320, 328, 331, 383, 407, 409, 410, 411, 412, 414, 415, 417, 419, 422, 423, 426, 427, 432, 437, 444, 449, 453, 475, 504.

R

Ratione Temporis 69,

Ratione Materiae 61, 75, 105, 108, 225, 231,

Res Judicata 117, 456,

Rendi juridik i Kosovës 86, 318, 328, 383, 407, 504,

Revizioni 16, 40, 43, 44, 83, 93, 135, 156, 171, 174, 235, 239, 240, 252, 255, 261, 324, 325, 326, 333, 334, 335, 337, 339, 343, 346, 350, 367, 385, 390, 468, 471, 486, 487, 516, 528, 530, 531,

Rigjykim 12, 61, 66, 68, 149, 152, 182, 190, 191, 210, 302, 319, 387, 389, 395, 498.

S

Seancë 52, 59, 70, 73, 87, 92, 104, 108, 128, 146, 167, 186, 190, 202, 204, 222, 230, 269, 273, 278, 279, 281, 282, 283, 301, 334, 338, 345, 346, 351, 365, 372, 402, 408, 430, 441, 443, 491, 492, 498, 504, 522, 526,

Sindikata e Pavarur 140, 143, 379, 380, 383,

Sistemi Gjyqësor 63, 67, 192, 194, 203, 397, 399, 400, 409, 413, 416, 418, 419, 420, 421, 422, 423, 424, 425, 427, 486, 521, 523, 524.

U

UNMIK 133, 134, 135, 136, 163, 164, 171, 172, 228, 388, 391, 464, 483.

V

Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit 21, 34, 79, 141, 148, 161, 169, 184, 192, 219, 259, 271, 321, 353, 360, 386, 396, 463, 520, 528,

Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit 28, 40, 48, 54, 111, 131, 154, 178, 201, 236, 243, 252, 314, 340, 433, 470, 500,

Vendimi i kontestuar 14, 21, 28, 30, 34, 38, 42, 54, 62, 79, 89, 99, 106, 111, 121, 131, 140, 141, 145, 148, 154, 161, 167, 169, 178, 184, 189, 192, 195, 1200, 211, 219, 226, 236, 242, 243, 252, 259, 267, 271, 279, 304, 314, 320, 321, 326, 327, 329, 337, 340, 341, 353, 360, 364, 367, 374, 380, 386, 389, 396, 404, 431, 448, 463, 468, 475, 480, 490, 495, 500, 506, 512, 520, 528, 535,

Z

Zyra e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës 306

INDEKSI I NENEVE TE KUSHTETUTËS

Neni	Titulli/Emërtimi	Vendimi/Numri i faqes
	KAPITULLI I DISPOZITAT THEMELORE	
1	**Përkufizimi i Shtetit**	416
3	**Barazia Para Ligjit**	39, 40, 43, 44, 101, 168, 169, 173, 174, 218, 222, 235, 236, 239, 294, 404, 406, 416
4	**Forma e Qeverisjes**	320, 330
7	**Ndarja e Pushtetit Vlerat**	101, 292, 294, 404, 406
10	**Ekonomia**	320, 330
18	**Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare**	416
	KAPITULLI II TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE	
21	**Parimet e Përgjithshme**	14, 24, 101, 292, 322, 341, 354, 357, 387, 481
22	**Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare**	161, 164, 242, 295, 416, 423, 425
23	**Dinjiteti Njerëzor**	131, 136, 137
24	**Barazia Para Ligjit**	14, 24, 89, 93, 96, 101, 112, 117, 131, 136, 137, 226, 229, 303, 308, 311, 404, 406, 416, 483, 511, 512, 514
29	**E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë**	24
31	**E Drejta për Gjykim të**	14, 24, 59, 63, 67, 69, 81, 84, 89, 93, 101,

	Drejtë dhe të Paanshëm	112, 117, 121, 128, 129, 131, 136, 137, 160, 161, 164, 168, 169, 173, 174, 177, 178, 181, 184, 187, 198, 194, 201, 218, 222, 225, 226, 229, 231, 233, 243, 246, 271, 303, 308, 310, 317, 321, 326, 339, 341, 347, 352, 356, 366, 368, 369, 376, 395, 397, 399, 433, 483, 520, 523, 524
32	**E Drejta për Mjete Juridike**	14, 24, 63, 67, 69, 177, 180, 211, 214, 225, 226, 229, 327, 339, 341, 347, 366, 368, 369, 404, 406, 484
33	**Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Çështjet Penale**	303, 308, 311
34	**E Drejta për të mos u Gjykuar dy Herë për të Njëjtën Vepër**	243, 246, 303, 308, 311, 483
45	**Të drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes**	416
46	**Mbrojtja e Pronës**	28, 30, 63, 67, 69, 121, 126, 129, 131, 136, 137, 161, 225, 226, 229, 327, 332, 337, 511, 512, 515, 527, 529, 530, 532
49	**E Drejta e Punës Ushtrimit të Profesionit**	89, 93, 96, 168, 170, 173, 174, 258, 259, 262, 263, 278, 280, 283, 284, 285, 381, 404, 406, 433, 463, 500, 503
53	**Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut**	15, 24, 89, 93, 101, 108, 121, 332
54	**Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave**	15, 63, 67, 69, 101, 112, 117, 125, 126, 128, 129, 201, 226, 229, 278, 280, 283, 284, 285, 339, 341, 347, 366, 368, 369, 395, 397, 399, 485
55	**Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore**	258, 259, 262, 263, 423, 425
56	**Të Drejtat dhe Liritë Themelore Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme**	425

KAPITULLI IV
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

65	**Kompetencat e Kuvendit**	416, 448
71	**Kualifikimet dhe Barazia Gjinore**	296
80	**Miratimi i Ligjeve**	278, 280, 282, 284

KAPITULLI V
PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

84	**Kompetencat e Presidentit**	448

KAPITULLI VI
QEVERIA E REPULIKËS SË KOSOVËS

96	**Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve**	292
101	**Shërbimi Civil**	296

KAPITULLI VII
SISTEMI I DREJTËSISË

102	**Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor**	63, 67, 69, 109, 356, 397, 399, 416, 521, 523, 524
103	**Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave**	63, 67, 69, 416, 419
104	**Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve**	296, 416
108	**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**	296

109	**Prokurori i Shtetit**	296
110	**Këshilli Prokurorial i Kosovës**	297

KAPITULLI VIII
GJYKATA KUSHTETUESE

113.1	**Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara**	98, 102, 278, 285, 327, 418, 449, 477, 494, 497
113.5		284
113.7		15, 19, 22, 35, 37, 39, 40, 41, 43, 44, 46, 48, 50, 52, 54, 57, 78, 79, 85, 87, 90, 95, 100, 102, 103, 104, 105, 106, 108, 112, 120, 128, 132, 138, 142, 146, 149, 152, 154, 158, 165, 167, 170, 176, 177, 179, 181, 182, 185, 187, 190, 198, 201, 205, 208, 212, 217, 220, 224, 227, 230, 236, 239, 241, 244, 246, 249, 253, 267, 272, 280, 284, 286, 305, 309, 312, 313, 316, 318, 322, 332, 338, 341, 348, 354, 357, 361, 363, 368, 372, 375, 377, 379, 381, 382, 383, 384, 387, 393, 403, 405, 408, 434, 438, 464, 469, 471, 473, 476, 478, 481, 484, 488, 490, 496, 499, 503, 504, 507, 513, 518, 521, 536, 539
113.8		285
113.9		288, 289, 290, 291, 292, 301, 409, 410, 411, 412, 430
116	**Efekti Juridik i Vendimeve**	33, 36, 50, 129, 373, 378, 442, 456, 489, 492, 505, 508

KAPITULLI XII
INSTITUCIONET E PAVARURA

134	**Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit te Popullit**	416, 451, 452

KAPITULLI XIII
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

144	**Amendamentimi**	288, 289, 290, 301, 409, 410, 411, 412, 430
145	**Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm**	131, 136, 137

KAPITULLI XIV
DISPOZITAT KALIMTARE

161	**Transicioni i Institucioneve**	409, 410
162	**Hyrja në Fuqi**	424, 425, 426, 427, 428, 429